



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1438/19 Prot

Tiranë, më 31 /07/2019

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Drejtuar: Zj. Frida KRIFCA
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT
BUJQËSOR DHE RURAL

Për Dijeni: Z. Bledi ÇUÇI
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural,, në bazë të programit të auditimit nr.1438/4, datë 28.02.2019, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për periudhën e veprimtarisë nga data *01.01.2017 deri në 31.12.2018*, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, u evidentuan në përgjithësi, zbatimi i tyre dhe nuk u konstatuan devijime materiale të kuadrit ligjor respektiv, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe **Vendimin nr.23, datë 30.07.2019, të Kryetarit të KLSH-së**, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Nga **auditimi i pasqyrave financiare**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit Financiar, për sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të

raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimet, banka, janë përfshirë në paqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar.

Opinion i pakualifikuar Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200², si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH-së, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural në datën 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018.

Baza mbi opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur në vlerësimin e riskut dhe të materialitetit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar. Auditimi i përputhshmërisë në AZHBR është kryer së bashku me pasqyrat financiare dhe audituesi nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale.

Opinion i pakualifikuar³

Nën gjykimin e grupit të auditimit, në lidhje me auditimin e përputhshmërisë shpreh një konkluzion/opinion pakualifikuar, ku në gjykimin profesional, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk kanë devijime materiale

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar-pa rezerve kur në gjykimin profesional të tij audituesi nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organikës së AZHBR-së, u konstatua se struktura organike e këtij institucioni ka ndryshuar dy herë për një periudhë një-vjeçare, e cila korrespondon me periudhën në auditim 2017-2018, konkretisht sipas Urdhrit nr. 190, datë 06.11.2017 “ Miratimi i Strukturës dhe Organikës se Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), numri i punonjësve ndryshoi nga 123 në 133 dhe sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018 “ Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural” duke ndryshuar nga 133 në 169 punonjës . Gjendja faktike numri i punonjësve është 129, pra ka një mungesë prej 40 punonjësish. Procedura e ristrukturimit të organikës së AZHBR-së, rritja e numrit të punonjësve nga 133 në 169, krijimi i vendeve vakant si rezultat i lirimit të punonjësve civilë shoqëruar kjo edhe me mos emërimin në kohë të punonjësve të rinj nga DAP, rezultat i procedurave të rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike, ka bërë që shumë sektorë dhe drejtori për një periudhë të punojnë me staf të reduktuar në numër, disa herë pa strukturat drejtuese (drejtorët dhe përgjegjësit), duke krijuar mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat funksionale.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 29-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: AZHBR ti kërkojë DAP, për të filluar procedurat e rekrutimit për plotësimin e menjëhershme të vendeve vakante, veçanërisht të specialistëve të fushës së inxhinierisë së ndërtimit, mekanike dhe elektrike, me qëllim përdorimin sa më eficient të burimeve njerëzore në plotësimin e vizionit të këtij Institucioni që është fokusimi në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përftohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” u konstatua se, komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një ndarje të tyre sipas zërave: vlera total për pajisje informatike, vlera total për vegla pune, mobilieri e pajisje zyre, kondicioner, etj sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit, por i ka grupuar në total në dy zëra “inventar ekonomik” dhe “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Veprime në kundërshtim me pikat 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

(Trajtuar më hollësisht në faq40-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga Komisioni i inventarizimit të merren masa që gjatë inventarizimit të aseteve të bëhet ndarja e aktiveve sipas zërave, me qëllim krahasimin e gjendjes fizike me gjendjen në kontabilitet dhe për diferencat e konstatuara sipas zërave nëse do të këtë, të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se komisioni, për të dy vitet objekt auditimi ka konstatuar diferenca, për të cilat nuk janë dhënë sqarime të mëtejshme se kush janë personat përgjegjës apo nga kusht është shkaktuar mungesa. Për diferencat e konstatuara, komisioni

nuk ka përpiluar një procesverbal, nëpërmjet të cilit vihet në dijeni instancat përkatës, për marrjen e masave të mëtejshme për kompensimin apo sistemimin e diferencave të konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 85, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Të ngrihet një komision i veçanta, për të bërë verifikimin e diferencave të konstatuara nga komisionet e mëparshme të inventarizimit dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse të personave që kanë në ngarkim vlerat materiale, duke i reflektuar diferencat e konstatuara dhe në kontabilitet. Më pas institucioni të marrë masat që për diferencat e konstatuara të vlerave materiale të behet kompensimi i vlerave të tyre duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme të cilat kanë sjell rritje të vlerës së tyre, si dhe vlerën e amortizimit të akumuluar.

Brenda datës 30.09.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 në zërin “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 202) “Studime dhe kërkime” në vlerën prej 21,674,642 lekë, e cila përbëhet nga shuma prej 295,800 lekë të projektit ish- 2KR dhe në shumën prej 21,378,842 lekë të dy kontratave për “Studim për mizën e ullirit” dhe “Projekti për ndërtimin e zyrave të AZHBR-së në Fushë Krujë” lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat nuk gjenden kontratat e lidhura. Në SKK nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” dhe SNK 38 “Aktive jo-materiale” thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore. Aktivi në fjalë nuk është më në funksion, si rrjedhojë nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivit jo-material, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 46-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga AZHBR, të merren masat që në bashkëpunim me MBZHR dhe Ministrinë e Financës, të analizojnë gjendjen “Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuar” dhe në varësi të rezultateve të analizës të bëhet nxjerrjen jashtë përdorimi dhe çregjistrimin e tyre nga kontabiliteti, për të bërë të mundur një paraqitje sa më reale të pozicionit financiar të institucionit.

Brenda datës 31.12.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, për vitin buxhetor 2017 dhe 2018 AZHBR-ja, më së shumti ka realizuar procedura me blerje të vogla, ndërsa në lidhje mbi procedurat e prokurimeve publike, për zërin 231 (investime) dhe zërin (602) mallra e shërbime me vlera të lartë, pjesa më e madhe tyre janë realizuar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) ose nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si Autoritet Kontraktor u konstatua se institucioni nuk ka njësi të prokurimit, si strukturë permanente, por është krijuar, rast mbas rasti në momentin që ka pasur procedura. Gjithashtu u konstatua se, anëtarët të cilët janë vendosur nga Titullari i AK nuk janë specialist të fushës dhe nuk janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme pranë Agjencia e Prokurimeve Publike (APP). Veprime në kundërshtim me Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Manuali për MFK nr. 108 datë 17.11.2016, pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 67-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Rekomandim: AZHBR të marrë masa që në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimeve Publike, të bëjë një plan masash për trajnimin e anëtarëve të cilët do jene pjesë e komisioneve të prokurimeve, duke rritur cilësinë e procedurave me të gjitha hallkat e atyre, për të pasur efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet me fondet të financuara nga buxheti i Shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillim bujqësor dhe rural për vitin 2018, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillim rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", konkretisht për Masën 12 (Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit), ku citohet: "Masa e financimit është parashikuar 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika ose jo më shumë se 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.", u konstatua se:

Duke përdorur metodën krahasimore midis mesatares së çmimeve të preventivave ofertave të përfituesve, me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", rezultoi se, ka diferenca në vlerë. Kështu, përfituesit e serrave diellore, kanë paraqitur preventiva të rritura, afërsisht 43 % të vlerës së investimit total për tre zëra kryesorë (plasmas serrash dhe aksesore, konstruksione metalike dhe betonin e gropave).

Për sa më sipër, duke pasur parasysh faktin se AZHBR, financon nga Buxheti i shtetit jo më shumë se 50% e vlerës së investimit, pra rreth 21.5% e vlerës së subvencionit, është financiar në mungesë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike sipas manualeve teknike shtetërore, por në referim të preventivave ofertues të mbështetura në çmimet e tregut vendas ose të huaj.

Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, Kreu IIX "Kriteret specifike dhe dokumentacioni për masat mbështetëse", pika 2, ku nuk është kërkuar referimi i çmimeve mbështetur në manual për Masën 12, duke hequr kërkesën që "...çmimet e preventivit konkurrues nuk duhet të jetë i vulosur dhe i firmosur nga inxh. ndërtimi i liçensuar.", siç është kërkuar për masat e tjera.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Rekomandim: Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, gjatë hartimit dhe miratimit të akteve normative ligjore dhe nënligjore, për skemat e masave mbështetëse kombëtare që realizohen nëpërmjet investimeve ndërtimore, të vendosin kriteret specifike dhe dokumentacion të unifikuar dhe të standardizuar, të cilat nuk duhet të ndryshojnë nga viti në vitin buxhetor të radhës. Me qëllim për mirëpërdorimin e fondeve publike në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit, hartimi i preventiveve dhe llogaritja e vlerës së financimit të behet sipas manualeve teknike me çmimeve të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM. Për ato zëra dhe çmime që nuk përfshihen në këto manuale të hartohen analizat teknike të të çmimeve mbështetur në normativat teknike dhe në çmimet tregut.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural, të përcaktuara sipas VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018” dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i ndryshuar, si dhe auditimet e kryera në terren nga grupi i auditimit, u konstatua se, për masat mbështetëse të skemave kombëtare të zhvilluara nëpërmjet investimeve ndërtimore konkretisht për masat:

- Masa 20 “*Ambiente grumbullimi dhe frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore*”
- Masa 21 “*Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime*”
- Masa 22 “*Linja përpunimi/makineri për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë*”
- Masa 23 “*Linja selektimi, paketim, ambiente për fruta, perime dhe bimë medicinale*”
- Masa 32 “*Ndërtimin e thertoreve dhe pajisjeve*”
- Masa 34 “*Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe makineri dhe pajisje*”
- Masa 44 “*Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin të turizmit rural*”
- Masa 45 “*Mbështetje për investime në agroturizëm*”
- Masa 51 “*Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve*”,

Në situacionet përfundimtare të punimeve është përdorur termi “*e pamatshme për punimet e maskuara*”. Grupet e monitorimit të AZHBR-së kryejnë, sipas manualit të kontrollit vetëm dy kontrolle (një në fillim para lidhjes së kontratës dhe një në fund të përfundimit të investimit). Grupet e kontrollit përbëhen nga inspektorë kontrolli që kanë profil jurist dhe ekonomist, dhe jo profil teknik (inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/ mekanik, inxh/elektrik, arkitekt etj), ndonëse nga AZHBR me disa shkresa nr.304 prot, datë 27.07.2018 dhe nr.3041 prot datë 27.07.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike është kërkuar rekrutimi i punonjësve për këto pozicione pune, të cilat ende janë vakante.

Kështu, specialistët të monitorimit, mbështeten vetëm në librezat e masave duke i marrë të mirëqena punimet e pamatshme, pa i bërë një analizë profesionale. Mbi punimet ndërtimore, përfituesit e subvencionit, e përcaktojnë vetë mbikëqyrësin e punimeve, i cili miraton volumet dhe projektin e azhurnuar.

Nga auditimi i dosjeve të përfituesve të subvencionit, konstatohet se mbikëqyrësi i punimeve realizon vetëm librezën e masave dhe asnjë dokumentacion tjetër mbi punimet si,(procesverbalet e punimeve të maskuara, ditarin e punimeve, ndryshimet e projektit, testet e kontrollit, certifikatat e materialeve të përdorura, foto gjatë punimeve etj), duke mos mbajtur asnjë përgjegjësi për punimet mbas përfundimit të investimit, pasi edhe në kontratën e lidhur midis AZHBR dhe përfituesit të subvencionit, nuk është shprehur si detyrim kontraktor, *ekzistenca e një mbikëqyrësi punimesh me licencën përkatëse*, sipas një marrëveshjeje dypalëshe të njohur nga AZHBR.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga AZHBR në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të merren masa, që të plotësohen vendet vakante me specialistë të fushës, nëse kjo nuk realizohet në kohë të shikohet mundësia e hapësirave ligjore për punësimin me kontratë të përkohshme ekspertë të jashtëm të fushës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.2. Rekomandim: Për kontratat e skemave të mbështetjes kombëtare duhet të vendoset një pikë e veçantë, mbi kontraktimin e një mbikëqyrësi me licence, në përputhje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se, propozimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, drejtuar Këshillit të Ministrave, për miratimin e VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018” dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i ndryshuar, nuk është realizuar paralelisht me miratimin Buxhetit vjetor që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë brenda datës 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke mos qenë në koherencë me vitin bujqësor por me vitin kalendarik buxhetor. Kjo, ka sjellë penalizmi e aplikantëve fitues për masat mbështetëse të skemave kombëtare, duke shkurtuar në maksimum kohën e ndërtimit të investimeve për periudhën 2-3 muaj.

8.1. Nga auditimi, u konstatua se, Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR, nuk ka strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat kryesore për masat mbështetëse (orientimi, treguesit etj) si dhe roli i AZHBR-së duket thjesht si ekzekutues i fondeve që duhen shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018” dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” , të cilat kanë pësuar ndryshime të shpeshta buxhetore, duke sjellë uljen e vlerës së parashikuar për skemat mbështetëse kombëtare.

8.2. Nga auditimi i procedurave të dhënies së subvencionet për skemat mbështetëse kombëtare kryesisht investime, numri i dokumenteve për të plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe kohore për aplikantët, për pasojë kemi ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare. E kundërta ka ndodhur për masa direkte mbështetëse, ku në vitin 2018, për herë të parë, është përdorur aplikim me 0 dokumente, duke ulur numrin e dokumenteve për fermerin, por duke shtuar volumin e punës dhe kosto administrative të larta, të administratës të AZHBR-së.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR-në, të marrin masat e nevojshme, për të realizuar në kohë propozimin dhe miratimin e kornizës ligjore dhe nënligjore, për hartimin e strategjisë, për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten, për përcaktimin e masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke rritur mundësinë që fondi i alokuar për skemat të mos pësojë ndryshime të shpeshta dhe të konsiderueshme gjatë vitit dhe të shtojë në këtë mënyrë aftësinë për të përthithur të gjitha fondet që akordohen nga Buxheti i shtetit për bujqësinë, në favor të përfituesve bujqësorë shqiptarë.

8.2. Rekomandim: AZHBR së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të punojnë për arritjen e marrëveshjeve dypalëshe, në mënyrë që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkojnë aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej vetë AZHBR-së , duke patur akses on-line me institucionet që japin këto vërtetime, me qëllim lehtësimin e aplikantit-përfitues, duke ulur e koston financiare dhe kohën fizike për përgatitjen e tyre.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se, nga AZHBR hartimi i kontratave me përfituesit e skemave mbështetëse kombëtare, janë kontrata tip, pa ndryshime nga njëra masë

tek tjetra, duke përcaktuar monitorimin e aktivitetit të detyrueshëm për 5 vite, por nuk dalin të qarta masat konkrete administrative, që duhet të ndërmarrë AZHBR në rastet e mosplotësimeve detyrimeve kontraktore, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9817 datë 22.10.20017 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i ndryshuar, neni 39 (sanksionet) pika 1 citohet se “*Kundravajtjet administrative dënohen me gjobë në masën 30, 000 (tridhjetë mijë) lekë – 40, 000 (dyzet mijë) lekë si dhe kthimin e financimit të përfituar*”.

9.1. Nga auditimi u konstatua se, strukturat e monitorimit të AZHBR-së, janë të pamjaftueshme me burime njerëzore, pasi nuk është e mundur të monitorohen në kohë subvencionet, dhe mos hartimi i një plani monitorimi periodik me objektiva të qarta, ka çuar në mungesë analize të hollësishme, në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e plan-bizneseve të paraqitura nga përfituesit.

Gjithashtu nga auditimit, u konstatua se, mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare), të AZHBR, nga sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, për periudhën 2017-2018, ka ndikuar negativisht në efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomikitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: AZHBR me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave dhe Sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, të hartojnë planin e monitorimit për subjektet e konstatuara me mosplotësimin të detyrimeve kontraktuale për periudhën 2017 dhe 2018, duke verifikuar në terren vazhdimësinë dhe saktësinë e zbatimit të subvencioneve për afatin 5 vjeçar, duke aplikuar penalitete dhe sanksionet sipas rasteve.

9.2. Rekomandim: Nga AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ti propozojë Këshillit të Ministrave, rritjen e numrit të punonjësve për strukturat monitoruese, të cilat duhet të harmonizohen në ndërveprime të përbashkëta me sektorët e tjerë, duke rritur shkallën e profesionalizmit për të arritur qëllimin dhe objektivat e AZHBR-së.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në bazë të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kreu VI, “Bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionet” neni 22, AZHBR krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të Regjistrit të fermës, proces i cili ende nuk është realizuar, ndonëse edhe në kuadër të procesit të aderimit për Bashkimin Evropian, si kusht për Agjencinë e Pagesave, është administrimi dhe funksionaliteti i IACS (Sistemi i Integruar i menaxhimit dhe kontrollit), me komponentë:

1-Regjistri i fermës;

2-LPIS-Sistemi i përcaktimit dhe i klasifikimit të parcelave bujqësore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masat, të fillojë projektin për krijimin dhe zhvillimin e Regjistrit të fermës, duke aplikuar të gjitha hapat ligjorë për një data basë të konsoliduar kombëtar dhe përfshirjen e të gjithë aktorët, për të përmbushur detyrimet ligjore sipas Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe Planit Kombëtar për Integrim Evropian.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve me përzgjedhje në AZHBR, u konstatua se me gjithë rekomandimet e dhëna nga sektori i auditimit të brendshëm, nuk ka fillim ecurie disiplinore nga Titullari i Institucionit për personat përgjegjës, dhe si rrjedhim ka një zbatim

minimal të rekomandimeve të auditit për përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut.

AZHBR në vlerësim të rëndësisë dhe frekuencës (numrit) së shkeljeve të konstatuara dhe të evidentuara në raportin përfundimtar të auditimit, duhet të kishte bërë klasifikimin e tyre dhe fillimin e procedurës për masë disiplinore për punonjësit përkatës. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 “Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, Kreu X “Disiplina në shërbimin civil”, neni 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor të shërbimit civil”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në AZHBR të planifikohen auditime mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të ndiqen me përgjegjësi maksimale niveli i zbatimit të tyre si dhe të evidentohen personat përgjegjës për raste të përsëritura të moszbatimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës së SAB-së, për vitin 2018 u konstatua se sipas Urdhrit nr. 140, datë 17.09.2018 “Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural” sektori i auditit të brendshëm duhet të kishte 4 punonjës 1+3 (një përgjegjës + tre auditues), por në fakt ka dy punonjës 1+1 (një përgjegjës + një auditues). Nisur nga rëndësia që ky sektor ka me rolin dhe misionin e tij, duke i mundur nivelit të lartë të menaxhimit siguri objektive në mënyrë të pavarur dhe duke përmirësuar veprimtarinë dhe performancën e AZHBR-së nuk mund ta kryejë këtë funksion kur përgjegjësit të sektorit i duhet të kryejë edhe rolin e audituesit për realizimin e planeve strategjike dhe planeve vjetorë të auditimit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” pika 3.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Juridike dhe Funksioneve Mbështetëse (sektori i burimeve njerëzore) në bashkëpunim me DAP (Departamentin e Administratës Publike), të merren masa të menjëhershme për plotësimin e dy vendeve vakant në këtë sektor shumë të rëndësishëm në mirë funksionimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, rregullores, udhëzimeve dhe urdhrave gjatë aktivitetit të AZHBR-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë, si pasojë e borxhit me vlerë prej 2,058,454,729 lekë, që trashëgon në mënyrë të vazhdueshme, i krijuar nga implementimi ish-Projekti 2KR (kredi pa interes që i ka dhënë Qeveria Japoneze Ministrisë së Bujqësisë për të ndihmuar fermerët shqiptar). Nga auditimi i 30 akt-paditë të bëra në gjykatë për këta debitorë është kërkuar vetëm zgjidhja e kontratave për shkak të mos përbushjen e detyrimeve kontraktuale të mbetura dhe pagimin e kamatëvonesave.

AZHBR në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore të hapura ndaj të gjithë debitorëve nuk ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave. Kjo kërkesë, nuk është bërë në paditë e ngritura, sepse në rast se, gjykata do të vendoste kthimin e linjave apo serave, buxheti i shtetit do të kishte një kosto të konsiderueshme që do të duhej për çmontimin, transportin, magazinimin si dhe përsëri montimin e tyre në ferma të tjera, por duhet një zgjidhje juridike, pa çenuar mungesa në buxhetin e shtetit. Për të nxjerrë në dukje koston e lartë buxhetore dhe

raportin kosto-përfitim për AZHBR, mjafton të përmendim dhe ti referohemi, VKM-së nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimit nr. 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfituar nga fondi kundër parti" me anën e të cilave AZHBR është financuar nga buxheti i shtetit me 17 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për sekuestrimin (heqjen) transportin dhe ruajtjen e dy linjave (pajisje dhe makineri për nxjerrjen e vajit të ullirit), të cilat aktualisht edhe sot që nga viti 2011 ndodhen në ruajtje në ambientet e Bordin e Kullimit Tiranë dhe kanë humbur vlerën e tyre përdorimit, për shkak të amortizimit. Për më tepër po të përmendim këtu, rastet e sekuestrimit të serave me sipërfaqe të mëdha mbi 1 ha, që kanë vite të shumta përdorimi dhe janë tejet të amortizuara do të kërkonte fonde buxhetore të konsiderueshme për vlerësimin, çmontimin, ruajtjen, transportimin dhe magazinimin. Deri në momentin e këtij auditimi, nga 30 procese gjyqësore të hapura kanë përfunduar procesin gjyqësor dhe kanë marrë formë të prerë nga Gjykata Administrative e Apelit, vetëm 3 (tre) subjekte. Konkretisht, "Ana; shpk;" "OERT" (Sucralba), sh.a, dhe "SARA" sh.p.k. dhe në kontekst për sa trajtuam më sipër, për këta 3 subjekte debitorë Gjykata ka marrë vendime të ndryshme si më poshtë:

Për subjektin "Sucraalba", ka vendosur, detyrimin që të përmbushë detyrimet kontraktore, duke i paguar AZHBR-së shumën prej 188,280,750 lekë (e cila përbëhet nga vlera e principalit 162.866.930 lekë detyrim kontraktuale dhe 25.413.820 lekë penalitete që janë interesa ligjore të pa paguara. Pra gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin "ANA" sh.p.k ka vendosur, të paguajë detyrimin në favor të AZHBR në masën 29,158,630 lekë dhe vlerën e kamatëvonesës në shumën 4,866,328 lekë. Edhe në këtë rast, gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin "SARA" sh.p.k ka vendosur zgjidhjen e kontratës së shitjes me rezervë, të sendeve të paluajtshme me nr.6741/1, datë 15.11.2017 dhe detyrimin e shoqërisë tregtare "SARA" sh.p.k. të kthejë sendin objekt kontrate. Pra sipas këtij vendimi gjykata ka vendosur të parashkruajë (të shuajë) detyrimin e pretenduar nga AZHBR prej 48,329,484.36 lekë dhe ka vendosur kthimin në AZHBRR të sendit (serave). Pra, duket qartë se gjykata ndryshe nga dy rastet e mësipërme, në këtë rast ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave, edhe pse kjo nuk është kërkuar nga vetë AZHBR.

Gjithashtu, për debitorët e linjave 2005-2009, të cilët kanë qenë subjekte të pajisur me NIPT pra të regjistruar në organin tatimor, u konstatua se ndër vite nuk kishte një bashkëpunim ndërmjet AZHBR dhe DPT, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, dhe më pas për subjektet aktivë në organin e tatimeve dhe debitorë në AZHBR, të hartonin për këtë periudhë planin i monitorimit dhe arkëtimit në bashkëpunim me MFE-në, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në kohë reale.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13. 1. Rekomandim: AZHBR, në bashkëpunim me MBZHR, të ngrenë komision të veçantë me specialistë të fushës që të ketë për objekt pune:

-**"Analizimin e shkaqeve dhe arsyeve të krijimit të subjekteve debitorë, fermerë"**. Nëse arsyet e krijimit dhe rritjes së debitorëve kanë ardhur si pasojë e mos subvencionimit të in puteve bujqësore dhe karburantit si dhe të mungesës së lehtësirave tatimore nga organet shtetërore, të mundësohet një marrëveshje bashkëpunimi dhe mirë kuptimin me subjektet debitorë, apo të marrin iniciativën ligjore për iniciimin e një projektvendimi të Këshillit të Ministrave, për rishikimin dhe ristrukturimin e këtij borxhi, me qëllim nxitjen e aktivitetit dhe shmangien e falimentimit që mund të vijë nga shlyerja e këtyre detyrimeve si pasojë e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.

- Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatave formës së prerë u kërkohet zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja e detyrimeve. Nëse kosto e sekuestrimit (çmontimit, transportit, ruajtjes etj) del më e lartë se përfitimi, AZHBR në mirëkuptim me këto subjekte të mundësojë një akt-marrëveshje, apo të marrin iniciativën ligjore për iniciimin e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave, me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit, stimulimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre për të shmangur falimentimit që mund të vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Menjëherë

13.2. Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me MBZHR dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe nisur nga statusi që subjektet debitorë, mund të kenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një plan bashkëpunimi për të gjithë debitorët dhe veçanërisht për debitorët e linjave mbas vitit 2005, për verifikimin e statusit në sistemin tatimor dhe marrjen e menjëhershme të masave bllokuese për ata subjekte që figurojnë aktivë dhe që prodhojnë të ardhura dhe realizojnë fitime pikërisht prej makinerive të linjave të këtyre viteve, të financuara nga AZHBR.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

13.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën **2,058,454,729 lekë**, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave mbas vitit 2005, me një borxh të mbartur në vlerën 1,032,644,780 lekë që i përket linjave të viteve mbas 2005, dhe një vlerë prej 169,388,097 lekë që i përket linjave të vitit 2009. Për këtë borxh të mbartur prej shumë vitesh i krijuar nga implementimi ish-Projekti 2KR (kredi pa interes që i ka dhënë Qeveria Japoneze Ministrisë së Bujqësisë për të ndihmuar fermerët shqiptar) AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë. Por, meqenëse se është konstatuar që ky fenomen është i përhapur në shumë fermerë, para se të hapeshin proceset gjyqësore, nga ish-Projekti 2KR dhe nga Ministria e Bujqësisë, duhet të analizonin shkaqet dhe arsyet objektive apo subjektive të krijimit të vështirësive financiare që i kanë detyruar këta fermerë të mos paguajnë këstet dhe kamatëvonesat sipas kontratave (shkaqet dhe arsyet, kanë të bëjnë me braktisjen e aktiviteteve nga vetë fermerët përfitues apo me mos subvencionimin e karburantit, in puteve bujqësore, mungesën e lehtësirave fiskale, etj).

(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.3. Rekomandim: AZHBR dhe MBZHR, të ngrejnjë grup pune të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **2,058,454,729 lekë**, pasi nga ky veprim nuk është krijuar fondi kundërparti dhe për pasojë nuk është vazhduar me skemën e refinancimit në dobi të fermerëve të tjerë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE:

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, si dhe reflektimin e tyre me qëllim përmirësimin e punës dhe proceseve, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore si një ndër objektivat kryesore të këtij institucioni.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit ***brenda 20 ditëve*** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ***brenda 6 muajve*** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

Bujar LESKAJ

KRYETAR

A circular official stamp of the High Control of the State of Kosovo is partially visible. The stamp contains the text "KONTROLI I LARTË I SHTETIT" and "KOSOVA". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink that reads "Bujar Leskaj".



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË

AGJENCINË E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL

Tirane, 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit
Bujqësor dhe Rural”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE

NË

“AGJENCINË E ZHVILLIMIT BUJQËSORË DHE RURAL”

Korrik, 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

RAPORT AUDITIMI
(auditim financiar dhe përputhshmërie)

“Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

<i>Nr</i>	<i>Përmbatja</i>	<i>Faqe</i>
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3-14
II.	HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)	
	a. Objektivat dhe qëllimi.....	15-15
	b. Identifikimi i çështjes.....	16-16
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	16-16
	d. Përgjegjësitë e audituesve.....	16-16
	e. Kriteret e vlerësimit.....	16-17
	f. Standardet e auditimit.....	17-17
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	18-18
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
	1. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	18-29
	2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	29-40
	3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare:.....	40-45
	4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit:.....	46-67
	5. Prokurimet e fondeve publike.....	67-80
	6. Auditimi i fondeve të dhëna për programet e bujqësisë	81-107
	7. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	107-115
	8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	115-119
	9. Probleme të tjera gjatë auditimit.....	119-145
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	152-158
VI.	ANEKSE	159-165



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Agjencinë e zhvillimit bujqësor dhe rural (AZHBR), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomik-financiar të AZHBR dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
2. Auditimin e procedurave të prokurimeve
3. Auditimi i fondeve të dhëna për programet e bujqësisë dhe për zhvillimin rural
4. Vlerësimin dhe funksionimin sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit,
5. Auditimin e pasqyrave financiare të AZHBR-së, si dhe
6. Pika të tjera të dala gjatë auditimit

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i organikës së AZHBR-së, u konstatua se struktura organike e këtij institucioni ka ndryshuar dy herë për një periudhë një-vjeçare, e cila korrespondon me periudhën në auditim 2017-2018, konkretisht sipas Urdhrit nr. 190, datë 06.11.2017 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), numri i punonjësve ndryshoi nga 123 në 133 dhe sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural" duke ndryshuar nga 133 në 169 punonjës . Gjendja faktike numri i punonjësve është 129, pra ka një mungesë prej 40 punonjësish. Procedura e ristrukturimit të organikës së AZHBR-së, rritja e numrit të punonjësve nga 133 në 169, krijimi i vendeve vakant si rezultat i lirimit të punonjësve civilë shoqëruar kjo edhe me mos emërimin në kohë të punonjësve të rinj nga DAP, rezultat i procedurave të rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike, ka bërë që shumë sektorë dhe drejtori për një periudhë të punojnë me staf të reduktuar në numër, disa herë pa strukturat drejtuese (drejtorët dhe përgjegjësit), duke krijuar mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat		MESËM	AZHBR ti kërkojë DAP, për të filluar procedurat e rekrutimit për plotësimin e menjëhershme të vendeve vakante, veçanërisht të specialistëve të fushës së inxhinierisë së ndërtimit, mekanike dhe elektrike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

2	<p>Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" u konstatua se, komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një ndarje të tyre sipas zërave: vlera total për pajisje informatike, vlera total për vegla pune, mobilieri e pajisje zyre, kondicioner, etj sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit, por i ka grupuar në total në dy zëra "inventar ekonomik" dhe "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune". Veprime në kundërshtim me pikat 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",</p>		MESËM	<p>Nga Komisioni i inventarizimit të merren masa që gjatë inventarizimit të aseteve të bëhet ndarja e aktiveve sipas zërave, me qëllim krahasimin e gjendjes fizike me gjendjen në kontabilitet dhe për diferencat e konstatuara sipas zërave nëse do të ketë, të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet.</p>
3	<p>Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se komisioni, për të dy vitet objekt auditimi ka konstatuar diferenca, për të cilat nuk janë dhënë sqarime të mtejshme se kush janë personat përgjegjës apo nga kusht është shkaktuar mungesa. Për diferencat e konstatuara, komisioni nuk ka përpiluar një procesverbal, nëpërmjet të cilit vihet në dijeni instancat përkatës, për marrjen e masave të mtejshme për kompensimin apo sistemimin e diferencave të konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 85, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".</p>		MESËM	<p>Të ngrihet një komision i veçantë, për të bërë verifikimin e diferencave të konstatuara nga komisionet e mëparshme të inventarizimit dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse të personave që kanë në ngarkim vlerat materiale, duke i reflektuar diferencat e konstatuara dhe në kontabilitet. Më pas institucioni të marrë masat që për diferencat e konstatuara të vlerave materiale të bëhet kompensimi i vlerave të tyre duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat kanë sjell rritje të vlerës së tyre, si dhe vlerën e amortizimit të akumuluar.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

4	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 në zërin "Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar" janë të pasqyruara (llog. 202) "Studime dhe kërkime" në vlerën prej 21,674,642 lekë, e cila përbëhet nga shuma prej 295,800 lekë të projektit ish- 2KR dhe në shumën prej 21,378,842 lekë të dy kontratave për "Studim për mizën e ullirit" dhe "Projekti për ndërtimin e zyrave të AZHBR-së në Fushë Krujë" lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat nuk gjenden kontratat e lidhura. Në SKK nr. 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore. Aktivi në fjalë nuk është më në funksion, si rrjedhojë nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivitetit jo-material, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.</p>		MESËM	<p>Nga AZHBR, të merren masat që në bashkëpunim me MBZHR dhe Ministrinë e Financës, të analizojnë gjendjen "Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuar" dhe në varësi të rezultateve të analizës të bëhet nxjerrjen jashtë përdorimi dhe çregjistrimin e tyre nga kontabiliteti, për të bërë të mundur një paraqitje sa më reale të pozicionit financiar të institucionit.</p>
5	<p>Nga auditimi është konstatuar se, për vitin buxhetor 2017 dhe 2018 AZHBR-ja, më së shumti ka realizuar procedura me blerje të vogla, ndërsa në lidhje mbi procedurat e prokurimeve publike, për zërin 231 (investime) dhe zërin (602) mallra e shërbime me vlera të lartë, pjesa më e madhe tyre janë realizuar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) ose nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si Autoritet Kontraktor u konstatua se institucioni nuk ka njësi të prokurimit, si strukturë permanente, por është krijuar, rast mbas rasti në momentin që ka pasur procedura. Gjithashtu u konstatua se, anëtarët të cilët janë vendosur nga Titullari i AK nuk janë specialist të fushës dhe nuk janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme pranë Agjencia e Prokurimeve Publike (APP). Veprime në kundërshtim me Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Manuali për MFK nr. 108 datë 17.11.2016, pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore".</p>		MESËM	<p>AZHBR të marrë masa që në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimeve Publike, të bëjë një plan masash për trajnimin e anëtarëve të cilët do jene pjesë e komisioneve të prokurimeve, duke rritur cilësinë e procedurave me të gjitha hallkat e atyre, për të pasur efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet me fondet të financuara nga buxheti i Shtetit.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

6	<p>Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillim bujqësor dhe rural për vitin 2018, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillim rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", konkretisht për <u>Masën 12 (Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit)</u>, ku citohet: "<u>Masa e financimit është parashikuar 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika ose jo më shumë se 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.</u>", u konstatua se: Duke përdorur metodën krahasimore midis mesatares së çmimeve të preventivave ofertave të përfituesve, me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", rezultoi se, ka diferencë në vlerë. Kështu, përfituesit e serrave diellore, kanë paraqitur preventiva të rritura, afërsisht 43 % të vlerës së investimit total për tre zëra kryesorë (plasmas serrash dhe aksesorë, konstrukcione metalike dhe betonin e gropave).</p> <p>Për sa më sipër, duke pasur parasysh faktin se AZHBR, financon nga Buxheti i shtetit <u>jo më shumë se 50% e vlerës së investimit, pra rreth 21.5% e vlerës së subvencionit, është financuar në mungesë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike sipas manualeve teknike shtetërore, por në referim të preventivave ofertues të mbështetura në çmimet e tregut vendas ose të huaj.</u></p> <p>Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, Kreu IIX "Kriteret specifike dhe dokumentacioni për masat mbështetëse", pika 2, <u>ku nuk është kërkuar referimi i çmimeve mbështetur në manual për Masën 12</u>, duke hequr kërkesën që "<u>....çmimet e preventivitit konkurrues nuk duhet të jetë i vulosur dhe i firmosur nga inxh. ndërtimi i licencuar.</u>", siç është kërkuar për masat e tjera.</p>		LARTË	<p>Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, gjatë hartimit dhe miratimit të akteve normative ligjore dhe nënligjore, për skemat e masave mbështetëse kombëtare që realizohen nëpërmjet investimeve ndërtimore, të vendosin kritere specifike dhe dokumentacion të unifikuar dhe të standardizuar, të cilat nuk duhet të ndryshojnë nga viti në vitin buxhetor të radhës. Me qëllim për mire përdorimin e fondeve publike në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficientë, hartimi i preventivave dhe llogaritja e vlerës së financimit të behet sipas manualeve teknike me çmimeve të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM. Për ato zëra dhe çmime që nuk përfshihen në këto manuale të hartohen analizat teknike të të çmimeve mbështetur në normativat teknike dhe në çmimet tregut.</p>
---	--	--	-------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

7	<p>Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural, të përcaktuara sipas VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, si dhe auditimet e kryera në terren nga grupi i auditimit, u konstatua se, për masat mbështetëse të skemave kombëtare të zhvilluara nëpërmjet investimeve ndërtimore konkretisht për masat:</p> <ul style="list-style-type: none">-Masa 20 "Ambiente grumbullimi dhe frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore"-Masa 21 "Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime"-Masa 22 "Linja përpunimi/makineri për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë"-Masa 23 "Linja selektimi, paketim, ambiente për fruta, perime dhe bimë medicinale"-Masa 32 "Ndërtimin e thertoreve dhe pajisjeve"-Masa 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe makineri dhe pajisje"-Masa 44 "Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin të turizmit rural"-Masa 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm"-Masa 51 "Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve", <p>Në situacionet përfundimtare të punimeve është përdorur termi "e pamatshme për punimet e maskuara". Grupet e monitorimit të AZHBR-së kryejnë, sipas manualit të kontrollit vetëm dy kontrolle (një në fillim para lidhjes së kontratës dhe një në fund të përfundimit të investimit).Grupet e kontrollit përbëhen nga inspektorë kontrolli që kanë profil jurist dhe ekonomist, dhe jo profil teknik (inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/mekanik, inxh/elektrik, arkitekt etj), ndonëse nga AZHBR me disa shkresa nr.304 prot, datë 27.07.2018 dhe nr.3041 prot datë 27.07.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike është kërkuar rekrutimi i punonjësve për këto pozicione pune, të cilat ende janë vakante.</p> <p>Kështu, specialistët të monitorimit, mbështeten vetëm në librezat e masave duke i marrë të mirëqena punimet e pamatshme, pa i bërë një analizë profesionale. Mbi punimet ndërtimore, përfituesit e subvencionit, e përcaktojnë vetë mbikëqyrësin e punimeve, i cili miraton volumnet dhe projektin e azhornuar.</p> <p>Nga auditimi i dosjeve të përfituesve të subvencionit, konstatohet se mbikëqyrësi i punimeve realizon vetëm librezën e masave dhe asnjë dokumentacion tjetër mbi punimet si,(procesverbalet e punimeve të maskuara, ditarin e punimeve, ndryshimet e projektit, testet e kontrollit, certifikatat e materialeve të përdorura, foto gjatë punimeve etj), duke mos mbajtur asnjë përgjegjësi për punimet mbas përfundimit të investimit, pasi edhe në</p>	LARTË	<p>7.1 Nga AZHBR në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të merren masa, që të plotësohen vendet vakante me specialistë të fushës, nëse kjo nuk realizohet në kohë të shikohet mundësia e hapësirave ligjore për punësimin me kontratë të përkohshme ekspertë të jashtëm të fushës.</p> <p>7.2. Për kontratat e skemave të mbështetjes kombëtare duhet të vendoset një pikë e veçantë, mbi kontraktimin e një mbikëqyrësi me licence, në përputhje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 7.</p>
---	---	-------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

	<p>kontratën e lidhur midis AZHBR dhe përfituesit të subvencionit, nuk është shprehur si detyrim kontraktor, <i>ekzistenca e një mbikëqyrësi punimesh me licencën përkatëse</i>, sipas një marrëveshjeje dypalëshe të njohur nga AZHBR.</p>			
8	<p>Nga auditimi, u konstatua se, propozimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, drejtuar Këshillit të Ministrave, për miratimin e VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, nuk është realizuar paralelisht me miratimin Buxhetit vjetor që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë brenda datës 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke mos qenë në koherencë me vitin bujqësor por me vitin kalendarik buxhetor. Kjo, ka sjellë penalizmi e aplikantëve fitues për masat mbështetëse të skemave kombëtare, duke shkurtuar në maksimum kohën e ndërtimit të investimeve për periudhën 2-3 muaj.</p> <p>8.1. Nga auditimi, u konstatua se, Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR, nuk ka strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat kryesore për masat mbështetëse (orientimi, treguesit etj) si dhe roli i AZHBR-së duket thjesht si ekzekutues i fondeve që duhen shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të cilat kanë pësuar ndryshime të shpeshta buxhetore, duke sjellë uljen e vlerës së parashikuar për skemat mbështetëse kombëtare.</p> <p>8.2. Nga auditimi i procedurave të dhënies së subvencionet për skemat mbështetëse kombëtare kryesisht investime, numri i dokumenteve për të plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe kohore për aplikantët, për pasojë kemi ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare. E kundërta ka ndodhur për masa direkte mbështetëse, ku në vitin 2018, për herë të parë, është përdorur aplikim me 0 dokumente, duke ulur numrin e dokumenteve për fermerin, por duke shtuar volumin e punës dhe kosto administrative të larta, të administratës të AZHBR-së.</p>		LARTË	<p>8.1. Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR-në, të marrin masat e nevojshme, për të realizuar në kohë propozimin dhe miratimin e kornizës ligjore dhe nënligjore, për hartimin e strategjisë, për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten, për përcaktimin e masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke rritur mundësinë që fondi i alokuar për skemat të mos pësojë ndryshime të shpeshta dhe të konsiderueshme gjatë vitit dhe të shtojë në këtë mënyrë aftësinë për të përthithur të gjitha fondet që akordohen nga Buxheti i shtetit për bujqësinë, në favor të përfituesve bujqësorë shqiptarë.</p> <p>8.2. AZHBR së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të punojnë për arritjen e marrëveshjeve dypalëshe, në mënyrë që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkojnë aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej vetë AZHBR-së, duke patur akses on-line me institucionet që japin këto vërtetime, me qëllim lehtësimin e aplikantit-përfitues, duke ulur e koston financiare dhe kohën fizike për përgatitjen e tyre.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Për fundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rrustal”

9	<p>Nga auditimi, u konstatua se, nga AZHBR hartimi i kontratave me përfituesit e skemave mbështetëse kombëtare, janë kontrata tip, pa ndryshime nga njëra masë tek tjetra, duke përcaktuar monitorimin e aktivitetit të detyrueshëm për 5 vite, por nuk dalin të qarta masat konkrete administrative, që duhet të ndërmerret AZHBR në rastet e mosplotësimeve detyrimeve kontraktore, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9817 datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i ndryshuar, neni 39 (sanksionet) pika 1 citohet se “Kundravajtjet administrative dënohen me gjobë në masën 30, 000 (tridhjetë mijë) lekë – 40, 000 (dyzet mijë) lekë si dhe kthimin e financimit të përfituar”.</p> <p>9.1. Nga auditimi u konstatua se, strukturat e monitorimit të AZHBR-së, janë të pamjaftueshme me burime njerëzore, pasi nuk është e mundur të monitorohen në kohë subvencionet, dhe mos hartimi i një plani monitorimi periodik me objektiva të qarta, ka çuar në mungesë analize të hollësishme, në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e plan-bizneseve të paraqitura nga përfituesit.</p> <p>Gjithashtu nga auditimi, u konstatua se, mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare), të AZHBR, nga sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, për periudhën 2017-2018, ka ndikuar negativisht në efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomikitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare.</p>		LARTË	<p>9.1.AZHBR me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave dhe Sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, të hartojnë planin e monitorimit për subjektet e konstatuara me mosplotësimin të detyrimeve kontraktuale për periudhën 2017 dhe 2018, duke verifikuar në terren vazhdimësinë dhe saktësinë e zbatimit të subvencioneve për afatin 5 vjeçar, duke aplikuar penalitete dhe sanksionet sipas rasteve.</p> <p>9.2. Nga AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ti propozojë Këshillit të Ministrave, rritjen e numrit të punonjësve për strukturat monitoruese, të cilat duhet të harmonizohen në ndërveprime të përbashkëta me sektorët e tjerë, duke rritur shkallën e profesionalizmit për të arritur qëllimin dhe objektivat e AZHBR-së.</p>
10	<p>Nga auditimi u konstatua se, në bazë të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kreu VI, “Bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionet” neni 22, AZHBR krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të Regjistrit të fermës, proces i cili ende nuk është realizuar, ndonëse edhe në kuadër të procesit të aderimit për Bashkimin Evropian, si kusht për Agjencinë e Pagesave, është administrimi dhe funksionaliteti i IACS (Sistemi i Integruar i menaxhimit dhe kontrollit), me komponentë:</p> <ul style="list-style-type: none">1-Regjistri i fermës;2-LPIS-Sistemi i përcaktimit dhe i klasifikimit të parcelave bujqësore.		LARTË	<p>AZHBR në bashkëpunim me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masat, të fillojë projektin për krijimin dhe zhvillimin e Regjistrit të fermës, duke aplikuar të gjitha hapat ligjorë për një data basë të konsoliduar kombëtar dhe përfshirjen e të gjithë aktorët, për të përmbushur detyrimet ligjore sipas Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe Planit Kombëtar për Integrim Evropian.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

11	<p>Nga auditimi i dosjeve me përzgjedhje në AZHBR, u konstatua se me gjithë rekomandimet e dhëna nga sektori i auditimit të brendshëm, nuk ka fillim ecurie disiplinore nga Titullari i Institucionit për personat përgjegjës, dhe si rrjedhim ka një zbatim minimal të rekomandimeve të auditit për përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut.</p> <p>AZHBR në vlerësim të rëndësisë dhe frekuencës (numrit) së shkeljeve të konstatuara dhe të evidentuara në raportin përfundimtar të auditimit, duhet të kishte bërë klasifikimin e tyre dhe fillimin e procedurës për masë disiplinore për punonjësit përkatës. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 "Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil", Kreu X "Disiplina në shërbimin civil", neni 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor të shërbimit civil".</p>		MESËM	<p>Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në AZHBR të planifikohen auditime mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të ndiqen me përgjegjësi maksimale niveli i zbatimit të tyre si dhe të evidentohen personat përgjegjës për raste të përsëritura të moszbatimit.</p>
12	<p>Nga auditimi i strukturës së SAB-së, për vitin 2018 u konstatua se sipas Urdhrit nr. 140, datë 17.09.2018 "Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural" sektori i auditit të brendshëm duhet të kishte 4 punonjës 1+3 (një përgjegjës + tre auditues), por në fakt ka dy punonjës 1+1 (një përgjegjës + një auditues). Nisur nga rëndësia që ky sektor ka me rolin dhe misionin e tij, duke i mundësuar nivelit të lartë të menaxhimit <u>siguri objektive</u> në mënyrë të pavarur dhe duke përmirësuar veprimtarinë dhe performancën e AZHBR-së <u>nuk mund ta kryejë këtë funksion kur përgjegjësit të sektorit i duhet të kryejë edhe rolin e audituesit për realizimin e planeve strategjike dhe planeve vjetorë të auditimit</u>. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik" pika 3.</p>		MESËM	<p>Nga Drejtoria Juridike dhe Funksioneve Mbështetëse (sektori i burimeve njerëzore) në bashkëpunim me DAP (Departamentin e Administratës Publike), të merren masa të menjëhershme për plotësimin e dy vendeve vakant në këtë sektor shumë të rëndësishëm në mirë funksionimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, rregullores, udhëzimeve dhe urdhrave gjatë aktivitetit të AZHBR-së.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

13	<p>Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën <u>2,058,454,729 lekë</u>, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave të viteve 2005-2009, me një borxh të mbartur në vlerën <u>1,032,644,780 lekë që i përket</u> linjave të vitit 2005 dhe një vlerë prej <u>169,388,097 lekë</u> që i përket linjave të vitit 2009. Për këtë borxh të mbartur prej shumë vitesh i krijuar nga implementimi ish-Projekti 2KR, AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë. Por, meqenëse se është konstatuar që ky fenomen është i përhapur në shumë fermerë, para se të hapeshin proceset gjyqësore, nga ish-Projekti 2KR dhe nga Ministria e Bujqësisë, duhet të analizonin shkaqet dhe arsyet objektive apo subjektive të krijimit të vështirësive financiare që i kanë detyruar këta fermerë të mos paguajnë këstet dhe kamatëvonesat sipas kontratave (shkaqet dhe arsyet, kanë të bëjnë me braktisjen e aktiviteteve nga vetë fermerët përfitues apo me mos subvencionimin e karburantit, in puteve bujqësore, mungesën e lehtësirave fiskale, etj). Në 30 akt-paditë e bëra në gjykatë për këta debitorë është kërkuar vetëm zgjidhja e kontratave për shkak të mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të mbetura dhe pagimin e kamatëvonesave. AZHBR në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore të hapura ndaj të gjithë debitorëve nuk ka kërkuar sekuestrimin dhe <u>kthimin e linjave apo serave</u>. Kjo kërkesë me të drejtë nuk është bërë në paditë e ngritura, sepse në rast se, gjykata do të vendoste kthimin e linjave apo serave, buxhetit i shtetit do të kishte një kosto të konsiderueshme që do ti duhej për çmontimin, transportin, magazinimin si dhe përsëri montimin e tyre në ferma të tjera. Për të nxjerrë në dukje koston e lartë buxhetore dhe raportin kosto-përfitim për AZHBR, mjafton të përmendim dhe ti referohemi, VKM-së nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimit nr. 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfituar nga fondi kundër parti" me anën e të cilave AZHBR është financuar nga buxheti i shtetit me 17 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për sekuestrimin (heqjen) transportin dhe ruajtjen e dy linjave (pajisje dhe makineri për nxjerrjen e vajit te ullirit), të cilat aktualisht edhe sot që nga viti 2011 ndodhen në ruajtje në ambientet e Bordin e Kullimit Tiranë dhe kanë humbur vlerën e tyre përdorimit, për shkak të amortizimit. Për më tepër po të përmendim këtu, rastet e sekuestrimit të serave me sipërfaqe të mëdha mbi 1 ha, që kanë vite të shumta përdorimi dhe janë tejet të amortizuara do të kërkonte fonde buxhetore të konsiderueshme për vlerësimin, çmontimin, ruajtjen, transportimin dhe magazinimin. Deri në momentin e këtij auditimi, nga 30 procese gjyqësore të hapura kanë përfunduar procesin gjyqësor dhe kanë marrë formë të prerë nga Gjykata Administrative e Apelit, vetëm 3 (tre) subjekte.</p>	LARTË	<p>13.1. AZHBR, në bashkëpunim me MBZHURU, të ngrënë komision të veçantë me specialistë të fushës që të ketë për objekt pune: - "Analizimin e shkaqeve dhe arsyeve të krijimit të subjekteve debitorë, fermerë". Nëse arsyet e krijimit dhe rritjes së debitorëve kanë ardhur si pasojë e mos subvencionimit të in puteve bujqësore dhe karburantit si dhe të mungesës së lehtësirave tatimore nga organet shtetërore, të mundësohet një marrëveshje bashkëpunimi dhe mirë kuptimin me subjektet debitorë, apo të marrin iniciativën ligjore për inicimin e një projektvendimi të Këshillit të Ministrave, për rishikimin dhe ristrukturimin e këtij borxhi, me qëllim nxitjen e aktivitetit dhe shmangien e falimentimit që mund të vijnë nga shlyerja e këtyre detyrimeve si pasojë e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore. - Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatave formës së prerë u kërkohej zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja e detyrimeve. Nëse kosto e sekuestrimit (çmontimit, transportit, ruajtjes etj) del më e lartë se përfitimi, AZHBR në mirëkuptim me këto subjekte të mundësojë një akt-marrëveshje, apo të marrin iniciativën ligjore për inicimin e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave, me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit, stimulimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre për të shmangur falimentimit që mund të vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.</p> <p>13.2. AZHBR në bashkëpunim me MBZHURU dhe me</p>
----	--	-------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

<p>Konkretisht, “Ana; shpk;“OERT” (Sucralba), sh.a, dhe “SARA” sh.p.k. dhe në kontekst për sa trajtuam më sipër, për këta 3 subjekte debitorë Gjykata ka marrë vendime të ndryshme si më poshtë:</p> <p>Për subjektin “Sucraalba”, ka vendosur, detyrimin që të përmbushë detyrimet kontraktore, duke i paguar AZHBR-së shumën prej 188,280,750 lekë (e cila përbëhet nga vlera e principalit 162.866.930 lekë detyrim kontraktuale dhe 25.413.820 lekë penalitete që janë interesa ligjore të pa paguara. Pra gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin “ANA” sh.p.k ka vendosur, të paguajë detyrimin në favor të AZHBR në masën 29,158,630 lekë dhe vlerën e kamatëvonesës në shumën 4,866,328 lekë. Edhe në këtë rast, gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin “SARA”sh.p.k ka vendosur zgjidhjen e kontratës së shitjes me rezervë, të sendeve të paluajtshme me nr.6741/1, datë 15.11.2017 dhe detyrimin e shoqërisë tregtare “SARA”sh.p.k. të kthejë sendin objekt kontrate. Pra sipas këtij vendimi gjykata ka vendosur të parashkruajë (të shuajë) detyrimin e pretenduar nga AZHBR prej 48,329,484.36 lekë dhe ka vendosur kthimin në AZHBRR të sendit (serave). Pra, duket qartë se gjykata ndryshe nga dy rastet e mësipërme, në këtë rast ka kërkuar sekuestrimin dhe <u>kthimin e linjave apo serave</u>, edhe pse kjo nuk është kërkuar nga vetë AZHBR.</p> <p>Gjithashtu, për debitorët e linjave 2005-2009, të cilët kanë qenë subjekte të pajisur me NIPT pra të regjistruar në organin tatimor, u konstatua se ndër vite nuk kishte një bashkëpunim ndërmjet AZHBR dhe DPT, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, dhe më pas për subjektet aktivë në organin e tatimeve dhe debitorë në AZHBR, të hartonin për këtë periudhë planin i monitorimit dhe arkëtimit në bashkëpunim me MFE-në, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në kohë reale.</p>		<p>Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe nisur nga statusi që subjektet debitorë, mund të kenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një plan bashkëpunimi për të gjithë debitorët dhe veçanërisht për debitorët e linjave 2005-2009, për verifikimin e statusit në sistemin tatimor dhe marrjen e menjëhershme të masave bllokuese për ata subjekte që figurojnë aktivë dhe që prodhojnë të ardhura dhe realizojnë fitime pikërisht prej makinerive të linjave 2005-2009, të financuara nga AZHBR.</p>
---	--	---

I/c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Nga *auditimi i pasqyrave financiare*, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimet, banka, janë përfshirë në paqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar.

Opinionin është i pakualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200², si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH-së, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural në datën 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018.

Baza mbi opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur në vlerësimin e riskut dhe të materialitetit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar. Auditimi i përputhshmërisë në AZHBR është kryer së bashku me pasqyrat financiare dhe audituesi nën

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale.

Opinion i pakualifikuar³,

Nën gjykimin e grupit të auditimit, në lidhje me auditimin e përputhshmërisë shpreh një konkluzion/opinion pakualifikuar, ku në gjykimin profesional, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk kanë devijime materiale.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1438/4, datë 28.02.2019, në Agjencinë e zhvillimit bujqësor dhe rural (AZHBR), nga data 01.03.2019-31.05.2019, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.12.2018, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në AZHBR, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Valentina Golemi, përgjegjës grupi,

³ Audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar-pa rezerve kur në gjykimin profesional të tij audituesi nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

2. Elona Llozanaj, Auditues
3. Joniada Goçaj, Auditues
4. Erjola Meçaj, Auditues
5. Aldo Kume, Auditues

a) Titulli:

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

b) Marrësi:

Ky raportv i adresohet Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së, Zj. Frida Krifca.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana e subjektit Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural përgjatë periudhës 01.01.2017 deri më 31.12.2018, nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:

- janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave funksionon veprimtaria e këtij institucioni,
- fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në funksion të kësaj veprimtarie, janë përdorur konform akteve ligjore në fuqi dhe në mënyrë efektive.
- dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që AZHBR u ka bërë fondeve të çelura, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve strategjike të miratuara nga strukturat përkatëse.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale. Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura për vitin 2017-2018), prokurimet e fondeve publike, auditimi i fondeve të dhëna për programin e bujqësisë etj.

b) Identifikimi i çështjes:

AZHBR-së ka si qëllim zhvillimin Agrikulturor dhe Rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

AZHBR, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përfitohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze. Detyrat e saj janë procedimi dhe analizimi i aplikimeve të fermerëve bazuar në rregullat e Qeverisë Shqiptare dhe Bashkimit Evropian për të lëvruar fonde nga buxheti i Shtetit dhe donatorët e huaj. Ngritja e një mjedisi pune eficient në bashkëpunim me partnerët e Agjencisë si dhe krijimin e një stafi profesional, të trajnuar dhe të kualifikuar me anë të strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Grupi i auditimit është fokusuar në detyrat kryesore të administrimit të Fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe investimet e realizuar nga këto fonde.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit 1438/4, datë 28.02.2019.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i AZHBR-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AZHBR-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

f) Kriteret e vlerësimit:



KONTROLLI LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Kriteret e vlerësimit do të bëhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave në funksion të vetëvlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Financave.

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik";
- UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik;
- Udhëzimi nr.8, datë 17.02.2003 "Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr. 918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", Udhëzimi i APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik",
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligjit me Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), si Agjenci e Pagesave", i ndryshuar me VKM Nr. 877, datë 14.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), si Agjenci e Pagesave".
- Udhëzimin Nr. 3, datë 30.12.2008 "Për rregullat dhe e funksionimit të brëndshëm të A.ZH.B.R.-së si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave mes saj, DRBUMK-ve dhe aktorëve të tjerë të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit".

e) Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar të KLSH, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar)
- ISSAI 4000 "Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë"
- ISSAI 1000-1999 "Manuali i Auditimit Financiar"
- ISSAI 4100 "Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë për auditime të performuara veçmas nga Auditimi i Pasqyrave Financiare".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

- ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etikës.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, AZHBR-së ka si qëllim zhvillimin Agrikultor dhe Rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

AZHBR, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përfitohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze. Detyrat e saj janë procedimi dhe analizimi i aplikimeve të fermerëve bazuar në rregullat e Qeverisë Shqiptare dhe Bashkimit Evropian për të lëvruar fonde nga buxheti i Shtetit dhe donatorët e huaj. Ngritja e një mjedisi pune eficient në bashkëpunim me partnerët e Agjencisë si dhe krijimin e një stafi profesional, të trajnuar dhe të kualifikuar me anë të strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekti i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të AZHBR-së përgjatë vitit 2017-2018.

- Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AZHBR-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit

- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të AZHBR-së me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2018, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.01.2017-31.12.2018.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

1.a) Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017 dhe 2018

Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural është krijuar në zbatim të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2017 “ Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, me VKM-në nr. 1443, datë 31.10.2008 “Për krijimin dhe organizimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural, si Agjenci e Pagesave” me objektiva kryesore :



KONTROLLI LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

Administrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për:

- mbështetjen e drejtëpërdrejtë të prodhimit bujqësorë
- zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve bujqësore, sii dhe administrimin e fondeve kundërparti dhe donatorëve të tjerë si Banka Botërore, Bashkimi European.

Baza ligjore për auditimin e programimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë:për vitet 2017 dhe 2018

- Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”
- Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;
- Udhëzimit të MF nr. 10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018 – 2020”
- VKM nr. 128 datë 07.03.2018 “ Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2019-2021”
- Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 “ Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”
- Udhëzimi plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për buxhetin e vitit 2017”
- Udhëzimi nr. 24, datë 28.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzimi nr. 2, datë 19.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Bujqësisë nr. 1905/1, datë 20.03.2017 “Për fillimin e procesit të përgatitjes së PBA-së 2018-2020” në zbatim të urdhërit nr. 10, datë 28.02.2017 të Ministrisë së Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2018-2020”, AZHBR ka hartuar projekt buxhetin PBA 2018-2020 Faza I, i cili i është dërgua Ministrisë së Bujqësisë me shkresën nr. 802, datë 31.03.2017, brenda afateve ligjore të paarshikuara.

Projekt buxheti për vitin 2018-2020 është hartuar konform legjislacionit përkatës, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale e ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601), llogaritja e tyre është bazuar në nivelin e pagave të ndryshuar sipas VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, ndërsa për numrin e punonjësve është marrë numri sipas strukturës së miratuar për 2017 prej 123.

Sipas artikujve tavanet e parashikuara me VKM nr. 197, datë 15.03.2017 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020” për vitin 2018 limitet e miratuara nga Ministria e Bujqësisë, për fazën e parë janë në shumën 3,727,320 mijë lekë, por AZHBR nuk ka program të dedikuar vetëm për të, por është pjesë e programit 04250



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

Zhvillimi Rural, ku ka edhe dy institucione shpenzuese AKDC e ESHFF, si dhe panairët e vrojtimit statistikore të Aparatit.

Kërkesat buxhetore të paraqitura nga AZHBR në fazën e parë dhe të dytë pas rishikimit të tavaneve të akorduara AZHBR-ja rezulton me rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA-në 2018-2020, në raport me limitin e dhënë për shpenzimet e vitit 2018 për shpenzimet korrente 606, Investimet me financim të huaj, Investimet me financim të brendshëm.

Domosdoshmëria e rritjes së kufirit të shpenzimeve për këtë program është kushtëzuar ndaj monitorueseve dhe auditit të kryer nga Bashkimi Evropian në kuadër të përmbushjes së standardeve për akreditimin e kësaj agjencie dhe marrjen nga BE të "Conferral of management" të fondeve të akorduara nga BE për Projektin IPARD 2014-2020, Projekti SARED "Mbështetje për Bujqësinë & Zhvillimin Ekonomik Rural", si dhe Bashkëfinancimi për Fondi garancisë BERZH.

Tabela 1: Parashikimi I shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2018-2020.

Faza e parë

<i>Në mijë leke</i>				
Llog	Artikujt	2018	2019	2020
600	Paga	114,198	114,605	115,055
601	Sigurimet Shoqërore	19,071	19,139	19,214
602	Mallra dhe Shërbime	72,114	69,910	69,030
605	Transferta Korente të Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind	2,291,012	2,520,113	
606	Kosto Lokale të Investimeve të huaja			2,600,000
231	Kapitale të trupëzuar të brendshme	1,916		
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	3,360		
Totali		2,501,671	2,723,767	2,803,299

Faza e dytë

<i>Në mijë leke</i>				
Llog	Artikujt	2018	2019	2020
600	Paga	111,156	146,519	152,674
601	Sigurimet Shoqërore	18,583	24,469	25,497
602	Mallra dhe Shërbime	98,963	126,420	121,780
605	Transferta Korente të Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind	2,291,012	3,000,000	3,500,000
606	Kosto Lokale të Investimeve të huaja			
231	Kapitale të trupëzuar të brendshme			
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	2,890,000	2,225,297	2,346,750
Totali		5,409,714	5,522,705	6,146,701

Viti 2018

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Bujqësisë nr. 3097, datë 03.04.2018 "Për fillimin e procesit të përgatitjes së PBA-së 2019-2021" në zbatim të urdhërit nr. 7/1, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financës "Për përgatitjen e PBA-së 2019-2021", AZHBR ka hartuar projekt buxhetin PBA 2019-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

2021, ku janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjeguese, Faza I e cila është dërgua Ministrisë së Bujqësisë me shkresën nr. 1170, datë 16.04.2018. Faza e II-të e PBA-së është dërguar me shkresën nr. 3326/1, datë 15.08.2018 brenda afatit të përcaktuar.

Tabela 1: Parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2018-2020.

Faza e parë

		Në mijë leke		
Llog	Artikujt	2,019	2020	2021
600	Paga	145,879	146,417	146,955
601	Sigurimet Shoqërore	24,362	24,452	24,541
602	Mallra dhe Shërbime	103,125	99,545	99,845
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind	3,000,000	3,500,000	4,000,000
606	Kosto Lokale te Investimeve te huaja			
231	Kapitale të trupëzuar te brendshme	40,122		2,000
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	953,902,500	953,562,500	953,562,500
Totali		957,215,988	957,332,914	957,835,841

Faza e dytë

		Në mijë leke		
Llog	Artikujt	2,019	2020	2021
600	Paga	146,519	152,674	153,235
601	Sigurimet Shoqërore	24,469	25,497	25,590
602	Mallra dhe Shërbime	126,420	121,780	122,000
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind	3,000,000	3,500,000	4,000,000
606	Kosto Lokale te Investimeve te huaja			
231	Kapitale të trupëzuar te brendshme	46,272		
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	2,179,125	2,346,750	2,011,500
Totali		5,522,805	6,146,701	6,312,325

1.b) Zbatimi I kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi I planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si dhe planin përfundimtar, për vitet 2017 – 2018.

Viti 2017

Detajimi i limitit mujor të fondeve të AZHBR është bërë mbështetur në ligjin nr. 130, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17911, datë 30.01.2017, dhe shkresës nr. 341, datë 18.01.2017 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ne vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxhetit i AZHBR gjatë vitit 2017:



KONTROLLI I ARTË I SHITESIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

Gjatë vitit 2017, janë bërë shkurtime të konsiderueshme buxhetore, me VKM me akte normative dhe shkresat të ardhura nga MBZHR. Ndryshimet në buxhetin e AZHBR për periudhën Janar – Dhjetor 2017 pasqyrohen më poshtë.

Artikulli	Shuma	Komente
600	104,100,000	Buxheti ne fillim vitit shkresa nr. 341, datë 18.01.2017
	+4,000,000	Me shkresën nr.4636/3 prot, datë 24.07.17 është akorduar shtese fondi 4,000,000 lek (600)
	+12,000,000	Me shkrese 8875/1, date 04.12.2017 shtesë 12,400,000 lekë me akt-normativ nr.3
	-12,000,000	VKM 746 dt 13.12.2017 shkresa janar 2018 pakësim 12,000,000 lekë
	108,500,000	Buxheti (600) Dhjetor 2017

Artikulli	Shuma	Komente
	18,780,000	Buxheti në fillim viti
601	+100,000	Me shkresën nr.4636/3 prot, datë 24.07.17 është akorduar shtesë fondi 100,000 lekë,
	+2,200,000	Me shkresë nr. 8875/1, datë 04.12.2017 shtesë 2,200,000 lekë me akt-normativ nr.3
	-3,000,000	VKM 746 dt 13.12.2017 shkresa janar 2018 pakësim 3,000,000 leke
	18,080,000	Buxheti (601)Dhjetor 2017

Artikulli	Shuma	Komente
602	26,140,000	Buxheti në fillim viti
	+8,100,000	Me shkresë të MF nr.4752/1 prot, datë 12.04.17 është akorduar shtesë fondi 8,100,000 lekë.
	+35,000,000	Me shkrese 3377/3, date 10.05.2017 transferim nga llog 606 35,000,000 leke
	+202,256,506	Me shkresën nr. 3606/4, datë 22.05.2017 transferim 202,256,506 lekë
	-202,256,506	Me shkresën nr.4636/3 prot, datë 24.07.17 pakësim fondi 202,256,506 lekë.
	+10,000,000	Me shkresën nr. 8875/1, datë 04.12.2017 shtesë 10,000,000 lekë me akt-normativ nr.3
	79,240,000	Buxheti (602) Dhjetor 2017

Artikulli	Vlera	Komente
606 skema nacionale	1,633,160,000	Celje skema nacionale 1,633,160,000 lekë
	-300,000,000	Shkresa nr. 2554/3 dt 21.4.2017 pakësim fondi 300,000,000 lekë
	-35,000,000	Shkresa nr. 3377/3 dt 10.05.2017 transferim tek 602 fondi 35,000,000 lekë
	-202,256,506	Shkresa nr. 3606/4 dt 22.05.2017 transferim tek 602 fondi 202,256,506 leke
	-148,000,000	Shkresa 4676/3 dt 24.07.2017pakesim fondi 148,000,000 leke
	-745,800,000	Me shkrese 8875/1, date 04.12.2017 pakësim fondi 745,800,000
	202,103,494	Buxheti Dhjetor 2017

606 bashkefinancim	153,000,000	Çelje bashkëfinancimi IPARD
	-35,800,000	Pakësim shkresë nr. 3964/6, dt 8.06.2017
	-104,200,000	Me shkresën nr. 8875/1, datë 04.12.2017 pakësim fondi 104,200,000
	13,000,000	Buxheti Dhjetor 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

606 ndihma ekonomike	+288,360	Me shkresën MF nr. 1462/1 dt 13.02.2017 shtesë 288,360 lekë fond i veçantë (nd.Ek),
	+30,000	Me shkresën nr. 2932/4 dt 23.05.2017 shtesë 30,000 lekë fond i veçantë (nd.Ek),
	+78,000	Me shkresën nr. 5327/4, dt 01.08.2017 shtesë 78,000 lekë fond i veçantë (nd.Ek),
	+50,000	Me shkresën nr. 8525/3 dt 29.12.2017 shtesë 50,000 lekë fond i veçantë (nd.Ek),
	446,360	Buxheti Dhjetor 2017

	Vlera	Komente
231 investim i brendshëm	5,898,000	- Çelje Investim i brendshëm (I ngurtësuar) (kap. 01) fond 5,898,000 lekë. Fillim vitit 2017 me shkresa nr. 1428, datë 23.02.2017
	-1,500,000	Shkresa MBZHR nr. 2431/3, dt 21.04.2017, dt 24.07.2017 pakësim fondi 1,500,000 lekë
	-4,398,000	Me shkresën nr. 8875/1, datë 04.12.2017 pakësim fondi 4,398,000 lekë me akt-normativ nr.3
	0	Buxheti 01(231) Dhjetor 2017

Investim i huaj plan buxheti, është llogari në bankë të nivelit te dyte	318,965,000	Çelje fillim viti IPA 2013 përmbytjet, banka nivelit 2. Fondi 318,965,000 lekë banka nivelit dytë. Buxheti (231) Dhjetor 2017
---	-------------	--

Burimi: Sektori I Financës

Viti 2018

Ndërsa për vitin 2018, detajimi i buxhetit është bërë në zbatim të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19433/96, datë 17.01.2018, AZHBR ka bërë detajimin e buxhetit për vitin 2018. Ne vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxhetit i AZHBR gjatë vitit 2018:

Artikulli	Shuma	Komente
600	119,400,000	Shkrese e MBZHR Nr.888/1, date 24.1.2018, Çelja e buxhetit
	-300,000	Shkrese e MBZHR nr.8202,dt.15.8.18
	-10,753,073	Shkrese e MBZHR nr.9992/3,dt.26.11.18
	(5,120,000)	Shkrese e MBZHR nr.162/1, dt.16.01.19, Akti normativ nr. 2 dt.19.12.2018
	103,226,927	Buxheti (600) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
601	22,200,000	Shkrese e MBZHR Nr.888/1, date 24.1.2018
	(4,600,000)	Shkrese e MBZHR nr.162/1, dt.16.01.19, Akti normativ nr. 2 dt.19.12.2018
	17,600,000	Buxheti (601)Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
602	72,000,000	Shkrese e MBZHR Nr.888/1, date 24.1.2018, çelja e buxhetit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

	10,753,073	Shkrese e MBZHR nr.9992/3,dt.26.11.18, Shtese fondi
	82,753,073	Buxheti (602) Dhjetor 2018

Artikulli	Vlera	Komente
606	2,565,000,000	Shkrese e MBZHR Nr.888/1, date 24.1.2018
Skema Nacionale	(776,000,000)	Shkrese e MBZHR nr.162/1,dt.16.01.19, Pakësim
	1,789,000,000	Buxheti Dhjetor 2018

Artikulli	Vlera	Komente
606	35,000,000	Shkrese e MBZHR nr.888/5,dt.2.3.2018, Shtese
Bashkëfinancim	-20,000,000	Shkrese e MBZHR nr.7158/2,dt.8.5.18, Pakësim
	15,000,000	Buxheti Dhjetor 2018

Artikulli	Vlera	Komente
231,	57,000,000	Shkrese e MBZHR Nr.888/1, date 24.1.2018 çelja e buxhetit
Investime te brendshme	(3,103,613)	Shkrese e MBZHR nr.888/11,dt.26.4.2018, pakësim fondi
	3,103,613	Shkrese e MBZHR nr.8639/3,dt.22.10.18, shtese fondi dhe ndarje ne tre projekte investimi
	(345,000)	Shkrese e MBZHR nr.162/1,dt.16.01.19, Akti normativ nr.2 dt.19.12.2018, pakësim fondi
	56,655,000	Buxheti Dhjetor 2018

1.c) Realizimi i planit të buxhetit

Në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", neni 43 parashikon se, NA i njësisë së qeverisjes qendrore i paraqet NPA sa here i kërkohet informacion lidhur me buxhetin, por jo me pak se 3 herë në vit lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program.

Viti 2017

Nga auditimi u konstatua se,

Me Ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Zhvillimit Rural janë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale 2,311,843 mijë lekë. Referuar ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" dhe akte ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u ulur për shumën 1,528,108 mijë lekë. Plani i buxhetit përfundimtar për vitin 2017 është 783,735 mijë lekë. Për vitin 2017, AZHBR ka realizuar një buxhet total prej 677,737 mijë lekë ndaj 783,735 mijë leke buxhet përfundimtar i miratuar (ose realizuar plani me rreth 86.4%)., ku peshën më të madhe e kanë zënë shpenzimet shpenzimet korente rreth 61%.

Shpenzimet korrente

në mijë lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

4250	3- mujori	6 mujor	9-mujor	12- mujor
600	104,100	104,100	108,100	108,500
601	18,780	18,780	18,880	18,080
602	26,140	271,496	69,240	79,240
606	1,786,448	1,213,422	1,065,500	215,550
	1,935,468	1,607,798	1,261,720	421,370

Burimi: Sektori i Financës, AZHBR

Vihet re se buxheti në total i AZHBR në raport me buxhetin në fund të 3-mujorit të parë, ka një ulje me 1,514,098 lekë, në raport me buxhetin në fund të 6-mujorit një ulje me 1,186,428 lekë, ndërsa në raport me buxhetin në fund të 9 mujorit ka një ulje me 840,350 lekë.

në mijë lekë

4250	plan 2017	ndryshuar	pl.ndrysh 2017	fakt 2017	% realizimit
600	104,100	4,400	108,500	108,407	99.9%
601	18,780	-700	18,080	18,035	99.8%
602	26,140	53,100	79,240	77,963	98.4%
604					
606	1,786,160	-1,570,610	215,550	210,947	97.9%
	1,935,180	-1,513,810	421,370	415,352	98.6%

Burimi: Sektori i Financës, AZHBR

Fondet me plan thesari në 31.12.2017 janë realizuar në masën 98.6%, ku ndikim në mosrealizim e buxhetit ka ardhur si rezultat i bllokimi në fund të vitit të sistemit të thesarit duke lenë pa paguar disa pagesa të llogarite 606 dhe 602 të pa financuara.

Artikulli 600 "Pagat" ka përfshirë pagën bazë dhe shtesat mbi pagë, mbështetur në VKM nr. 589, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 610 datë 24.07.2013. Struktura e ABZHR dhe numri i punonjësve janë likuiduar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 156 datë 01.12.2015- "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AZHBR", i ndryshuar me Urdhrin nr. 190, datë 06.11.2017 (ku numri nga 123 u bë 133 punonjës).

Derdhja dhe likuidimi i kontributeve – artikulli 601 është bërë në përputhje me Ligjin nr. 184/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH", si dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" dhe VKM nr. 399. Datë 03.05.2017 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vend".

Artikulli 602 "Shpenzime operative" në shumën 77,963 mijë lekë është realizuar në respektim të limiteve të detajuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas shkresës nr. 341 datë 18.01.2017 "Detajimi i buxhetit për vitin 2017, për shpenzimet korrente". Nga auditimi rezultoi se, fondet e miratuara janë realizuar në masën 98.4%.

Krahas shlyerjes së nevojave bazë që janë shërbimi i rojeve, energji, ujë janë realizuar gjithashtu edhe blerje kancelari, materiale pastrimi, blerje karburant, furnizim dhe vendosje pajisje për mjete transporti, furnizime dhe materiale te tjera zyre, si dhe shpenzime për mirëmbajtje sisteme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

elektronike. Gjatë vitit 2017 janë likuiduar gjithashtu edhe detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore,

Artikulli 606 "Transferta nga buxhetet familjare" është realizuar në shumën 97.9% nga ku 201,706 mijë janë realizuar për "Skemën e mbështetjes në bujqësi" ose 99.8 % e shumës së planifikuar, 8,973 mijë lekë janë realizuar nga "Bashkëfinancim i IPA" ose 69% e shumës së planifikuar dhe 446,360 lekë janë realizuar nga "Fondi i veçantë" ose 100% e shumës së planifikuar. Bazuar në VKM-në nr. 482, datë 5.7.2017" për pezullim të përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017", AZHBR nuk ka kontraktuar investime deri me daljen e VKM-së nr. 580, datë 13.10.2017 "Për shfuqizimin e VKM së 482, e cila lejonte lidhjen e kontratave", por koha që institucioni ka pasur në dispozicion pas disbursimit të fondeve, ka qene e pamundur për kontraktimin e investimeve në llogarinë 606.

Investimet 231

	<i>në mijë lekë</i>			
4250	3- mujori	6 mujor	9-mujor	12- mujor
231	5,898	4,398	4,398	0
231 (tvsh)	318,965	318,965	318,965	318,965
231 (kosto lokale)	39,200	39,200	39,200	39,200
231 (IPARDI)	4,200	4,200	4,200	4,200
231 (Kosto Lokale)	7,000			
231 (tvsh IPA)	1,400			
231 (kredi)		285,000	285,000	22,000
231 (kredi)		152,000	152,000	
	376,663	803,763	803,763	384,365

Burimi: Sektori i Financës, AZHBR

Vihet re se buxheti i AZHBR në raport me buxhetin në fund të 3-mujorit të parë, ka një rritje me 7,702 mijë lekë, në raport me buxhetin në fund të 6-mujorit një ulje me 419,398 mijë lekë, ndërsa në raport me buxhetin në fund të 9 mujorit nuk ka ndryshime me 6 mujorin.

	<i>në mijë lekë</i>				
4250	plan 2017	ndryshuar	pl.ndrysh 2017	fakt 2017	% realizimit
231	5,898	-1,500	0	0	
231 (tvsh)	318,965	0	318,965	223,867	70.2%
231 (kosto lokale)	39,200	0	39,200	38,518	98.3%
231 (IPARDI)	4,200	0	4,200		
231 (Kosto Lokale)	7,000	-7000			
231 (tvsh IPA)	1,400	-1,400			
231 (kredi) BB		285000			
231 (kredi) BB		152,000			
	376,663	427,100	362,365	262,385	72.4%

Shkurtimi i fondeve në masën 82% nga MBZHR është vlerësuar si një vit me mangësi të theksuara të bazën ligjore të financimeve duke ulur ndjeshëm përfitueshmërinë nga subvencionet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural”

Përsa i përket fondeve të IPA 231, buxheti për këtë zë është një parashikim për kontratat që do të lidhen, fondet që do të alokohen dhe disbursohen. Pra nuk janë fonde me plan thesari, mbasi janë fonde të donatorit BE dhe transferohen në llogari të bankës së nivelit të dyte, me urdhër të Ministrit. Realizimi është bërë në përputhje me kontratat e lidhura dhe pagesat direkte të miratuara. Këto fonde janë audituar nga një kompani e pavarur ERK, rekrutuar nga MBZHR.

IBRD dhe STF janë fondet e Bankës Botërore në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore. Ndikim në mosrealizim ka patur mos fillimi i financimit të “Projektit të Shërbimeve Mjedisore” të Bankës Botërore. Deri në fund 31.12.2017, për “Projektin për shërbimet mjedisore” janë lidhur 62 kontrata me një vlerë totale shumë më të ulët se parashikimi 253,634 mijë lekë dhe kanë paraqitur kërkesa për pagesë 8 subjekte me një vlerë totale 52,868 mijë lekë, ku deri në 31.12.2017 asnjë pagesë nuk është ekzekutuar.

Viti 2018

Në zbatim të Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, AZHBR janë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale 3,297,786 mijë lekë. Referuar dhe akteve ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u ulur për shumën 751,269 mijë lekë.

Mbështetur në shkresën e MBZHR nr.888/1, datë.24.01.2018, për detajimin e buxhetit të vitit 2018 për AZHBR, si dhe në shkresën nr.19433/97, datë 17.01.2018 të Ministrisë së Financave, janë çelur fondet, sipas zërave të paraqitura më poshtë:

Shpenzimet korrente

	<i>në mijë lekë</i>				
4250	plan 2018	ndrysh	pl.ndrysh 2018	fakt 2018	% realizimit
600	119,400	-15,873	103,227	103,216	100.0%
601	22,200	-4,600	17,600	17,503	99.4%
602	72,000	10,753	82,753	79,879	96.5 %
606	2,565,000	-776,000	1,789,000	1,646,962	92.1%
606	0	162	162	162	100.0%
606	0	15,000	15,000	12,896	86.0%
Totali	2,778,600	-770,558	2,007,742	1,860,619	92.7%

Burimi: Sektori I Financës, MHK

Artikulli 600 “Pagat” përfshin pagën bazë dhe shtesat mbi pagë, në zbatim të VKM nr.589, datë 30.04.2018. Struktura e ABZHR dhe numri i punonjësve janë likuiduar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 156 datë 01.12.2015- “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AZHBR”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 190, datë 06.11.2017 (ku numri nga 123 u bë 133 punonjës) i ndryshuar me urdhërin nr. 140, date 17.09.2018 (ku numri nga 133 u bë 169 punonjës).

Artikulli 602 “Shpenzime operative” është detajuar me shkresën e MBZHR nr. 888/1, datë 24.01.2018. Rritje e llogarisë 602 është bërë për efekt të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të cilat kishim marrë formën e prerë përmes përmbartimit shtetëror. Krahas shlyerjes së nevojave bazë që janë shërbimi i rojeve, energji,, ujë janë realizuar gjithashtu edhe blerje kancelari, letër fotokopje, materiale pastrimi, furnizime dhe materiale te tjera zyre, si dhe shpenzime për mirëmbajtje sisteme elektronike



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural”

Artikulli 606 “Transferta nga buxhetet familjare” është realizuar në shumën 92% nga ku:

- 162 mijë lekë janë realizuar nga “Fondi i veçantë” ose 100% e shumës së planifikuar.

Ndërsa për shumën 1,659,859 lekë në zbatim të VKM nr. 72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, të ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët të MBZHR dhe MFE, i ndryshuar, si dhe në zbatim të kontratave në masat e investimeve 20-24,32-36,40,44-52, 50 subjektet kanë paraqitur kërkesat për financim të plotë 100% ose investime pjesore. AZHBR në mbyllje të vitit 2018 ka 105 kontrata aktive nga të cilat: 80 kontrata janë financuar 100%, 17 kontrata janë financuar 80% mbasi për herë të parë Udhëzimi i përbashkët kërkon pajisjen me licenca të subjekteve, 5 kontrata në masën e zhvillimit të agroturizmit, që për arsye të vështirësive të motit vlerësohen se duhet të trashëgohen në buxhetin e vitit 2019, 2 kontrata me cdoganime të vonuara që kërkojnë të mbarten në buxhetin e vitit 2019.

Në kushtet kur procesi i licencimit nga QKB zgjat 45 dite, kjo kalon përtej vitit buxhetor. Ashtu si edhe në vitet paraardhëse, VKM ja e vitit 2019 ka mbartur si detyrim fondin prej 83 mln leke si detyrim të prapambetur të vitit 2018. Ky fond është miratuar në VKM Nr. 128, datë 13.3.2019 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin”, pika 66. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2019, të përdoret shuma prej: a) 83 000 000 (tetëdhjetë e tre milionë) lekësh, për pagesën e vlerës së palikuiduar për subjektet e shpallur fituese nga AZHBR-ja, në zbatim të vendimit nr. 72, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, të ndryshuar;

Gjithashtu, për masat direkte të financimit mos realizimi i fondeve ka ardhur si rrjedhojë se:

- Fermerët u shpallen fitues me kusht që duhet të plotësojnë kushtin e derdhjes koherente të sigurimeve shoqërore, por nuk paraqitet dokumenta vërtetues.

- Fondi i parashikuar për masën e dorëzimit të qumështit nuk u realizuar buxheti mbasi numri i faturave të rregullta të depozituara në AZHBR ishte më i vogël, se buxheti i akorduar për këtë masë.

Investimet 231

në mijë lekë

4250	plan 2018	ndryshuar	pl.ndrysh 2018	fakt 2018	% realizimit
231	57,000	-345	56,655	47,044	83.0%
231 (tvsh)					
231 (kosto lokale)					
231 (IPARDI)					
231 IPA Përmbytjet	250,000	7,200	257,200	255,752	99.4%
231 (tvsh IPA)	20,000	-19,480	520	513	98.6%
231 STF GRANT	192,186	-113,186	79,000	77,549	98.2%
231 (kredi) IBRD		145,100	145,100	147,884	101.9%
Totali	519,186	19,289	538,475	528,742	98.2%

Burimi: Sektori i Financës, AZHBR



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural”

Ne llogarinë 231 “Investime”, Referuar Urdhërit të Ministrit të MBZHR, Nr. 20, datë 19.01.2018, “Për krijimin e Sporteve Unike të Shërbimeve për Fermerët”, u krijuan Agropikat si njësi të drejtpërdrejta në varësi të AZHBR-së, të cilat ofrojnë shërbime dhe informacion tek fermerët për programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ku në fund të muajt dhjetor ka përfunduar procesi i Rikonstruksionit të 15 Agropikave (supervizim, kolaudim dhe mobilim). Në mbyllje të vitit 2018 nga AZHBR-ja nuk janë likuiduar gjithë detyrimin e lindur nga kontrata “Rikonstruksion i 15 Agropikave”, për arsye të problematikave të konstatuara në Agropikën Berat. Shuma në total e likuiduar në 2018 është 42,598,075 lekë. Detyrimin në shumën prej 3,120,000 lekë është mbartur në buxhetin e vitit 2019. Mbështetur në shkresën e MBZHR nr.888/11, datë 26.4.2018 në zërin Rikonstruksion zyra dhe pajisje për 15 zyra të AZHBR ka pasur një pakësim të fondit në vlerën 3,103,613, fond i cili ka kaluar në zërin e projektit Studim, Projektim, Rikonstruksion.zyra dhe “Pajisje të 15 zyrave të AZHBR”. Ky shërbim u mundësua nëpërmjet donacionit dhe ky fond u rialokua me shkresë nr. 8639/3, datë 22.10.2018 për projektet e “Blerje pajisje kompjuterike” me vlerën 2,169,274 leke. Me shkresën 9831/1 date 20.11.2018 është pakësuar fondi ne projektin “Rikonstruksion zyra dhe pajisje për 15 zyra të AZHBR” me vlerën 5,287,303 lekë, duke çelur projektin “Blerje pajisje për Agropikat (Mobilje)”, ku realizimi i këtij projekti ishte ne vlerën 2,395,200 leke ose 45,3 % ne zbatim te kontratës se lidhur nga Agjencia e Blerjeve te Përqendruara me objekt prokurimi “Blerje pajisje për Agropikat (Mobilje) për AZHBR”

TVSH IPA 2013 nuk parashikohet nga AZHBR, por vetëm nga MBZHR. Paguhet vetëm TVSH për faturat e shërbimeve për MBZHR, me urdhër të ministrit.

IPA 231 – Buxheti i miratuar në Marrëveshje financimi, por realizimi 99,4 % mbasi disa investime të kontraktuara janë paguar me diference nga kontrata, mbas verifikimit ne terren.

STF dhe IBRD janë fondet e Bankës Botërore në kuadër të Projektit te Shërbimeve Mjedisore. Pagesat janë bere në dy forma: në bankat e nivelit te dytë dhe pagesa direkte nga llogaria ne Bankën Botërore. Fondet janë realizuar ne zbatim te kontratave. Realizimi ka qene 101 %.

1. ç) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore

AZHBR nuk realizon te ardhura nga veprimtaria e saj kryesore, apo veprimtari ekonomike dytësore.

Nga auditimi rezultoi se AZHBR në raportin periodike të monitorimit të buxhetit për periudhën 2017- 2018 , ka bërë një analizë të (mos) realizimit të zërave (artikujve) krahasuar me planin, si dhe një analizë të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizim, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ.

Nga subjekti është bërë vlerësimi i performance, nga ku është realizuar krahasimi i treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar.

- Nga subjekti në raportet e monitorimit janë evidentuar nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, duke propozuar veprimeve korrigjuese, duke rialokuar burimet, etj, me qëllim evidentimin e impaktit potencial në performancën e objektivave të lidhura me to.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Kryerja e raporteve të monitorimit në vetvete është hallkë e rëndësishme e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr.1438/4 datë 28.02.2019, mbi "Auditimin Financiar dhe Përputhshmërinë në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR)", u shqyrtuan dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organizative e AZHBR-së
- Listëpagesat dhe libri i pagave
- Pagesat e përfituara nga fondi i veçantë
- Dokumentet e personelit, dokumentet e largimit nga puna të punonjësve shoqëruar me motivacion, plani i nevojave për rekrutimin e personelit.
- Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil si dhe masat e marra nga institucioni në rastin ku punonjësi i larguar ka marrë një vendim të formës së prerë për pagesën e pagës deri në rikthimin e tij në punë.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural u krijua në datë 30.12.2008 në bazë të V.K.M. Nr. 1443 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), në Udhëzimin Nr. 3, datë 30.12.2008 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky institucion ka detyrë të ndjekë dhe zbatojë Ligjin për Bujqësinë Nr.9817, datë 22.10.2007 të VKM-ve përkatëse "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" si dhe "Për menaxhimin e fondit të mbështetjes për bujqësinë", të përcaktuara me udhëzime përkatëse.


Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të Nenit 21 të Ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", dhe të Nenit 10 të Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave.

Për vitin 2017, sipas organigramës të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 156, datë 01.12.2015, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)", deri në Urdhrin e Kryeministrit nr. 190, datë 06.11.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", AZHBR-ja ka funksionuar sipas strukturës së mëposhtme:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"



Nga auditimi u konstatua se:

Gjate periudhës 2017-2018, struktura e AZHBR-së ka ndryshuar:

1. Urdhër nr. 190, datë 06.11.2017 " Miratimi i Strukturës dhe Organikes se Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e pagesave). Numri i punonjësve ndryshoi nga 123 ne 133.
2. Urdhër nr. 140, datë 17.09.2018 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Numri i punonjësve ndryshoi nga 133 ne 169.


1. Organigrama e AZHBR-së për vitin 2017

Sipas organigramës të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 156, datë 01.12.2015, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)", deri në Urdhërin e Kryeministrit nr. 190, datë 06.11.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", AZHBR-ja ka funksionuar sipas strukturës së mëposhtme:




KONTROLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"



Sipas kësaj strukture njësia kryesore organizative e AZHBR-së ka qenë e organizuar mbi bazën e 6 drejtorive me 16 sektorë dhe 2 sektorë të varur direkt nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR: Sektori i Auditimit të Brendshëm dhe Sektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit, **me numër total 123 punonjës.**

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 190, datë 06.11.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", struktura e AZHBR është ndryshuar në përbërje dhe numër.



Totali 123



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

Struktura aktuale për vitin 2017 është shtuar me 10 punonjës, nga 123 në 133 punonjës dhe është e organizuar mbi bazën e 6 drejtorive me 15 sektorë dhe 4 sektorë të varur direkt nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR: Sektori i Auditimit të Brendshëm dhe Sektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit dhe Sektori i Përafrimit të Legjislacionit dhe Ndihmës së huaj.

Në varësi të Drejtorisë së Kontrollit dhe në funksion të kësaj janë inspektorët rajonalë të instaluar për periudhën raportuese pranë Drejtorive të Bujqësisë të qarqeve përkatëse me nga 2 - 4 inspektorë për çdo qark sipas madhësisë dhe peshës specifike rurale të çdo rajoni.

Me hyrjen në fuqi të VKM Nr. 877, datë 14.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 719, datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), si Agjenci e Pagesave", marrëdhëniet e punës të stafit të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil.

Sipas rregullores së Brendshme të AZHBR-së, objektivat dhe detyrat specifike të çdo njësie administrative të AZHBR gjatë vitit 2017 kanë qenë si më poshtë vijon:

1. Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Arovimit të Projekteve (DPAP)

Drejtoria (DPAP) është përgjegjëse për pranimin dhe regjistrimin e aplikimeve, kontrollin administrativ të tyre, vlerësimin, përzgjedhjen dhe renditjen e aplikimeve të pranuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me udhëzimet dhe procedurat përkatëse të MBZHR dhe MF.

2. Drejtoria e Autorizimit të Pagesave (DAP)

Drejtoria e Autorizimit të Pagesave (DAP), është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave administrative të autorizimit të pagesës, kryerjen e procesit të autorizimit të pagesave, duke kontrolluar kërkesat për pagesë dhe dokumentacionin bashkangjitur të dërguar nga përfituesi, pasqyrimi i listës së projekteve të autorizuar, marrjen e vendimeve të ndryshme në lidhje me procesin e punës si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sektorët dhe drejtoritë e tjera pjesë funksionale të AZHBR-së.

3. Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP)

Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP), është përgjegjëse për organizimin dhe implementimin e funksioneve të ekzekutimit të pagesave direkte tek përfituesi, për skemat kombëtare dhe të sigurojë transferimin e fondeve tek përfituesi të investimeve nga programe të ndryshme financimi si dhe programeve të para aderimit në bujqësi .

4. Drejtoria e Kontrollit (DK)

Drejtoria e Kontrollit (DK), është përgjegjëse për organizimin dhe kryerjen e kontrolleve në terren të projekteve të aprovuara të skemave kombëtare dhe atyre të IPARD, para kontraktimit, para pagesave dhe kontrolleve monitoruese të projekteve të financuara (ex-post), sipas procedurave të miratuara.

5. Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për mbështetjen, funksionimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së brendshme të AZHBR-së, në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe me legjislacionin e Bashkimit Europian në lidhje me IPARD.

Në varësi të DJSHM janë këta sektorë:

- a)Sektori i Burimeve Njerëzore (SBNJ),
- b)Sektori Juridik,
- c)Sektori i Teknologjisë së Informacionit (STI)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

d) Sektori Integritit dhe Harmonizimit të Procedurave (SIHP)

6. Drejtoria e Financës (DF) është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin financiar, ndjekjen dhe realizimin e buxhetit të shtetit, kontabilizimin e të gjithë aktivitetit financiar të AZHBR së, ndjekje e debitorëve të mbartur nga ish Projekti 2 KR apo të krijuar gjatë aktivitetit të AZHBR, në përputhje me Rregulloren e Brendshme .

7. Sektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) është krijuar dhe e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik. Fushat kryesore të veprimtarisë së auditimit të brendshëm kanë qenë vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në kuadër të krijimit dhe funksionimit të sistemit të pagesave në bujqësi, sistemit të prokurimeve, sistemit të pagave dhe pagesave, sistemit të vlerësimit, kontraktimit dhe pagesave të projekteve IPARD-like si dhe sistemit i funksionimit të Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse (DJSHM). Sektori i Auditimit të Brendshëm funksionon si njësi e pavarur nga Drejtoritë e tjera dhe i raporton direkt Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR, si Titullar institucioni.

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është e organizuar në rang sektori dhe përmban në organikën e saj 4 auditues (Përgjegjës sektori dhe tre specialistë), të miratuar në datën 01.12.2015, me Urdhër të Kryeministrit Nr. 156 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.

8. Sektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit (*SRPMAR*) e ngritur në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 156, datë 01.12.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)” është përgjegjëse për bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me riskun e Agjencisë për arritjen e objektivave, investigimin dhe raportimin e rasteve të parregullsive dhe mashtrimeve të identifikuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe funksioneve në AZHBR si dhe analizën dhe raportimin e aktiviteteve të AZHBR-së sipas procedurës së Raportimit.

Për vitin 2017 janë larguar nga puna 21 punonjës dhe është kërkuar pezullimi i statusit për 1 (një) punonjës,

- i. Ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të daljes në pension pleqërie 1 punonjës, (Inspektor).
- ii. Kanë kërkuar dorëheqjen për arsye personale 13 (trembëdhjetë) punonjës.(3 Drejtor Drejtorie, 4 Inspektor, 1 Përgjegjës Sektori, 4 Specialist, 1 Shofer)
- iii. Ka kërkuar pezullim të statusit 1 Drejtor drejtorie dhe 1 Specialist.
- iv. Ka ndërprerë marrëdhënien për shkak të përfundimit të kontratës së punës 1 Specialist dhe 3 inspektorë..
- v. Kanë lidhur kontratë pune 4 Inspektor dhe 1 Shofer si dhe janë transferuar pranë AZHBR-së nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike 2 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori, 1 inspektor dhe 1 specialist.

II-Me hyrjen në fuqi të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 140, datë 17.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, në strukturë shtohet një sektor në varësi të DPAP (Sektori i Asistencës Teknike), dhe 36 punonjës duke e rritur numrin total të punonjësve nga 133 në 169.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

2/1-Referuar Urdhërit të Ministrit të MBZHR, Nr. 20, datë 19.01.2018, “Për krijimin e Sporteve Unike të Shërbimeve për Fermerët” janë krijuar Agropikat si njësi të drejtpërdrejta në varësi të AZHBR-së që ofrojnë shërbim dhe informacion tek fermerët për programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Në vitin 2018 është krijuar “Agropika”- Sportel unik për shërbimin ndaj fermerit. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, janë vënë në funksion të shërbimit 5 Agropikat e para, përkatësisht në rrethet Fier, Lushnjë, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Nuk ka informacion për 15 Agro-pikat e tjera pasi në total numri i tyre është 20.

Sipas strukturës së miratuar 20 Agropikat e miratuara janë të pajisura me nga 2-3 punonjës sipas madhësisë dhe peshës specifike rurale të çdo rajoni, si dhe kanë varësi nga DPAP (Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve) dhe DK dhe kryejnë funksione informimi, aplikim dhe kontroll në terren për skemat kombëtare si dhe për fondet IPARD II.

Sportelet Agropika kryejnë shërbime për fermerët dhe subjekte të tjera, personat fizikë e juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari bujqësore apo veprimtari të tjera ekonomike të lidhura me të në fushën e zhvillimit bujqësor, të industrisë agroushqimore e zhvillimit rural, dhe ofrojnë shërbime, si më poshtë vijon:

- a) Informojnë dhe promovojnë programet dhe masat/skemat kombëtare të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- b) Informojnë dhe promovojnë programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë e zhvillimin rural të financuara nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë.
- c) Japin informacion për fondet e garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare e financiare për fermerët dhe subjektet e interesuara për mbështetje financiare në veprimtaritë e lidhura me zhvillimin bujqësor dhe rural.
- ç) Ndërmjetësojnë marrëdhëniet me institucionet financiare dhe ato bankare lidhur me kreditë e refuzuara/ristrukturuar.
- d) Japin informacion për legjislacionin për bujqësinë, veterinarinë, sigurinë ushqimore, agroturizmin, si dhe institucionet përgjegjëse rregullatore.
- dh) Regjistrojnë të dhënat e fermës bujqësore e blegtorale sipas përcaktimeve ligjore për hyrjen e të dhënave në regjistrat përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për database shtetërore.
- e) Asistojnë aplikimet online apo në bazë dokumentesh për masat/skemat kombëtare, programet IPARD II, si dhe të projekteve të tjera komunitare të donatorëve të ndryshëm.
- ë) Pranojnë aplikimet dhe raportojnë në vazhdimësi në sistemin e bazës së të dhënave të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në përputhje me afatet ligjore të miratuara për këtë qëllim, për mbështetjen financiare nga fondet e masave/skemave kombëtare.
- f) Inspektojnë fermerët dhe subjektet përfituese të fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.”

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, u konstatua se këto Agropika kanë funksionuar si njësi të drejtpërdrejta në varësi të AZHBR-së. Pesë Agropikat e para janë përkatësisht në rrethet Fier, Lushnje, Durrës, Vlorë dhe Korçë .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

Në përputhje me përshkrimet e reja të pozicioneve të punës dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2018, nga AZHBR /Drejtoria Juridike dhe e Shërbimeve Mbështetëse janë bërë lëvizjet e mëposhtme:

Janë liruar 30 nëpunës të shërbimit civil për shkaqe si më poshtë vijon :

- 21 nëpunës civilë për shkak të dorëheqjes së tyre, përkatësisht 1 Përgjegjës BNJ, 5 Inspektor DK, 3 Nëpunës në DJSHM, 3 Inspektor në DPAP IPARD, 1 Inspektor DAP Kombëtar, 2 Inspektor DEP Kombëtar, 1 Përgjegjës Kontabiliteti, 1 Specialist Promocion komunikim, 1 Inspektor DK IPARD, 1 Inspektor DK Kombëtar, 2 Inspektor DPAP IPARD.

- 5 nëpunës civilë të liruar për shkak të ligjit, përkatësisht: 4 Inspektorë nga DK për shkak të konstatimit të marrëdhënies së punës me Kod Pune, si dhe 1 Specialist nga sektori i Auditimit të Brendshëm.

- 4 nëpunës civilë të liruar për shkak të ristrukturimit, përkatësisht: 1 Drejtor në DAP, 1 Drejtor në DEP, 2 Inspektorë Kontrolli.

Janë kryer 63 procedura konkurimi për rekrutimin e stafit sipas Drejtorive dhe Sektorëve të mëposhtëm, përkatësisht :

- Për Drejtorinë e Ekzekutimit te Pagesave janë kryer 3 procedura rekrutimi;

- Për Drejtorinë e Kontrollit janë kryer 16 procedura rekrutimi;

- Për Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve janë kryer 14 procedura rekrutimi;

- Për Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave janë kryer 12 procedura rekrutimi;

- Për Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse janë kryer 3 procedura rekrutimi;

- Për Drejtorinë e Financës janë kryer 6 procedura rekrutimi;

- Për Sektorin e Promocionit dhe Komunikimit janë kryer 3 procedura konkurimi;

- Për Sektorin e Riskut, Parandalimit te Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit është kryer 1 procedurë rekrutimi;

- Për Agropikat Specialist Info-Aplikimi 5 procedura rekrutimi.

c. Janë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, 41 nëpunës sipas pozicioneve si më poshtë vijon:

- 4 nëpunës në pozicionet "Drejtor Drejtorie";

- 11 nëpunës në pozicionet "Përgjegjëse Sektori";

- 19 nëpunës në pozicionet "Inspektorë";

- 7 nëpunës në pozicionet "Specialistë".

Konstatohet se megjithëse për periudhën në auditim 2017-2018, organika e AZHBR-së është ristrukturuar dy herë, institucioni ka vazhduar të funksionojë me të njëjtën rregullore me nr.prot 810/2, datë 10.02.2016, e cila nuk i përshtatet ndryshimeve në strukturë (gjatë periudhës në auditim 2017-2018) duke sjellë mangësi në përgjegjësitë funksionale për çdo punonjës dhe rrjedhimisht në funksionet drejtuese për të marrë feed-back për punën e kryer sipas funksioneve të reja dhe të shtuara në strukturë.

Rregullorja e re për funksionimin dhe organizmin e administratës për AZHBR është miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2019, me nr.prot.97/1, datë 21.02.2019.

Procedura e ristrukturimit të organikës së AZHBR-se rritja e numrit të punonjësve nga 133 në 169 dhe krijimi i vendeve vakant rezultat i lirimit të punonjësve civilë për arsyt e përmendura më lart,



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

e shoqëruar me mos emërimin në kohë të punonjësve, rezultat i procedurave të ndërlikuara në DAP, ka bërë që shumë sektorë dhe drejtori për një periudhë të punojnë me staf të reduktuar në numër, disa herë pa strukturat drejtuese (drejtorët dhe përgjegjësat), duke krijuar mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat funksionale. Aktualisht ne organikën e AZHBR-së **janë 27 vende vakant.**

Nëpunësi përgjegjës (Përgjegjësi i sektorit juridik i komanduar me detyra shtesë) për mbajtjen e korrespondencës me Departamentin e Administratës Publike, ka pasur komunikim të vazhdueshëm në lidhje me çështjet të cilat i janë adresuar këtij institucioni, por jo një plan vjetor nevojash për rekrutim për sistemin, apo për drejtori të veçanta. Megjithatë në drejtim të DAP janë dërguar në mënyrë të njëpasnjëshme shpalljet për vende të lira për AZHBR-në, duke specifikuar sipas formularëve tip arsimin e nevojshëm që duhet por kjo e thënë në mënyrë të përgjithshme. Ndërkohë ky institucion nga auditimi që grupi i KLSH-së zhvilloi në terren, konstatoi se është shumë e nevojshme plotësimi i vendeve vakant me punonjës në profesionin “inxhinier ndërtimi/ elektrik etj, pasi në verifikimin e investimeve të realizuara u konstatua se për shumë nga punimet e kryera përdoret termi “E PAMATSHME”, nga inspektorët e kontrollit dhe pikërisht vlerat në lekë që i korrespondojnë këtij termi përbëjnë rreth 50 % të investimit, duke sjellë kështu një pamje jo të qartë për ne si auditues të jashtëm për të dalë në konkluzionin që burimet njerëzore janë përdorur me ekonomikitet, efikasitet dhe eficiencë. Në grupet e punës pothuajse të gjithë punonjësit janë në profilin jurist dhe ekonomist, të cilët i marrin të mirëqena punimet e ndërtimit të kryera nisur vetëm nga fasada dhe jo nga një analizë e hollësishme që mund të kryente vetëm një inxh/ndërtimi.

Konkretisht nisur nga struktura kemi:

Drejtoria e Kontrollit – 60 punonjës, nga këta me profil inxh.ndërt 2.

Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve –23 punonjës, nga këta me profil inxh.ndërt 2.

DAP-Drejtoria e Autorizimit të Pagesave—9 punonjës nga këta me profil inxh.ndërtimi 1.

Pra nga sa më sipër në institucionin e AZHBR-së janë gjithsej 4 inxhinier ndërtimi.

Nga sa më sipër Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Burimeve njerëzore duhet të marrin masa të menjëhershme që në formularët tip për rekrutimin e punonjësve të rinj të specifikohet që niveli i edukimit të jetë në fushën inxhinierike, me qëllim arritjen e objektivave të AZHBR-së, në detyrat funksionale të saj.

Situata:	Nga auditimi i organigramës së AZHBR-së, u konstatua se struktura organike e këtij institucioni ka ndryshuar dy herë për një periudhë një –vjeçare e cila korespondon me periudhën në auditim 2017-2018, konkretisht sipas Urdhrit nr. 190, datë 06.11.2017 “ Miratimi i Strukturës dhe Organikës se Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e pagesave), numri i punonjësve ndryshoi nga 123 ne 133 dhe sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018 “ Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka ndryshuar nga 133 ne 169 dhe aktualisht në fakt numri i punonjësve është 129 pra ka një mungesë prej 40 punonjes.. Procedura e ristrukturimit të organikës së AZHBR-së, rritja e numrit të punonjësve nga 133 në 169 dhe krijimi i vendeve vakant është si rezultat i lirimimit të punonjësve civilë për arsyet e përmendura më
----------	---



KONTROLLI I LARTË T SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

	lart, e shoqëruar me mos emërimin në kohë të punonjësve, rezultat i procedurave të ndërlikuara në DAP, ka bërë që shumë sektorë dhe drejtori për një periudhë të punojnë me staf të reduktuar në numër, disa herë pa strukturat drejtuese (drejtorët dhe përgjegjësat), duke krijuar mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat funksionale. Këto lëvizje të shpeshta kanë ndikuar në performancën e institucionit dhe stafit, si dhe kosto financiare për AZHBR-në.
Kriteri:	Urdhri nr. 190, datë 06.11.2017 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e pagesave), dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.
Ndikimi/Efekti:	Mosplotësimi i vendeve vakante, krijon mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat funksionale.
Shkaku:	Mosplotësimi i vendeve vakant nga DAP dhe megjithë shtimin në strukturë të numrit të punonjësve, numri i vendeve të paplotësuara është 27
Rëndësia:	I mesëm

b. Mbi realizimin e fondit të pagave, respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe të punonjësve të tjerë, sipas kategorive të pagave.

Pagat e punonjësve në AZHBR janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar Ligjit Nr. 152/2013, PËR NËPUNËSIN CIVIL (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017 datë 03.03.2017), Vkm Nr.187, datë 8.3.2017 –“ Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucionit dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, VKM nr. 60, datë 31.01.2018, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore.

Spektori i burimeve njerëzore i cili gjatë periudhës nën auditim ka qenë në varësi të Drejtorisë Juridike me një strukturë 1+3 specialistë dhe dy punonjës me kontratë (shofer + punonjës pastrimi).

U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve korrik –gusht- shtator 2017 dhe tetor-nëntor- dhjetor 2018. Në listëpagesat e zgjedhura u audituan numri i punonjësve të paguar me kohë të plotë, paga sipas funksionit, shtesat e veçanta, prezenca, vjetërsia, llogaritja e ndalesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, etj.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listë prezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo Drejtorie dhe përgjegjësat respektivë si dhe janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës /Anxhela Meta dhe Titullari i Përgjithshëm.

Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara. Tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ndërsa kontributi i sigurimeve shoqërore është llogaritur në zbatim të Ligjit nr. 10070, datë 05.02.2009 “Për sigurimet shoqërore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Burimeve dhe Rural"

në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, si dhe janë kryer ndalesat, të cilat janë derdhur në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve. Nga auditimi i strukturës për periudhën në auditim, u konstatua se, në organikën e AZHBR-së nuk ka të punësuar me kontratë të përkohshme.

Shpenzime Personeli (600+601)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 ka qenë 119,400,000 lekë, me shkresën e MBZHR nr. 8202, datë 15.08.2018 ka një pakësim në buxhetin e këtij zëri me vlerë 300,000 lekë. Gjithashtu me shkresën e MBZHR nr. 9992/3, date 26.11.2018 fondi i pagave ka pasur një pakësim prej 10,753,073 lekë. Akti normativ nr. 2 i datës 19.12.2018 ka pasur edhe një tjetër pakësim në këtë zë të buxhetit prej 5,120,000 lekë.

Fondi i planifikuar për zërin shpenzime personeli për periudhën Janar– Dhjetor 2018 është 103,226,927 lekë, fondi i realizuar është 103,215,984 lekë ose 99.9 %. Fondi i sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit për periudhën Janar- Dhjetor 2018 me Aktin normativ nr. 2 të datës 19.12.2018 ka pasur një pakësim prej 4,600,000 lekë. Fondi i planifikuar ka qenë 17,600,000 lekë dhe është realizuar 17,502,684 leke ose 99.4%.

Numri i punonjësve në buxhetin e vitit 2018 është miratuar 133, ndërsa me Urdhërin e Kryeministrit nr.140, datë 17.09.2018, është ndryshuar organika e AZHBR dhe ka pasur një shtesë, të numrit të punonjësve në 169.

Në mbyllje të vitit 2018 numri faktik i punonjësve të AZHBR-së është 124.

Në AZHBR kryhen vlerësime periodike të punonjësve, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësive të tyre.

Vlerësimi i punonjësve bëhet periodikisht, sipas Udhëzimit specifik për vlerësimin e performacës. Përgjegjës për menaxhimin e procesit të vlerësimin është Drejtori i DJSHM dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive. Ndërsa Përgjegjëset e Sektorëve, Drejtorët e Drejtorive dhe Titullari i institucionit janë ata që bëjnë vlerësimin e performancës së rezultateve të punës së stafit që kanë në varësi.

Për vitin 2017 dhe 2018 Sektori i Burimeve Njerëzore ka ndjekur procesin e vlerësimit 6-mujor të performancës për punonjësit e AZHBR-së.

a) Në vitin 2017 janë vlerësuar 110 (punonjës duke përjashtuar vendet vakante, punonjësit me leje lindje, punonjësit në kohë prove/punonjës të rinj) nga të cilët janë vlerësuar me 1 (shumë mirë) 34 punonjës ose 30.9 %, me 2 (mirë) janë vlerësuar 45 punonjës ose 40.9 %, me 3 (kënaqshëm) 16 punonjës ose 14.54 % dhe me 4 (jo kënaqshëm) 15 punonjës ose 13.66%.

b) Në vitin 2018 janë vlerësuar 103 (punonjës duke përjashtuar vendet vakante, punonjësit me leje lindje, punonjësit në kohë prove/punonjës të rinj) nga të cilët janë vlerësuar me 1 (shumë mirë) 41 punonjës ose 40%, me 2 (mirë) janë vlerësuar 33 punonjës ose 32.5 %, me 3 (kënaqshëm) 23 punonjës ose 22.5 % dhe me 4 (jo kënaqshëm) 5 punonjës ose 5%.

- Në lidhje me respektimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

Nga dhënia e shpërblimeve dhe ndihmave në kryerjen e detyrave u konstatua se gjatë vitit 2017 fondi i veçantë është përdorur në shumën prej 446,360 lekë dhe gjatë vitit 2018 është përdorur në shumën prej 162,000 lekë, pagesat e të cilëve janë bërë pas miratimit nga MFE.

- Zbatimi i vendimeve të gjykatës

Për vitin 2017, për punonjësit e larguar nga puna janë paguar shuma prej 23,184,815 lekë, të gjitha pas vendimit të formës së prerë, ndërsa për vitin 2018 janë paguar 6,176,150 lekë. Për periudhën objekt auditimi, nga institucioni janë bërë planifikime buxhetore në lidhje me këto shpenzime. Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", AZHBR ka krijuar bazën e të dhënave si dhe është ngritur Komisioni i Posaçëm "Për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë.

3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE DHE MONETARE.

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit nr. 1438/4, datë 28.02.2019, mbi "Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në AZHBR", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarëkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim.

- Transaksionet e llogarive bankare

- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës

- Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësisimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Drejtorin e Financës së AZHBR, veprimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre", i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore", i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji.

Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime në përgjithësi nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Nga institucioni është bërë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë viteve 2017-2018. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve në *ditarin e shpenzimeve*, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike në kohë me programin Financa 5. Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve

- Janë kryer pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

- Për periudhën ushtrimore 2017 janë zhvilluar 16 prokurime me vlerë të vogël për mallra e shërbime, si dhe blerje bileta avioni në shumën prej 6,733,000 lekë me TVSH.

- Për periudhën ushtrimore 2018 janë zhvilluar 33 prokurime me vlerë të vogël për mallra e shërbime në shumën prej 10,270,756 lekë me TVSH

b. Saktësia dhe rregullueshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për vitin 2017 dhe 2018. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë-hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina bëhet me programin Financa 5. Fletë hyrje dhe fletë dalje, ndjekin rendin kronologjik, ku ka adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli.

Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve;

- Për hyrjet e aktiveve të dhuruara rezultoi se dokumentacioni shoqërues përbëhet nga fatura që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Procesverbali i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve, si dhe është bashkëngjitur kontrata e grandit së njësisë donatore.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Nga auditimi u konstatua se Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “...për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...

Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 276, datë 19.12.2017 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aseteve të AZHBR" dhe nr. 6668, datë 31.12.2018 për vitin 2018 ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit dhe së fundmi plotësimin e procesverbalit me listën e materialeve që vlerësohen pa vlerë dhe për nxjerrje jashtë përdorimit.

Në vitin 2017, krahasuar me inventarin e vitit 2016, rezulton se në inventarin e AQT, ka pasur ndryshime si rrjedhojë e blerjeve, transferimeve dhe daljes jashtë përdorimi të ndodhura gjatë vitit. Në përfundim të inventarizimit komisioni ka hartuar relacionin mbi përfundimin e inventarizimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, para fillimit të inventarit është fokusuar numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve, si dhe është mbajtur një proces verbal midis palëve. në përputhje me pikën 83 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011.

Për vitin 2017

- "Ndërtime e konstruksione" (llog. 212) paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 65,177,039 lekë. Kjo vlerë është e përbërë nga vlera bruto e godinës së AZHBR-së
- Llogaria 215 "Mjete Transporti", paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 22,449,122 lekë dhe përfaqëson vlerën e 8 automjeteve në dispozicion të AZHBR-së.
- Llogaria 218 "Inventar ekonomik" paraqitet në vlerën prej 55,539,283 lekë dhe sipas inventarit ka ndryshime, pasi janë bërë hyrje nga brenda sistemit në shumën prej 6,265,235 lekë të dhuruara nga GIZ pajisje informatike në shumën 6,265,235 lekë, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje, ku është bashkëngjitur i gjithë dokumentacioni shoqërues si Marrëveshja/akti i dhurimit; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Procesverbalin i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve.

Për vitin 2018

- "Ndërtime e konstruksione" (llog. 212) paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën prej 65,177,039 lekë e godinës së AZHBR-së plus 43,104,315 lekë rikonstruksioni i Agropikave.
- Llogaria 215 "Mjete Transporti", paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 31,933,871 lekë dhe përfaqëson vlerën e 10 automjeteve në dispozicion të AZHBR-së, ku për dy automjete në vitin 2018 janë bërë transferim kapitali 2 mjete transporti, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 446, datë 16.11.2018 në vlerën 6,612,810 lekë
- Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" paraqitet në vlerën prej 640,852 lekë ku janë hyrje pa pagesë, e një sere të dhuruara nga donator.
- Llogaria 218 "Inventar ekonomik" paraqitet në vlerën prej 70,294,746 lekë e cila ka pasur ndryshime, pasi janë bërë hyrje nga jashtë dhe brenda sistemit në shumën prej 10,606,303 lekë, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje, ku i është bashkëngjitur i gjithë dokumentacioni shoqërues si Marrëveshja/akti i dhurimit; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Procesverbalin i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural”

Në formatin nr. 1 “Gjendja Inventarit” për vitin 2017 në vlerën 50,782,381 lekë janë të pasqyruara sipas zërave dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

28	Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit	50,782,381	49,231,748
29	31	Materiale	10,196,439	8,982,065
30	32	Objekte inventari	3,857,182	3,520,923
31	33	Prodhime, punime e shërbime ne proces		
33	35	Mallra	36,728,760	36,728,760

Llogaria 31 “Materiale”, paraqitet në vlerat 10,196,439 lekë, sipas inventarit të magazinës të datës 31.12.2017 dhe në krahasim nga viti paraardhës është rritur për shumën 1,214,374 lekë. Ndërsa llogaria 32 “Objekte inventari” paraqitet në vlerën prej 3,857,182 lekë referuar inventarit më 31.12.2017 dhe përfaqëson gjendjen e materialeve kancelari.

Në llogarinë 31 & 32 është përfshirë dhe vlera e karburantit dhe pjesë këmbimi për mjetet e transportit.

Llogarinë 35 “Mallra” paraqitet në vlerat 36,728,760 lekë, sipas inventarit të realizuar është mall i transferuar që nga bilancet e mëparshme të trashëguar nga 2KR, për të cilën janë në proces shitjeje në ankand nga institucioni.

Në formatin nr. 1 “Gjendja Inventarit” për vitin 2018 në vlerën 49,522,356 lekë janë të pasqyruara sipas zërave dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

28	Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit	49,522,356	50,782,381
29	31	Materiale	8,110,657	10,196,439
30	32	Objekte inventari	4,682,939	3,857,182
33	35	Mallra	36,728,760	36,728,760

Llogaria 31 “Materiale”, paraqitet në vlerat 8,110,657 lekë, sipas inventarit të magazinës të datës 31.12.2017 dhe në krahasim nga viti paraardhës është ulur për shumën 2,085,782 lekë. Ndërsa llogaria 32 “Objekte inventari” paraqitet në vlerën prej 4,682,939 lekë, referuar inventarit më 31.12.2018 dhe përfaqëson gjendjen e materialeve kancelari.

Komisioni i inventarizimit ne relacion e vitit 2017 është shprehur se lëvizja e mjeteve elektronike janë bërë pa procesverbale, ku është lënë si detyrë që në vazhdimësi lëvizja e tyre të bëhet sipas rregullave të përcaktuar dhe të ketë penalizime për punonjësit që nuk mbajnë procesverbal lëvizja e mjeteve fikse dhe elektronike.

Nga komisioni është konstatuar se punonjësit të cilët janë larguar nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e mjeteve të cilat kanë pasur në ngarkim, për të cilat duhet të ishte bërë hyrje e mallit në magazine. Nga komisioni për këto vlera është krijuar një kartelë e mjeteve në ruajtje.

Nga numërimi fizik komisioni ka konstatuar se në magazinë ka artikuj të trashëguar nga 2016 “Artikuj të dëmtuar në magazinë”, ku përveç tyre nga inventarizimi është konstatuar dhe artikuj të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

tjerë të dëmtuara. Komisioni ka konstatuar dhe një shumë prej 276,010 lekë të artikujve që mungojnë.

Nga komisioni i vlerësimit të aktiveve i ngritur me urdhërin nr. 61 datë 27.03.2017 ka bërë propozim për daljen jashtë përdorimi të aktiveve, për të cilat citojnë se një pjesë e këtyre materialeve dhe pajisjeve e kanë kaluar afatin e përdorimit dhe janë jashtë funksioni. Komisioni është mbështetur për inventarizimin e realizuar në 2016.

- Në Llogarinë 218 "Inventar ekonomik" nga Drejtoria e financës në MBZHR, për këto aktive që janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimi dhe do asgjësohen kanë zbritur shumën e amortizimit të akumuluar ndër vite për to, në shumë prej 186,298 lekë të amortizimit të akumuluar të llogaritur ndër vite

- Në relacionin e vitit 2018 komisioni ka konstatuar aktive jo në përdorim në vlerën prej 1,162,975 lekë, si dhe artikujve që mungojnë në shumë prej 1,126,415 lekë që janë të trashëguara.

Nga komisioni janë konstatuar dublime në regjistrimin e aseteve për të cilat i janë paraqitur drejtorisë përkatëse për sistemim, ku është bërë rregullimi kontabël për vitin 2018.

Për të dy vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj etj. Në relacion nuk është paraqitur gjendja fizike e pajisjeve kompjuterike që AZHBR disponon fizikisht.

Për vitin 2017, në relacion shuma e mallrave që mungojnë janë në shumën prej 290,914 lekë, ndërsa në relacionin e komisionit të vitit 2018 është evidentuar mungesë e inventarit në shumën prej 1,126,415 lekë, pa dhënë sqarime të mëtejshme se kush janë personat përgjegjës apo nga kusht është shkaktuar mungesa.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se komisioni i inventarizimit nuk ka bërë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, dhe për diferencat konstatuara për të dy vitet të mbante një procesverbal, i cila është përgjegjësi e komisionit. Procesverbali për mungesën e konstatuar se bashku me dosjen e inventarizimit dhe relacionin i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm (NA)., pasi është NA, që vë në lëvizje NZ për të marrjen masave të mëtejshme për kompensimin apo sistemimin e diferencave të konstatuara.

Pra, nga institucioni nuk ka procedura të mëtejshme për të ngarkuar me përgjegjësi personat që i kanë pasur në ngarkim këto asete, si dhe për të vazhduar procedurat për kompensimin e vlerës të tyre.

Situata:	Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" u konstatua se, komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një ndarje të tyre sipas zërave: vlera total për pajisje informatike, vlera total për vegla pune, mobilieri e pajisje zyre, kondicioner, etj sipas formatit të regjistrit
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural”

	të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit, por i ka grupuar në total në dy zëra “inventar ekonomik” dhe “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”.
Kriteri:	Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74, pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion
Shkaku:	Mos rakordim nga komisioni i çdo zëri të aseteve me regjistrin kontabël.
Rëndësia:	I mesëm

Situata:	Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se komisioni, për të dy vitet objekt auditimi ka konstatuar diferenca, për të cilat nuk janë dhënë sqarime të mëtjshme se kush janë personat përgjegjës apo nga kusht është shkaktuar mungesa. Për diferencat e konstatuara, komisioni nuk ka përpiluar një procesverbal, nëpërmjet të cilit vihet në dijeni instancat përkatës, për marrjen e masave të mëtjshme për kompensimin apo sistemimin e diferencave të konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 85, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” neni 85.
Ndikimi/Efekti:	Mosngarkimi me përgjegjësi i personave, riskon moskompensimin e vlerave të munguara.
Shkaku:	Mosdorëzimi i materialeve në ngarkim, nga personat e larguar.
Rëndësia:	I mesëm

Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina.

Për vitin 2017 ka pasur aktive të propozuar për jashtë përdorimi nga komisioni i inventarizimit. Drejtori i Përgjithshëm me urdhër nr. 60, datë 27.03.2017 ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi, i cili ka mbajtur proces verbalin e vlerësimit, pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: Relacioni i bërë nga komisioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Komisioni ka propozuar daljen jashtë përdorimi të aseteve në shumën 567,037 lekë, të cilat janë bërë dalje shoqëruar me fletë dalje nga magazina.

Ndërsa për vitin 2018 është ngritur Komisioni me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 217, datë 30.07.2018 “Për ngritjen e komisionit për aktivet e propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimi”, ku mbështetur në procesverbalin e Komisionit të vlerësimit të daljes jashtë përdorimi i ngritur me urdhërin nr. 1632/1, datë 22.05.2018, vendosi nxjerrjen jashtë përdorimi të artikujve në vlerën 4,839 lekë, për të cilat janë bërë të gjitha veprimet në përputhje me kuadrin ligjor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL

a. Mbatja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në, Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për vitin 2017-2018 është bërë në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj".

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj", ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 27.02.2008.

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat e bilancit (aktiv-pasivin), pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas burimit, lëvizjet e CASH-it, aktivet me vlerën bruto dhe pasqyrën e amortizimit si dhe relacionin shpjegues. Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Veprimet e regjistrimit të transaksioneve në kontabilitet janë regjistruar në ditarët respektiv, të bankës, magazinës, etj.

Bilanci i vitit 2017 është hartuar dhe depozituar më datë 27.02.2018 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë. Pasqyra financiare është e firmosura nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues.

Viti 2017

b. Llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve

Në pasqyrën e shpenzimeve të periudhës ushtrimore 2017, në formatin nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 1,550,633 lekë të ndara sipas zërave si (600) "Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli" në vlerën 107,688 mijë lekë ose 26 % të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2017. Llog. (601) "Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore" në vlerën 17,933 mijë lekë ose 4.3 % të totalit të shpenzimeve,

Llog. (602) "Mallra dhe shërbime të tjera" në vlerën 77,963 mijë lekë ose 19% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2017. Nga auditimi u konstatua se subjekti ka të regjistrua detyrimet për 12 muaj ndaj enteve publike për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

shërbime të marra të energjisë dhe ujit, të cilat janë kontabilizuar, ku pagesa e tyre është bërë brenda afateve ligjore,

Llog. (606) "Transferta për buxhete familjare e individët" në vlerën 210,946 mijë lekë ose 51 % të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën 1,550,633 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 "transferim për ndryshim gjendje inventari" në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 janë si më poshtë:

Në lekë

Nr.llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
b	c	2017	2016
Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	412,981,346	1,764,631,637
60	I. Shpenzime Korrente	414,531,979	1,765,484,843
600	Paga,shpërblime e te tjera personeli	107,688,487	103,261,444
6001	Paga, personeli i përhershëm	107,688,487	102,722,438
6002	Paga, personel i përkohshëm		
6003	Shpërblime		
6009	Shpenzime tjera personeli		539,006
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	17,933,578	17,623,015
6010	Kontribute për sigurimet shoqërore	16,101,756	14,491,431
6011	Kontribute për sigurimet shëndetësore	1,831,822	3,131,584
602	Mallra dhe shërbime të tjera	77,963,293	202,680,631
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	1,381,108	1,205,159
6021	Materiale dhe shërbime speciale		128,952,422
6022	Shërbime nga te trete	39,170,157	40,490,423
6023	Shpenzime transporti	3,949,258	3,982,302
6024	Shpenzime udhëtimi	5,119,317	5,323,224
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,601,160	3,523,139
6026	Shpenzime për qiramarrje		
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	23,949,837	9,066,099
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
6029	Shpenzime të tjera operative	2,792,456	10,137,863
603	Subvencionet		
604	Transferime korrente të brendshme		
605	Transferime korrente me jashtë		
6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja		
606	Transferta për buxh.familjare e individe	210,946,621	1,441,919,753
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga inst te tjera e Org. Pushtet Vendor	210,946,621	1,441,919,753
63	II. Ndryshimi I gjendjeve të inventarit (+ -)	-1,550,633	-853,206
68	III. Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara		



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

681	Kuotat e amortizimit të shfrytëzimit		
65, 66	B. SHPENZIME FINANCIARE(I+II)		
67	C. SHPENZ.TE JASHTEZAKONSHME		
Klasa 6	TOTALI I SHPENZIMEVE	412,981,346	1,764,631,637
82,83,84	D. OPERAC.KORIGJ.REZULTATIT	2,407,016	1,209,796
8420	Derdhje të ardhura në buxhet	856,383	356,592
8423	Transferime për ndrysh gjendje	1,550,633	853,204
8424	Transferim për debitorë të konstatuar e të ngjashme		
Klasa 6 e 8	TOTALI OPERACIONEVE	415,388,362	1,765,841,433
85	REZULTATI NGA FUNKSIONIMI	0	
X	TOTALI	415,388,362	1,765,841,433

- Format nr. 3/1 "Shpenzime të ushtrimit", nga auditimi rezultoi se formulat e miratuara nga Ministria e Financave ishin zbatuar. Janë kryer veprimet përkatëse si llogaria 85 e formatit nr. 3/1 e barabartë me llog. 85 në pasiv të bilancit kontabël. Ndryshimi i gjendjes në formatin nr. 3/1 ishte e barabartë me diferencën e klasës 3 në aktiv të bilancit, si dhe llogaritë 8423 e paraqitur në formatin nr. 3/1

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me thesarin ku konstatohet se: Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimin me degën e thesarit Tiranë "Mallra dhe shërbime të tjera", sipas bilancit paraqiten në vlerën 77,963,293 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 70,095,754 lekë si dhe xhirime të brendshme në shumën 580,424 lekë, ku diferenca prej 7,287,115 lekë vjen si rezultat diferencës së faturave 2017 (të konstatuara në 2017 dhe që do paguheshin në periudhat e ardhshme në shumën prej 13,138,166 lekë) me faturat e 2016 (të konstatuara në 2016 dhe paguara në 2017 në shumën 5,851,051 lekë).

Rezultoni se pagesat e realizuara në janar për efekt të buxhetit të vitit që u mbyll janë konstatuar si detyrime ndaj të tretëve me 31 Dhjetor 2017.

Paga, shpërblime e të tjera personeli sipas bilancit paraqiten në vlerën 107,688,487 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 108,407,040 lekë, ku diferenca prej 718,553 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2017 (të konstatuara në 2017 dhe paguar në 2018) me atë të dhjetor 2016 (të konstatuara në 2016 dhe paguara në 2017). "Paga, shpërblime e të tjera personeli" në pasqyrën financiare në formatin nr. 3/1 është pasqyruar totali për periudhën Janar-Dhjetor, ku vlera e pagave Dhjetor kalon në thesar në janar të vitit pasardhës. E njëjti fenomen ndodh dhe me llogarinë 601 "Kontributeve të sig. shoq. e shëndetësore" sipas bilancit paraqiten në vlerën 17,933,578 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 18,034,969 lekë, ku diferenca prej 101,391 lekë vjen si rezultat diferencës së kontributeve të dhjetor 2017 (të konstatuara në 2017 dhe paguar në 2018) me atë të dhjetor 2016 (të konstatuara në 2016 dhe paguara në 2017)

"Transferta për buxh. familjare të individëve", sipas bilancit paraqiten në vlerën 210,946,621 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 371,224,246 lekë, ku diferenca prej 160,277,625 lekë vjen si rezultat diferencës së faturave 2017 (të konstatuara në 2017 dhe që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

do paguhen në periudhat e ardhshme në shumën prej 3,869,578 lekë) me faturat e 2016 (të konstatuara në 2016 dhe paguara në 2017 në shumën 164,147,205 lekë).

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	414,531,979	568,342,433	-153,810,454
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	107,688,487	108,407,040	-718,553
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	17,933,578	18,034,969	-101,391
602	Mallra dhe shërbime te tjera	77,963,293	70,676,178	7,287,115
605	Transferta korente me jashtë			0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	210,946,621	371,224,246	-160,277,625

Nga auditimi i dokumentacionit të monitorimit të buxhetit dhe të pasqyrave financiare rezulton se ka rakordim ndërmjet treguesve të realizimit të buxhetit dhe Pasqyrave financiare për vitin 2017, të cilët kanë përputhje.

- Formatin nr. 3/2 "Të ardhurat e ushtrimit", në përfundim të auditimit rezultoi se janë hedhur të ardhurat e shfrytëzimit, si të ardhurat jo tatimore, e përbërë nga "Zhdëmtim- shume marrë mbi kuotë", pasi institucioni nuk ka të ardhura parësore dhe dytësore.

Edhe në këtë format, në përfundim të llogaritjeve nga grupi i auditimit, rezultoi se kishte gjetur zbatim formulat e miratuar nga Ministria e Financave, ku formatin nr. 3/1 nuk kishte diferencë me formatin nr. 3/2. Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i të ardhurave të pasqyrës 3/2 me thesarin, ku nuk u konstatua diferencë.

Në lekë

Klasifikimi	Përshkrimi	Shuma e Arkëtuar	Pjesë e institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbetur për tu trashëguar
7115600	Zhdëmtim- shume marrë mbi kuotë	856,383			856,383	
	Shuma	856,383	0	0	856,383	

Në lekë

34	71	III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)	856,383	356,592
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	856,383	356,592
36	7100	- Nga nderm.publike jo financiare		
37	7101	- Nga nderm.publike financiare	856,383	336,413
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		20,179
39	711	b) Shërbime administ.e ardhura sekondare		
47	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore		

Në pasqyrën e të ardhurave në formatin nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (grant) në shumën 396,947,298 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit në vitin 2018 në vlerën 17,584,681 lekë, që ka të bëjë me detyrimet e konstatuara në 2017 (përkatësisht për llogarinë 602-606) dhe që do të likuidohen me fondet buxhetore të 2018.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

Rakordohen, llogariten dhe regjistrohen në llogarinë 4342 "Marrëdhënie me shtetin debitor" detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara dhe që parashikohen të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhshëm, me veprimin kontabël debi llogaria e mësipërme 4342 "Të tjera operacione me shtetin" në kredi të llogarisë 7206" Financim i pritshëm nga buxheti".

Grante korente Format 3/2:

Në lekë

48	72	IV.GRANTE KORENTE(a+b)	414,531,979	1,766,017,011
49	720	a) Grant korent I brendshëm	414,531,979	1,766,017,011
50	7200	- Nga I njëjti nivel Qeverisje	396,947,298	1,747,731,830
51	7201	- Nga nivele tjera Qeverisje		
52	7202	- Nga buxheti për pagesa posaçme të ISSH		
53	7203	- Nga buxheti për mbul.deficiti të ISSH e ISKSH		
54	7204	- Pjesëmarrje instit.ne tatime nacionale		
55	7205	- Financ. shtese nga të ardh. kriju. brenda sistemit		
56	7206	- Financim I pritshëm nga buxheti	17,584,681	18,285,181
57	7207	- Sponsorizime nga të trete		
58	7209	- Të tjera grante të brendshme		
59	721	b) Grant korent I jashtëm		

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Pasqyrat financiare të vitit 2017 (llogaria vjetore 2017) është përpiluar nga Sektori i Financës dhe dhe konfirmuar nga Drejtori I përgjithshëm. Kopja e bilancit është dërguar në MBZHR me shkresën nr. 655 datë 28.02.2018.

Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2017 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Aktivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2017.

Në lekë

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi I Paraardhës
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	726,976,162	475,441,510
3	20, 230	I. Te pa trupëzuara	22,012,649	22,012,649
4	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave		
5	202	Studime dhe kërkime	21,674,642	21,674,642
6	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	338,007	338,007
7	209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara(-)		
8	230	Shpenzime për rritjen e aktiv. qendr. patrupëzuara		
9	21,23,24,28	II.Akt.Qendr.te Trupëzuara	704,963,513	453,428,861
10	210	Toka,troje, Terene		
11	211	Pyje,Kullota Plantacione		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

12	212	Ndërtime e Konstruksione	65,177,309	65,177,309
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
14	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune		
15	215	Mjete transporti	25,321,061	25,321,061
16	216	Rezerva shtetërore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	55,539,283	49,841,085
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr. te trupëzuara(-)	(43,017,203)	(33,338,721)
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale		
22	24	Aktive te Qendr. te trupëzuara te dëmtuara		
23	28	Caktime	601,943,063	346,428,127
24	25.26	III. Aktive Financiare		
25	25	Huadhënie e nen huadhënie		
26	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet		
27	B	AKTIVE QARKULLUESE	2,391,497,555	2,583,295,755
28	Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit	50,782,381	49,231,748
29	31	Materiale	10,196,439	8,982,065
30	32	Objekte inventari	3,857,182	3,520,923
31	33	Prodhime, punime e shërbime ne proces		
33	35	Mallra	36,728,760	36,728,760
38	Klasa 4	II. Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët	2,155,268,780	2,146,289,439
39	409	Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore		
40	411-418	Klientë e llogari te ngjashme	2,030,606,190	2,017,526,122
41	423.429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	2,023,155	2,023,155
42	431	Te drejta e taksa për t'u derdhur ne shtet		
43	432	Tatime mbledh nga shteti për llog. Pushtetit Lokal		
44	433	Shenz. fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti		
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	17,584,681	17,746,177
46	435	Sigurime Shoqërore		
51	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja let. Vlerë	51,488,067	51,488,067
52	468	Debitorë te ndryshëm	53,566,687	57,505,918
53	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
54	50.59	III. Llogarite financiare	185,446,394	387,774,568
55	50	Letra me vlere te vendosjes		
56	511	Vlera për tu arkëtuar		
57	512	Llogaria në bankë	180,760,492	383,088,566
58	520	Disponibilitete ne thesar	4,685,902	4,686,002
59	531	Llogari ne arke		
60	532	Vlera te tjera		
64	C	LLOGARI TE TJERA AKTIVE		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

65	477	Diferenca konvertimi aktive		
68	85	Rezultati I Ushtrimit (saldo debitorë)		
69	X	TOTALI I AKTIVIT	3,118,473,717	3,058,737,265

Shuma e aktivitet të pasqyrës financiare pasqyron aktivitet e qëndrueshme, aktivitet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitet të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor 2017, rezulton se totali i aktivitet me 31.12.2017 paraqitet me vlerën 3,118,473,717 lekë dhe se, "Aktivitet e Qëndrueshme", zënë 23.3% të vlerës totale të aktivitet ndërsa, Aktivitet Qarkulluese zënë 76.6 % të vlerës totale. Aktivitet e Qëndrueshme në krahasim me vitin 2016, janë rritur në vlerën 251,535 mijë lekë ndërsa, Aktivitet Qarkulluese janë ulur në vlerën 191,798 mijë lekë.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuar në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprkasht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivitet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivitet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivitet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivitet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivitet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rrural"

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivitetit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:

- Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 21,674,642 lekë e cila përbëhet nga shuma prej 295,800 lekë të projektit ish- 2KR dhe në shumën prej 21,378,842 lekë të dy kontratave për "Studim për mizën e ullirit" dhe "Projekti për ndërtimin e zyrave të AZHBR-së në Fushë Krujë" lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat nuk gjenden kontratat e lidhura, të cilat nuk janë më në funksion, si rrjedhojë nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Në SKK nr. 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jo material që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore, por mund të jetë më e shkurtër në varësi të periudhës gjatë të cilës njësia pret të përdorë aktivin. Në vite për objekt auditimi për llogarinë 202 nuk është llogaritur amortizimi, ku në zbatim të SNK 38 pika 107, rrjedh që ky aktiv është cilësuar si aktiv jo-material me një jetë të dobishme të pafundme (pika 91. Termi 'i pafundëm' nuk kuptohet si 'pafundësi' (në infinit)). Një aktiv jo-material konsiderohet nga njësia ekonomike se ka një jetë të dobishme të pafundme, kur bazuar në një analizë të të gjithë faktorëve përkatës, nuk ka kufizime të parashikueshme të periudhës gjatë së cilës aktivi pritet të gjenerojë flukse monetare për njësinë ekonomike.

Në përputhje me SNK 36, njësia ekonomike kërkohet të testojë një aktiv jo-material me një jetë të dobishme të pafundme për ç vlerësim duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme me vlerën e tij kontabël (neto)

(a) çdo vit, dhe (b) nëse ka tregues se aktivi jo-material mund të jetë ç vlerësuar.

Jeta e dobishme e një aktivi jo-material që nuk amortizohet rishikohet çdo periudhë për të përcaktuar nëse ngjarjet dhe rrethanat vazhdojnë të mbështesin vlerësimin e një jete të dobishme të pafund për atë aktiv.

Përfundimet e jetës së dobishme dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të një AAJM (Pika 112) ... "Një aktiv jo-material çregjistrohet: (a) kur nxirret jashtë përdorimit; ose (b) kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij ose shitja".

Pra subjekti duhet të marrë masa për të nxjerrë jashtë përdorimi dhe të bëjë çregjistrimin e AAGJJ nga kontabiliteti për të bërë një paraqitje sa më reale të pozicionit financiar të subjektit.

- Llogaria 203 "Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme" në shumën prej 338,700 lekë përfaqëson shpenzime për programin "Ëindoës".

- Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione", paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 65,177,039 lekë. Kjo vlerë është e përbërë nga vlera bruto e godinës së AZHBR-së.

- Llogaria 215 "Mjete Transporti", paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 22,449,122 lekë dhe përfaqëson vlerën e 8 automjeteve në dispozicion të AZHBR-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujësor dhe Rural"

Situata:	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 në zërin "Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar" janë të pasqyruara (llog. 202) "Studime dhe kërkime" në vlerën prej 21,674,642 lekë, e cila përbëhet nga shuma prej 295,800 lekë të projektit ish- 2KR dhe në shumën prej 21,378,842 lekë të dy kontratave për "Studim për mizën e ullirit" dhe "Projekti për ndërtimin e zyrave të AZHBR-së në Fushë Krujë" lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat nuk gjenden kontratat e lidhura. Në SKK nr. 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore. Aktivi në fjalë nuk është më në funksion, si rrjedhojë nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivit jomaterial, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.
Kriteri:	Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". SKK nr. 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale,
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi i saktë gjendjes financiare të institucionit.
Shkaku	Institucioni nuk disponon dokumentacionin justifikues, pasi janë aktive të blera që në kohën e projektit ish -2KR
Rëndësia:	I mesëm

- Llogaria 218 "Inventar ekonomik", paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 55,539,283 lekë dhe krahasuar me vitin paraardhës është rritur në shumën 5,698,198 lekë, ku ndikim ka lëvizja e bërë brenda sistemit, dhuratë nga GIZ.

- Llogaria 28 "Caktime" paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 601,943,063 lekë, e cila përbëhet nga 387,026,837 lekë për Projektin IPA 2013 "Mbështetje për përmbytjet" 2016-2017, nga 210,700,799 lekë për "Investime në Përmbytje" dhe 4,215,405 lekë "Instalime teknike, makineri, pajisje" që nga bilanci e mëparshme që janë transferuar në AZHBR, por që nuk janë aktive të institucionit.

Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" (Llog. nr. 219) prej 43,017,203 lekë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7.

Formati 7 "Pasqyra e amortizimeve", nga auditimi rezulton se është plotësuar sipas Udhëzimit të MF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"

Amortizimi vjetor është llogaritur dhe kontabilizuar sipas normave të përcaktuara në VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike të përdoret ligji aktual fiskal "Për Tatimin mbi të Ardhurat" me norma amortizimi 25% dhe aplikimi të bëhet mbi vlerën e mbetur. Në bazë të këtyre dispozitave këto norma duhet të jenë;

- 15% për studime dhe kërkime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

- 1 % për ndërtesat e konstruksionet
- 3 % për Inventarin ekonomik
- 25 % për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike
- 5.8 % për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla
- 13.8 % për Mjetet e transportit
- Llogaria 31 & 32 "Materiale ", paraqitet në vlerën 10,196,439 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës është me rritje në shumën 1,214,374 lekë. Kjo llogari përfaqëson materiale pastrimi, materiale kancelari, lëndë djegëse, goma, vaj filtra e pjesë këmbimi për automjete, si dhe mjete hidraulike etj.
- Llogaria 35 "Mallra" paraqitet në vlerën 36,728,760 lekë përfaqëson mallra që nga projekti 2KR.
- Llogaria 411-418 "Klientë e llogari te ngjashme" në shumën prej 2,030,606,190 lekë përfaqëson detyrimet e mbetura të paarkëtuara për debitorët e grandeve Japoneze, debitorët e linjave të agropërpunimit, sera me ngrohje, debitorë për dhoma frigoriferike, linjat e përpunimit të qumështit dhe fruta perime të financuara nga Projekti 2KR, AZHBR, si dhe debitorë të krijuar nga Projekti IPA 2013 "Mbështetje për Përmbytje".
- Llogaria 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba" paraqitet në vlerën 2,023,155 lekë përfaqëson detyrimet e punonjësve e mbartur nga viti paraardhës. Nga këto 1,162,793 lekë për leje të zakonshme, 459,300 lekë për orët jashtë orarit, në bazë të urdhërit nr. 68 datë 08.09.2010. 328,268 lekë për zhvillimin e procedurave të tenderit, si dhe 72,794 lekë për tejkallim karburanti në bazë të urdhrit nr. 90 datë 22.11.2010.
- Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin", në vlerë prej 17,584,681 lekë përfaqëson paga e sigurime të personelit për tu paguar në Janar të vitit 2018. detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësore, pra janë shpenzime të vitit 2017 që do të paguhet në vitin 2018, si dhe shuma kreditorë të ndryshëm. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Gjithashtu në këtë vlerë përfshihen dhe shuma e angazhimeve të konstatuar në vitet paraardhëse dhe që do shlyhen në 2018.
- Llogaria 465 "Efekte për tu arkëtuar nga shitja" në vlerë prej 51,488,067 lekë përfaqëson detyrime të mbartura që nga vitet 2004-2005 për karburant nga ish projekti 2KR.
- detyrimi I 2004-2005 ish-2KR shuma 39,772,425 lekë
- detyrimi I 2006 në shumën 9,097,784 lekë
- detyrime për karburant pa akcizë I 2006 në shumën 788,858 lekë
- lista e subjekteve të krijuara për subvencione nga AZHBR për vitin 2013, në shumën 1,847,000 lekë, te cilat kanë rezultuar pas monitorimit në terren.
- Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerë 53,566,687 lekë, përbëhet nga detyrime të trashëguara nga vitet e mëparshme për të cilën institucioni është në procese gjygjësore me subjektet, për të mundësuar arkëtimin e tyre.

Pasivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2017

Në lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi I Paraardhës
-----	-----------	---------------------------------	--------------------	-----------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

1	A	FONDE TE VETA	2,996,952,079	2,938,857,892
2	10	I. Fonde te veta	2,996,952,079	2,938,857,892
3	101	Fonde baze	257,599,615	153,137,812
4	105	Grante te brendshme kapitale ne natyre	569,177,532	615,545,148
5	106	Grante te huaja kapitale ne natyre	2,170,174,932	2,170,174,932
6	107	Vlera Akt.Qend.te caktuara ne përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi aktiveve te qëndrueshme		
8	11	II. Fonde te tjera te veta		
9	111	Fonde rezerve		
10	115	Caktim nga rezultati i vitit për investime		
11	116	Te ardhura nga shitja e Ak. Qëndrueshme		
12	12	III. Rezultati i mbartur		
13	13	IV. Subvecone te jashtëzakonshme (-)		
14	14	V. Pjesëmarrje te instit.ne invest.për te trete		
15	15	VI. Shuma parashikuara për rreziqe e shpenz.		
16	B	D E T Y R I M E	109,190,885	107,548,622
17	16,17,18	I. Borxhe afatgjate	7,875,987	0
18	16	Huamarrje e brendshme dhe te ngjashme	7,875,987	
19	17	Huamarrje e huaj		
20	Klasa 4	II. Detyrime afatshkurtër	101,314,898	107,548,622
21	419	Klientë (Kreditore), parapagese pjesore	20,948,428	20,789,370
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to		
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	6,608,632	7,210,650
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	639,137	672,758
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog.Pusht.Lokal		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	2,023,155	2,023,155
28	435	Sigurime shoqërore	2,011,720	2,173,207
29	436	Sigurime shëndetësore	279,689	302,528
30	437.438	Organizma te tjerë shoqërore		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje		6,231,283
36	467	Kreditore te ndryshëm	68,804,137	68,145,671
37	C	LLOGARI TE TJERA	12,330,751	12,330,751
40	480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar	12,330,751	12,330,751
42	85	Rezultati I ushtrimit (Saldo kreditore)		
43	X	TOTALI I PASIVIT	3,118,473,715	3,058,737,265

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezultojnë se totali i pasivit më 31.12.2017, paraqitet me vlerën 3,118,473,715 lekë, ku "Fondet e veta", zënë respektivisht 96% të vlerës totale të pasivit ndërsa, "Detyrimet" zënë 3.5%.

Llogaria 42 "Personeli dhe llogari të lidhur me to" në vlerën 6,608,632 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2017, ndërsa llogaria 431 në shumën prej 639,137 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2017 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujësor dhe Rural"

Llogaria 435 & 436 "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore" në vlerën 2,291,409 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror dhe e sigurimit shëndetësor të muajit Dhjetor 2017, e cila likuidohet në muajin Janar 2018.

Llogaria 437 & 438 "Organizma të tjerë shoqërore" në vlerën 40,116 lekë, detyrime ndaj tre subjekteve për të cilën nuk janë likuiduar me argumentin "Mungon dokumentacioni vërtetues për detyrimin e krijuar".

- Llogaria 4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor)" në shumën prej 2,023,155 lekë, e cila vjen e trashëguar nga vitet e mëparshme e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve ndaj shtetit.

- Llogaria 467 "Kreditore të ndryshëm (kreditore për investime)" në shumën prej 68,804,139 lekë, të trashëguara ndër vite.

- Llogaria 480 "Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar" në vlerën prej 12,330,751 lekë përfaqëson të ardhura të arkëtuara të paklasifikuara.

Llogaria 63 e evidentuar në formatin 3/1 është sa ndryshimi i gjendjeve të magazinës në aktiv të PF dhe diferenca është transferuar në llogarinë për transferimin e ndryshimit të gjendjeve.

Rakordimet e pasqyrave të bilancit financiar:

Auditimi u bë me të zgjedhur për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:

- Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 3,118,473,715 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I "fondet e veta" të institucionit që arrijnë në vlerën 2,996,952,079 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit të bilancit dhe grupeve B "detyrimeve" dhe C "llogari të tjera" të pasivit.

- Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 3,118,473,715 lekë.

Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë nga funksioni" në Formatin nr. 3/1 "Shpenzime të ushtrimit" është e barabartë me llogarinë 85 "Rezultati i ushtrimit" në Pasivin e bilancit kontabël. Rezultati është zero, pasi është institucion buxhetor.

- Llogaria 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 1,550,633 lekë në fund të vitit 2017, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 "Gjendja e inventarit" në aktivin e bilancit. Pra, janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 1,550,633 lekë.

- *Pasqyra e lëvizjes së fondeve (pasqyra 8)*

Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur (raportues). Në këtë pasqyrë financiare është evidentuar:

- Shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë, ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga burime të brendshme (nga grantet e brendshme kapitale, transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë, nga shitjet e AAGJ-së, nga rezultate të mbartura, nga rezervat etj.), si dhe nga burime të jashtme (nga grantet e jashtme kapitale dhe transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë).

Në fund të pasqyrës është pasqyruar totali i fondeve të veta për çdo zë të pasqyruar.



KONTROLLI I LARTË I SHTEHTIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural”

Totali i fondeve të veta të kësaj pasqyre është i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në pasiv të pasqyrës financiare. Teprica në fund e llog. 101, është e njëjtë me tepricën e saj në pasiv të bilancit kontabël, pasqyra nr. 2 në vlerën 2,996,952,079 lekë.

ç. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

- Formati nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në CASH” në përfundim të auditimit rezultoi që të dhënat për disponibilitetin në thesar përkojnë me situacionet faktike të pagesave dhe arkëtimeve të rakorduar për vitin 2017, dokumente të cilat janë bashkëlidhur edhe bilancit kontabël. Formati ka të plotësuar edhe kontrollin sipas formulës së miratuar nga Ministria e Financave, ku llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogaria 512 “llogari në bankë” në çelje formati nr. 5 barabartë sa paraqit bilanci. Gjithashtu nga auditimi rezultoi se edhe totali i derdhjeve në buxhet (pasqyra e lëvizjes në “CASH”, formati nr. 5 të ardhura jo tatimore në “CASH”) ishte i barabartë me shumën e rubrikave përkatëse të derdhjeve në buxhet, të pasqyruar në akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë, të pasqyruar në formatin nr. 3/2.

Viti 2018

- Pasqyrat financiare për vitin 2018 janë përgatitur në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuar pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash'floë), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe anekset përkatëse. Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në pasqyrat financiare. Veprimet e regjistrimit të transaksioneve në kontabilitet janë regjistruar në ditarët respektiv, të bankës, magazinës, etj.

b. Llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm

Të ardhurat paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së performancës financiare. Totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të të ardhurave jo tatimore, totalit të të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali të të ardhurave të tjera si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve. Për vitin 2018 institucioni nuk ka të ardhura parësore e as dytësore.

- Shpenzimet paraqiten në rubrikën B të pasqyrës së performancës financiare. Totali i shpenzimeve është i barabartë me shumën e totalit të shpenzimeve për pagat dhe përfitimet e punonjësve, totalit të shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, totalit të shpenzimeve për subvencione, totalit të shpenzimeve për transferime korrente, totalit të shpenzimeve financiare, totalit të shpenzimeve për kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara, totalit të shpenzimeve që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit si dhe totalit të shpenzimeve të tjera.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

Në pasqyrën e performancës financiare, formati nr. 2 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 1,260,025 lekë të ndara sipas zërave si (600) "Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli" në vlerën 103,928 mijë lekë ose 5.6% të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2018.

Llog. (601) "Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore" në vlerën 17,597 mijë lekë ose 0.9 % të totalit të shpenzimeve,

Llog. (602) "Mallra dhe shërbime të tjera" në vlerën 74,579 mijë lekë ose 4 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2018. Nga auditimi u konstatua se subjekti ka të regjistrua detyrimet për 12 muaj ndaj enteve publike për shërbime të marra të energjisë dhe ujit, të cilat janë kontabilizuar, ku pagesa e tyre është bërë brenda afateve ligjore,

Llog. (605) "Transferime korente me jashtë" në vlerën 1,574 mijë lekë ose 0.08% të totalit të shpenzimeve.

Llog. (606) "Transferta për buxhete familjare e individët" në vlerën 1,560,021 mijë lekë ose 89.3 % të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën 1,260,025 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 "transferim për ndryshim gjendje inventari" në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 janë si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Nr. llogarisë	PËRSHKRIMI I OPERACIONIT	Viti ushtrimor	Viti I mëparshëm
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	1,857,697,942	412,981,346
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET		
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurinë		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit		
18	704	4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtarë		
23	705	5.Takse e rrugës		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtarë		
25	709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
26	75	II.kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore		
34	71	III.Te ardhura jo tatimore		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
53	72	V.GRANTE KORENTE	1,857,697,942	412,981,346
54	720	1.Grant korent I Brendshëm	1,857,697,942	414,531,979
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	1,843,034,024	396,947,298
61	7206	Financim I pritshëm nga buxheti	14,663,918	17,584,681
64	721	2.Grant korent I Huaj		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

73	73	<i>VII.ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve</i>		-1,550,633
74	B	SHPENZIMET	1,858,957,967	412,981,346
75	600	I. PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	103,927,964	107,688,487
76	6001	Paga, personel I përhershëm	103,927,964	107,688,487
77	6002	Paga personel I Përkohshëm		
78	6003	Shpërblime		
79	6009	Shpenzime te tjera për personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	17,596,579	17,933,578
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	15,829,999	16,101,756
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	1,766,580	1,831,822
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	74,578,661	77,963,293
84	602	Mallra dhe shërbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	2,643,400	1,381,108
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	255,200	
87	6022	Shërbime nga te trete	42,170,514	39,170,157
88	6023	Shpenzime transporti	1,530,066	3,949,258
89	6024	Shpenzime udhëtimi	8,877,973	5,119,317
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	3,918,475	1,601,160
91	6026	Shpenzime për qiramarrje		
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	3,295,930	23,949,837
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	11,887,103	2,792,456
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
101		V.TRANSFERIME KORENTE	1,661,594,738	210,946,621
102	604	1.Transferime korente te brendshme	0	0
107	605	2.Transferime korente me jashtë	1,574,018	0
108	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
109	6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja		
110	6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurëse te huaja	1,574,018	
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
112	606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	1,660,020,720	210,946,621
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,660,020,720	210,946.621
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE		
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme		
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme		
125		VII.kuota amortizimi dhe shuma te parashikuara		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	1,260,025	-1,550,633
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	0	
132	83	Teprica ose deficiti i periudhës Rezultati I Veprimtarisë se vitit (Ushtrimor	-1,260,025	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

Rubrika C e pasqyrës së performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur) dhe është e barabartë me diferencën algjebrike midis totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare është e barabartë me zërin rezultatit e veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës nr. 2 me thesarin ku konstatohet se: Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimit me degën e thesarit Tiranë "Mallra dhe shërbime të tjera", sipas bilancit paraqiten në vlerën 74,578,661 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 85,330,540 lekë, ku diferenca prej 10,751,879 lekë vjen si rezultat diferencës së faturave 2018 (të konstatuara në 2018 dhe që do paguhen në periudhat e ardhshme) me faturat e 2017(të konstatuara në 2017 dhe paguara ne 2018).

Rezulton se pagesat e realizuara në janar për efekt të buxhetit të vitit që u mbyll, janë konstatuar si detyrime ndaj të tretëve me 31 Dhjetor 2018.

Paga, shpërblime e të tjera personeli sipas bilancit paraqiten në vlerën 103,927,964 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 103,215,981 lekë, ku diferenca prej 711,983 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2018 (të konstatuara në 2018 dhe paguar ne 2019 me atë të dhjetor 2017 të konstatuara në 2017 dhe paguara ne 2018. E njëjti fenomen ndodh dhe me llogarinë 601" Kontributeve e sig. shoq. e shëndetësorë" sipas bilancit paraqiten në vlerën 17,596,579 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 17,502,684 lekë, ku diferenca prej 93,895 lekë vjen si rezultat diferencës së kontributeve të dhjetor 2018 (të konstatuara në 2018 dhe paguar ne 2019) me atë të dhjetor 2017 (të konstatuara në 2017 dhe paguara ne 2018).

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	1,857,697,942	1,465,510,865	392,187,077
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	103,927,964	103,215,981	711,983
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	17,596,579	17,502,684	93,895
602	Mallra dhe shërbime të tjera	74,578,661	85,330,540	-10,751,879
605	Transferta korente me jashtë	1,574,018		1,574,018
606	Transferta për buxh. familjare e individë	1,660,020,720	1,259,461,660	400,559,060

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare
Pasqyra e pozicionit financiar pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues, nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit 2018.

Në lekë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëësor dhe Rural"

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	AKTIVET	3,694,172,985	3,120,288,651
2		I.Aktivët Afat shkurtër	2,470,423,954	2,391,497,555
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	262,570,286	185,446,394
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke	255,754,480	180,760,492
6	520	Disponibilitete në Thesar	6,815,806	4,685,902
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	49,522,356	50,782,381
12	31	Materiale	8,110,657	10,196,439
13	32	Inventar i imët	4,682,939	3,857,182
16	35	Mallra	36,728,760	36,728,760
21		3.Llogari të Ar këtushme	2,158,331,312	2,155,268,780
22	411	Klientë e llogari të ngjashme	2,038,601,884	2,030,606,190
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	2,023,155	2,023,155
31	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	51,488,067	51,488,067
32	468	Debitorë të ndryshëm	51,554,288	53,566,687
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	14,663,918	17,584,681
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
42		II.Aktivët Afat gjatë	1,223,749,031	728,791,096
43	20	I.Aktive Afatgjatë jo materiale	22,012,649	22,012,649
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	21,674,642	21,674,642
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme	338,007	338,007
47	21	2.Aktive Afatgjatë materiale	1,201,736,382	706,778,447
48	210	Toka, T,roje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	104,281,054	64,396,553
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	640,852	0
53	215	Mjete Transporti	15,758,264	11,431,817
56	218	Inventar ekonomik	36,871,618	29,007,016
57	24	Aktive afatgjatë të dëmtuara	0	0
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjatë	1,044,184,594	601,943,061
59	25-26	3.Aktive Afatgjatë Financiare	0	0
62		4.Investime	0	0
65	B	PASIVET (DETYRIMET)	119,522,452	121,521,638
66		I.Pasivet Afat shkurtër	119,522,452	121,521,638
67		1. Llogari të Pagueshme	86,334,097	88,242,459
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to		



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

69	42	Detyrime ndaj personelit	7,184,161	6,608,632
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra	6,758,484	7,875,989
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	696,028	639,137
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	2,163,503	2,011,720
76	436	Sigurime Shëndetësore	301,360	279,689
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	2,129,904	
82	467	Kreditore te ndryshëm	65,077,502	68,804,137
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	2,023,155	2,023,155
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	33,188,355	33,279,179
86	419	Kreditore, Parapagime	20,857,604	20,948,428
87	475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar	12,330,751	12,330,751
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagueshme		
93	16.17,18	Huatë Afat gjata		
94		Provizionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,574,650,533	2,998,767,013
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,574,650,533	2,998,767,013
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	290,903,404	259,414,549
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	1,260,025	
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	814,546,562	569,177,532
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	2,467,940,542	2,170,174,932
108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	3,694,172,985	3,120,288,651

Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Llogaria 520 "Disponibilitete ne Thesar" në shumën 6,815,806 lekë e cila përbëhet nga vlera 4,682,902 lekë të ardhura jashtë limiti nga viti 2014 dhe 2,129,904 lekë garanci punimesh prej 5 % të rikonstruksionit të agropikave.

Llogaria 512 "Mjete monetare në Bankë" në shumën 255,754,480 lekë, e cila përbëhet nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

- 522,487 lekë përfaqëson llogarinë e projektit të përmbytjes
- 182,898,870 lekë përfaqëson llogarinë e sektorit të borxhit
- 72,332,783 lekë përfaqëson llogarinë e "Projektit Mjedisor" "IBRD" dhe "SIDA"
- Llogaria 31 & 32 "Materiale ", paraqitet në vlerën 12,793,596 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës është me ulur në shumën 1,260,025 lekë. Kjo llogari përfaqëson materiale pastrimi, materiale kancelari, lëndë djegëse, goma, vaj filtra e pjesë këmbimi për automjete.
- Llogaria 411-418 "Klientë e llogari te ngjashme" në shumën prej 2,038,601,884 lekë përfaqëson detyrimet e mbetura të pa arkëtuara për debitorët e grandeve Japoneze, debitorët e linjave të agropërpunimit, sera me ngrohje, debitorë për dhoma frigoriferike, linjat e përpunimit të qumështit dhe fruta perime të financuara nga Projekti 2KR, AZHBR, si dhe debitorë të krijuar nga Projekti IPA 2013 "Mbështetje për Përmbytje".
- Llogaria 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba" paraqitet në vlerën 2,023,155 lekë përfaqëson detyrimet e punonjësve e mbartur nga viti paraardhës. Nga këto 1,162,793 lekë për leje të zakonshme, 459,300 lekë për orët jashtë orarit, në bazë të urdhërit nr. 68 datë 08.09.2010. 328,268 lekë për zhvillimin e procedurave të tenderit, si dhe 72,794 lekë për tejkalim karburanti në bazë të urdhërit nr. 90 datë 22.11.2010.
- Llogaria 465 "Efekte për tu arkëtuar nga shitja" në vlerë prej 51,488,067 lekë përfaqëson detyrime të mbartura që nga vitet 2004-2005 për karburant nga ish projekti 2KR.
- detyrimi I 2004-2005 ish-2KR shuma 39,772,425 lekë
- detyrimi I 2006 në shumën 9,097,784 lekë
- detyrime për karburant pa akcizë I 2006 në shumën 788,858 lekë
- lista e subjekteve të krijuara për subvencione nga AZHBR për vitin 2013, në shumën 1,847,000 lekë, te cilat kanë rezultuar pas monitorimit në terren.
- Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerë 51,554,288 lekë të trashëguara nga vitet e mëparshme.
- Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin", në vlerë prej 14,665,918 lekë përfaqëson paga e sigurime të personelit për tu paguar në Janar të vitit 2019. detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësorë, pra janë shpenzime të vitit 2018, që do të paguhet në vitin 2019, si dhe shuma kreditorë të ndryshëm. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Gjithashtu në këtë vlerë përfshihen dhe shuma e angazhimeve të konstatuar në vitet paraardhëse dhe që do shlyhen në 2019.
- Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione", paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 104,281,054 lekë, Kjo vlerë është e përbërë nga vlera bruto e godinës së AZHBR-së. në shumën 65,177,039 lekë dhe 43,104,315 lekë rikonstruksioni i 15 Agropikave të realizuara në 2018 dhe amortizimi i akumuluar në shumën 4,000,570 lekë.
- Llogaria 215 "Mjete Transporti", paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 15,758,264 lekë ku kosto historike është në shumën 31,933,871 lekë dhe përfaqëson vlerën e 10 automjeteve në dispozicion të AZHBR-së si dhe amortizimi I akumuluar në shumën 16,175,607 lekë.
- Llogaria 218 "Inventar ekonomik", paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto/kosto historike 36,871,618 lekë, ku vlera bruto është në shumë 70,294,746 lekë dhe amortizimi i akumuluar në shumën 33,418,289 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujësor dhe Rural”

- Llogaria 28 “Caktime” paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën prej 1,044,184,597 lekë, e cila përbëhet nga 388,475,342 lekë për Projektin IPA 2013 “Mbështetje për përmbytjet” 2016-2018 TVSH për vitin 512628 lekë, “Investime në Përmbytje” në vlerën 425,548,392 lekë dhe 4,215,405 lekë “Instalime teknike, makineri, pajisje” që nga bilancet e mëparshme që janë transferuar në AZHBR, por që nuk janë aktive të institucionit.

Formati 7/b “Pasqyra e amortizimeve”, nga auditimi rezulton se është plotësuar sipas Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasivet (detyrimet) pasqyrohen në Rubrikën B të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i pasiveve përbëhet nga shuma e totalit të pasiveve afatshkurtra dhe totalit të pasiveve afatgjata.

Rubrika e I-rë përfaqëson pasivet afatshkurtra, e cila përbëhet nga:

Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 7,184,161 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2018, ndërsa llogaria 431 në shumën prej 696,028 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2018 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2019.

Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” në vlerën 2,464,863 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror dhe e sigurimit shëndetësor të muajit Dhjetor 2018, e cila likuidohet në muajin Janar 2019.

- Llogaria 466 “Kreditore për mjete ne ruajtje” në vlerën 2,129,904 lekë përfaqëson 5% garanci Rikonstruksioni të 15 zyrave për vitin 2018.

- Llogaria 467” Kreditore të ndryshëm (kreditore për investime) “ në shumën prej 65,077,502 lekë të mbartur nga periudha paraardhëse.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 2,023,155 lekë, e cila vjen e trashëguar nga vitet e mëparshme e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve ndaj shtetit.

- Llogaria 419 “Kreditore, Parapagime” në vlerën 20,857,604 lekë detyrime të trashëguara nga periudhat e mëparshme.

- Llogaria 480 ”Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar” në vlerën prej 12,330,751 lekë përfaqëson të ardhura të arkëtuara të paklasifikuara.

Rubrika C e pasqyrës së pozicionit financiar evidenton aktivet neto ose fondet neto. Fondet neto përbëjnë diferencën midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve. Fondet neto përfshijnë zëra si: Llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale te Huaja” në vlerën 2,467,940,542 lekë, e cila përfaqëson grante të trashëguara nga projekti 2KR.

teprica apo deficitin e akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata.

Fluksi i mjeteve monetare

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund të pasqyrës jepen të dhënat në lidhje me shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Në lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralës dhe Rural"

Nr. Reshti	Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periodha Raportuse	Periodha Paraardhëse
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	226,683,534	-194,771,736
2	1	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)	2,007,742,000	460,569,854
3	2	Arkëtime e te hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor	89,687,289	
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	0	
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	15,224,602	21,147,958
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	72,332,783	
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	2,129,904	
10		Te tjera, arkëtuar(+)		
11	3	Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente	-1,870,745,755	-453,869,899
12		Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-17,007,744	
13		Për detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-1,843,610,961	
14		Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	-10,127,050	-222,619,649
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	9,618,097	0
19		Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	57,175,000	
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nen huadhënies(+)		
23		Pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	-15,477,338	
24		Për detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-32,079,565	
25		Huadhënie e Nen huadhënie(-)		
26		Pjesëmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	-159,177,739	-7,556,438
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-306,443	-856,383
30		Transferime ne buxhet te Fondeve të pa përdorura(-)	-156,741,392	-6,700,055
31		Lëvizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)	-2,129,904	
32	IV	Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare	77,123,892	-202,328,174
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	185,446,394	387,774,568
34	VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	262,570,286	185,446,394

Rubrika një pasqyron flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë. Totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Nënrubrika "akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente" përfaqëson flukse monetare hyrëse që rrjedhin nga akordimet e fondeve buxhetore për shpenzime korrente në shumën prej 2,007,742,000 lekë.

Nënrubrika "arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor" përbëhet nga shuma e zërave si: të hyra nga projekti IBRD dhe SIDA në shumën neto prej 72,332,783 lekë, vlera prej 15,224,602 ka të bëjë me arkëtimet e borxhit dhe vlera 2,129,904 lekë ka të bëjë me 5% garanci mjete ne ruajtje

Nënrubrika "Pagesa për detyrime e shpenzime korrente" përbëhet nga shuma e zërave si: pagesa për detyrime e shpenzime nga vitet e kaluara, për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor, interesi i paguar, tatime të paguara, pagesat për mjetet në ruajtje si dhe të tjera të paguara.

Rubrika II pasqyron flukset monetare nga veprimtaritë e investimeve të njësisë, ku përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale, pagesa për detyrime e Investime të viti ushtrimor (-), si dhe pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara (-).

Rubrika III pasqyron flukset monetare nga transfertat dhe transaksionet si: derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet, transferime në buxhet të fondeve të përdorura dhe lëvizje e brendshme e transfertat të tjera, që përfaqëson 5% garanci mjete ne ruajtje

Rubrika IV përfaqëson shtimin neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur, të barabarta më vlerën e paraqitur në pasqyrën nr. 1 të "Pozicionit financiar".

Në lidhje me proceset gjyqësore të viteve 2017-2018, nga auditimi u konstatua se nga institucioni ndër vite ka një fond të planifikuar për proceset gjyqësore. Në PBA-në e institucionit është planifikuar një fond për këto detyrime. Mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve gjyqësore është kryere referuar numrit të pagave të përcaktuara në Vendimet e Gjykatave të formës së prere, si dhe shpenzimeve për ekzekutimin e tyre të paraqitura nga Zyrat përmbarimore sipas rastit.

Drejtoria e financës ka bërë kontabilizimin dhe konstatimin e detyrimeve gjyqësore vetëm në momentin e likuidimit të personave me urdhër shpenzim kaluar nëpërmjet degës së thesarit, ndërsa detyrimet e lindura për tu paguar nuk janë të kontabilizuara në pasqyrën financiare.

Nga institucioni duhet të krijohen provizionet për shpenzime gjyqësore pasi janë ngjarje të ndodhura dhe kanë probabilitet që do të sjellin detyrim për t'u paguar Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë. Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet bëhen si më poshtë:

a) Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime:

- Debitohet llogaria 683, "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"; dhe
- Kreditohet llogaria 150, "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime".

5. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

Gjatë auditimit në bazë të Programit të Auditimit Nr.1438/4 datë 28.02.2019, mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (institucion varësie pranë Ministrisë së Bujqësisë), për vitet buxhetore 2017 dhe 2018, grupi i audituesve të KLSH-së,u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

publik", VKM nr.918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", Udhëzim e APP-së nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik", Udhëzimin e APP-së nr.3 datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit, ndryshimet e tjera të APP-së.

Në bazë të regjistrave të parashikimit dhe ato të realizimit të cilat janë paraqitur brenda afateve sipas viteve buxhetore të dërguara pranë ish-Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave duke e përcjellë në Agjencinë së Prokurimit Publik (APP) me nr.144/1 prot datë 27.01.2017 (Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2017 për (AZHBR) si dhe me shkresë nr.52/1 prot me datë 08.01.2018 "Rregjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2017", ndërsa për vitin 2018 regjistri i parashikimit është dërguar online pranë APP-së, në bazë të ndryshimeve të pësuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 4 dhe neni 7/2, i ndryshuar si dhe në bazë të shkresës nr.122 prot datë 09.01.2019 (Regjistri i Realizimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2018).

Përqendrimi i grupit të auditimit, është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

- Hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik;
- Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit;
- Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave; elektronik (SPE);
- Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces;
- Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit
- Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
- Zbatimi dhe monitorimi i kontratës.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur procedura prokuroese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Për vitin 2017 u konstatua se, AZHBR ka parashikuar në total 28 procedura prokurimi (duke përfshirë edhe shtesat e regjistrave), nga të cilat janë realizuar 25 procedura me blerje të vogël. Nga auditimi, u konstatua se për vitin buxhetor, ka pakësim të konsiderueshëm të fondeve prokuroese, në mbështetje të VKM-së nr. 482 datë 5.7.2017 "Për pezullimin e procedurave të prokurimit", ku sipas fondit total sipas regjistrit të parashikuar u konstatua në vlerë prej 14,959,324.80 lekë me TVSh, dhe është realizuar në vlerë prej 11,547,449 lekë me TVSh, duke realizuar 77 % vlerës së parashikuar.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur procedura prokuroese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Kështu, është audituar, procedura me objekt "Ftese për Negociata" me objekt "Informimi i publikut të gjere për skemat e mbështetjes në bujqësi për vitin 2017", në vlerën prej 33.265.060



KONTROLLI I LARTË I SHFETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

lekë, lidhur kontratat me subjektin "My Afisha". Kjo procedurë është realizuar në mbështetje të VKM nr.1195 datë 05.08.2008, "Për blerjen, zhvillimin prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radioteleviziv ose botimin në median e shkrua, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore", e cila rezultoi në përputhje me aktin e mësipërm nënligjor.

Për vitin 2018, AZHBR ka parashikuar në total 40 procedura prokurimi (duke përfshirë edhe shtesat e rregjistrave), nga të cilat 33 procedura me blerje të vogël, ku janë përfshirë edhe procedurat me emergjence, 1 kërkesë me propozim dhe 5 procedura të hapura. Fond i limit total sipas regjistrimit të parashikuar të prokurimit ka qene 113,556,782.40 lekë me TVSh, realizuar me vlerë 98,142,510 lekë me TVSh, duke realizuar 86 % të vlerës së parashikuar.

Grupi i auditimit të KLSH-së, auditoi **3 procedura**, 1 procedurë e hapur me vlerë kontrate në vlerë prej 38,098,396 lekë pa tvsh, 1 procedurë kërkesë me propozim me vlerë kontrate prej 1,513,838 lekë pa TVSh dhe 1 procedurë me objekt "Informimi mediatic i publikut për skemat mbështetëse për vitin 2018", me vlerë 29,096,700 lekë me TVSh, realizuar në mbështetje të VKM nr.1195 datë 05.08.2008, "Për blerjen, zhvillimin prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radioteleviziv ose botimin në median e shkrua, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore", pra është audituar vlera prej 68,708,934 lekë pa TVSh ose 70% ve vlerës së prokuruar për vitin 2018.

Gjithsesi, duke mos mohuar kontributin AZHBR-së, si institucioni publik kryesor, e cila ka si mision garantimin e përmbushjes së të drejtës së administrimit, menaxhimit dhe monitorit, të fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, duke mbështetur fermerët shqiptarë dhe sipërmarrësit në sektorin ushqimor dhe agrokulturën, etj, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit dhe nga fonde të BE.

Gjatë auditimit të procedurave prokuruese në lidhje me, investimet për rikonstruksione, shërbime në mallra, etj, janë evidentuar dobësi në zinxhirin e procedurave tenderuese si në pjesën e realizimit dhe në pjesën e monitorimit të procedurave të prokurimeve publike, të cilat po prezantojmë në formë të përmbledhur si më poshtë vijon:

a).Nga auditimi i KLSH-së, është vërejtur se në procedurat e prokurimeve publike, për rikonstruksionin e objekteve të agropikave, blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve për vitin 2017 dhe vitin 2018, të përzgjedhura nga audituesit, është konstatuar se në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si Autoritet Kontraktor, nuk është ngritur Njësia e Prokurimit Publik, si strukturë permanente, si pasojë në procedurat tenderuese me objekt "**Rikonstruksioni i 15 Agropikave 2018**", u konstatua se, APP me anë të emalinit të datës 27.09.2018, drejtuar AZHBR-së, në bazë të monitorimit të procedurave të sistemit elektronik për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për këtë procedurë tenderuese, ka sjellë në vëmendje që të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore. Agjencia e Prokurimit Publik (APP), në dokumentet e tenderit në sistemin elektronik, duke sjellë më pas ndryshimin e kriteve të veçanta dhe specifikimet teknike, pasi anëtarët të cilët janë vendosur nga Titullari i AK, nuk ka formimin arsimor dhe profesional, në fushën prokuruese, nuk



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

kanë marrë pjesë në trajnimet e domosdoshme dhe të nevojshme, të cilat organizohen nga Agjencia e Prokurimeve Publike (APP). Gjithashtu, me të njëjta mangësi rezultojnë dhe burimet njerëzore (anëtarët) e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO)-ve, të cilët nuk janë specialistë të fushës që është prokuruar.

Në bazë të auditimit të realizuar më zgjedhje në bazë të vlerës monetare të tenderuar dhe prokuruar, grupi i audituesve të KLSH-së, do të raportojë më poshtë, mbi evidentimin e problematika të mësipërme në sistemin e prokurimeve të realizuara nga ana e Autoritetit Kontraktor të AZHBR, gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018.

1) Mbi auditimin e procedurës me objekt "Rikonstruksioni i 15 Agropikave 2018" realizuar në vitin 2018, me fond limit me vlerë prej 40,507,570 lekë pa tvsh .

Nga auditimi, rezultoi se, referuar Urdhërit të Ministrit të MBZHR, nr. 20, datë 19.01.2018, "Për krijimin e Sporteve Unike të Shërbimeve për Fermerët", u krijuan Agropikat si njësi të drejtpërdrejta në varësi të AZHBR-së që ofrojnë shërbim dhe informacion tek fermerët për programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Sportelet Agropika kryejnë shërbime për fermerët dhe subjekte të tjera, personat fizikë e juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari bujqësore apo veprimtari të tjera ekonomike të lidhura me të në fushën e zhvillimit bujqësor, të industrisë agrorshqimore e zhvillimit rural, dhe ofrojnë shërbime, si më poshtë vijon:

- a) Informojnë dhe promovojnë programet dhe masat/skemat kombëtare të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- b) Informojnë dhe promovojnë programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë e zhvillimin rural të financuara nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë.
- c) Japin informacion për fondet e garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare e financiare për fermerët dhe subjektet e interesuara për mbështetje financiare në veprimtari të lidhura me zhvillimin bujqësor dhe rural.
- ç) Ndërmjetësojnë marrëdhëniet me institucionet financiare dhe ato bankare lidhur me kreditë e refuzuara/ristrukturuara.
- d) Japin informacion për legjislacionin për bujqësinë, veterinarinë, sigurinë ushqimore, agroturizmin, si dhe institucionet përgjegjëse rregullatorë.
- dh) Regjistrujnë të dhënat e fermës bujqësore e blegtorale sipas përcaktimeve ligjore për hyrjen e të dhënave në regjistrat përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për data basë shtetërore.
- e) Asistojnë aplikimet online apo në bazë dokumentesh për masat/skemat kombëtare, programet IPARD II, si dhe të projekteve të tjera komunitare të donatorëve të ndryshëm.
- ë) Pranojnë aplikimet dhe raportojnë në vazhdimësi në sistemin e bazës së të dhënave të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në përputhje me afatet ligjore të miratuara për këtë qëllim, për mbështetjen financiare nga fondet e masave/skemave kombëtare.
- f) Inspektojnë fermerët dhe subjektet përfituese të fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural."

Kështu, për sa më sipër, me Urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është bërë transferim kapital, pa pagesë, i ambienteve nga zyrat e Drejtorive të Bujqësisë/Drejtorive të AKU,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

për krijimin e njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimit si Agropika. Referuar urdhrave të Ministrit u morën në dorëzim sipas procedurave ligjore ambientet në Dibër, Gjirokastrë, Shkodër, Mat, Kukës, Berat dhe Librazhd, Lezhë, Sarandë, Elbasan, Pogradec, Tirane, Kavaje, Përmet dhe Pukë. Ky proces përfundoi në muajin Shtator të vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe, AZHBR publikoi në faqen e saj zyrtare Thirrjen për donacion, me objekt projektimin, rikonstruksionin dhe mobilimin e Agropikave. Bazuar në projektimin e dhuruar AZHBR ka zhvilluar procesin e prokurimit të rikonstruksionit të 15 agropikave në dy faza, rikonstruksion dhe mobilim. Procedura e mobilimit si procedurë prokurimi u zhvillua nga Ministria e Brendshme. Në fund të muajt dhjetor ka përfunduar procesi i Rikonstruksionit të 15 Agropikave (supervizim, kolaudim dhe mobilim).

Më poshtë po paraqesim procedurën prokuruese:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i 15 Agropikave 2018"			
1. Urdhër Prokurimi nr. 380 prot. Datë 21.09.2018	3. Njësia e Prokurimit Majlinda Polisi Kreshnik Gega Vjosana Sala	3.2. Grupi i hartimit të termave të referencave Petrit Pollo, Erion Medha, Amantia Lleshi.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 381 datë 21.09.2018 Mirgen Dobruna, Jolanda Shtini, Orgeta Kapllani, Enel Cinije, Amela Osmanaj
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "I hapur"			
5. Fondi Limit (pa tvsh) 40,507,570 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 38,098,396 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,409,174 lekë	
8. Data e hapjes së tenderit Data 31.10.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE	
11. Ankimime AK- 5763 datë 23.11.2018; nr. 5744/1 datë 23.11.2048 KPP- Ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa 5763/1 prot. datë 23.11.2018		
14. Lidhja e kontratës 18.12.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 45,718,075 lekë		

a. Informacion i përgjithshëm i realizimit të procedurës së prokurimit.

Nga auditimi u konstatua se, operatori ekonomik "Tesla Vizion" sh.p.k, i është përgjigjur pozitivisht thirrjes së interesit për donacion të projektimit të 15 zyrave të reja të Agropikave, nëpërmjet sistemit elektronik të AZHBR, me shkresën nr. 833/16 prot. datë 06.08.2018.

Ndërsa në lidhje, mbi planifikimin dhe mobilimin e Agropikave, nga titullari i AK me urdhrin nr. 383 prot. datë 21.09.2018, është ngritur komisioni i hartimit të specifikimeve teknike të mobileve, ku procedura tenderuese të mobilimit, për shpalljen e operatorit fitues është realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme. Kështu në bazë të shkresës nr. 48/5 prot. datë 14.12.2018, të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, është autorizuar AZHBR, për zbatimin e procedurave ligjore dhe financiare me nënshkrimin dhe zbatimin e kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Kontrata e furnizimit me nr. 6417/1 prot. datë 17.12.2018, në vlerën 2,395,200 lekë me TVSH, nënshkruhet midis titullarit të AK dhe operatorit "RO-AL"sh.p.k.

b. Mbi auditimin përlogaritjes së fondit limit, hartimin dhe miratimin e DT, realizimi i procedurës për shpalljen e operatorit ekonomik dhe lidhjen e kontratës.

Nga auditimi, rezultoi se, në bazë të UP nr. 380 prot. datë 21.09.2018, ka filluar procedura prokuruese me fond limit 40,507,570 lekë pa tvsh. Me urdhrin e AK, nr. 3950/1 prot. datë 14.09.2018, është ngritur grupi i hartimit të specifikimeve teknike, termave të referencës, kriteret e veçanta të kapacitet teknik të prokurimit, për objektin "Rikonstruksioni i Agropikave", i cili ka paraqitur raportin nr. 3950/3 prot. datë 21.09.2018, ku ka argumentuar, hartimit të termave të referencës, vendosjen e kërkesave kualifikuese të kapaciteteve ekonomike dhe teknike, duke i argumentuar ose llogaritur në funksion të afatit të realizimit prej 45 ditësh dhe volumit të punës. Mbi kërkesat kualifikuese të punëtorisë, grupi punës ka kryer analizë të punëtorisë me shpërndarjen gjeografike të agropikave.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, APP me anë të emalin të datës 27.09.2018, drejtuar AZHBR-së, në bazë të monitorimit të procedurave të sistemit elektronik për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për këtë procedurë tenderuese, ka sjellë në vëmendje që të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore. Agjencia e Prokurimit Publik (APP), në dokumentet e tenderit në sistemin elektronik ka konstatuar se:

1. Në shtojcën 11 të DT Operatori ekonomik nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

APP, ka bërë me dije se është një kërkesë e shfuqizuar me VKM nr. 80 datë 14.02.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 dhe është shtuar: Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nëkontraktor për kontratë/ kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

2. Sipas nenit 26/8/d të VKM nr. 914. datë 29.12.2014, në preventivin e punimeve AK i është referuar markave "Knauf". APP ka sjellë në vëmendje nenin 23/5 të LPP, që të përdoren fjalën ekuivalent, të përfshira detyrimisht në specifikime.

1. Në pikën 1.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë *eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.*

Në lidhje me eksperiencën e kërkuar prej 15 vjetësh për drejtuesin teknik, APP vlerëson se duhet të mire argumentohet nga AK, referuar kriterëve të licencimit të shoqërive në fushën e zbatimit në ndërtim (VKM nr. 42, datë 16.01.2018) të cilat përcaktojnë kufijtë minimal të eksperiencës për regjistrimit e profesionistëve në rolin e drejtuesit teknik dhe procedurat që vlerësohen për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bnjoësor dhe Rural"

miratimin e këtij roli nga dispozitat në fuqi, bazuar gjithashtu në specifikat e punimeve të parashikuara për ekzekutimin e kontratës.

Gjithashtu APP sqaron se në rastin kur AK konsideron të nevojshëm ndryshimin e dokumenteve të tenderit (përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim), mbështetur në nenin 42 të LPP, nuk anulon procedurën, por mund të kryej ndryshimet përkatëse përmes hartimit të një shtojce.

Për sa më sipër, AK ka marrë masa për modifikimet e kriterëve kualifikuese, përveç eksperiencës 15 vjeçare të drejtuesit teknik, duke e argumentuar se "Drejtuesi Teknik i punimeve është kërkuar me eksperiencë pune me qëllim që në objekt të jetë një person përgjegjës që të drejtojë me rigorozitet dhe profesionalizëm zbatimin e punimeve, të cilët duhet të realizohen me cilësi optimale, të cilat i ka referuar në shtojcën e dokumentave të tenderit.

Nga auditimi, u konstatua se, në bazë të urdhrin nr. 381 datë 21.09.2018 të titullarit të AK-së, është miratuar KVO-ja me përbërë (Mirgen Dobruna, Jolanda Shtini, Orgeta Kapllani, Enel Cinije dhe Amela Osmanaj), ku në datë 14.11.2018, është bërë hapja e ofertave, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa T.V.SH	kualifikimet
1	"Klajger Konstruksion" shpk	38.098.396 Lekë	Kualifikuar/ Fituesi
2	"Liqeni VII" shpk & "Ndregjoni"shpk	38.832.724 Lekë	Kualifikuar
3	"Aurora Konstruksion" shpk & "Viante"shpk	35.934.208 Lekë	S' Kualifikuar
4	"LEON Konstruksion" shpk	32.396.914 Lekë	S' Kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

A. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Aurora Konstruksion" shpk & "Viante" shpk, me vlerë të ofertës 41.248.682 lekë pa TVSH , është s'kualifikuar pasi:

- Sipas DST, operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit, duke e bërë të pamundur identifikimin të dhënave të tij. Në nenin 63, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së".

Në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 6454 prot. datë 30.05.2013 përcaktohet se: "Duke marrë shkas nga problemet e hasura nga Operatorët Ekonomikë gjatë procesit të ngarkimit të dokumenteve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik sugjeron që skanimi i dokumenteve të bëra në format .pdf, të bëhet me rezolucion më të ulët se 75 dpi. Gjithashtu rekomandojmë që Operatorët Ekonomikë që ofertojnë në procedurat me vlerë më të lartë se 400.000 lekë, të ulin në maksimum numrin e file-ve, duke i grupuar ato në sa më pak dokumente për të lehtësuar upload-imin e ofertës".

Në manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për operatorët ekonomikë është përcaktuar se: "(... Para se të filloni me ngarkimin e dokumenteve, duhet të siguroheni që të gjithë dokumentet të jenë të konvertuara në mënyrë elektronike në kompjuterin tuaj...) Materialet e ngarkuara në sistem duhet të jenë në formatin pdf ...)".

Sa më sipër, është sqaruar, se është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit të plotë, të saktë e të qartë për nga mënyra e leximit dhe identifikimit të të dhënave të tij, në mënyrë që të jetë i lexueshëm dhe për të verifikuar nëse ai



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu nga AK, është sqaruar se, nuk është në kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP në të cilin përcaktohet se *"Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme"*, pasi sqarimet mund të kërkojnë vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret.

- Kamion targa TR9083J, me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.5 Ton, në plotësim të kësaj pike operatori ekonomik "Aurora" shpk ka paraqitur një kontratë me shoqërinë "Rafaello" ku fotografitë e mjetit janë tërësisht të paqarta dhe targa është e palexueshme ndërkohë që, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit, duke e bërë të pamundur identifikimin të dhënave të tij.

- Operatori Ekonomik "Viante Konstruksion" shpk ka deklaruar në shtojcën nr. 10 se disponon mjetet. Operatori ekonomik në shtojcën 10 të paraqitur në sistemin elektronik të app-së ka deklaruar se disponon mjete të siguruara me qera me kompaninë "Sina 98".

Për sa më sipër, nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kontraktor, ka bërë kontrollin e dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri në sistemin elektronik të APP-së, ku ka rezultuar, që OE, nuk ka ngarkuar dokumentacion lidhur me këto mjete, kështu AK ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamionë kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maksimum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës.

Nga auditimi, u konstatua se, bashkimi i OE –kë, në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë paraqitur një kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK, por AK ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionë kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 7 ton dhe maksimum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur një kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentet standarde të tenderit. Pra, dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionët me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton të kërkuar nga AK (3 copë) si dhe me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton dhe maksimumi 10 ton të kërkuar nga AK (2 copë) për rrjedhojë i pavlefshëm.

Nisur, nga sa më sipër bashkimi i OE "Aurora Konstruksion" shpk & "Viante Konstruksion" shpk, me shkresën nr. 5744/1 prot. datë 23.11.2018, kanë kontestuar vendimin për skualifikim nga ana e KVO-së lidhur me mjetin me targa AA108HK, duke kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që mjeti me targa AA108HK të konsiderohet me tonazh të rregullt. "Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshën e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje".

Nga auditimi rezultoi se, në përgjigje të ankesës, autoriteti kontraktor ka sqaruar se, *"Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetohen se*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës".
Pra nga auditimi me të drejtë, AK, ka kthyer përgjigje, se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

B. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Leon Konstruksion" shpk, me vlerë të ofertës 32.396.914,19 lekë pa tvsh, është s'kualifikuar, për arsyet e mëposhtme:
Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamionë kapaciteti mbajtës duhet të jetë (minimum 3.5 ton dhe maksimum 5 ton), secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur dy kamiona me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentet standarde të tenderit.

AK sqaron se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personelin dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga OE lidhur me shtojcën 10, është i paplotë përse i përket kamionëve me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor (3 copë) për rrjedhojë i pavlefshëm.

Nga auditimi u konstatua se, operatori ekonomik "Leon Konstruksion" shpk ka kontestuar vendimin e KVO me ankesën nr. 5763/1 prot. datë 23.11.2018, për arsyet e s'kualifikimit, duke kërkuar të mos bëhet interpretim strikt në përmbushjen e kriterit të mjetëve.

Nga AK, është sqaruar, se përse i përket arsyetimit tuaj në lidhje me faktin se s'kualifikimi për mjetin, i cili nuk plotëson tonazhin e përcaktuar në DST të AK.

Gjithashtu, në bazë të ankesës drejtuar KPP-së, i cili me Vendimin nr. 1791/1 datë 04.12.2018, ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimit në themel. KPP-ja ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga BOE "Aurora Konstruksion" shpk & "Viante" shpk për objektin "Rikonstruksioni i 15 Agropikave", duke urdhëron AZHBR të dërgojë informacion të hollësishëm në procesin e vlerësimit të ofertave, me të gjithë shoqëritë pjesëmarrëse në procedurë.

Me shkresën e titullarit nr. 5744/4 prot. datë 06.12.2018, dërgohen materialet e procedurës në themel tek KPP në zbatim të vendimit nr. 1791/1 prot. datë 06.12.2018.

Me shkresën e KPP nr. 840/1 prot. datë 13.12.2018, dërgohet Vendimi nr. 840/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik "Aurora Konstruksion" shpk & "Viante" shpk dhe lejon AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Referuar procedurës AK me raportin përmbledhës nr. 5744/7 prot. datë 17.12.2018, miratohet procedura e prokurimit, me operatorin "Klajger Konstruksion" shpk, me ofertë 38.098.396 lekë pa të identifikuar si ofertë e suksesshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Kontrata e punimeve nënshkruhet me nr. 6487 prot. datë 18.12.2018, midis AK, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme zj. Frida Krifca dhe operatorit ekonomik "Klajger Konstruksion" shpk, i përfaqësuar nga administratori z. Denis Lumi.

Pra si përfundim, nga auditimi i procedurës së prokurimeve publike, me objekt "*Rikonstruksioni i 15 Agropikave 2018*" u konstatua se, meqenëse pranë AK, nuk është ngritur Njësia e Prokurimit Publik, si strukturë permanente, vendosja e kriterëve të veçanta dhe specifikimet teknike fillimisht në DT nuk kanë qënë të mirëargumentuar, *kjo për shkak se, personat të cilët janë vendosur nga Titullari i AK, nuk ka formimin arsimor dhe profesional, në fushën prokuruese.*

Kështu, më pas është hartuar dhe miratuar hartuar Shtojca me ndryshime në DT, në bazë të sugjerimit të bërë nga APP, në mbështetje të monitorimit të procedurave të sistemit elektronik për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në mbështetje të Udhëzimit të APP nr.9 datë 29.03.2018 "Për koordinimin e veprimtarisë së prokurimit publik me person përgjegjës", kjo në referim të email-it të datës 27.09.2018, drejtuar AZHBR-së, duke sjellë në vëmendje që të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore. Gjithashtu, me të njëjta mangësi rezultojnë dhe burimet njerëzore (anëtarët) e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO)-ve, të cilët nuk janë specialistë të fushës që është prokuruar.

2) Auditimi në lidhje mbi procedurën e prokurimit me objekt, "Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve të AZHBR, për vitin 2018" me të dhënat si më poshtë.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve të AZHBR, për vitin 2018"		
1.Urdhër Prokurimi 225, datë 24.05.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Daniela Jaupaj Klea Sali Majlinda Polisi	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Dalip Basha Redi Cuku Ernal Manaj
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,600,000	6.Oferta fituese (pa tvsh) Classic shpk me vlerë 1,513,838 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 86.162 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.06.2018	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomike I-Classic shpk

Nga auditimi u konstatua se me Urdhrin nr.06.08.01.2018 "Për Krijimin e grupeve të Punës për hartimin e specifikimeve teknike, sasitë dhe përcaktimin e fondit limit" janë përcaktuar grupet e punës për të gjitha procedurat që do të zhvillohen në vitin 2018. Për procedurën Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit , hartuesit e specifikimeve teknike , sasive dhe fondit limit janë : Ervin Kaci, Sokol Dedi dhe Gentjan Saliu.

Është mbajtur relacioni me nr.119/9, datë 12.01.2018 mbi shërbimet dhe grafikun e ekzekutimit. Llogaritja e fondit limit u bë me testim tregu duke marrë si bazë çmimet mesatare nga tre operatorë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

ekonomik : 1- Hyundai me ofertë 1,241,030 lekë pa tvsh, 2-Tirana Auto me ofertë 1,208,070, 3- Classic shpk me ofertë 1,183,594. Komisioni konkludoi se vlera e fondit limit është 1,600,000 lekë pa tvsh .

Nuk ka kërkesë nga Sektori i Shërbimeve, të dhënat teknike të automjeteve inventari, gjendja teknike e automjeteve, sasia e automjeteve.

-Për përcaktimin e vlerës që duhet të financohej nga buxheti i shtetit për riparimet dhe shërbimet që do të behen automjeteve (para llogaritjes së fondit limit) nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit të çdo mjeti e motorike në përputhje me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", udhëzimin nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Po kështu, nuk ka evidenca për çdo mjet (libër shërbimesh) se sa kilometra ka përshkruar përgjatë viteve të mëparshëm,. Pra nuk ka dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme për të argumentuar gjendjen reale të përdorimit dhe nivelin e amortizimit të çdo automjeteve, me qëllim identifikimi e saktë të nevojës për riparime dhe shërbime, mbi bazën e të cilave do të llogaritet dhe të kërkohej financimi buxhetor për të vijuar me pas me llogaritjen e fondit limit sipas përcaktimeve të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Nuk ka procesverbal për llogaritjen dhe argumentimin e Fondit Limit nga grupi i punës, por vetëm një relacion mbi shërbimet dhe grafikun e ekzekutimit.

Është mbajtur Procesverbali nr.1804/6, datë 05.06.2018 për Hartimin e Dokumentave të Tenderit. Është ngritur urdhri me nr.224, datë 24.05.20178, për "Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave" me përbërje: Dalip Basha, Redi Cuku dhe Ermal Manaj.

Nga auditimi konstatohet se ka ardhur një ankesë për kriteret e vendosura për kualifikim dhe përkatësisht për vendosjen e :

I. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 17 punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën Janar 2017-Dhjetor 2017 dhe për periudhën Janar-Prill 2018, nga të cilët në stafin teknik të jenë të punësuar 4 inxhinierë mekanik, 1 motorist, 1 pompist, 1 saldator, 1 gomist, 1 xhenerik, 1 elektroauto.

Operatori duhet të ketë jo më pak se 10 ura ngritëse për automjetet me kapacitet jo më pak se tre ton.(Nuk specifikohen se pse janë vendosur 10 ura ngritëse).

Sipas Ankuesit këto kriteret janë vendosur me qëllim limitimin e operatorëve ekonomik për pjesëmarrje.

Nga AK është vendosur pezullimi i procedurës së prokurimit me shkresën nr.1963, datë 11.06.2018, dhe është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me përbërje: Gentian Saliu, Leonard Gërmenji dhe Neritan Shabani.

Nga komisioni është vendosur pranimi i ankesës dhe ndryshimi i specifikimeve teknike si më poshtë :

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 17 punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën Janar 2017-Dhjetor 2017 dhe për periudhën Janar-Prill 2018, nga të cilët në stafin teknik të jenë të punësuar 3 inxhinierë mekanik, 1 motorist, 1 pompist, 1 saldator, 1 gomist, 1 xhenerik, 1 elektroauto.

Operatori duhet të ketë jo më pak se 8 ura ngritëse për automjetet me kapacitet jo më pak se tre ton.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

Sipas procesverbaleve të mbajtura nga KVO për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave është paraqitur një operator ekonomik :

1-Classic shpk me vlerë 1,513,838 lekë pa tvsh.

KVO vlerësoi si ofertë ekonomike të suksesshme Classic shpk i cili përmbush kriteret ekonomike për kualifikimin e ofertës të përcaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit, lidhur me gjendjen financiare dhe ekonomike.

Është lidhur kontrata me nr1804/12, datë 30.07.2018 me subjektin Classic shpk.

Me urdhrin nr.336, datë 02.08.2018 është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje : Leonard Germeji, Erion Medha dhe Bledar Musabelliu.

3) Mbi auditimin e procedurës me objekt “Informimi mediatic i publikut për skemat mbështetëse për vitin 2018”, realizuar në mbështetje të VKM nr.1195 datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radioteleviziv ose botimin në median e shkrua, dhe për kontratat, për kohë transmetimi”.

Informacion i përgjithshëm.

AZHBR në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike ka hartuar një plan komunikimi dhe veprimi në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi masat mbështetëse kombëtare, viti 2018.

Në hartimin e planit të komunikimit dhe veprimit është synuar një kombinim i mjeteve të komunikimit për të adresuar drejt nevojat për njohuri dhe dhënie të informacionit të duhur në kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe efikase, duke lehtësuar përfshirjen aktive të grupeve të interesit në iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri.

Ky plan siguron që të gjitha politikat mbi skemat mbështetëse kombëtare të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), të implementohen në mënyrën e duhur nga AZHBR-ja duke mundësuar shfrytëzimin në maksimumin e mundshëm të potencialeve rurale drejt arritjes së një zhvillimi dhe konsolidimi të qëndrueshëm mbarëkombëtar.

Bazuar në Udhëzimin e përbashkët të MBZHR dhe MFE, Nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, është bërë promovimi i masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018 nëpërmjet, realizimit të procedurës me objekt “Informimi mediatic i publikut për skemat mbështetëse për vitin 2018”, realizuar në mbështetje të VKM nr.1195 datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radioteleviziv ose botimin në median e shkrua, dhe për kontratat, për kohë transmetimi”.

Kështu, për sa më sipër, nga auditimi u konstatua se, kjo procedurë është iniciuar nga AZHBR, për të informuar publikun mbi të politikat e mbështetjes, masave të financimit për zhvillimin rural 2018, e tú shpjegojë qytetarëve nxitjen për përfshirjen e sa më shumë fermerëve në skemën e mbështetjes për bujqësinë. Mbështetur VKM-së nr. 72 datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, propozohet titullarit të AZHBR, fillimi i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

procedurës për prodhimin apo bashkëprodhimin të programeve a të reklamave, transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe procedurat për kontratat për kohë transmetimi për ç'do rast, duke parashikuar objektin, nevojën e kryerjes së programit/reklamës spotit, shpeshtësinë dhe periudhën e shfaqjes së tij.

- Me urdhrin e titullarit të AZHBR nr. 92 datë 09.02.2018, i ndryshuar me urdhrin nr. 92/2 datë 13.02.2018, ngrihet komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të sporteve/reklamave për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018, i përbërë nga Zana Kaloshi, Rovena Veizaj dhe Bianka Kashifi.

- Komisioni i mësipërm, sipas relacionit mbi hartimin e specifikimeve teknike nr. 486/3 prot. datë 14.02.2018, ka përgatitur kriteret dhe kërkesat specifike, ku procesi i publikimit të spotit, do të realizohej nëpërmjet medias vizive, radiofonike, të shkruar, në nivele kombëtare, duke e përlllogaritur që ky shërbim do të kapte vlerën prej 29.2 milionë lekë pa TVSH. Mbi përlllogaritjet e fondit limit janë marrë 3 oferta nga operatorë të ndryshëm (EGGRA Albania shpk, Pro Video shpk, Albartex shpk).

- Me urdhrin e titullarit nr. 96 datë 14.02.2018, urdhërohet blerja, zhvillimi dhe prodhimi i spoteve/reklamave publicitare 2018, me fond limit 29,166,667 lekë pa TVSH, në zbatim të VKM 1195 datë 05.08.2008 "*Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore*", i përbërë nga Mirgen Dobruna, Albana Pulaj, Ilir Pajenga, Ardita Kuçi dhe Amantia Molla.

- Me urdhrin nr. 110 datë 19.02.2018, dërgohen ftesa për negociata për procedurën e prokurimit, të cilët janë "Advanced" shpk, "Eggra Albania" shpk, "My Afisha" shpk, "Pro Video" shpk, Albartex" shpk, "Pro Sound" shpk.

- Me procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave nr. 544/13 prot. datë 20.02.2018, konstatohen se në procedurë kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik, ku s'kualifikohen 2 operatorë për mangësi në dokumentacion. Sipas specifikimeve për kualifikim me pikë, vlerësohen me 35 pikë projekt-idea, 30 pikë koha televizive dhe 35 pikë oferta më e ulët ekonomike. Operatori Ekonomik "My Afisha" shpk, është vlerësuar me pikët maksimale nga projekt idea, nga koha televizive dhe oferta ekonomike me vlerë 29,096,700 lekë pa TVSH.

- Me kontratën e porosisë nr. 570 prot. datë 21.02.2018, nënshkruhet kontrata midis porositesit AZHBR i përfaqësuar nga titullari Zj. Frida Krifca dhe të porositurit "My Afisha" shpk i përfaqësuar nga Zj. Migena Kola. Afati i kontratës është nga data 21.02.2018 deri më datën 31.03.2018.

- Me urdhrin nr. 113 datë 23.02.2018, krijohet komisioni i monitorimit të publicitetit të skemave për vitin 2018, i përbërë nga Daniela Jaupaj, Valentina Murashi dhe Mirgjana Gjermizi. Shoqëria "My Afisha" shpk, ka dorëzuar spotet grafike dhe planet e transmetimit në përputhje me parashikimet e kontratës dhe me procesverbalin e komisionit të monitorimit nr. 891 prot. datë 26.03.2018, miratohet pagesa për fazën paraprake ideim/prodhim 40% të realizimit të kontratës. Me procesverbalin e dorëzimit nr. 544/19 prot. datë 29.03.2018, dorëzohen materialet e informimit, të cilat janë bashkëlidhur me Media-planin e transmetimit, Media-planin e monitorimit, faturën tatimore, raport monitorimit dhe CD me transmetimin e spoteve për çdo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

televizion. Me procesverbalin e komisionit të monitorimit nr. 1290 prot. datë 24.04.2018, miratohet pagesa për fazën II-të të transmetimit në TV dhe Radio, 60% të realizimit të kontratës.

Nga auditimi i monitorimit të Promovimit mediatic, u konstatua se,

Informimi mediatic u realizua nëpërmjet 7 spoteve publicitare të realizuara nga subjekti «My Afisha» shpk, i kontraktuar për shërbimin me objekt: Informimi mediatic i publikut të gjërë, lidhur me masat e mbështetjes së programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018.

Sipas kontratës së shërbimit me subjektin spotet e realizuara janë me tematikë si më poshtë:

- «Lajmërimi i datës së fillimit të aplikimeve me 0 dokumenta»
- «Bujqësia, bashkimi i fermerëve për përfitimin e investimeve»
- «Përmirësimi i peshkimit dhe rritja e standarteve»
- «Blegtoria, mbështetje e lindjeve të reja të të imtave dhe gjedhit»
- «Agroturizmi dhe mbështetja në produkte dhe prodhime tradicionale»
- «Modeli i suksesit në zhvillimin e agropërpunimit»
- «Modeli i suksesit në përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij»

Kohëzgjatja e secilit spot sipas kushteve kontraktuale ishte jo më pak 30 sekonda, me shpeshtësi shfaqje jo më pak se 2 (dy) herë në ditë.

Transmetimi i spoteve u bë në 9 kanale televizive dhe konkretisht :

- 4 televizione kombëtare (RTSH, TV KLAN, VIZION PLUS dhe TOP – CHANNEL)

- 5 televizione me natyrë informuese (NEËS 24, REPORT TV, ABC NEËS, ORA NEËS dhe FAX NEËS), për 30 ditë rresht, jo më pak se 2 herë në ditë, ku të paktën 1 (një) transmetim ishte në kohën me shikueshmëri më të lartë.

Transmetimet e spoteve në televizione u bënë gjatë periudhës së aplikimit sipas një media plani të parashikuar që me nënshkrimin e kontratës.

Situata:	<p>Nga auditimi është konstatuar se, për vitin buxhetor 2017 dhe 2018 AZHBR-ja, më së shumti ka realizuar procedura me blerje të vogla, ndërsa në lidhje mbi procedurat e prokurimeve publike, për zërin 231 (investime) dhe zërin (602) mallra e shërbime me vlera të lartë, pjesa më e madhe tyre janë realizuar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) ose nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.</p> <p>Në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si Autoritet Kontraktor u konstatua se institucioni nuk ka njësi të prokurimit, si strukturë permanente, por është krijuar, rast mbas rasti në momentin që ka pasur procedura.</p> <p>Nga auditimi, u evidentua se, anëtarët të cilët janë vendosur nga Titullari i AK nuk janë specialist të fushës dhe nuk janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme pranë Agjencia e Prokurimeve Publike (APP).</p>
Kriteri:	<p>Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Manuali për MFK nr. 108 datë 17.11.2016, pika 3.1. Mjedisi i kontrollit te brendshëm "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore" .</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Kriteret e përcaktuar në procedurën e prokurimeve nuk janë bërë në përputhje me nenin 46, të LPP nr. 9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar, si dhe me nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku çdo kriter i veçantë duhet të jete në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Shkaku:	Mos trajnimi i specialistëve në fushën e prokurimit.
Rëndësia:	I mesëm

6. AUDITIMI I FONDEVE TË DHËNA PËR PROGRAMET E BUJQËSISË DHE PËR ZHVILLIMIN RURAL

Në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, të fondeve të dhëna për programet e bujqësisë dhe për zhvillim rural, me burim financimi nga Buxheti të Shtetit, grupi i audituesve të KLSH-së u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr.9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural"; VKM-së nr.719 datë 31.10.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural si Agjenci e Pagesave", i ndryshuar me VKM nr. 877, datë 14.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 719"; Urdhrit të Kryeministrit Nr. 140, datë 17.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AZHBR; VKM nr. 137 datë 22.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2017"; Udhëzimin e përbashkët të MBZHRAU dhe Ministrisë së Financave nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; Udhëzimin e përbashkët të MBZHRAU dhe MF, nr. 10, datë 22.05.2017, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; Manuali i Procedurave për Implementimin e Skemave Kombëtare, dokumenti me nr. 1921, datë 07.07.2017 ; VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural "i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik."

Mbështetur në Standardit Ndërkombëtar i Auditimit ISSAI 1610 e cili lejon, *audituesin e jashtëm që të përdorë punën e auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose kohën, ose për të zvogëluar shkallën e procedurave të auditimit që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga audituesi i jashtëm*, e gjykojmë të rëndësishme të përdorim të dhëna e raportit "Tekniko - financiar vjetor" të AZHBR-së, përkatësisht për vitet 2017-2018.

Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2017 dhe 2018, është operuar më dhënien e subveicioneve në ndihmë të fermerëve, shoqërive bujqësore dhe personave fizike, për zhvillimin dhe përmirësimin në drejtim të bujqësisë, blegtorisë dhe agroturizëm, nëpërmjet mundësimit të:

1.)Skema mbështetëse me burim financimi nga BE, nuk u audituan nga grupi i audituesve, pasi nga vetë strukturat audituese të BE-së, është realizuar auditimi dhe monitorimi, në muajin shtator 2018.

2.)Skema kombëtare me burim financimi Buxhetin e Shtetit, të cilat janë produkt i vendim marrjes së Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë, për çdo fillim viti, të shoqëruara



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

nga nen aktet ligjore Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2017, baza ligjore e programit të mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural bazohet në:


-VKM nr. 137 datë 22.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2017"; Udhëzimin e përbashkët të MBZHRAU dhe Ministrisë së Financave nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; Udhëzimin e përbashkët të MBZHRAU dhe MF, nr. 10, datë 22.05.2017, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; Manuali i Procedurave për Implementimin e Skemave Kombëtare, dokumenti me nr. 1921, datë 07.07.2017.

Në bazën ligjore të mësipërme janë përcaktuar kriteret, detyrat dhe kompetencat e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në procesin e menaxhimit të fondeve të programit për mbështetjen e drejtpërdrejtë të bujqësisë dhe zhvillimit rural, përgjatë 17 masa mbështetëse, ku pranimi dhe vlerësimi i aplikimeve filloi në datën 02/05/2017 dhe përfundoi më datën 16.06.2017.

Grupi i auditimit, u përqendrua në skemën e aplikimit për skemën e investimeve, ku u konstatua se janë depozituar pranë protokollit të AZHBR 124 aplikime, është bërë kontrolli administrativ i dosjeve nga "Sekretariati" dhe "Komisioni i Vlerësimit dhe Miratimit të Projekteve".

Grafiku i mëposhtëm jep shpërndarjen e aplikimeve sipas qarqeve, ku dominancën më të madhe në aplikime e ka zona qendrore e dominuar nga Durrës, Fier, Tiranë, Elbasan dhe më pak zonat veriore si Kukës dhe Dibër.

Fig. 3: Numri i aplikimeve për skemën e investimeve sipas qarqeve





KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

Por, mos miratimi i alokimit të fondeve nga MBZHR dhe VKM 482 datë 5.7.2017 "Për pezullimin e procedurave të prokurimit" nuk lejoi lidhjen e kontratave të investimeve. VKM nr. 580, datë 13.10.2017 " Mbi shfuqizimin e VKM së 482 datë 5.7.2017 bënte të pamundur realizimin e investimeve brenda vitit fiskal. Akti normativ Nr.3 date 4.12.2017 pakësoi fondet.

Pra, për vitin 2017, u konstatua se, keq planifikimi, keq administrimi si dhe rialokimet e shpeshta të fondeve për skemat kombëtare, të miratuara me Vendimet e Këshillit të Ministrave, brenda vitit 2017, ka ndikuar negativisht tek aplikantët e këtyre skemave, duke ulur efektivitetin e skemave kombëtare dhe besimin e fermerëve se mund të përfitojnë nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2018 , nga auditimi u konstatua se, referuar dinamikës së fondeve buxhetore të parashikuara me vlerë më të lartë, ka sjellë rritje 2-3 herë më shumë të financime nga Buxheti i Shtetit, në krahasim me vitet 2014;2015;2016;2017, për pasojë është rritur dhe numri skemave mbështetëse prej 52 skema mbështetëse, te cilat janë të ndryshme dhe më të larmishme se skemat e viteve paraardhëse, si më poshtë vijon:

-Për herë të parë në vitin 2018, është bërë aplikim online për masat mbështetëse direkte, mbi bazën e parimit "zero dokumente", në momentin e aplikimit. Për 30 masat e mbështetjes ka patur një numër total të aplikimeve 6,141 aplikime;(6,058 + 83 përfshirja tufës bazë) aplikime, nga të cilat të rregullta me 0 dokumenta në momentin e aplikimit 5,685 aplikime me një vlerë totale të kërkuar 1,035,746,000 lekë.

-Për herë të parë, në vitin 2018, është krijuar "Agropika"- Sportel unik për shërbimin ndaj fermerit. Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2018, janë vënë në funksion të shërbimit 5 Agropikat e para, përkatësisht në rrethet Fier, Lushnje, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Si dhe 15 Agropikat e tjera janë rikonstruktuar, duke plotësuar numrin 20 në të gjithë vendin.

-Viti 2018 në vlerë financiare është viti më i lartë i tre viteve të fundit të disbursimeve për mbështetjen në bujqësi duke shënuar vlerën financiare prej 13,2 mln EUR.

Në tabelën më poshtë jepet krahasim i disbursimit me vite të tjera.

Buxheti	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
	11	10.14	1.61	20
% e rritjes së buxhetit të vitit 2018 në krahasim me vitet paraardhëse	45%	52%	1000%	-

Aplikime	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
	3,406	3,245	4,090	6,370
% e rritjes së aplikimeve të vitit 2018 në krahasim me vitet paraardhëse	47%	49%	36%	-

Përfitues	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
	3,133	3,089	790	4,059



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

% e rritjes së përfituesve të vitit 2018 në krahasim me vitet paraardhëse	23%	24%	510%	-
---	-----	-----	------	---

-Për herë të parë, AZHBR ka marrë besimin për zbatimin e një Programi prej 94 mln Euro për Bujqësinë, të bashkëfinancuar 75 % nga fondet e B.E dhe 25 % nga fondet e buxhetit të Shtetit. Akreditimi është marrë për 3 masa investimi: Masa 1 - Investime në aktive fizike në fermat bujqësore, Masa 3- Investime në aktive fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, Masa 7- Diversifikimi Fermave dhe Zhvillimi Biznesit.

-AZHBR ka hapur thirrjen për aplikime nga data 1 Nëntor 2018 deri në 31 Janar 2019, si dhe ka angazhuar stafin me një fushatë intensive informimi në të gjitha rajonet e Shqipërisë, ku janë informuar dhe trajnuar rreth 1200 persona përfshirë fermer, agro-përpunues, konsulet, ekstensionist, punonjës të agropikave si dhe pale të tjera të interesuara. E gjithë puna intensive është finalizuar me një numër të konsiderueshëm aplikimesh, rreth tre herë më i madh sesa analiza e parashikuar, për thirrjen e parë. Kjo tregon se në institucion është rritur besimi në kuadër edhe të transparencës që ka treguar AZHBR.

-AZHBR ka rritur kapacitetet e stafit, është kryer procedura e ristrukturimit të AZHBR-së duke rritur numrin e punonjësve nga 133 në 169 veta, si dhe stafi ka marrë trajnime intensive për gjithë funksionet, me mbështetje nga USAID, GIZ, TAIEX si dhe institucione të tjera.

-Për projektin e shërbimeve mjedisore, nga zbatimi i thirrjes së parë, nga 63 kontrata të lidhura, janë financuar 61 subjekte përfituese me një vlerë totale prej 225,419,330.98 ALL Referuar projekteve të financuara janë përmirësuar 3159.47 ha sipërfaqe pyjore, 178.23 ha kullota dhe janë ndërtuar 84 prita malore dhe 23 lera. Gjithashtu gjatë vitit 2018 u hap thirrja e dytë publike ku u shënua interesim më i madh nga aplikantët, u regjistruan 151 aplikime apo 10 % më shumë se në thirrjen e parë.

-N/Komponentit 1 të Programit "Rimëkëmbja nga Përmbytjet", Janë dëmshpërblyer përfundimisht në total 3,420 fermerë nga fondet e BE me një vlerë përfitimi 387,957,869 ALL dhe 3,363 fermerë nga fondet e buxhetit të shtetit me një vlerë përfitimi 42,882,263 ALL. N/Komponentit 2 të Programit "Rimëkëmbja nga Përmbytjet". Në përfundim të projektit janë financuar gjithsej 28 subjektet e kontraktuara me vlerë totale 472,791,001.04 ALL, nga të cilat me fondet e BE 425,511,892.04 ALL (90% e vlerës së financimit), dhe me fondet kombëtare 47,279,109.0 ALL (10% e vlerës së financimit).

Kështu, grupi i auditimit u fokusua kryesisht në skemat kombëtare të investimit, të cilat përbëjnë vlerën më të madhe të financuara nga Buxheti i shtetit, ku në fillim viti 2018, me vlerë prej 1,624,303,073 lekë, më pas Buxheti pas aktit normativ është ndryshuar dhe është ulur në vlerën 1,141,787,683 lekë dhe realizimi deri në datë 31.12.2018 rezultoi në vlerën 1,001,916,005 lekë, e paraqitur në formë tabelare Tab.1 dhe Tab .2 si më poshtë:

Investimet



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural”

<p>Bujqësia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim serash diellore (Perime) • Ambiente frigoriferike (Fruta/Perime) • Ambiente grumbullimi (Fruta/Perime) • Linja përpunimi (Fruta/Perime) • Linjë selektimi, paketim (Fruta/Perime) 	<p>Peshkimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Linjë filetimit, tharje, tymosje (Peshku liqeneve) • Mbështetje për blerjen e Sistemeve të monitorimit të anijeve të peshkimit (MTU) • Instalim bankina lundruese (Peshku) • Ambiente frigoriferike (Peshku)
<p>Blegtoria</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim thertore, blerje pajisje për to (Mish) • Ndërtim pika grumbullimi, blerje pajisje të nevojshme (Qumësht) • Makineri dhe pajisje për fermat (Qumësht) • Sistem ftohës për pikat e grumbullimit dhe/ose përpunimit (Qumësht) • Përmirësimi infrastrukturë tregjeve të kafshëve 	<p>Agroturizëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritje ose rikonstruksion të ambienteve për turizmin rural me 6 – 10 shtretër • Investime në agroturizëm • Ngritje ose rikonstruksion ambienteve të prodhimit tradicionale • Makineri dhe pajisje për prodhime tradicionale • Mbështetje për Marketing/ambalazhim/paketim të prodhimeve tradicionale të zonës • Mbështetje për çdo sipërmarrje të re nga individ të moshës 22 – 36 vjeç (start-up) • Përmirësimi i kushteve në Stane • Ngritja Inkubator të prodhimeve tradicionale • Mbështetje për subjektet e shitjes me pakicë të produkteve ushqimore të prodhuara në vend

Skema kombëtare direkt mbështetëse (jo investime)

<p>Mbjellje Mollë Mbjellje Qersh Mbjellje Arra Mbjellje Lajthi dhe Shegë Mbjellje Gështenjë Mbjellje Ullinj Plotësimi i rrëzës bimëve në ullishtat e vjetra Mbjellje e Agrumeve Mbjellje vreshta Mbjellje Luleshtrydhe Mbjellje Bimë medicinale dhe aromatike Ujitje me pika Sistem ngrohës me biomasë Zëvendësimi plasmasi në serra diellore Prodhim bostanorësh në tunele Rrjeta për mbrojtjen nga breshëri për mollën dhe qershinë</p>	<p>Polenizim i kulturave perimore në serra me bletë polenizuese Sistem automatizimi për kontrollin e energjisë në serra Çertifikimi Global GAP Standarti IFS Çertifikimi i për fermat organike dhe në kalim Çertifikatë ISO Primi i sigurimit për prodhimet bujqësore Mbështetja Lindjet e reja në të imta dhe gjedh Enë transporti qumështi Dorëzim qumështi Mbarështrim bletari Mbështetja fidanë perimesh Dorëzim Acuge/Sardele Mbështetja për mbjelljen Grurë, elb, thekër, tërshërë, koçkull</p>
--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

Nr. Masave	MASAT E PËRFITIMIT	Aplikime total	BUKJETI FILLIM VITIT		BUKJETI PAS AKTIT NORMATIV		Realizimi date 31.12.2018	
			Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
12	Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit	59	31	281,278,106	19	177,299,597	19	171,307,415
20	Ambiente grumbullimi dhe frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore	34	19	353,286,922	15	221,772,962	15	203,268,715
21	Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime	9	7	61,324,843	6	59,044,156	6	47,596,556
22	Linja përpunimi/makineri pajisje për fruta – perime, vaj ulliri dhe verë	34	21	268,300,000	15	212,617,773	15	206,791,449
23	Linja selek., paketimi, amb. për fruta, perime dhe bimë medicinale	16	8	35,747,680	4	17,956,940	4	17,771,620
24	Linja për fletimin, tharjen, tymosjen e produkteve peshkore	1	1	3,000,000	-	-	0	0
32	Ndërtimin e thetoreve dhe pajisjeve	24	12	156,600,000	11	152,654,332	11	123,363,936
33	Ndërtimin e pakeve të reja të grumbullimit të qumështit dhe pajisjeve	5	2	4,464,960	1	3,000,000	1	3,000,000
34	Ndërtimin e ambienteve për mbarëshkrimin e kafshëve dhe makineri dhe pajisje	31	12	191,696,373	12	148,747,453	12	129,563,885
35	Sisteme ftohëse të qumështit për pikat e grumbullimit	1	0	-	-	-	-	-
36	Përmirësim të infrastrukturës së tregjeve të kafshëve	1	0	-	-	-	-	-
39	Mbështetje të anjeve të peshkimit dhe/oseOMP	1	1	15,555,000	1	5,000,000	0	0
40	Mbështetje den në 70% të vlerës për instalimin e bankinave lundruese	0	0	-	-	-	0	0
44	Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin të turizmit rural	19	8	14,286,000	4	5,936,286	4	5,611,494
45	Mbështetje për investime në agroturizim	57	19	186,800,000	13	115,862,879	13	75,332,861
46	Konstruksion ambienteve prod. tradicionale	0	0	-	-	-	-	-
47	Makineri dhe pajisje për prod. tradicionale	0	0	-	-	-	-	-
48	Marketing për produktet tradicionale	1	0	-	-	-	-	-
49	Start up në zhvillimin rural	1	0	-	-	-	-	-
50	Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane	12	4	1,400,000	1	200,000	1	200,000
51	Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve	4	4	42,550,815	2	17,695,305	2	14,444,771
52	Mbështetje në mjete dhe subjekteve të shijes me pakicë të produkteve	4	4	8,012,374	2	4,000,000	2	3,663,303
TOTALI		314	153	1,624,303,073	106	1,141,787,683	105	1,001,916,005

Nga auditimi u konstatua se, pranimit dhe vlerësimi i aplikimeve ka filluar në datën 28.02.2018 dhe është përfunduar më datë 28.03.2018 për masat direkte të mbështetjes 30(tridhjetë) masa dhe në datën 27.04.2018 për skemat e investimeve, ka janë parashikuar për aplikime 22 (njëzet e dy) masa në zbatim të VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar.

Sipas VKM nr. 374, datë 20.06.2018, "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 72, datë 07.02.2018 të KM "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit nr. 11, datë 21.06.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 19.02.2018, "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", aplikimet për masat mbështetëse 44 dhe 45, u rihapën nga data 22.06.2018 deri në 15.07.2018.

Mbi auditimin e Objektivave të masave 2018



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

Në bazën ligjore të mësipërme janë përcaktuar kriteret, detyrat dhe kompetencat e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në procesin e menaxhimit të fondeve të programit për mbështetjen e drejtpërdrejtë të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2018 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri "Transferte në buxhetet familjare", në vlerën 2,565,000,000 lekë është përdorur për mbështetjen e 52 masave të grupuara për arritjen e objektivave të mëposhtme:

1. Rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, nëpërmjet shtimit të sipërfaqes së tokës së punuar dhe të sipërfaqeve të mbjella me kultivarë të kërkuar nga tregu, përmirësimit të teknologjive të kultivimit, certifikimit të produkteve, rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të grumbullimit, ruajtjes, pastrimit, seleksionimit, paketimit dhe përpunimit të tyre.
2. Përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara të lindjeve të reja, pagesave për dorëzimin e qumështit cilësor, investimeve në thertore, në pikat e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve, makineri dhe paisje në fermat blegtorale.
3. Nxitjen e formalizimit dhe kooperimit të prodhuesve nëpërmjet pagesave për furnizimin me inpute dhe pagesave ndaj prodhimit të dorëzuar.
4. Përmirësimin e menaxhimit të peshkimit.
5. Mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet mbështetjes së agroturizimit, prodhimit dhe tregtimit të produkteve tradicionale, nxitjen e bizneseve të reja.

- Për sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH, u fokusua në aplikimin, përzgjedhjen, lidhjen e kontratave dhe monitorimin e tyre, për skemat e investimeve, kjo në bazë të Udhëzimit nr. 1, datë 19.02.2018, i ndryshuar, ku janë evidentuar 20 masa konkretisht (12, 21-24, 32-36, 39, 40, 44-52), ku në total, në bazë të 2 thirrjeve të bëra, kanë aplikuar gjithsej 314 subjekte (fermer, SHBB, shpk, person fizik/juridik) të shpërndara pothuajse në të gjithë qarqet e vendit.

Në bazë të thirrjes së parë janë administruar 270 aplikime, dhe për thirrjen e dytë për aplikime vetëm për masat 44 dhe 45 (masat e Agroturizimit) me afat aplikimi nga 22.06.2018 deri me 17.07.2018, janë administruar 44 aplikime të shpërndara nëpër qarqe, nga të cilat janë s kualifikuar 27 aplikantë.

-Nga auditimi u konstatua se, në përfundim të shqyrtimit administrativ janë s'kualifikuar 161 subjekte, e më pas janë kontraktuar 105 aplikantë me vlerë totale të kontraktuar prej 1,035,929,666 lekë dhe vlerë faktike të përfituar nga aplikantët pas verifikimit të AZHBR prej 1,001,916,005 lekë.

Nga auditimi i dosjeve fizike u konstatua se, Drejtoria e Përzgjedhjes së Projekteve, s kualifikimet e aplikimeve, janë bërë në përputhje të mos përmbushjes të kriterëve të vendosura në mbështetje të VKM nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar.

Arsyet kryesore të s'kualifikimeve kanë të bëjnë konkretisht:

- mungesa e planit të biznesit/ pjesa financiare,




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

- mungesa e tre ofertave dhe vlefshmëria e tyre,
- preventivi nuk është i vulosur dhe i firmosur nga inxh/ndërtimi i licencuar,
- debitorë ndaj MBZHR si dhe
- tërheqja e aplikantëve.

-Grupi i audituesve, ka përzgjedhur për auditim subvencionet të përfituara për masat 12, 20, 22, 34, 44-45, etj, pasi këto zënë peshën më të madhe financiare të financuara nga Buxheti i shtetit. Konkretisht, nga grupi u audituan 64 dosjet fizike të subvesioneve duke i gërshetuar me verifikime në terren në rrethet Lushnjë, Fier, Berat, Vlorë, Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër dhe Korçë, gjithsej 64 subjekte me vlerë subvencioni 617,833,402.00 lekë, ose 61.7% të vlerës së subvencioni të siguruar me financim nga Buxheti i shtetit, konkretisht i ndarë sipas masave si më poshtë:



Në vlerësimin dhe nga diskutimet formale, që grupi i auditimit ka realizuar me stafin e AZHBR-së, me aplikantë (fermerë, shoqëri të bashkuar bujqësore SHBB, persona fizik/juridik), si dhe në bazë të dokumentacionit të aplikimeve fituese, lidhjen e kontratave dhe monitorimin në terren të zhvillimit të investimit kontraktor, u konstatua mangësitë si më poshtë:

I) Nga auditimi, u konstatua se, propozimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, drejtuar Këshillit të Ministrave, për VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, nuk është realizuar paralelisht me miratimin Buxhetit vjetor që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë brenda datës 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke mos qene në koherencë me vitin bujqësor por me vitin kalendarik buxhetor, e për pasojë ka sjellë penalizim e aplikantëve fitues që investimi të realizohet brenda periudhës afat shkurtër 2-3 muaj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

II) Nga auditimi, për **Masën 12** (Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit), ku citohet: "Masa e financimit është parashikuar 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika ose jo më shumë se 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.", u evidentua se, duke përdorur metodën krahasimore midis mesatares së çmimeve të ofertave të përfituesve, me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", konstatohen se ka diferenca në vlerë sipas çmimeve me kontratat e përfituesve si më poshtë vijon:

Masa 12 "Ndërtim i serrave diellore" viti 2018									
Përshkrimi i punimeve sipas zërave	Njësia	Danish Green Garden	Klaud Meta	Juliana Pupa	Dritan Kuqo	Cmimi Mestatar LEK	Cmimi sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015	Diferenca ne LEK	Rritja ne %
Germim dhe gropa	m3	710		854		782.20	637.00	145.20	23%
Beton	m3		13,200	11,000		12,100.00	8,398.00	3,702.00	44%
Konstruksionet metalike (kollona, tirante etj)	kg	263	214	270	146	223.08	138.20	84.88	61%
Plasmas serrash dhe aksesore (Nuk ka reference)	m2	74	159	230	489	237.96			43%

Pra, sipas tabelës së mësipërme u evidentua se përfituesit e serrave diellore, në zërat e mësipërme, kanë paraqitur preventiva të rritura në mënyrë artificiale afërsisht 43 % të vlerës së investimit total për tre zëra kryesorë.

Kështu, nga kjo analizë, duke patur parasysh faktin se AZHBR, financon nga buxheti i shtetit jo më shumë se 50% e vlerës së investimit, pra rreth 21.5% e subvencionit është përfituar padrejtësisht nga aplikantët, pasi në Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, Kreu IIX "Kriteret specifike dhe dokumentacioni për masat mbështetëse", pika 2, nuk është kërkuar referimi i çmimeve mbështetur në manual për Masën 12, duke hequr kërkesën që preventivi duhet të jetë i vulosur dhe i firmosur nga inxh. ndërtimi i licensuar, siç është kërkuar për masat e tjera.

III) Nga auditimi, u konstatua se, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR, nuk ka ndonjë strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat, masat mbështetëse të synuara, treguesit etj, si edhe roli i AZHBR-së duket thjesht si ekzekutues i fondeve që duhen shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriteve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".

IV) Nga auditimi, u konstatua se, hartimi i kontratave me përfituesit e skemave mbështetëse kombëtare, janë kontrata tip, pa ndryshime nga njëra masë tek tjetra, ku nuk del e qartë masat konkrete administrative që duhet të ndërmarrë AZHBR në rastet e mosplotësimeve detyrimeve kontraktore, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9817 datë 22.10.20017 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, neni 39 (sanksionet) pika I citohet se "*Kundravajtjet administrative dënohen me gjobë në masën 30, 000 (tridhjetë mijë) lekë – 40, 000 (dyzet mijë) lekë si dhe kthimin e financimit të përfituar*".

Gjithashtu, në kontratë, është përcaktuar që monitorimi i aktivitetit është i detyrueshëm për 5 vite, por nuk është përcaktuar qartë garancitë financiare të kontratës, por është mjaftuar me sigurimin e kontratës, e cila çlirohet në momentin e ekzekutimit të pagesave nga AZHBR.

Nga auditimi i kontratave, u konstatua se, nuk përcaktohet emri i mbikëqyrësit të punimeve sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me përfituesit e skemave mbështetëse në rastin investim (ndërtim, rikonstruksion, etj, por është mjaftuar vetëm në firmosjen nga supervizori librezën e masave), e cila duhet të bëhet, në përputhje me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar neni 7 ku citohet se "*..për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve i emeruar nga investitori duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektin që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektit, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit, caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse.*"

V) Gjithashtu nisur nga dosjet e audituara, në lidhje me investimet dhe fondet e përfituara për investime nga AZHBR është konstatuar se, në grupet e kontrollit për miratimin e dokumentacionit të aplikimit dhe kontrollin në terren në terren, të Drejtorisë së Kontrollit, Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve si dhe Drejtoria e Autorizimit të Pagesave, të cilat kanë rolin funksional kryesor, në vlerësimin, përzgjedhje, kontroll dhe monitorim, ka një numër të konsiderueshëm punonjësish më profil-jurist, ku mungojnë në strukturë punonjës me profil, inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/ mekanik, inxh/elektrik.

Nisur dhe nga auditimet e kryera në terren nga grupi i KLSH-së, u evidentuan që për shumë nga punimet e kryera përdoret termi "*E PAMATSHME*", dhe pikërisht vlerat në lekë që i korrespondojnë këtij termi përbëjnë rreth 50 % të investimit, duke sjellë kështu një pamje jo të qartë për ne si auditues të jashtëm për të dalë në konkluzionin që burimet njerëzore janë përdorur me ekonomikitet, efikasitet dhe eficiencë. Në grupet e punës pothuajse të gjithë punonjësit janë në profilin jurist dhe ekonomist, të cilët i marrin të mirëqena punimet e ndërtimit të kryera nisur vetëm nga fasada dhe jo nga një analizë e hollësishme që mund të kryejnë specialistët e fushës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

VI) Nga auditimi i procedurave të dhënies së subvencionet për skemat mbështetëse kombëtare kryesisht investime, numri i dokumentave për të plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe kohore për aplikantët, për pasojë kemi ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare. E kundërta ka ndodhur për masa direkte mbështetëse, ku në vitin 2018, për herë të parë, është përdorur aplikim me 0 dokumenta, duke ulur numrin e dokumentave për fermerin, por duke shtuar volumin e punës dhe kosto administrative të larta, të administratës të AZHBR-së.

VII) Më poshtë po paraqesim auditimin e dokumentacionit fitues të përfituesve për skemat mbështetëse kombëtare, në fushën e investimeve, ku janë evidentuar rastet e sipërpërmendura si edhe rastet kur subjektet përfitues kanë rezultuar në përputhshmëri të plotë. Nga auditimi, në bazë të dokumentacione të subjekteve përfituese duke i gërshetuar në auditimin në terren, si dhe duke u bazuar në kontrollet ex-post të skemave mbështetëse nga Skemat Kombëtare, për vitin 2018 dhe të viteve të mëparshme.

Kështu, grupi audituesve, u verifikuan në terren subjektet e Qarkut Tiranë dhe Durrës. Nga auditimi, në Qarkun Tiranë, janë përfituar gjithsej 19 aplikantë përfitues për Skemat Kombëtare në vlerë totale 193,434,895 lekë, ku të ndarë sipas masave janë:

- 1 subjekt për masën 12 "Ndërtimi i serave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit, në vlerën 9,840,877 lekë.
- 2 subjekte për masën 20 "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore", në vlerën 37,612,442 lekë.
- 5 subjekte për masën 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë", në vlerën 66,121,332 lekë.
- 2 subjekte për masën 32 "Ndërtimin e thertoreve, ambienteve të përpunimit dhe produkteve blegtorale", në vlerën 26,152,174 lekë.
- 1 subjekt për masën 52 "Mbështetje në rrjetin e subjekteve të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore në vend", në vlerën 1,782,328 lekë.
- 4 subjekte për masën 44-45 "Mbështetje për investime në agroturizëm dhe rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural", në vlerën 20,016,798 lekë.

Sikurse konstatohet pjesën më të madhe në Qarkun Tiranë e zënë masa 22 dhe masa 44-45 si në numër aplikuesish dhe rrjedhimisht edhe në vlerë.

1). Në subjektin "Coral" shpk, përfitues i masës 20 "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore" në vlerën e kërkuar dhe miratuar prej 20 mln lekë, në momentin e kontrollit u konstatua se nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare duke mos vendosur në një vend të dukshëm një stendë afishimi, poster apo tabel, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

2). Për subjektin "Elton Mema" pf përfitues në skemën 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë" u konstatua se investimi ishte ekzistues por në momentin e kontrollit investimi nuk përdorej sipas qëllimit fillestar në përputhje me kontratën e nënshkruar. Ambientet e magazinës ishin bosh dhe nuk ishin në funksion në përputhje me kontratën e grandit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

Nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare pasi mungonte dhe nuk ishte vendosur në asnjë moment një stendë afishimi, poster apo tabelë, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

Subjekti ka shkelur detyrimet kontraktuale dhe konkretisht nenin 5, Përgjegjësitë e Përfituesit, pika 5.6, ku citohet se:

Përfituesi i grantit duhet të dokumentojë vendet e reja të punës të krijuara nga investimi i ri në përputhje me bines-planin e dorëzuar në AZHBR.

3. Nga kontrolli i përfituesit "Shqiponja" me Nipt-L71624023M, shpk, përfitues i masës 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë" u konstatua se makineria e përpunimit të vaj-ulliri ishte në ambientin e aktivitetit por nuk ishte vendosur ende në funksion prej instalimit e deri në maj në momentin e auditimit. Gjithashtu vazhdonte rikonstruksioni i ambientit në të cilin ndodhej makineria, i cili ishte duke u ndërtuar.

Përfituesi nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare duke mos vendosur stendën e afishimit, poster apo tabelë, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

Nisur nga deklaratimet e këtij subjekti është konstatuar se ky tatimpagues është regjistruar në QKB në 24.04.2017, dhe deklaroi me zero kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore prej periudhës 22.05.2017 e në vazhdimësi, veprim ky në kundërshtim me kontratën e lidhur me AZHBR me nr.prot 1107/5, datë 27.08.2018, si dhe me Udhëzimin nr .1, datë 19.02.2018, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" pika IV, Dokumentacioni i detyrueshëm për tu siguruar nga AZHBR, nënpika.6.ku citohet se:

Vërtetimi për "shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore" (pas përfshirjes së aplikuesit në listën paraprake të fituesve);

Nisur nga sa më sipër, AZHBR duhet të monitorojnë në mënyrë permanente subjektet me aktivitet sezonal si dhe të verifikojnë në bashkëpunim me DPT-në, vazhdimësinë e aktivitetit të tyre.

4. Nga kontrolli i përfituesit "Enol" shpk, me nipt-K81512026T, me përfaqësues z.Qemal Alushi, përfitues i dy masave 44-45 "Mbështetje për investime në agroturizëm dhe rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural" përkatësisht në vlera 1,319,649 dhe 9,447,454 lekë, u konstatua se investimi në rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural për 4 dhoma ishte kryer dhe ishte funksional pra i shërbente aktivitetit. Subjekti ka lidhur kontratën me AZHBR me nr.prot.2804/9 datë 07.09.2018, për masën 44 "Mbështetje për rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 1,500,000 lekë" në rastin konkret rikonstruksion i bujtinës me katër dhoma në adresën Prezë, Tiranë. Vlera e investimit të pranuar është 3,023,861.28 lekë dhe masa e mbështetjes financiare 1,500,000 lekë. Kontrata e dytë me nr.prot 2804/12, datë 17.09.2018 ka të bëjë me masën 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50 % të vlerës totale, por jo më shumë se 10,000,000 lekë. Vlera e investimit të pranuar është 19,862,558.40 lekë dhe masa e mbështetjes financiare 9,931,279.20 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare.



KONTROLLI I LARTË I SHTEMIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

5. Nga kontrolli i përfituesit "Agromel" shpk, me Nipt-L59308601M, përfitues i masës 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë" në vlerën 20,000,000 lekë, u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional pra i shërbente aktivitetit. Investimi konsistonte në blerjen e makinerisë *për larjen dhe ngrirjen e frutave si luleshtrydhe e qershi*. Subjekti ka lidhur kontratën me AZHBR me nr.prot.1256/9, datë 05.10.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 50,227,565.60 lekë dhe masa e mbështetjes financiare 20,000,000 lekë. Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare.

Për Qarkun Durrës, kanë përfituar gjithsej 9 aplikantë për Skemat Kombëtare në vlerë totale 96,586,432 lekë, ku të ndarë sipas masave janë :

1 subjekt për masën 12 "Ndërtimi i serave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit, në vlerën 10,701,356 lekë.

2 subjekte për masën 20 "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore", në vlerën 34,077,584 lekë.

1 subjekt për masën 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë", në vlerën 19,296,787 lekë.

1 subjekt për masën 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve dhe për rritjen e shpendëve si dhe makineri për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale ", në vlerën 5,119,951 lekë.

1 subjekt për masën 23 "Linja seleksionimi, paketimi, pastrimi, përfshirë dhe ambalazhe për fruta perime dhe bimë medicinale dhe aromatike", në vlerën 5,000,000 lekë.

3 subjekte për masën 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm dhe rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural", në vlerën 22,390,754 lekë.

1.Nga kontrolli i subjektit "Buna" shpk me Nipt: J61826501C, përfaqësues zj.Gentiana Sinjari, adresë Shkozet-Durrës, përfitues i masës 20 "Ambiente grumbullimi ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore, jo më shumë se 20,000,000 lekë u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional në shërbim të aktivitetit.

Subjekti ka lidhur kontratën me AZHBR me nr.prot.1076/5, datë 27.08.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 41,290,722 lekë dhe masa e mbështetjes financiare 20,000,000 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare.

2.Nga kontrolli i subjektit "KAMI" shpk me Nipt: L81316502S, përfaqësues z. Fundim Gjepali, adresë Gjepalaj e Poshtme Durrës, përfitues i masës 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50 % të vlerës totale, por jo më shumë se 10,000,000 lekë" u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional në shërbim të aktivitetit.

Subjekti ka lidhur kontratën me AZHBR me nr.prot.2808/7 datë 07.09.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 43,658,209.20 lekë me tvsh dhe masa e mbështetjes financiare 10,000,000 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare duke mos vendosur në një vend të dukshëm një stendë afishimi, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

3. Nga kontrolli i subjektit "KAMI" shpk me Nipt: L81316502S, përfaqësues z. Fundim Gjepali, adresë Gjepalaj e Poshtme Durrës, përfitues i masës 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50 % të vlerës totale, por jo më shumë se 10,000,000 lekë" u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional në shërbim të aktivitetit.

Subjekti ka lidhur kontratën më AZHBR me nr.prot.2808/7 datë 07.09.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 43,658,209.20 lekë me tvsh dhe masa e mbështetjes financiare 10,000,000 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare duke mos vendosur në një vend të dukshëm një stendë afishimi, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

4. Nga kontrolli i subjektit "Shqipe Huqi" person fizik me Nipt: L51404515M, përfaqësues zj. Shqipe Huqi, adresë Liqeni i Huqve, Radë-Manëz, Durrës, përfitues i masës 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50 % të vlerës totale, por jo më shumë se 10,000,000 lekë" u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional në shërbim të aktivitetit.

Subjekti ka lidhur kontratën më AZHBR me nr.prot.2815/7 datë 08.10.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 20,611,343 lekë me tvsh dhe masa e mbështetjes financiare 10,000,000 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

5. Nga kontrolli i subjektit "Vajdiqe Duka" person fizik me Nipt: L21327507P, me përfaqësues zj. Vajdiqe Duka dhe adresë fshati Ishëm Durrës përfitues i masës 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë" jo më shumë se 20,000,000 lekë, u konstatua se investimi ishte ekzistues dhe ishte funksional pra i shërbente aktivitetit. Investimi konsistonte në blerjen e makinerisë *për përpunimin e rrushit dhe prodhimin e verës* .

Subjekti ka lidhur kontratën më AZHBR me nr.prot.1185/7 datë 17.08.2018, në të cilën vlera e investimit të pranuar është 38,593,573.41 lekë me tvsh dhe masa e mbështetjes financiare 19,286,787 lekë.

Nga auditimi në terren u konstatua se Përfituesi nuk respektonte rregullat e vizibilitetit të bashkëfinancimit nga fondet kombëtare duke mos vendosur në një vend të dukshëm një stendë afishimi, për të bërë të njohur faktin se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bashkëfinancuar investimin.

Qarku Fier

1. Nga kontrolli i përfituesit "Ilirian Hoxha" shpk, përfitues i masës 20 "ambiente grumbullimi dhe ruajtjes frigoriferike për fruta dhe prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), jo më shumë se 20,000,000 lekë për një subjekt". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 38,228,460 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 19,144,230 lekë me TVSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralësor dhe Rural"

Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 940/8 prot. datë 02.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 30.10.2018 dhe me nr. 940/13 prot. datë 15.10.2018, është realizuar amendim kontrate mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit.

Më datë 15.11.2018 subjekti përfitues ka kërkuar kërkesë për pagesë dhe me shkresën nr. 940/24 prot. datë 21.12.2018, njoftohet autorizimi i pagesës së grantit.

- Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.

2. Nga kontrolli i përfituesit "Flavio Fs 2013" sh.p.k, përfitues i masës 20 "ambiente grumbullimi dhe ruajtjes frigoriferike për fruta dhe prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), jo më shumë se 20,000,000 lekë për një subjekt". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 39,700,080 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 19,850,040 lekë me TVSH. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 1274/8 prot. datë 08.10.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.11.2018 dhe me nr. 1274/10 prot. datë 16.10.2018, është realizuar amendim kontrate mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit. Me amendimin e kontratës nr. 1274/15 prot. datë 14.11.2018, shtyhet afati i ndërtimit deri më datë 30.11.2018. Me shkresën nr. 1274/20 prot. datë 20.12.2018, dorëzohet dokumentacioni i kontrollit të objektit në Drejtorinë e Autorizimit të Projekteve.

Dokumentacioni i kontrollit në vend nga inspektorët e AZHBR dhe miratimet nga përgjegjësi i sektorit të kontrollit u konstatua se inspektorët e kontrollit nuk janë specialistë të fushës së ndërtimit dhe nga verifikimet në objekt konstatohet se punimet e mësipërme janë të pamatshme, pasi janë të maskuara (fshehura). Gjatë verifikimeve të grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.

3. Nga kontrolli i përfituesit "Klaud Meta" shpk, përfitues i masës 12 "Ndërtim i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit, dhe specit me sipërfaqe jo më pak se 0.2 HA dhe jo më shumë se 1 Ha". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 26,553,820 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 13,276,910 lekë me TVSH, por jo më shumë se 1,500,000 lekë/dynym për serrat me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë ujitjen me pika. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 2037/7 prot. datë 15.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.11.2018 dhe me nr. 2037/9 prot. datë 12.10.2018, është realizuar amendim kontrate mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.

4. Nga kontrolli i përfituesit "Danish Green Garden" shpk, përfitues i masës 12 "Ndërtim i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit, dhe specit me sipërfaqe jo më pak se 0.2 HA dhe jo më shumë se 1 Ha". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 26,766.250 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 13,383,125 lekë me TVSH, por jo më shumë se 1,500,000 lekë/dynym për serrat me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë ujitjen me pika. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 2284/5 prot. datë 01.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 30.10.2018. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.



KONTROLLI I LARTË I SITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

5. Nga kontrolli i përfituesit "Juljana Pupa" shpk, përfitues i masës 12 "Ndërtim i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit, dhe specit me sipërfaqe jo më pak se 0.2 HA dhe jo më shumë se 1 Ha". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 15,803,714 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 7,901,857 lekë me TVSH, por jo më shumë se 1,500,000 lekë/dynym për serrat me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë ujitjen me pika. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 2212/7 prot. datë 16.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.10.2018. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.

6. Nga kontrolli i përfituesit "Dritan Kuqo" shpk, përfitues i masës 12 "Ndërtim i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit, dhe specit me sipërfaqe jo më pak se 0.2 HA dhe jo më shumë se 1 Ha". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 19,835,154 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 9,917,577 lekë me TVSH, por jo më shumë se 1,500,000 lekë/dynym për serrat me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë ujitjen me pika. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 2052/6 prot. datë 24.10.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.10.2018. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar edhe në funksion.

Për Qarkun Lezhë, kanë përfituar gjithsej 4 aplikantë për Skemat Kombëtare në vlerë totale 27,812,427 lekë, ku të ndarë sipas masave janë :

1 subjekt për masën 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë", në vlerën 4,641,675 lekë.

1 subjekt për masën 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve dhe për rritjen e shpendëve si dhe makineri për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale ", në vlerën 15,000,000 lekë.

2 subjekte për masën 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm dhe rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural", në vlerën 8,170,752 lekë.

Për Qarkun Shkodër kanë përfituar gjithsej 6 aplikantë për Skemat Kombëtare në vlerë totale 45,556,138 lekë, ku të ndarë sipas masave janë :

1 subjekt për masën 20 "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore", në vlerën 12,229,523 lekë.

1 subjekt për masën 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve dhe për rritjen e shpendëve si dhe makineri për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale ", në vlerën 12,900,000 lekë.

1 subjekte për masën 32 "Ndërtimin e thertoreve, ambienteve të përpunimit dhe produkteve blegtorale", në vlerën 10,000,000 lekë.

1 subjekte për masën 23 "Linja seleksionimi, paketimi, pastrimi, përfshirë dhe ambalazhe për fruta perime dhe bimë medicinale dhe aromatike", në vlerën 4,837,820 lekë.

1 subjekt për masën 50 "Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imta", në vlerën 20,000,000 lekë.

1 subjekt për masën 51 "Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve", në vlerën 5,388,798 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujësor dhe Rural"

Për Qarkun Korçë kanë përfituar gjithsej 12 aplikantë për Skemat Kombëtare në vlerë totale 110,440,746 lekë, ku të ndarë sipas masave janë :

3 subjekte për masën 32 "Ndërtimin e thertoreve, ambienteve të përpunimit dhe produkteve blegtorale", në vlerën 37,600,114 lekë.

1 subjekt për masën 21 "Ambiente grumbullimi për fruta perime", në vlerën 1,183,516 lekë.

2 subjekte për masën 22 "Linja përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë", në vlerën 27,255,149 lekë.

3 subjekt për masën 20 "Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imta", në vlerën 25,365,252 lekë.

1 subjekt për masën 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve dhe për rritjen e shpendëve si dhe makineri për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale", në vlerën 15,000,000 lekë.

2 subjekte për masën 44-45 "Mbështetje për investime në agroturizëm dhe rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural" në vlerën 4,036,715 lekë.

1. Nga kontrolli i përfituesit "Kantina Caco" shpk, përfitues i masës 22 "Linja përpunimi/makineri pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë jo më shumë se 20,000,000 lekë për subjekt". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 27,117,728 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 13,558,864 lekë me TVSH. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 1313/7 prot. datë 27.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 30.10.2018 dhe me amendimin nr. 1313/10 prot. datë 30.10.2018, shtyhet afati i realizimit deri më datë 15.11.2018. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar në përputhje me specifikimet teknike dhe është në funksion.

2. Nga kontrolli i përfituesit "ARNA" shpk, përfitues i masës 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve për rritjen e shpendëve si dhe makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale dhe jo më pak se 100 lopë, jo më pak se 100 të imta, jo më pak se 10 dosa dhe me kapacitet jo më pak se 10,000 shpendë por jo më shumë se 15,000,000". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 35,379,303 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 15,000,000 lekë me TVSH. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 1157/7 prot. datë 07.09.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.11.2018 dhe me amendimin nr. 1157/12 prot. datë 30.10.2018, shtyhet afati i realizimit deri më datë 07.12.2018. Me amendimin e kontratës nr. 1157/9 prot. datë 18.10.2018 mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar në përputhje me specifikimet teknike dhe është në funksion.

3. Nga kontrolli i përfituesit "Fix Pro" shpk, përfitues i masës 32 "Ndërtimin e thertoreve ambiente të përpunimit të produkteve blegtorale dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 20,000,000 lekë". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 40,176,763 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 20,000,000 lekë me TVSH. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 853/7 prot. datë 16.08.2018. Afati i realizimit të kontratës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Butoësor dhe Rural"

është 22.10.2018 dhe me amendimin nr. 853/10 prot. datë 12.10.2018, shtyhet afati i realizimit deri më datë 30.10.2018 dhe mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar në përputhje me specifikimet teknike dhe është në funksion.

4. Nga kontrolli i përfituesit "SHAKA BOBOSHTICE" shpk, përfitues i masës 32 "Ndërtimin e thertoreve ambiente të përpunimit të produkteve blegtorale dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 20,000,000 lekë, dhe për rikonstruksion/pajisje në thertoret ekzistuese për plotësimin e standardeve të legjislacionit në fuqi, jo më shumë se 10,000,000 lekë". Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 32,044,888 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 16,022,444 lekë me TVSH. Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 888/8 prot. datë 07.09.2018. Afati i realizimit të kontratës është 15.11.2018 dhe me amendimin nr. 888/14 prot. datë 08.11.2018, shtyhet afati i realizimit deri më datë 30.11.2018. Me amendimin e kontratës nr. 888/10 prot. datë 17.10.2018 mbi pagesën paraprake 30% të masës së financimit. Gjatë verifikimeve preventiv të punimeve në aneksin e kontratës dhe verifikimet e grupit të auditimit në objekt, u konstatua se objekti ishte realizuar në përputhje me specifikimet teknike dhe është në funksion.

Qarku Dibër.

Nga kontrolli i përfituesit "Shemsi Ngota" sh.p.k, përfitues i masës 32 "Ndërtimin e ambienteve të përpunimit të produkteve blegtorale dhe pajisjeve të nevojshme me to, jo më shumë se 20,000,000 lekë për rikonstruksion/pajisje në thertore për plotësimin e standardeve të legjislacionit në fuqi, jo më shumë se 10,000,000 lekë".

Vlera e investimit të pranuar nga AZHBR, është 39,751,903 lekë me TVSH, ku nga AZHBR mbështetet 50% e vlerës së investimit në vlerën 19,875,951 lekë me TVSH.

Kontrata e përfituesit është nënshkruar me nr. 929/7 prot. datë 03.08.2018. Afati i realizimit të kontratës është 31.10.2018 dhe me kërkesën nr. 929/11 prot. datë 12.10.2018 të përfituesit, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve deri më 15.12.2018. Me amendimin e kontratës nr. 929/16 prot. datë 31.10.2018, shtyhet afati i ndërtimit deri më datë 15.12.2018.

- Me shkresën e titullarit nr. 929/12 prot. datë 17.10.2018, njofton përfituesit për amendim kontrate në zbatim të udhëzimit nr. 14 datë 28.09.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e përbashkët nr. 1 datë 19.02.2018" dhe me nr. 929/13 prot. datë 19.10.2018, realizohet amendimi i kontratës për pagesën paraprake në masën 30% të vlerës së mbështetjes. Nga lista e kontrolleve në vend të investimit, përfituesi është financuar për vlerën 15,380,536 lekë me TVSH.

Dokumentacioni i kontrollit në vend nga inspektorët e AZHBR dhe miratimet nga përgjegjësi i sektorit të kontrollit u konstatua se inspektorët e kontrollit nuk janë specialistë të fushës së ndërtimit dhe nga verifikimet në objekt konstatojnë se punimet e mësipërme janë të pamatshme, pasi janë të maskuara (fshehura), por janë marrë të mirëqëna dhe të justifikuar nga librezat e masave.

Grupi i auditimit të KLSH-së, në lidhje me problematikat e evidentuara, dorëzoi Akt-verifikim nr.2 datë 31.05.2019, me nr. 1639 prot të AZHBR, janë paraqitur observimet me shkresë nr.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

1639/1prot, të datës 05.06.2019 të AZHBR, i firmosur nga z.Mirgen Dobruna në cilësinë e Drejtorit i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve DPAP, nga z.Enel Ciniye në cilësinë e Drejtorit (me detyra shtesë) të Drejtorisë së Kontrollit (DK) dhe nga zj.Bledjana Karafilaj përgj/burimeve njerëzore.

Grupi i auditimit është njohur me observimet të cilat në parim ka marrë dakortësinë e drejtuesve të institucionit, duke i vlerësuar si problematika reale të konstatuara në skemat mbështetëse në nivel kombëtare, për të cilat janë shprehura në observimet e tyre shprehur si më poshtë vijon:

II. Konstatimi nr. II, Auditimi i Masës 12

Në lidhje me konstatimin se preventivat e përfituesve të serrave diellore janë të rritura në mënyrë artificiale 43% të vlerës, referuar tabelës në akt-konstatim sqarojmë se:

Në Udhëzimin nr.1, datë 19.02.2018, sikurse konstatohet edhe nga grupi i auditimit të KLSH, preventivi nuk ishte kriter i cili kërkohej për aplikantët dhe AZHBR si Agjenci zbatuese, në mungesë të preventivit, nuk mund ta kërkonte si dokument.

Në Udhëzimin nr.3/1, datë 15.04.2019 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit e për bujqësinë dhe zhvillimin rural", për vitin 2019, investimet në serra nuk janë të përfshira pasi janë pjesë e investimeve të pranueshme në Programin IPARD II 2014-2020. Bazuar në procedurat e akredituara për Programin IPARD II 2014-2020, vlerësimi i kostove për investimet në serra dhe llogaritja e shpenzimet e pranuar për grant behet sipas çmimeve referencë të përcaktuar në VKM nr.629, datë 15.07.2015.

V. Konstatimi nr. V, Përdorimi i termit "E PAMATSHME"

-Në lidhje me këtë konstatim shpjegojmë se termi punime "TE PAMATESHME" i referohet punimeve "TE FSHEHTA", të cilat janë kryer gjatë periudhës pas kontraktimit deri në momentin e kontrollit parapagese, dhe për rrjedhojë janë "PUNIME TE PAMATSHME" në momentin e kontrollit në terren para pagese. Punimet e të fshehta (të maskuara), nuk mund të verifikohen gjatë kontrollit në terren para pagese por në çdo rast kontrollet në terren janë kryer duke shqyrtuar edhe Librezat e Masave të nënshkruara dhe konfirmuara nga supervizori i punimeve të ndërtimit/rindërtimit (origjinale), pjesë e dosjes së Autorizimit të Pagesës.

-Në lidhje me mungesën e profileve Ing.Ndërtimi, Urbanist, Mekanik, Elektrik sqarojmë se: AZHBR është institucion me status Nëpunësi Civil dhe për rrjedhojë proceset e përzgjedhjes së stafit për pozicionet "nëpunës civil", administrohen nga Departamenti i Administratës Publike.

Në total gjatë vitit 2018 janë shpallur për:

-Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, 14 pozicione Inspektorë ku është specifikuar qartë kriteri i shkollimit: Arsim i Lartë, në profil Shkenca Ekonomike, Shkenca Bujqësore, Shkenca Juridike, Inxhinieri Mjedis, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Ndërtimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

-Drejtorinë e Autorizimit të Projekteve, 9 pozicione Inspektorë ku është specifikuar qartë kriteri i shkollimit: Arsim i Lartë në Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Bujqësore, Shkenca Inxhinierike në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Shkencave të Natyrës.

-Drejtorinë e Kontrollit 12 pozicione Inspektorë ku është specifikuar qartë kriteri i shkollimit: Arsim i Lartë në Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Bujqësore, Shkenca Inxhinierike në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Shkencave të Natyrës.

Kërkesat për shpalljen e pozicioneve të më sipërme janë bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në përkrahimin e punës të secilit pozicion. AZHBR nuk ka akses në procesin e verifikimit të kandidatëve të interesuar. AZHBR behet pjesë e procesit të përzgjedhjes në fazën e intervistimit me gojë të kandidatëve.

-AZHBR i është drejtuar DAP me Shkresën Nr. 1201 prot., datë 08.04.2019 për vënie në dispozicion të kandidatëve potencial të cilët zotëronin diplomë në fushat: Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Mekanike, Bioteknologji dhe Mjekësi Veterinare, ku me Shkresën nr. 2109/1 prot., datë 25.04.2019 "Kthim përgjigje", DAP përgjigjet se asnjë nga kandidatët potencial që gjenden në lista e tyre nuk plotëson kriterin e shkollimit.

Konstatimi nr. VII, Për verifikimin në terren të investimeve të mbështetura gjatë vitit 2018: "Coral" Sh.p.k përfitues i Masës 20 "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore".

-Në lidhje me tabelat e vizibilitetit, sqarojmë se nuk janë zëra financimi në aneks-kontratë dhe nuk kanë një vlerë ekonomike që financohet nga granti i AZHBR, por janë detyrim kontraktor i cili realizohet nga përfituesi, pasi kryhet pagesa, dhe vetëm pasi përfituesi merr grantin, vlera e paguar vendoset në tabelën e vizibilitetit.

-Në këto kushte në kontrollin në terren para pagese, nuk verifikohet vendosja e tabelës së financimit pasi përfituesi nuk ka marrë akoma financimin (mund të ketë edhe zbritje vlerë apo mos paguhet pas kontrollit në terren).

-Pajisja e investimit me tabelën e vizibilitetit kontrollohet gjatë procesit ex-post (monitorim) dhe për këto raste AZHBR do të marrë masa të menjëhershme monitorimi duke njoftuar përfituesit për vendosjen dhe do të kryejë kontrolle në terren.

Elton Mema përfitues i Masës 22 "Linje përpunimi/makinëri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe vere",

Ne Aktkonstatimin Nr.2 konstatohet se në Subjekti Elton Mema nuk kryen aktivitet dhe nuk ka respektuar rregullat e vizibilitetit.

Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se:

Linja e përpunimit të vajit të ullirit është e furnizuar dhe e montuar në vendin e investimit konfirmuar edhe nga kontrolli i KLSH. Prodhimi i vajit të ullirit është një aktivitet sezonal dhe në momentin që Grupi i Auditit të KLSH ka kryer inspektimin, subjekti nuk kishte aktivitet për shkak se nuk është sezoni prodhimit të ullinjve që të përpunohen në fabrikë dhe të prodhohet vaji i ullirit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

Në lidhje me tabelat e vizibilitetit, sqarojmë se nuk janë zëra financimi në aneks-kontratë dhe nuk kane një vlerë ekonomike që financohet nga granti i AZHBR, por janë detyrim kontraktor i cili realizohet nga përfituesi, pasi kryhet pagesa, dhe vetëm pasi përfituesi merr grantin vlera e paguar vendoset ne tabelën e vizibilitetit.

Në këto kushte në kontrollin në terren para pagese, nuk verifikohet vendosja e tabelës së financimit pasi përfituesi nuk ka marrë akoma financimin (mund të ketë edhe zbritje vlerë apo mos paguhet pas kontrollit në terren). Pajisja e investimit me tabelën e vizibilitetit kontrollohet gjatë procesit ex-post (monitorim) dhe për këto raste monitorimi do të marre masa të menjëhershme duke njoftuar përfituesit për vendosjen dhe do të kryejë kontrolle në terren.

"Vaji i Ullirit Shqiponja" Sh.p.k përfitues i Masës 22 "Linjë përpunimi/makineri, pajisje për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë";

Në Aktkonstatimin Nr. 2, konstatohet se mungon aktiviteti në subjektin "Vaji i Ullirit Shqiponja", përfitues i Linjës së përpunimi i vaj ullirit dhe janë ne vazhdim punime në lidhje me rindërtimin e godinës.

Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se:

Subjekti "Vaji i Ullirit Shqiponja" Sh.p.k është financuar vetëm për investim në Masën 22 dhe gjatë kontrollit në terren është konstatuar se linja e prodhimit të vajit të ullirit ishte furnizuar dhe montuar në vendin e investimit (sipas kontratës).

Prodhimi i vajit të ullirit është një aktivitet sezonal dhe në momentin që Grupi i Auditit të KLSH ka kryer inspektimin, subjekti nuk kishte aktivitet për shkak se nuk është sezoni prodhimit të ullinjve që të përpunohen në fabrikë dhe të prodhohet vaji i ullirit.

Përsa i përket konstatimit për sigurimet shoqërore, ju sqarojmë se subjekti ka qene subjekt pa aktivitet në momentin e aplikimit. Kërkesa e udhëzimit për skemat e investimeve për Masën 22 është që aplikanti të mos detyrime ndaj Tatimeve dhe MBZHR, ndërsa detyrimi për shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore (pas përfshirjes së aplikantit në listën paraprake të fituesve), është vetëm për aplikantët në masat e subvencioneve direkte Masa 1-11.

"Kami" sh.p.k përfitues i Masës 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% te vlerës totale, por jo më shumë se 10.000.000 lekë".

Në lidhje me tabelat e vizibilitetit, sqarojmë se nuk janë zëra financimi në aneks-kontratë dhe nuk kane një vlerë ekonomike që financohet nga granti i AZHBR, por janë detyrim kontraktor i cili realizohet nga përfituesi, pasi kryhet pagesa, dhe vetëm pasi përfituesi merr grantin vlera e paguar vendoset ne tabelën e vizibilitetit.

Në këto kushte në kontrollin në terren para pagese, nuk verifikohet vendosja e tabelës së financimit pasi përfituesi nuk ka marrë akoma financimin (mund të ketë edhe zbritje vlerë apo mos paguhet pas kontrollit në terren). Pajisja e investimit me tabelën e vizibilitetit kontrollohet gjatë procesit ex-post (monitorim) dhe për këto raste monitorimi do të marrë masa të menjëhershme duke njoftuar përfituesit për vendosjen dhe do të kryejë kontrolle në terren.

Për të gjitha rastet e konstatuara në Aktkonstatimin Nr. 2, Drejtoria e Kontrollit do të marrë të gjitha masat për të ndjekur procedurat bazuar në manualet e brendshme të punës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Situata:	<p>Nga auditimi i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural për vitin 2018, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", konkretisht për <u>Masën 12 (Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit)</u>, ku citohet: "Masa e financimit është parashikuar 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika ose jo më shumë se 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.", u konstatua se:</p> <p>Duke përdorur metodën krahasimore midis mesatares së çmimeve të preventivave ofertave të përfituesve, me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", rezultoi se, ka diferenca në vlerë. Kështu, përfituesit e serrave diellore, kanë paraqitur preventiva të rritura në mënyrë artificiale afërsisht 43 % të vlerës së investimit total për tre zëra kryesorë (plasmas serrash dhe aksesorë, konstruksione metalike dhe betonin e gropave).</p> <p>Për sa më sipër, duke patur parasysh faktin se AZHBR, financon nga Buxheti i shtetit <u>jo më shumë se 50% e vlerës së investimit, pra rreth 21.5% e vlerës së subvencionit, është financuar në mungesë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike sipas manualeve teknike shtetërore, por në referim të preventivave ofertues të mbështetura në çmimet e tregut vendas ose të huaj.</u></p>
Kriteri:	<p>VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre",</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mungesa e preventivave të detajuara me çmime reference, për tre zëra kryesorë (plasmas serrash dhe aksesorë, konstruksione metalike dhe betonin</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

	e gropave), duke sjellë rritjen e vlerave të investimeve të kryera nga aplikantët dhe përfitimin e marrë nga AZHBR.
Shkaku:	Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, Kreu IIX "Kriteret specifike dhe dokumentacioni për masat mbështetëse", pika 2, <u>ku nuk është kërkuar referimi i çmimeve mbështetur në manual për Masën 12</u> , duke hequr kërkesën që "...çmimet e preventivit konkurrues nuk duhet të jetë i vulosur dhe i firmosur nga inxh. ndërtimi i licencuar.", siç është kërkuar për masat e tjera.
Rëndësia:	I lartë

Situata:	<p>Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural, të përcaktuara sipas VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, si dhe auditimet e kryera në terren nga grupi i auditimit, u konstatua se, për masat mbështetëse të skemave kombëtare të zhvilluara nëpërmjet investimeve ndërtimore konkretisht për masat:</p> <ul style="list-style-type: none">-Masa 20 "Ambiente grumbullimi dhe frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore"-Masa 21 "Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime"-Masa 22 "Linja përpunimi/makineri për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë"-Masa 23 "Linja selektimi, paketim, ambiente për fruta, perime dhe bimë medicinale"-Masa 32 "Ndërtimin e thertoreve dhe pajisjeve"-Masa 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe makineri dhe pajisje"-Masa 44 "Mbështetje për ngritjen ose rikonstrukcionin të turizmit rural"-Masa 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm"-Masa 51 "Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve", <p>në situacionet përfundimtare të punimeve është përdorur termi "e pamatshme për punimet e maskuara", pasi grupet e monitorimit të AZHBR-së kryejnë sipas manualit të kontrollit vetëm dy kontrolle(një në fillim para lidhjes së kontratës dhe një në fund të përfundimit të investimit).Grupet e kontrollit përbëhen nga inspektorë kontrolli që kanë profil jurist dhe ekonomist, dhe jo</p>
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

	<p>profil teknik (inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/ mekanik, inxh/elektrik, arkitekt etj), ndonëse nga AZHBR me disa shkresa nr.3041 prot datë 27.07.2018 dhe nr.3041prot datë 27.07.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike është kërkuar rekrutimi i punonjësve për këto pozicione pune, të cilat ende janë vakante.</p> <p>Kështu, specialistët e kontrollit të monitorimit, mbështeten vetëm në librezat e masave, duke i marrë të mirëqena punimet e pamatshme, pa bërë analizë e hollësishme profesionale që mund të kryejnë specialistët e fushës(këto punime janë justifikuar me librezat e masave). Mbi punimet ndërtimore, përfituesit e subvencionit, e përcaktojnë vetë mbikëqyrësin e punimeve, i cili miraton volumet dhe projektin e azhurnuar.</p> <p>Nga auditimi i dosjeve të përfituesve të subvencionit, konstatohet se mbikëqyrësi i punimeve realizon vetëm librezën e masave dhe asnjë dokumentacion tjetër mbi punimet si,(procesverbalet e punimeve të maskuara, ditarin e punimeve, ndryshimet e projektit, testet e kontrollit, certifikatat e materialeve të përdorura, foto gjatë punimeve etj), duke mos mbajtur asnjë përgjegjësi për punimet mbas përfundimit të investimit, pasi edhe në kontratën e lidhur midis AZHBR dhe përfituesit të subvencionit, nuk është shprehur si detyrim kontraktor, <i>ekzistenca e një mbikëqyrë punimesh me licensën përkatëse</i>, sipas një marrëveshjeje dypalëshe të njohur nga AZHBR.</p>
Kriteri:	VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"
Ndikimi/Efekti:	Mos monitorimi i punimeve të pamatshme, si rrjedhojë e mungesës së strukturave me specialist të fushës.
Shkaku:	Kjo situatë ka ardhur, si pasojë, pasi grupet e kontrollit përbëhen nga inspektorë kontrolli që kanë profil jurist dhe ekonomist, dhe jo profil teknik (inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/ mekanik, inxh/elektrik, arkitekt etj), ndonëse nga AZHBR me disa shkresa nr.3041 prot datë 27.07.2018 dhe nr.3041prot datë 27.07.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike është kërkuar rekrutimi i punonjësve për këto pozicione pune, të cilat ende janë vakante.
Rëndësia:	I lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Situata:	<p>- Nga auditimi, u konstatua se, propozimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, drejtuar Këshillit të Ministrave, për miratimin e VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, nuk është realizuar paralelisht me miratimin Buxhetit vjetor që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë brenda datës 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke mos qenë në koherencë me vitin bujqësor por me vitin kalendarik buxhetor. Kjo, ka sjellë penalizimin e aplikantëve fitues për masat mbështetëse të skemave kombëtare, duke shkurtuar në maksimum kohën e ndërtimit të investimeve për periudhën 2-3 muaj.</p> <p>- Nga auditimi, u konstatua se, nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR, nuk ka strategji komunikimi, për të përcaktuar objektivat kryesore për masat mbështetëse të synuara, treguesit etj , si edhe roli i AZHBR-së duket thjesht si ekzekutues i fondeve që duhen shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" , të cilat kanë pësuar ndryshime të shpeshta buxhetore, duke sjellë uljen e vlerës së parashikuar për skemat mbështetëse kombëtare.</p> <p>- Nga auditimi i procedurave të dhënies së subvencioneve për skemat mbështetëse kombëtare, numri i dokumentave për të plotësuar ka arritur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe atyre kohore për fermerin, me ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare. Kështu për herë të parë në vitin 2018 është përdorur aplikimi me 0 dokumenta, për masat direkte mbështetëse dhe jo për investime, duke ulur numrin e dokumentacionit për fermerët, por duke shtuar punën administrative në AZHBR, duke patur ndikim në efektivitetin e punës së stafit dhe kosto administrative të larta.</p>
Kriteri:	VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

	Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"
Ndikimi/Efekti:	Mospasja e një strategjie, e një kornize ligjore të mire përcaktuar, sjell ndryshimin e skemave çdo vit, duke çuar në uljen e fondeve për bujqësinë.
Shkaku:	Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e moskordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të niveli të lartë qendrore Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë me institucionet e varësisë, në këtë rast më AZHBR.
Rëndësia:	I lartë

Situata:	<p>Nga auditimi, u konstatua se, hartimi i kontratave me përfituesit e skemave mbështetëse kombëtare, janë kontrata tip, pa ndryshime nga njëra masë tek tjetra, ku nuk dalin qartë masat konkrete administrative që duhet të ndërmarrë AZHBR në rastet e mosplotësimeve të detyrimeve kontraktore, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9817 datë 22.10.20017 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, neni 39 (sanksionet) pika 1 citohet se "<i>Kundravajtjet administrative dënohen me gjobë në masën 30, 000 (tridhjetë mijë) lekë – 40, 000 (dyzet mijë) lekë si dhe kthimin e financimit të përfituar</i>".</p> <p>Gjithashtu, në kontratë, është përcaktuar që monitorimi i aktivitetit është i detyrueshëm për 5 vite, por nuk janë përcaktuar garancitë financiare të kontratës, duke u mjaftuar me sigurimin e kontratës, e cila çlirohet në momentin e ekzekutimit të pagesave nga AZHBR.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se, strukturat e monitorimit të AZHBR-së, janë të pamjaftueshme me burime njerëzore, pasi nuk është e mundur të monitorohen në kohë subvencionet, dhe mos hartimi i një plani monitorimi periodik me objektiva të qarta, ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e plan-bizneseve të paraqitura nga përfituesit.</p> <p>Gjithashtu nga auditimit, u konstatua se, mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare), të AZHBR, nga sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, për periudhën 2017-2018, ka ndikuar negativisht në efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomicitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare.</p>
Kriteri:	Ligjin nr.9817 datë 22.10.20017 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktimi i saktë i masave konkrete administrative që duhet të ndërmarrë AZHBR, në hartimin e detyrimeve kontraktore.
Shkaku:	Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e përdorimit të kontratave tip, pa ndryshime nga njëra masë tek tjetra.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Rëndësia:	I lartë
------------------	---------

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, në bazë të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", Kreu VI, "Bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionet" neni 22, AZHBR krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të Rregjistrit të fermës, proces i cili ende nuk është realizuar, ndonëse edhe në kuadër të procesit të aderimit për Bashkimin Evropian, si kusht për Agjencinë e Pagesave, është administrimi dhe funksionaliteti i IACS (Sistemi i Integruar i menaxhimit dhe kontrollit), me komponentë: 1-Rregjistri i fermës; 2-LPIS-Sistemi i përcaktimit dhe i klasifikimit të parcelave bujqësore.
Kriteri:	Ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", Kreu VI, "Bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionet" neni 22.
Ndikimi/Efekti:	Mos evidentimi i një situatë reale të fermave në territorin Shqiptar.
Shkaku:	Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e moskordinimit dhe bashkepunimit nga Ministria e Bujqësisë, e cila vetëm sa ka ngritur grupe pune, duke mos e finalizuar me ngritjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të rregjistrit të fermës.
Rëndësia:	I lartë

7. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SITEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit "Nr.1438/4 datë 28.02.2019", i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Hartimi i objektivave dhe zbatimi i planeve strategjik dhe vjetorë në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari.
- Pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm
- Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.) nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit, për të gjithë komponentët si: "Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi" si dhe "Monitorimi", në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime", ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin



KONTROLLI I ARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Me synimin e implementimit të këtij ligji dhe të akteve rregullatore është kërkuar: regjistri i riskut, pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportet vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, koordinorit të riskut, sekretarit të GMS, procesverbalet e mbledhjeve të GMS, rishikimi i regjistrit të riskut, rivlerësimi dhe plani i veprimit me masa korigjuese, dokumentimi i gjurmës së auditimit, harta e proceseve të punës etj.

Misioni i AZHBR-së është zhvillimi Agrikulturor dhe Rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

AZHBR, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale. nëpërmjet granteve që përfitohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze. Detyrat e saj janë procedimi dhe analizimi i aplikimeve të fermerëve bazuar në rregullat e Qeverisë Shqiptare dhe Bashkimit Evropian për të lëvruar fonde nga buxheti i Shtetit dhe donatorët e huaj. Ngritja e një mjedisi pune eficient në bashkëpunim me partnerët e Agjencisë si dhe krijimin e një stafi profesional, të trajnuar dhe të kualifikuar me anë të strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Objektivi i veprimtarisë së AZHBR është administrimi i :

- Fondeve të buxhetit të shtetit;
- Fondeve kundërpartit, të ish-projektit 2KR;
- Fondeve të Bashkimit Evropian;
- Fondeve të siguruar nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.

- Për vitin 2017 Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka kryer funksionet e saj mbi bazën e strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 156, datë 01.12.2015, i ndryshuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 190, datë 06.11.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural". ku numri i miratuar i punonjësve është 133.

- Për vitin 2018, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka kryer funksionet e saj mbi bazën e strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 190, datë 06.11.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural". i ndryshuar me Urdhërin të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AZHBR, marrëdhëniet e punës të stafit të AZHBR rregullohen në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil dhe kodit të punës. ku numri i miratuar i punonjësve është 169.

Grupi i auditimit në zbatim të përgjegjësive menaxheriale, sipas nenit 11 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, mori informacione lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin që nëpunësi zbatues ka si detyrim ndaj nëpunësit autorizues. Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Agjencisë së zhvillimit bujqësor dhe rural (AZHBR), për periudhën objekt auditimi, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë



KONTROLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural”

rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike. Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Ky institucion, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2 germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, *Institucioni nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, por zbaton Ligjin për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”* si dhe Ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ku të gjithë punonjësit e AZHBR kanë firmosur Deklaratën e Konfidencialitetit dhe Paanësisë për të parandaluar konfliktin e interesave por edhe për ruajtjen e informacionit.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. AZHBR ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 156, datë 01.12.2015, i ndryshuar me urdherin nr. 190, datë 06.11.2017, i ndryshuar nr. 140, datë 17.09.2018, ku marrëdhëniet e punës të stafit të AZHBR rregullohen në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil dhe kodit të punës

AZHBR ushtron veprimtarinë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore dhe mbi bazën e **Rregullores së Brendshme** të miratuar me Urdhër të Titulluarit nr. 810/2, datë 10.02.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e AZHBR-së” dhe përditësuar me Urdhër nr. 97/1, datë 21.02.2019, për të cilën janë bërë azhurnime, në lidhje me ndryshimet në strukturë, si dhe ndryshimet në detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë.

Njësia ka një program buxhetor me qëllim përdorimin me eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Në vitet objekt auditimi është vërejtur se buxheti ka qenë i mirëplanifikuar për arritjen e objektivave të institucionit. Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konflikt interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH", si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 "Për organizimin e administratës shtetërore" si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS)*. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 10269, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës përgjegjës për vendosjen e objektivave. Në këtë grup marrin pjesë të gjithë Drejtorët e Drejtorive si dhe Përgjegjësit e Sektorëve të Auditimit dhe Riskut

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Punonjësit e AZHBR i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit mbi nëpunësin civil, në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, orarin dhe kohën e punës etje, e cila është përditësuar duke ju përshtatur strukturave të ndryshuar të institucionit. Nga institucioni është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Staf i AZHBR-së është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Staf është rekrutuar nëpërmjet konkurrimit të kryer nga DAP në rastin kur rekrutimi i punonjësve bëhet sipas ligjit të nëpunësit civil.

Gjatë vitit 2017 janë bërë 22 trajnime nga burime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, nga të cilat kanë dominuar trajnimet e realizuara nga vetë stafi i AZHBR, në pjesën më të madhe për rritjen e kapaciteteve të të gjitha stafit në kuadrin e akreditimit të AZHBR, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) për problemet e prokurimit publik, probleme të shërbimit civil, të auditimit të brendshëm në kuadrin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 73 tema trajnimi me stafin e strukturës IPARD dhe atë Kombëtar sipas nevojave specifike, të cilat kanë qenë të brendshme me trajnues nga stafi më me përvojë në institucion por edhe nga ekspertë të jashtëm

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore

Përgjegjësitë: Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 10 të Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", strukturat përgjegjëse janë:

- Titullari i njësive publike është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë së tij.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

- Nëpunësi Autorizues, që në AZHBR është njëkohësisht dhe titullari i institucionit është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar; është Koordinator i Riskut dhe përgjigjet për monitorimin e kontroleve për minimizimin e risqeve brenda njësisë. Sidoqoftë, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Nëpunësi autorizues mund të delegojë detyra që kanë lidhje me koordinimin e riskut, një menaxheri tjetër të njësisë në vartësi direkt prej tij.
- Auditimi i brendshëm në rolin e vlerësuesit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe këshilluesit. Nga auditimi rezultoi se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*:
- nga AZHBR është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, në përputhje me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se.... “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut” **Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike **gjë e cila është realizuar nga institucioni**. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike
- Për vitet objekt auditimi, nga AZHBR është hartuar regjistri i riskut për institucionin, në përcaktimin e risqeve sipas objektivave për çdo drejtori, sektor dhe njësi shpenzuese në përputhje të nenit 21 Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar. Gjatë vitit 2017-2018 janë identifikuar nga grupi i menaxhimit të riskut ngjarjet që mund të kenë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të vendosura. Si rezultat i kësaj procedure është plotësuar Rregjistri i Riskut të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Hapi I “Organizimi i procesit”, përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. GMS duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike dhe duhet të mbliidhet të paktën 4 herë në vit, ku këto takime duhet të regjistrohen nga sekretari dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike. gjë e cila nuk është faktuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe të udhëzimit të MF nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika 2.2.4. Nga auditimi rezulton se për vitet 2017-2018 janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe është rishqyrtuar vlerësimi i riskut, të cilat janë reflektuar në raportin vjetor të përgatitur nga AZHBR-ja. Përgatitja e këtij raporti ka ndikuar dhe në monitorimin dhe raportimin mbi gjendjen e riskut, duke dhënë një informacion nëse aktivitetet e kontrollit kanë minimizuar risqet dhe nëse objektivat e planifikuara për tu realizuar janë rrezikuar nga këto risqe. Nga auditimi konstatohet se stafit ka njohuri të duhura në lidhje me menaxhimin e riskut



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

- Grupi për Menaxhimin Strategjik funksionon në drejtim të trajtimit të çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe bën pasqyrimin e veprimitarisë së saj në dokumentacionin përkatës. *Nga auditimi konstatohet se mosplotësimi i stafit sipas strukturës së miratuar ndikon në mënyrë të moderuar në hallkat e kontrollit, në mosfunksionimin e tij sipas objektivave të vendosura nga institucioni, e cila është një risk i moderuar për aktivitetin e njësisë.*

3. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

Metoda e përgjithshme e rekomanduar për krijimin, vlerësimin dhe raportimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit përmbledhet në disa hapa kryesore.

Hapi IV- Harta ose Lista e proceseve të punës.

Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi është hartuar një listë mbi proceset e punës nga drejtoritë përkatëse në AZHBR-rë, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, e cila garanton kryerjen e kontroleve efektive, si dhe ruan ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/ transaksioni, ku përgjegjësitë janë ndarë në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin, marrjen e vendimit, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Siç u vërejt zbatimi imenaxhimi të riskut nga institucioni si dhe monitorimi i tij ka çuar dhe në identifikimin dhe bërjen e *planeve të veprimit nga menaxhmenti*, ku janë përshkruar risqet e konstatuara, objektivat që duhet të arrihen, veprimet që duhet të ndërmerren, personat përgjegjës, afatet e kryerjes, si dhe fondet e nevojshme që duhet të planifikojë institucioni për zbatimin e planit dhe monitorimit të tij.

Hapi 5 "*Gjurmët e auditimit*". Nga auditimi u konstatua se çdo drejtori ka të përgatitur gjurmën e auditimit të përgatitur nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë, ku janë përfshirë proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe ku janë përfshijë zbatimi i aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj, për zbatimin e buxhetit nga AZHBR, ashtu siç përcaktohet në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 16 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, e cila ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

Gjurma e auditimit është rifreskuar në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecursisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces.

Ndarja e detyrave

Në pjesën më të madhe të njësive publike ekzistojnë përshkrimet e punës, të cilat përfshihen në rregulloret e brendshme ose në kontratat e punës. Ndryshimet e vazhdueshme të strukturave si dhe të formatimit të drejtorive kërkojnë dhe rishikimin në vazhdimësi të rregulloreve të brendshme të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

institucioneve si rrjedhojë edhe rishikimet e pozicioneve të punës, *gjë e cila është realizuar nga institucioni.*

Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare është kryer ndarja e detyrave, për të cilën është përdorur sistemi me dy firma, ku janë përcaktuar rregulla të qarta për ruajtjen e pronës.

- Nga institucioni ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

4. Informim dhe komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave.

Sistemet e shkëmbimit të informacionit menaxhohen nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit, i cili siguron mbështetje për kryerjen e veprimtarisë së institucionit. Sistemi i menaxhimit të informacionit në AZHBR është përmirësuar për sa i përket infrastrukturës së brendshme në termat e hardware dhe software.

Nëpërmjet Rregullores së Brendshme dhe përshkrimeve të qarta të punës, punonjësit njohin rolin, përgjegjësitë dhe detyrimet në këtë sistem. Titullari informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, dhe raporte përmbledhëse rreth punës së tyre.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. AZHBR ka faqen e saj zyrtare dhe nëpërmjet këtij website të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të saj.

5. Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efçente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Vlerësimi i vazhdueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të tij duhet të jetë detyrë e titullarit të njësisë, nëpunësit autorizues dhe menaxherëve të tjerë. Ky vlerësim mund të kryhet ose nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të komponentëve të sistemit të kontrollit ose nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme, të cilat kanë munguar gjatë periudhës objekt auditimi.



- Në zbatim të Nenit nr. 24 "Monitorimi", të Ligjit Nr. 10296 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka plotësuar edhe pyetësonin e vetë-vlerësimit për vitin 2017-2018 dhe i është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku komponentët janë vlerësuar me nivelin 3 dhe 4, duke dhënë justifikimet dhe arsyetimet përkatëse se si ka funksionuar MFK-së gjatë viteve.

- Nga auditimi konstatohet se Monitorimi është kryer nëpërmjet vlerësimit të performancës së punonjësve në fund të vitit, raporteve periodike dhe mbikëqyrjes së punës së përditshme.

- Drejtoritë përgatisin raportet tremujore dhe oficeri i raportimit përgatit Raportin Tekniko-Financiar të konsoliduar, mbi bazën e të cilave bëhet analiza e punës, shqyrtohen problematikat mbi të cilën merren masa për përmirësime të mëtejshme. Ky raport është dërguar në MBZHRAU. Në AZHBR është ngritur Sektori i Monitorimit të Skemave, i cili mbi bazën e një programi pune të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, e cila kontrollon në terren investimet e kryera.

Gjithashtu, në specifikën e saj AZHBR trashëgon debitorë dhe kreditorë nga ish Projekti 2 KR si dhe debitorë të rinjë të krijuar gjatë aktivitetit të saj. Sektori i Borxhit në bashkëpunim me Sektorin Juridik ndjekin, monitorojnë dhe raportojnë për gjithë njoftimet dhe takimet zyrtare si dhe çeljen e ndjekjen e proceseve gjyqësore, për të ulur numrin e debitorëve dhe detyrimet e tyre financiare. Për të përmbushur qëllimin e Nenit Nr. 24 "Monitorimi", të Ligjit Nr. 10296 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka plotësuar edhe pyetësonin e vetë-vlerësimit për të gjithë komponentët e MFK-së sipas formatit standard.

Konkluzion: Menaxherët dhe punonjësit e njësisë kanë njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, çka tregon se ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe punonjësit kanë njohuri mbi ligjin, duke bërë të mundur, që drejtuesit kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Raportimi periodike të cilat janë realizuar nga institucioni kanë shërbyer për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune

Për periudhën objekt auditimi 2017- 2018, nga auditimi rezultoi se:

- Përgjatë periudhës objekt auditimi, Institucioni ka hartuar **planin strategjik**, në mënyrë periodike për të reflektuar objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndër-sektoriale,

- GMS për vitin 2017-2018, ka kryer takimet periodike, në përputhje me nenin 27 të ligjit "Për MFK", si dhe Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 "Grupi për menaxhimin strategjik", ku cilësohet: "GMS të kryejë takimet 4 herë në vit si dhe vendimet e grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë". Pasi zhvillimi i MFK-së kërkon zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme.

Nga GMS është rishqyrtuar vlerësimi i riskut, të cilat janë reflektuar në raportin vjetor, i quajtur raporti tekniko financiar. Përgatitja e këtij raporti ka ndikuar dhe në monitorimin dhe raportimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit
Rural dhe Rural”

mbi gjendjen e riskut, duke dhënë dhe një informacion nëse aktivitetet e kontrollit kanë minimizuar risqet dhe nëse objektivat e planifikuara për tu realizuar janë rrezikuar nga këto risqe. – institucioni ka regjistruar e riskut, i cili është përgatitur nga çdo drejtori, dhe më pas është konsoliduar në një dokument të vetëm të miratuar nga titullari.

- Nga auditimi u konstatua se drejtoritë e institucionit kanë *përpiluar gjurmët e auditimit për funksionimin e tyre.*

- Nga institucioni ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Planet e kontrollit kanë ndikuar dhe në monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

8. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMET E MËPARSHME.

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit “Auditim financiar dhe përputhshmërie në AZHBR”, u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e AZHBR-së, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së Znj.Valentina Golemi dhe Znj. Elona Llozana, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në prezencë të përfaqësuesit të subjektit të auditimit Znj Frida Krifca me detyrë Drejtore e Përgjithshme .

Objekti i këtij akt verifikimi është:

Zbatimi rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH, dërguar në AZHBR, me shkresën Nr. 639/7 Prot, datë 30.12.2017 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, Efektiviteti i Granteve në AZHBR” si dhe me shkresën nr.prot 1138/29, datë 19.01.2018.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi.

-Programi i Auditimit “1438/4, datë 28.02.2019”.

-Shkresa e KLSH Nr.639/7 Prot, datë 30.12.2017 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, Efektiviteti i Granteve në AZHBR”.

-Shkresa e KLSH-së me nr.prot.1139/29, datë 19.01.2018 sipas program auditimit me nr.prot 1139, datë 11.11.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për 3-mujorin e IV të vitit 2016 dhe gjashtëmujorin e vitit 2017.

-Plani i masave me nr.prot.15/3, dt 25.01.2018, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i adresuar për çdo drejtori në AZHBR.

-Plani i Masave nr. 2937, datë 13.11.2017,” Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i adresuar për çdo drejtori në AZHBR”.

Shkresa e AZHBR nr. 2002/1, datë 29.06.2018 “Raportim lidhur me zbatimin e Rekomandimeve, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit”.

Nga auditimi u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rrural"

1) AZHBR ka marrë Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së (Departamenti i Auditimit të Performancës) me nr.15 Prot, datë 05.01.2018 dhe ka kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, për zbatimin e rekomandimeve me shkresën Nr. 15/3 Prot., datë 25.01.2018 , shoqëruar me Planin e Masave të miratuar nga titullari, ku janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se ky informacion duhet dërguar brenda 6 muajve nga marrja e tij, AZHBR, ka dërguar informacion në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, me shkresën Nr. 2002/1 Prot., datë 29.06.2018 "Raportim mbi ecurinë për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në AZHBR".

2) Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, përcjellë nga KLSH me shkresën me nr.prot.1139/29, datë 19.01.2018, është konstatuar se:

AZHBR ka marrë Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së (Departamenti i Auditimit të Performancës) me nr. 1139/29, datë 19.01.2018 dhe nuk ka kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 1, pika j, e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" ku përcaktohet se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: Të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 30, pika 2, e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se ky informacion duhet dërguar brenda 6 muajve nga marrja e tij, AZHBR, nuk ka dërguar informacion në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Të analizuar sipas natyrës së rekomandimeve rezultoi se:

Për përmirësimin e gjendjes janë audituar 5 masa organizative, të lëna mbas auditimit të zbatimit të rekomandimeve të realizuara nga KLSH, dërguar më shkresën me nr. 1139/29, datë 19.01.2018. Më hollësisht realizimi i rekomandimeve paraqitet në vijim.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Për periudhën e audituar u konstatua se mungonte unifikimi në mënyrën e mbajtjes së llogarive kontabile gjatë të tre periudhave. Përpos përdorimit të programit financa 5 i cili shërben për kontabilizimin e të dhënave financiare sërish në AZHBR, vazhdohet në mbajtjen e llogarive sipas ditarit në excel sidomos për llogarinë 606. Nga auditimi i zonave të llogarisë, është e rëndësishme të theksojmë rëndësinë e paraqitjes së pasqyrave financiare vetëm në nivel të konsoliduar, dhe jo një bashkim mekanik siç ndodh me llogarinë 606 e cila zë gati 80 % të buxhetit total të AZHBR-s, duke nënkuptuar aplikimin e të njëjtës metodologji kontabël për evidentimin dhe vlerësimin e zërave të tyre. Kjo mënyrë mbajtje e llogarive rrit riskun e manipulimit të dhënave, të mundësisë së gabimit njerëzor në evidentimin e transaksioneve dhe po ashtu në minimizimin e sigurinë e arsyeshme rreth vlerave kontabël, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësishë. Si



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

pasojë, mungesa e kryerjes së një procesi të tillë në mënyrë të unifikuar, cenon nivelin e sigurisë së arsyeshme të audituesve të pavarur, për të njohur dhe pranuar "vlerat" e aktiveve.

Për sa më sipër nga KLSH është rekomanduar që:

AZHBR të marrë **masa të menjëhershme** që të gjithë sektorët të aplikojnë të njëjtën mënyrë përmbajtjen dhe kontabilizimin e të dhënave financiare. Të kryhet një unifikim i mënyrës së regjistrimit të transaksioneve financiare në mënyrë që të minimizohen risqet e mundshme. Aplikimi i të njëjtës metodologji kontabël për evidentimin dhe vlerësimin e zërave do të rrisë nivelin e sigurisë mbi të dhënat e raportuara.

Zbatimi i rekomandimit:

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe mbajtja e llogarive në kontabilitet është e unifikuar për të gjitha llogaritë. Gjithë aktiviteti ekonomik financiar i AZBR-së kontabilizohet në softin financa 5. Mbajtja me ex-cel bëhet vetëm për evidencë nga sektori i ekzekutimit të pagesave për rakordimet me thesarin

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

2.Nga auditimi konstatohet se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të qëndrueshme debitorë dhe kreditorë, të cilët në total deri më 30.9.2016, janë në vlerën 2,088,803,343 lekë, një nivel i lartë ky, i debitorëve të mbartur nga ish projekti 2KR, ku pavarësisht përpjekjeve të dokumentuara nga ana e AZHBR, të shoqëruara edhe me kosto të larta të shpenzimeve gjyqësore, nuk kanë sjellë një zgjidhje të situatës.

Për sa më sipër nga KLSH është rekomanduar që:

MBZHR si institucion qendror në bashkëpunim me AZHBR dhe MF, pas analizimit të situatës mbi debitorët, të vlerësojnë të gjitha mundësitë për arkëtimin qoftë edhe pjesor të detyrimeve dhe të përshtaten skema alternative shlyerje që fermerët të jenë të gatshëm për derdhjen e shumave për të cilat janë debitorë. Nisur nga fakti që skema shoqërohet me nivel të lartë debitorësh duhet të shtohet vëmendja tek mënyra e funksionimit të skemës dhe veçanërisht në sanksionimin e të drejtave dhe detyrimeve e palëve. Të ketë sanksione të ekzekutueshme menjëherë për rastin e deviacioneve nga objektivat e skemës dhe në të gjitha rastet të vlerësohen drejt instrumentet që do të mundësonin mbrojtjen e interesave të shtetit. Për të gjitha rastet e shtesës së debitorëve të analizohen edhe përgjegjësitë institucionale që kanë krijuar kushtet për rritjen e debitorëve.

Zbatimi i rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar nga titullari me Planin e Masave nr. 2937, datë 13.11.2017, dhe janë ngarkuar për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së, Drejtoria Juridike dhe shërbimeve mbështetëse me afat zbatimi të menjëhershëm.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces por pa shpresa arkëtimi pasi deri në datën e mbajtjes së këtij akt-verifikimi, nga strukturat përgjegjëse, borxhi i trashëguar nga ish projekti 2-KR dhe borxhi i ri i krijuar nga pagesat për subvencione vazhdon të mbetet në vlera të larta dhe saktësisht i detajuar në tabelën I:

Tabela .1.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

Nr.	Përshkrimi	Nr. Debitorësh	Vlera në Lekë
1.	Debitorë të trashëguar nga ish-Projekti "2KR" (para krijimit të AZHBR-së)	622	1,584,703,060
2.	Debitorë të Agjencisë (2009 – 2017)	101	473,751,669
	TOTALI	723	2,058,454,729

Pra në total deri më 31.12.2018 vlera e borxhit është 2,058,454,729 lekë.

Ky rekomandim është në proces.

3. Në bilancet e agjencisë, për të dy vitet 2014-2015 konstatohet se: Në lidhje me Caktimet të përfshira në Inventarin Ekonomik: vazhdon mbartja në zërin "Aktive Qendrore të Trupëzuara" e llogarisë kontabël 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje" e vlerës 4,215,407 lekë, qysh prej bilancit të vitit 2013 e cila është mbartur deri në kalim zyrtar të këtij zëri në llogari të godinës së MBZHRAU. Në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 12, datë 20.01.2014 me Nr. 6265/1 Prot. për transferimin e zyrave të AZHBR nga ambientet e MBZHRAU tek godina e përdorura si zyra të AKU-s me anë të shkresës Nr. 1156 Prot. Date 6.5.2014, AZHBR i ka rikërkuar MBZHRAU kalimin kapital të shumës 4,215,407 lekë. Ndërkohë nuk është arritur në zgjidhjen e problemit me Ministrinë dhe kjo shumë vazhdon të mbartet në bilancin e AZHBR-së. Si pasojë e kësaj mbartje paraqitja e informacionit financiar nuk jep gjendjen reale të njësisë duke mbajtur parasysh se në të janë edhe vlera që nuk i përkasin agjencisë. Kjo shkakton një paraqitje jo të drejtë të llogarisë së aktiveve dhe në këto kushte cenon parimet bazë të ndërtimit të pasqyrave financiare si: Mbështetur në SKK 15, shkelet parimi i besueshmërisë: Për të qenë i dobishëm, informacioni duhet të jetë i besueshëm. Informacioni mbart cilësinë e besueshmërisë, kur ai është i paanshëm dhe nuk mbart gabime materiale, si dhe kur përdoruesit mbështeten mbi të, duke pasur besim që ky informacion është një prezantim besnik i asaj që ky informacion përpiket ose pritet në mënyrë të arsyeshme të prezantojë.

Për sa më sipër nga KLSH është rekomanduar që:

AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa të menjëhershme, për të realizuar ndarjen nga Bilanci Kontabël i AZHBR-së, të inventarit ekonomik të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MBZHRAU dhe të procedohet me trajtimin e tij, pasi mbartja e shumave që nuk i përkasin aktivitetit të institucionit bën që pasqyrat financiare të tij të mos pasqyrojnë situatën reale.

Zbatimi i rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga Titullari me Planin e Masave nr. 2937, datë 13.11.2017, dhe janë ngarkuar për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së, Drejtoria e Finacës me afat zbatimi në vazhdimësi.

Nga auditimi rezultoi se :

- Nga inventari është bërë kalimi kapital i zyrës së sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR.
- Inventari në vlerën 4,215,405 lekë që përfaqëson instalimet e kryera në ish-zyrat e MB, nuk është pranuar për transferim nga Ministria për mungesë të dokumentacionit bazë të trashëguar nga ish-Projekti-2KR. Bazuar në ligjin e Kontabilitetit ky zë vazhdon të qëndrojë në llogarinë



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

"çaktim", deri në amortizimin e plotë të vlerës sipas normave të përcaktuara në Ligjin 8438 "Për Tatimin mbi të Ardhurat".

Ky rekomandim konsiderohet në proces.

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se njësi për vitin 2015 kishte parashikuar në zërin "blerje pajisje e makineri" një buxhet prej 7,000,000 lekë, gjatë vitit pas marrjes së një financimi nga GIZ për të njëjtën vlerë ajo kërkoj ndryshim të destinacionit të përdorimit të fondeve nga blerje pajisje në blerje makine, me shkresë nr. 181 prot. datë 22.01.2015. Pas marrjes së aprovimit prej Ministrisë së Financave, shkresa nr.2656/1 datë 26.02.2015, fondin njësi e përdori për blerjen e dy makinave. Ajo çka konstatohet është se në Bilancin Kontabël pasqyrohet tek llogaria 215 "Mjete transporti", ndërkohë që duhej të ishte pjesë e llogarisë 602.

Për sa më sipër nga KLSH është rekomanduar që:

Me qëllim reflektimin e një situatë reale financiare të njësisë dhe rritjen e transparencës së të dhënave, AZHBR të jetë e kujdesshme për të shmangur gabimet gjatë rakordimeve me Thesarin si dhe gjatë mbartjes së tyre në pasqyrat financiare.

Zbatimi i rekomandimit.

Rekomandimi nuk është pranuar nga Titullari, pasi janë blerje makine dhe rrjedhimisht regjistrohen në llogarine 215 "Mjete transporti".

5. Nga auditimi i gjendjes në magazina rezultoi se ka mallra e materiale të hyra në magazinën e AZHBR-s dhe në ambientet e saj, të bëra dhuratë (10 copë TV Plazma LG), për të cilat nuk kishte asnjë lloj dokumentacioni origjine, por thjesht janë regjistruar në librin e magazinës si artikuj dhuratë dhe personat që i kanë në përdorim, pa vlera dhe pa u shtuar si vlerë në inventarin ekonomik.

Për sa më sipër nga KLSH është rekomanduar që:

Institucioni të marrë masa në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të bëhet vlerësimi dhe kontabilizimi i artikujve të marrë dhuratë, si dhe pasqyrimin në kartelat personale të personave që i kanë në përdorim duke i shtuar si vlerë në inventarin ekonomik.

Zbatimi i rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar nga Titullari me Planin e Masave nr. 2937 datë 13.11.2017, dhe janë ngarkuar për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së, Drejtoria e Financës me afat zbatimi të menjëhershëm. Nga auditimi rezultoi se është bërë vlerësimi me komision i televizorëve dhe ato tashmë janë pjesë e aseteve të AZHBR-së, pasqyruar në pasqyrat financiare.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

9. VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në zbatim të pikës 9. të programit të auditimit me nr.prot.1438/4 datë 28.02.2019", u shqyrtuan pranë AZHBR, dokumentacionet si më poshtë:

1. Dosjet e auditimeve të kryera në AZHBR.
2. Analiza vjetore e SAB-së (Sektorit të Auditit të Brendshëm).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

3. Manuali i SAB-së.
4. Plani vjetor 2017 dhe Plani Strategjik 2017-2019.
5. Plani Vjetor 2018 dhe Plani Strategjik 2018-2020.
6. Raporti vjetor 2017 dhe pasqyrat e miratuara.
7. Raporti vjetor 2018 dhe pasqyrat e miratuara.

Në kuadër të kryerjes së auditimit, u vendosën në dispozicion Planet vjetorë 2017-2018, Plani strategjik 2017-2019 i SAB-së (Sektorit të Auditit të Brendshëm), Plani strategjik 2018-2020 i SAB-së (Sektorit të Auditit të Brendshëm), analiza vjetore e viteve 2017-2018 e realizimit të detyrave, si dhe Auditime të kryera nga Auditimi i Brendshëm në AZHBR, me zgjedhje, në mënyrë shkresore dhe elektronike.

Nga auditimi i ushtruar në AZHBR, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, u konstatua se:

1/a. Veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, bazohet në Ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, shfuqizuar me Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 "Mbi Proçedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, Rregulloren e Brendshme të AZHBR, të miratuar me nga Ministri i MBZHR dhe Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR. SAB është e pavarur nga ana funksionale dhe raporton drejtpërdrejt tek Titullari i Përgjithshëm. Ky sektor auditon të gjithë aktivitetin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Veprimtaria e audituesve ushtrohet në përputhje me Kodin e Etikës së Audituesve të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Financave.

Struktura organizative, punonjësit, kualifikimet.

Organika e miratuar për SAB në AZHBR, paraqitet si vijon:

Viti 2017

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.01.2017	Nr. Punonjësish(fakt) 31.12.2017
1	Përgjegjës Sektori	1	1	1
2	Auditues	3	3	3
Total		4	4	4

Viti 2018

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish(fakt) 01.01.2018	Nr. Punonjësish(fakt) 31.12.2018
1	Përgjegjës Sektori	1	1	1
2	Auditues	3	3	1
Total		4	4	2

Funksioni i Përgjegjës të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në AZHBR, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017-2018, por gjatë periudhës që përgjegjësi i Sektorit ka qenë me leje lindje është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

komanduar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit specialistja e auditit, Znj. Nensi Xhani me Urdhër nr.78/1, datë 31.01.2018.

Gjatë vitit 2018, kanë ndodhur ndryshime në strukturë, përkatësisht 2 specialistë auditit janë larguar, specialistja Znj. Nensi Xhani, larguar nga institucioni me dorëheqje në datën 02 Maj 2018 dhe Znj. Lado Xhelili, shkeputjen e marrëdhënies së punës në Sektorin e Auditit të Brendshëm në datë 30.11.2018.

Sipas strukturës, Sektori është i organizuar me një përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë **ku 2 vende janë vakante.**

Struktura në fakt e personelit specialist është:

- ekonomistë 2 vetë ose 50 %.

Niveli i tyre profesional është i mirë. Përvoja e tyre si auditues varion nga 4-9 vjet.

Personeli është i çertifikuar si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik".

Ajo që konstatohet është se

Organizimi dhe funksionimi i SAB-së, bazohet në Nenin 10 të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, në kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të DAB në sektorin publik", i ndryshuar Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik miratuar prej Ministrit të Financave me Urdhrin Nr. 69 datë 29.09.2010 dhe Urdhrin Nr. 100 datë 25.10.2016.

Për gjatë vitit ky Sektor ka funksionuar pa kapacitetin e plotë të burimeve njerëzore, me 1 auditues dhe Përgjegjës të NJAB-së. Sektori i Auditit të Brendshëm gjatë vitit 2018, objekt auditimi ka funksionuar vetëm me 2 (dy) punonjës, pjesë e grupit të auditimit është edhe Përgjegjësi i Sektorit të AB dhe si rrjedhim nuk sigurohet pavarësi e plotë për autorizimin e grupit të auditimit dhe rishikimin e brendshëm të cilësisë. Kjo mund të kufizojë cilësinë e punës dhe përputhshmërinë me Standartet e AB përkatësisht 1300 – Programi i Siguridhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë dhe 2230 – Shpërndarja e Burimeve në Angazhim.

Gjithashtu kjo është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" dhe me pikën 3 (tre) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, i cili citon se

"Njësia e auditit të brendshëm përbëhet jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë".

Planifikimi dhe Raportimi i Veprimtarisë së Njësisë.

Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2017 është përgatitur "Plani vjetor 2017 dhe Strategjik për zhvillimin e auditit për vitet 2017 – 2019".

Plani është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe me shkresë nr.2403/3 prot, datë 13/10/2016, është dërguar në Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF **brenda afatit ligjor.**

Plani Strategjik për periudhën 2017 – 2019, përbëhet nga :

1. Pasqyra Nr .1- Vlerësimi I nivelit të riskut për subjektet për vitin 2017
2. Pasqyra Nr.2 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2017-2019.
3. Pasqyra Nr.3 - Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2017 .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

4. Pasqyra Nr.4 –Planifikimi vjetor I nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2017 .

5. Pasqyra Nr.5 –Planifikimi vjetor I buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2017

Në planin e parë vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar , të pasqyruara në "Formatin nr. 2" të planit. Sipas planit janë parashikuar të ndërmerren 8 angazhime auditimi për 8 sisteme prioritare dhe vlerësimin e riskut për këto sisteme sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Viti 2017

Sipas llojit të auditimit, Auditimet e planifikuara për vitin 2017 janë përkatësisht 2 (dy) auditime financiare; 2 (dy) auditime të performancës; 2 (dy) auditime përputhshmërie, 1 (një) i zbatimit të rekomandimeve; 1 (një) rast të paparashikuar sipas nevojës për rishikim të aktiviteteve të Agjencisë.

Në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2017, (shkresa nr.2403/3 prot, datë 13/10/2016) janë parashikuar gjithsej 8 misione auditimi dhe shërbime të sigurisë dhe konsulencës për titullarin e institucionit.

Gjatë vitit 2017, Sektori i auditimit të brendshëm ka realizuar Planin Vjetor të auditimit duke realizuar 9 misione auditimi.

Sipas planit duhet të kryheshin gjithsej 8 auditime, realizimin e të cilave po e paraqesim në mënyrë tabelore në tabelën 1.1.

Tabela 1.1 – Viti 2017

Nr	Muajt	Program Auditimi	Afati i Auditimit	Realizimi	
				Projekt raport	Raport Final
1	Janar	Nr.202/3 date 31.01.2017	07.02.2017	08.02.2017	21.02.2017
2	Shkurt-Mars	Nr.490/2 date 08.03.2017	24.03.2017	24.03.2017	10.04.2017
3	Prill	Nr.700/3 date 20.03.2017	10.04.2017	11.04.2017	25.04.2017
4	Maj-Qershor	Nr.1202/2 date 10.05.2017	30.06.2017	14.07.2017	01.08.2017
5	Qershor	Nr.1496/3 date 09.06.2017	12.06.2017	13.06.2018	16.06.2017
6	Korrik-Gusht	Nr.1901/2 date 17.07.2017	04.08.2017	14.08.2017	28.08.2017
7	Shtator-Tetor	Nr.2217/1 date 29.08.2017	06.10.2017	23.10.2017	10.11.2017
8	Nentor-Dhjetor	Nr.2836/1 date 02.11.2017	30.11.2017	05.12.2017	15.12.2017

Pra si konkluzion SAB në raportin vjetor të vitit 2017 gjithsej ka realizuar dhe përfunduar 8 angazhime auditimi kjo sipas pasqyrës nr.2, plotësuar nga përgjegjësi i sektorit ku rezultojnë të përfunduar:

1. Sistemi i prokurimeve
2. Procedurat e ndjekura në dhënien e pronësisë për mallrat e trashëguara nga ish-Projekti 2 KR dhe kreditë pa interes".
3. Auditimi "Sistemi i ndjekjes së debitorëve të pagesave të kompesimit direkt të projektit IPA 2013 "Mbulimi i dëmeve bujqësore dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

4. Anullimin e procedurave të prokurimit për procedurave të prokurimit për procedurën "Mbrojtja e ullishteve nga dëmtimi i Mizës së Ullirit
 5. Mbulimi i dëmeve bujqësore dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese, Nënkomponenti i 2 – Ndhimë Financiare Investimi, IPA 2013 (kontraktimi i projekteve)
 6. Sistemin e pagesave dhe pagesave
 7. Funksionimi i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse
 8. Mbulimi i dëmeve bujqësore dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese, Nënkomponenti i 2 – Ndhimë Financiare Investimi, IPA 2013 (autorizimi i pagesave dhe ekzekutimi i pagesave)
- Pra SAB rezulton me një realizim të planit prej 100 %.

Në lidhje me raportin vjetor të Sektorit të AB-së raportohet që janë realizuar: 8 misione auditimi gjithsej, nga këto nga të cilat 2 (dy) auditime financiare; 2 (dy) auditime performance, 4 (katër) auditime të përputhshmërisë.

Viti 2018

Sipas llojit të auditimit, për vitin 2018 janë parashikuar, gjithsej 8 misione auditimi, nga të cilat 3 (tre) auditime financiare; 1 (një) auditim të performancës; 3 (dy) auditime përputhshmërie; 1 (një) rast të paparashikuar sipas nevojës për rishikim të aktiviteteve të Agjencisë.

Në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2018, (shkresa nr. 2617 prot, datë 12/10/2017), janë parashikuar gjithsej 8 misione auditimi dhe shërbime të sigurisë dhe konsulencës për titullarin e institucionit.

Gjatë vitit 2018, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka realizuar Planin Vjetor të auditimit duke realizuar 8 misione auditimi nga të cilat 3 (tre) auditime financiare; 1 (një) auditim performance, 3 (tre) auditime të përputhshmërisë dhe 1 (një) rast të paparashikuar me urdhër të titullarit të AZHBR-së.

Sipas planit duhet të kryheshin gjithsej 8 auditime, realizimi i të cilave paraqitet në mënyrë tabelore në tabelën 1.2.

Tabela 1.2-Viti 2018

Nr	Muajt	Program Auditimi	Afati i Auditimit	Realizimi	
				Projekt raport	Raport Final
1	Shkurt-Mars	Nr.278/3 date 30.01.2018	17.02.2018	26.02.2018	13.03.2018
2	Prill	Nr.1067/1 date 06.04.2018	04.05.2018	18.05.2018	01.06.2018
3	Prill	Nr.1121/1 date 12.04.2018	16.04.2018	01.05.2018	14.05.2018
3	Prill-Maj	Nr.1212/1 date 18.04.2018	27.4.2018	04.05.2018	21.05.2018
4	Prill	Nr.1121/1 date 12.04.2018	16.04.2018	01.05.2018	14.05.2018
5	Maj-Qershor	Nr.1794/2 date 29.05.2018	08.06.2018	26.06.2018	11.07.2018
6	Qershor-Gusht	Nr.2331/2 date 06.07.2018	03.08.2018	17.08.2018	31.08.2018
7	Gusht-Tetor	Nr.3570/1 date 31.08.2018	01.10.2018	15.10.2018	22.10.2018
8	Tetor -Dhjetor	Nr.4610/2 date 12.10.2018	31.01.2019	15.02.2019	27.02.2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

1. Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në planifikimin vjetor SAB ka identifikuar fushat/sistemet, sipas nivelit të riskut.

Nga angazhimet e realizuara në subjektet e audituara janë përcaktuar risqet kryesore për të cilat sipas rastit janë lënë dhe rekomandime.

Duke bërë krahasimin e vlerësimeve të riskut sipas parashikimeve në planin vjetor me vlerësimet në fakt ka rezultuar se:

Për 8 auditime të planifikuara dhe realizuara, sipas planit të rishikuar vlerësimi i riskut në planin vjetor është parashikuar si vijon:

- 5 subjekte për tu audituar janë vlerësuar me risk të lartë

- 3 subjekte për tu audituar me risk të mesëm.

Për auditimet e realizuara me kërkesë të Titullarit, risqet e tyre janë vlerësuar gjatë realizimit të misioneve, dhe kanë rezultuar me risk të lartë.

Duke krahasuar vlerësimet e risqeve në planifikimin vjetor me risqet e vlerësuara gjatë realizimit të angazhimit, rezulton se në disa nga subjektet ka mospërputhje të vlerësimit të risqeve të parashikuar me vlerësimin e risqeve të kryer gjatë angazhimit të auditimit.

Për vitin 2017 janë vlerësuar më risk të lartë fushat si vijon:

IDENTIFIKIMI I RISQEVE	Mundësia e ndodhjes	Impakti	Risku total
Sistemi i Pagesave për Subvencionet për Bujqësinë	I lartë	I lartë	I lartë
Sistemi i Prokurimeve	I mesëm	I lartë	I lartë
Sistemi i Pagave dhe Pagesat	I mesëm	I mesëm	I mesëm
Sistemi i teknologjisë së informacionit	I mesëm	I mesëm	I mesëm
Sistemi i vlerësimit të IPARD II 2014-2020	I lartë	I lartë	I lartë

Për vitin 2018 janë vlerësuar më risk të lartë fushat si vijon:

IDENTIFIKIMI I RISQEVE	Mundësia e ndodhjes	Impakti	Risku total
Sistemi i Pagesave për Subvencionet për Bujqësinë	I lartë	I lartë	I lartë
Sistemi i Prokurimeve	I lartë	I lartë	I lartë
Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar	I mesëm	I mesëm	I mesëm
Sistemi i Pagave dhe Pagesat	I lartë	I lartë	I lartë
Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit	I lartë	I lartë	I lartë
Sistemi i menaxhimit të borxhit	I mesëm	I mesëm	I mesëm



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural”

Bazuar në metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut, janë programuar dhe audituar ato që paraqiten me një nivel të lartë risku.

Në planifikimin vjetor njësia e AB ka identifikuar sistemet, sipas nivelit të riskut. Nga angazhimet e realizuara në subjektet e audituara janë përcaktuar risqet kryesore për të cilat sipas rastit janë lënë rekomandimet përkatëse.

2. Natyra e gjetjeve të auditimeve të SAB, paraqitet në vijim:

Gjetjet kryesore të konstatuara nga SAB për vitin 2017:

1. Mos zbatimi i Udhëzimit nr. 2, datë 17.02.2016 “Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit nga fondi i Programit për Bujqëinsë dhe Zhvillimin Rural”, për skemat e investimeve në mungesë dokumentacioni në dosjet e kontraktimit të projekteve:

- Në 1 rast aplikanti nuk ka eksperiencën në bujqësi apo diplomën në bazë të udhëzimit nr. 2, datë 17.02.2016.
 - Në 4 raste mungon vlefshmëria e ofertave për punimet e ndërtimit.
 - Në 1 rast mungon përkthimi i ekstraktit nga regjistri tregtar i kompanisë italiane.
 - 1 rast ku ekstrakti i regjistrimit tregëtar të njërit prej ofertuesve është i vitit 2011.
2. Arkëtim i ulët i detyrimeve debitore, të mbartura nga projekti 2KR, për shkak të mungesës së bazës ligjore për sekuestrimin e mjeteve nga grantet për traktorët. Parashkrimi i afateve ligjore për procedurat gjyqësore.
3. Në bazë të Udhëzimit të ri nr.1 datë 9.11.2006, përcaktohet që të gjithë subjektet që kanë përfituar nga shlyerja me këste e mallrave dhe nuk kanë shlyer detyrimin duke filluar nga kësti i dytë, do të sekuestrohen mallrat me Urdhër të Drejtorit të Projektit 2 KR dhe pagesat e kryera deri në atë moment nuk do të kthehen. Në asnjë nga rastet për periudhën objekt auditimi nuk janë marrë nisma ligjore nga projekti 2KR. *Në këto kushte të drejtat dhe detyrimet vazhdojnë edhe pas krijimit të AZHBR, por baza ligjore nuk e parashikon.*
4. Gjatë procesit të disbursimit të kompensimeve nga projekti IPA 2013, janë konstatuar gabime në llogaritjen dhe ekzekutimin jo të saktë të pagesës, për 5 raste fermerësh.
5. Nuk është kryer një verifikim për financime të dyfishta për të njëjtin investim, në lidhje me programet e tjera të B.E në Shqipëri as para kontraktimit dhe as para pagesës.
6. Nuk është bërë publikimi i Listave të kontratave të nënshkruara të Granteve, në faqen e internetit të AZHBR-së ëë.azhbr.gov.al, sipas “Udhëzimit për Aplikantët” Seksionit 3.4 pika F, “Informacioni në lidhje me grantet e dhëna si dhe lista e grant kontratave të nënshkruara publikohet në faqen e internetit të AZHBR-së www.azhbr.gov.al”.
7. Nga auditimi u konstatua se ka pasur lëvizje të shumta në personel, largime nga puna për shkak të ndryshimit të strukturës, masa disiplinore etj. Këto lëvizje të shpeshta kanë ndikuar në performancën e institucionit dhe stafit, si dhe kosto financiare për AZHBR-në.
8. Në disa prej përshkrimeve të punës janë identifikuar raste me arsim të përgjithshëm, jo i specifikuar sipas pozicionit të punës.
9. Sistemi i kontrollit të brendshëm për aktivitetet e kontrollit të brendshëm, nuk është krijuar dhe nuk funksionon, në Sektorët e Drejtorise Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse si më poshtë:
- Manuali i Sektorit Juridik, i cili krijohet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

si funksion bashkrendimin e punës brenda sektorit, është në versionin draft i pa miratuar nga Titullari.

- Manuali i procedurave të sektorit të IT është i pa miratuar nga Titullari i AZHBR duke qenë se është në versionin draft.
- Manuali i Procedurave të sektorit të Integritit dhe Harmonizimit të Procedurave disponohet nga 2 specialistët vetëm në versionin draft.

10. Gjatë auditimit u verifikua që nuk ka asnjë gjurmë të auditimit për krijimin apo përditësimin e rubrikës "Programi i Transparencës", për vitin 2015.

11. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe atij të realizimeve të prokurimit publik në organin qendror (MBZHRAU), është bërë në kalim të afatit të vendosur në VKM nr 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Megjithatë në ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimet publike" i ndryshuar, VKM nr 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, udhëzimin nr 2, datë 27/01/2015, "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik", nuk parashikohet ndonjë sanksion.

12. Në disa raste ekzekutimet e vendimeve gjyqësore (për zgjidhjen e marëdhënieve të punës), janë kryer me përmbarues privat, si pasojë e kalimit të afateve të parashikuara në dispozitivin e vendimit të gjykatës për likuidimin vullnetar.

13. Në dosjen e pagesës administrohet dokumentacioni i nevojshëm që argumenton kryerjen e investimit në përputhje me Udhëzuesin për aplikantë. Pagesa e kryer për pjesën e kontributit të B.E është kryer brenda afatit 3 muaj, ndërsa pagesa e kontributit kombëtar është kryer në një afat më shumë se 3 muaj, me një vonesë prej 20 ditësh.

14. Gjatë auditimit janë evidentuar raste kur afatet e parashikuara në manualin e Procedurave për Drejtorinë e Kontrollit për afatin e kryerjes së kontrollit në terren nuk janë zbatuar, duke e kaluar afatin më shumë se 20 ditë, për shkak të ngarkesës në punë.

Gjetjet kryesore të konstatuara nga SAB për vitin 2018:

1. Në përputhje me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", procedurat e qarkullimit të dokumentacionit kanë nevojë për përmirësim, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra. Procedurat duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi, apo procesi në njësi ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/dokumentit që është lëshuar me këtë rast.

2. Nuk ka funksionuar sistemi i menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, janë kryer gabime administrative gjatë procesit të disbursimit të projektit IPA 2013. Debitorët e krijuar gjatë zbatimit të projektit ndahen në 3 grupe:

1. Debitorë të krijuar nga pasaktësitë e listave të MBZHR-së;
2. Debitorë të krijuar nga pagesat e pasakta nga Bankat;
3. Debitorë të krijuar nga gabimet administrative;

Për 41 rastet e evidentuara me gabime apo parregullsi janë përgatitur njoftimet për shpallje debitor, përkatësisht 18 raste gjatë periudhës Janar-Maj 2017 dhe 29 raste në dhjetor të vitit 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

3. Kontabilizimi i pagesave është bërë sipas Urdhër Shpenzimeve totale për listat bashkëlidhur pagesave për kontributin 10% dhe me listat totale sipas Urdhër xhirimeve bankare për kontributin e donatorit 90%. Detyrimet e AZHBR si strukturë zbatuese dhe ekzekutuese e buxhetit është të kryejë pagesën pas aprovimit nga MBZHR-ja për fermerët të cilët janë identifikuar si përfitues të kompesimit (aprovuar në listën e Ministrit), por për shkak të gabimeve administrative gjatë zbatimit të projektit janë paguar gabim.
4. Aktivitetet e kontrollit kanë nevojë për përmirësime konkretisht duhet të krijohet sistemi për marrjen e informacionit nëse “investimi për të cilin aplikohet është financuar nga një program tjetër kombëtar apo i BE-së, pasi do të përdoret edhe gjatë zbatimit të Programit IPARD.
5. Bazuar në pikën 8 të VKM Nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontaktat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, në komision nuk ka asnjë specialist të fushës.
6. Sistemi i kontrollit të brendshëm është krijuar për të siguruar funksionin e informimit të publikut në njësi të veçantë organizative, përkatësisht Sektori i Promocionit dhe Komunikimit, sipas strukturës së miratuar me Urdhërin Nr. 190 datë 06.11.2017. Sektori përbëhet nga 2 specialistë dhe një Përgjegjës Sektori. Aktualisht janë rekrutuar 2 specialistë dhe procesi i rekrutimit për Përgjegjës Sektori është në proces.
7. Nuk janë përgatitur procedura të shkruara për funksionimin e Sektorit të Promocionit dhe Komunikimit dhe ndarjen e detyrave me Drejtoritë e tjera.
- 8. Manuali i Sektorit të Monitorimit është në version draft dhe i pa miratuar nga titullari.**
- 9. Nuk ka një kalendar për kryerjen e monitorimeve dhe një metodologji për përcaktimin e kritereve se si duhet të monitorohen investimet.**
10. Mungon pllakata informuese që tregon që investimi është financuar nga AZHBR
11. Gjatë kontrollit në terren u konstatuan 2 subjekte, kanë pezulluar aktivitetin e tyre që nga viti 2017 e reflektuar kjo edhe në QKB.
12. Gjatë kontrollit në terren për 1 subjekt në Qarkun Vlorë, grupi i auditimit nuk nxjerr dot konkluzione pasi u limitua në kryerjen e verifikimit. Subjekti nuk u përgjigj në telefon pas disa tentativave si dhe pse u shkua në vendodhjen e investimit sipas adresës në kontratën e grantit ishte e pamundur aksesimi në investim. Subjekti është financuar për traktorë dhe agregatë bujqësorë.
13. Gjatë kontrollit në terren 2 subjekte, përkatësisht në Qarkun Tiranë dhe në Qarkun Gjirokastrë, Grupi i Auditimit nuk nxjerr dot konkluzione pasi u limitua në kryerjen e verifikimit. Subjektet nuk u përgjigjën në telefon pas disa tentativave edhe pse u shkua në vendndodhjen e investimit sipas adresës në kontratën e grantit, ishte e pamundur aksesimi në investim.
14. Struktura e Miratuar me Urdhër të KM, me 18 pozicione shtesë IPARD, do të fillojë efektet financiare nga Janar 2019.
- 15. Në Drejtorinë e Kontrollit, mungon ekspertiza me inxhinierë të fushës, inxhinierët civilë, inxhinierët e përpunimit të ushqimit, teknikët zoologjik etj.**
16. Sipas Analizës së ngarkesës në punë Autotrizimi i pagesave nuk procedon dot në kohë pagesat, me stafin aktual 1 Përgjegjës + 3 Inspektorë.
17. Rotacioni i stafit dhe mungesa e një politike reale motivimi me incentiva, bonuse në raport me performancën dhe ngarkesën në punë përbën risk për sistemin.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural”

18. Komisioni i Vlerësimit të çmimeve është krijuar por ka nevojë të testohet funksionimi

Nga dokumentacioni i auditimeve të kryera, u përzgjedhën sipas riskut që ato paraqesin për t’u audituar auditimet si më poshtë :

Auditimi i Sistemi të menaxhimit të borxhit.

A) Auditimi është kryer bazuar në Planin Vjetor 2018 dhe në zbatim të Urdhërit nr.163, datë 12.04.2018 të Titullarit të AZHBR-së **për periudhën 08.02.2017 deri në 12.04.2018** për auditimin e “Sistemi i menaxhimit të borxhit- Ligjshmëria e ndjekjes së debitorëve gjatë vitit 2017-2018: bashkëpunimi midis Drejtorive për konfirmimin e debitorëve si kusht pranueshmërie për grante”

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit Eranda Mulla, Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, Amanda Derveni, Audituese dhe Lado Xhelili, Audituese.

Ajo që konstatohet nga ky auditim si dhe gjetjet kryesore janë :

Pesha e madhe specifike që zë borxhi i trashëguar nga ish Projekti 2 KR, që në konstatimin tonë të mëtejshëm rezultojnë **“I Paarkëtueshëm”**. Sektori i Menaxhimit të borxhit është njësi përgjegjëse për evidentimin, raportimin dhe monitorimin e debitorëve. Gjendja aktuale e llogarive bankare të menaxhuara nga Sektori i Menaxhimit të Borxhit në fund të vitit 2017 është **170,410,617.13 lekë**. Arkëtimet nga të gjitha subjektet debitorë për periudhën Janar - Dhjetor 2017 kanë qenë vetëm në nivelin e 10%, dhe janë arkëtuar gjithsej **19,337,638 lekë**.

Situata e arkëtimeve të subjekteve debitorë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1. Arkëtime sipas klasifikimit të debitorëve (Janar-Dhjetor 2017)

Nr	Emertimi	Plani 2017	Vlera e arkëtuar 3 mujori I	Vlera e arkëtuar 3 mujori II	Vlera e arkëtuar 3 mujori III	Vlera e arkëtuar 3 mujori IV	Totali (Janar-Dhjetor 2017)	Diferenca me planifikimin	Realizimi
1	Debitorët e FKP 2009	142,027,000	3,400,000	663,700	495,042	3,227,258	7,786,000	134,241,000	5.5%
2	Debitorët e FKP 2012	25,056,000	550,000	1,385,000	90,000	445,000	2,470,000	22,586,000	9.9%
3	Debitorët e FKP 2013	13,516,050	670,000	1,263,350	59,650	167,050	2,160,050	11,356,000	16.0%
4	Debitorët 2014-2015	16,978,203	1,630,000	1,274,543	3,846,743	-	6,751,286	10,226,917	39.8%
5	Debitorët e Trakt. & Agregate	-	-	170,000	-	302	170,302		
6	Te ardhura të tjera	-				323,069	323,069		
TOTALI 1-5		197,577,253	6,250,000	4,756,593	8,331,045	4,162,679	19,337,638	178,409,917	9.8%

Për përfituesit e traktorëve (kontrata të lidhura në vitet 2000 - 2005), **nuk ka një plan të caktuar arkëtimi për vitin 2017**, pasi detyrimi duhet të ishte shlyer brenda 2 viteve nga nënshkrimi i kontratës. Nga debitorët për traktorë janë arkëtuar vetëm **170,302 Lekë**.

Arkëtimet më të larta gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, në përqindje të detyrimit, janë realizuar nga debitorët e vitit 2014-2015, në masën 40% të detyrimit për vitin 2017.

Pra konstatohet që **arkëtimi është shumë i ulët nga “Debitorët e traktorëve”**.

AZHBR si institucion, në rastin e debitorëve të linjës së traktorëve ngre problemin edhe të mungesës së fondeve për kryerjen e procesit të sekuestrimit të traktorëve dhe ambjentin e depozitimit të tyre në rastet e konfiskimit.



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural"

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bërë kërkesa zyrtare në MBZHR për ristrukturimin e kredive me Udhëzim të përbashkët të MBZHR dhe MFE por nuk ka një zgjidhje të kësaj çështje edhe aktualisht.

2-Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet vërtetimet e pronësisë mbi mallrat janë dhënë vetëm kur subjekti/fermeri ka shlyer plotësisht të gjithë pagesën.

3- Gjatë periudhës së audituar nuk ka procedura për fshirjen nga hipoteka të pasurive të vëna kolateral në favor të AZHBR-së. Përkatësisht, përfituesit e kredisë pa interes për Linja përpunimi; pasi shlyejnë totalisht detyrimin përfshirë principalin dhe kamatvonesat, llogaritur nga Sektori i Menaxhimit të Borxhit duke marrë si referencë tabelat e vëna në dispozicion nga Kompania audituese e jashtme MAZARS, mund të heqin barrën hipotekore të pasurisë.

- Përfituesit e Fondit Kundërparti të shpërndarë në vitin 2005, **gjithsej 42 linja**, përjashtuar një linjë që është në proces gjyqësor për shlyerjen e penalteteve, gjithë të tjerët janë në proces gjyqësor ose *në fazë ekzekutimi të vendimeve gjyqësore*.

- Nga debitorët e linjave të vitit 2009 të cilëve u ka mbaruar afati i shlyerjes së detyrimit, janë arkëtuar gjithsej 7,786,000 lekë, *janë në proces gjyqësor për pjesën e prapambetur*.

- Nga përfituesit e vitit 2012 janë arkëtuar 2,470,000 Lekë. Nga konfirmimi me Sektorin e Borxhit, 7 nga këta përfitues janë në proces gjyqësor ndërsa 3 janë të rregullt me pagesat sipas grafikëve të shlyerjeve përkatëse.

- Nga përfituesit e vitit 2013 janë arkëtuar 2,160,050 Lekë. Gjithsej janë 8 përfitues nga të cilët 6 janë në proces gjyqësor.

- Nga përfituesit e vitit 2014 - 2015 janë arkëtuar 6,751,286 lekë. Gjithsej janë 5 përfitues, 3 nga të cilët janë dërguar kërkesat tek Sektori Juridik për të filluar procedurat gjyqësore..

Sektori i Menaxhimit të Borxhit ka llogaritur penaltetet sipas kushteve kontraktuale për të gjithë përfituesit e kredisë pa interes nga viti 2009-2015, dërguar me Shkresë zyrtare nr. 264 prot. datë 30.01.2018, Drejtorisë së Financës.

4-Objektivat janë përcaktuar në Planin vjetor të punës, por nuk janë realizuar sipas indikatorëve, pasi niveli i arkëtimit është shumë i ulët.

5-Për Kreditë pa interes ka një ndjekje periodike të tyre, me njoftime dhe procese gjyqësore por *për traktorët nuk ka një plan të mirëfilltë arkëtimi.*

6-Sektori i Menaxhimit të Borxhit në bashkëpunim me Sektorin e kontabilitetit të bëjnë sistemimet e nevojshme të debitorëve të cilët kanë shlyer detyrimet por janë në listën detyrimeve.

7-Të krijohet një database ku përfshin kontaktet aktuale, adresa, numër telefoni, nëse kryen aktivitet apo jo sipas financimit të marrë, statusi i debitorit, vonesa, procese gjyqësore apo që të shërbejë si bazë e azhornuar për kontaktet me debitorët.

8-Të rritet bashkëpunimi dhe kordinimi midis Drejtorive.

B) Auditimi i dytë me përzgjedhje është mbi "Efektivitetine granteve dhe monitorimi dhe qëndrueshmëria e projekteve të financuara nga AZHBR 2014-2018". Auditimi është kryer në zbatim të Urdhërit nr. 273, datë 25.06.2018 të Drejtores së AZHBR-së për auditimin e performancës për "*Efektiviteti i Granteve- Monitorimi dhe qëndrueshmëria e projekteve tfinancuara nga AZHBR 2014-2018*"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

Subjekti i Auditimit ishte : efektiviteti i granteve, monitorimi dhe qëndrueshmëria e projekteve të financuara nga AZHBR përgjatë viteve 2014-2018 duke përfshirë edhe kontrollet në terren mbi subjektet e përzgjedhura. Auditimi i performancës së granteve, me fokus efektivitetin e skemave kombëtare, përfshirë një shqyrtim të detajuar të elementëve kyç në këtë proces:

- Analizimi i burimeve njerëzore, përfshirë çështje rregullatore dhe të logjistikës së nevojshme së bashku me indekset e performancës;

- Analiza e gjithë procedurës së monitorimit të granteve (planifikim, njoftim, monitorim, raportim etj) me rolin e Drejtorisë së Kontrollit, Sektorit të Monitorimit, duke verifikuar procedurën e monitorimit në terren.

Sipas problematikave të kontatuara, gjetjet e këtij auditimi jepen në vijim:

Gjetja 1: Manuali i Sektorit të Monitorimit është në version draft dhe i pa miratuar nga titullari.

Gjetja 2: Nuk ka një kalendar për kryerjen e monitorimeve dhe një metodologji për përcaktimin e kriterëve për mënyrën se si duhet të monitorohen investimet.

Gjetja 3: Mungon pllakata informuese që tregon se investimi është kryer nga AZHBR.

Gjetja 4: Gjatë kontrollit në terren u konstatuan 2 subjekte të cilët kanë pezulluar aktivitetin e tyre që nga viti 2017, verifikuar me ekstraktin e rregjistrit tregtar nga QKB.

Gjetja 5: Gjatë kontrollit në terren grupi i auditimit nuk nxjerr dot konkluzione pasi u limitua në kryerjen e verifikimit. Subjekti është financuar për traktorë dhe agregatë bujqësorë.

Gjetja 6: Gjatë kontrollit në terren për 2 subjekte grupi i auditimit nuk nxjerr dot konkluzione pasi u limitua në kryerjen e verifikimit. Subjektet nuk u përgjigjën në telefon pas disa tentativa edhe pse u shkua në vendodhje të investimit sipas adresës në kontratën e grantit ishte e pamundur aksesi në investim.

Gjetjet e konstatuara nga SAB, janë evidente dhe përshkruajnë saktë problematikat që shfaqen gjatë auditimit të efektivitetit të granteve, të cilat përputhen me gjetjet e grupit të auditimit të KLSH-së për periudhën në auditim dhe verifikimeve nga ana jonë të investimeve në terren, por ajo që konstatohet është se mungesa e një manuali si për sektorin e monitorimit në Drejtorinë e Kontrollit ashtu edhe për DAP (Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave), ka sjellë rekomandime të njëanshme nga SAB duke lënë detyrë për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, pikërisht vetëm për Drejtorinë e Kontrollit, kur ndërkohë përgjegjësia funksionale, nisur edhe nga Rregullorja e Brendshme me nr. prot dt është edhe për DAP por edhe për Sektorin e Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit i cili është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me riskun e agjencisë, investigimin, raportimin e rasteve të parregullsive dhe mashtrimeve të identifikuara gjatë ushtrimit të funksioneve, gjithashtu analizën dhe raportimin e aktiviteteve të AZHBR-së sipas procedurës së raportimit.

Ajo cka konstatohet nga grupi i auditimit të KLSH-së është se sektori i monitorimit ka kryer procedura të verifikimit në terren duke mos pasur një kalendar për kryerjen e monitorimeve, një metodologji për përcaktimin e kriterëve për mënyrën se si duhet të monitorohen investimet, cili investim do të monitorohet në bazë të riskut dhe se sa herë duhet të monitorohet brenda 5 viteve. Paralelisht me këtë edhe për rastet e konstatuara me shkelje kontraktuale nga përfituesit e skemave kombëtare për vitin 2018, brenda afatit 5-vjecar, nga sektori i monitorimit të përcjella periodikisht në DAP dhe SRMAR nuk ka asnjë veprim të ndërmarrë nga këta sektorë duke e ulur shumë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

eficiencën dhe efektivitetin e burimeve njerëzore dhe rrjedhimisht efektivitetin e fondeve të dhëna për periudhën 2014-2018.

Nga verifikimi i materialit konstatohet se, nga SAB nuk është lënë asnjë masë përkatëse për DAP dhe SRMAR për mosveprime pas njohjes me problematikat e konstatuara në terren dhe të paraqitura me memo të brendshme nga sektori i monitorimit përkatësisht tek këto dy njësi . Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 114/2015 datë 22.10.2015 " Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik " Neni 16 Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm, pika "e", ku citohet se:

e)Të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes.

Situata:	Nga auditimi i dosjeve me përzgjedhje në AZHBR, u konstatua se me gjithë rekomandimet e dhëna nga SAB nuk ka fillim ecurie disiplinore nga Titullari i njësisë së audituar dhe si rrjedhim dhe një zbatim minimal i rekomandimeve të auditit për përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut AZHBR në vlerësim të rëndësishë dhe frekuencës (numrit) së shkeljeve të konstatuara dhe të evidentuara në raportin përfundimtar të auditimit, duhet të kishte bërë klasifikimin e tyre dhe fillimin e procedurës për masë disiplinore për punonjësit përkatës..
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 8, datë 31.03.2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 "Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për Nënpunësin Civil", Kreu X "Disiplina në shërbimin civil", neni 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor të shërbimit civil".
Ndikimi/Efekti:	Zbatim i ulët i rekomandimeve sjell mos përmirësim në kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike dhe përdorimin e burimeve njerëzore me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë
Shkaku:	Mosnxjerrja e përgjegjësive dhe mosfillim i ecurisë disiplinore sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit e njësisë nën auditim
Rëndësia:	I mesëm

Situata:	Nga auditimi i strukturës së SAB-së, për vitin 2018 u konstatua se sipas Urdhrit nr. 140, datë 17.09.2018 " Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural" sektori i auditit të brendshëm duhet të kishte 4 punonjës 1+3 (një përgjegjës + tre auditues), por në fakt ka dy punonjës 1+1 (një përgjegjës + një auditues). Nisur nga rëndësia që ky sektor ka me rolin dhe misionin e tij, duke i mundësuar nivelit të lartë të menaxhimit <i>siguri objektive</i> në mënyrë të pavarur dhe duke përmirësuar veprimtarinë dhe performancën e AZHBR-së <i>nuk</i>
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Ruralë dhe Rural"

	<i>mund ta kryejë këtë funksion kur përgjegjësit të sektorit i duhet të kryejë edhe rolin e audituesit për realizimin e planeve strategjike dhe planeve vjetorë të auditimit.</i>
Kriteri:	Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" dhe me pikën 3 (tre) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik"
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizimi me objektivitet dhe pavarësi i auditimeve të kryera në këtë institucion
Shkaku:	Mosplotësimi i vendeve vakant nga DAP..
Rëndësia:	I mesëm

10. Borxhit progresiv i AZHBR-së

Drejtorja e Financës është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e funksionit të Kontabilitetit, financës dhe të borxhit për programet kombëtare dhe ato të para-aderimit në bujqësi.


Detyrat e Drejtorisë së Financës ndahen në:

- Procedura të Kontabilitetit;
- Procedura të borxhit;
- Ndjekja e zërave të shpenzimeve operative.

Sipas grupimit të detyrave, struktura e brendshme organizative e DF ndahet në tre sektorë:

- Sektori i Kontabilitetit SK
- Sektori i Financës SF
- Sektori i Menaxhimit të Borxhit SMB

Paraqitja e grafike e strukturës së brendshme është:





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Nisur nga rregullorja e Brendshme e AZHBR-së, Sektori i Menaxhimit të Borxhit (SMB) është përgjegjës për të siguruar kthimin e borxheve nga debitorët, si dhe zbardhjen, ndjekjen dhe kthimin e borxhit të trashëguar nga ish projekti 2-KR dhe borxhin e ri të krijuar nga pagesat për subvencione.

Nga verifikimi dhe auditimi i dokumentacionit në lidhje me borxhin, vlerat dhe moshën e tij prej krijimit të AZHBR-së u konstatua se:

Për menaxhimin e fondeve kundërpartit të ish Projektit "2KR", i janë akorduar Qeverisë Shqipëtare nga Qeveria Japoneze prej vitit 2000 vlera prej 20,000,000 USD. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka trashëguar debitorë nga ish Projekti "2KR" si dhe nga riciklimi i këtyre fondeve, ka krijuar debitorë të rinj.

Debitorët e ish projektit "2-KR" në bazë të llojit të kontratave dhe kohës së shpërndarjes së fondit ndahen në grupe si më poshtë:

- Debitorë për mekanikën bujqësore dhe plehra kimike
- Debitorë nga përfituesit e vitit 2005, "Linja dhe Sera"
- Debitorët e karburantit pa akcizë

Në tabelën nr.1 jepet gjendja progresive e debitorëve të krijuar nga Agjencia në raport me debitorët e trashëguar nga ish Projekti "2KR".

Tabela.1

Nr.	Përshkrimi	Nr. Debitorësh	Vlera në Lekë
1.	Debitorë të trashëguar nga ish-Projekti "2KR" (para krijimit të AZHBR-së)	622	1,584,703,060
2.	Debitorë të Agjencisë (2009 – 2017)	101	473,751,669
	TOTALI	723	2,058,454,729

Totali i debitorëve të AZHBR-së: nga 2009 e në vazhdim

Nr.	Përshkrimi	Nr. Debitorësh	Vlera Debitorë deri në fund të vitit 2018
1	Linjat-serat 2009	28	169,317,068
2	Kredia pa interes 2012	10	134,672,169
3	Kredia pa interes 2013	8	76,228,142
4	Kredia pa interes 2014-2015	5	89,632,045
5	Debitorët e skemave kombetare	25	2,785,264
6	Debitorët e permbytyjeve	25	1,116,981
	TOTALI	101	473,751,669

Vlera prej **1,584,703,060 lekë** përbëhet nga debitorët e linjës 2005, debitorët e linjës 2009 dhe debitorët e krijuar nga marrja e linjës së traktorëve dhe plehra.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Nga informacionet e marra në rrugë shkresore dhe elektronike nga SB (sektori i borxhit) është konstatuar se:

1-Debitorë për linjat e shpërndara në vitin 2005 janë 30 subjekte me vlerë totale të detyrimit 1,032,644,781 lekë ose e thënë ndryshe 50 % e borxhit total që ka sot AZHBR. Janë lidhur gjithsej 30 (tridhjetë) "Kontrata shitje me rezervë", bazuar në nenin 746 të Kodit Civil, subjektet janë përfitues nga Grantet Japoneze, përkatësisht Fondi Kunder Parti dhe Non Projekt Grand Aid nga viti 2000-2006.

Për këto 30 kontrata, detyrimi në total paraqitet:

-**Detyrim principal** për 29 subjekte në total në datë 31.12.2018 është 835,550,820 lekë

-Detyrimi principal+penalite në total është 1,032,644,780 lekë.

30 Subjektet përfituese kanë marrë në dorëzim dhe kanë qenë posedues, jo pronar të linjave të përpunimit, të serave me ngrohje dhe fabrikave të përpunimit prej vitit 2000 e në vazhdim, por pa pasur asnjë kontratë/marrëveshje me Projektin 2KR/AZHBR, në mënyrë që të detyroheshin të kthenin detyrimin kontraktual. Në periudhën 2006-2008, është bërë e mundur firmosja e kontratave të shitjes me rezervë, si mjeti i vetëm ligjor për kthimin e këtij detyrimi nga këto subjekte, të cilët në realitet përfitonin prej shumë vitesh duke përdorur sendet të luajtshme nga momenti i marrjes në dorëzim.

Detyrimi ligjor i subjekteve përfituese ka qenë në vazhdimësi pagimi i kësteve sipas kontratës dhe grafikut të përcaktuar bashkëlidhur kontratës së nënshkruar mes palëve. Në rast të mospagimit të detyrimit kontraktual, si sanksion në kontratë ka qenë përcaktuar që sendet të sekuestroheshin sipas procedurave ligjore, gjë që nuk është realizuar deri më tani.

Nga sektori i borxhit dhe sektori juridik, janë hapur procese gjyqësore për këta 30 subjekte debitorë (bashkëlidhur kopje të kërkesë padive për secilin rast dhe shkresa e sektorit të borxhit me nr.prot.103, datë 17.05.2016,për hapjen e këtyre proceseve). Por, meqënëse ky fenomen është i përhapur në shumë fermerë, para se të hapeshin proceset gjyqësore, ish-Projekti 2KR dhe Ministria e Bujqësisë, duhet të analizonin shkaqet dhe arsyet objektive apo subjektive të krijimit të vështirësive financiare që i kanë detyruar këta fermerë të mospaguajnë këstet dhe kamatvonesat sipas grafikut të përcaktuar në kontratën së nënshkruar. Këto shkaqe dhe arsye objektive apo subjektive, kanë të bëjnë me braktisjen e aktiviteteve agrobujqësore nga vetë fermerët përfitues, apo kane të bëjnë me shkaqe objektive apo subjektive të vetë strukturave shtetërorë që lidhen me mos subvencionimin e karburantit, te plehrave kimike, inputeve bujqësore, mungesës së letësirave fiskale, etj.

Në 30 akt-padi e bëra nga AZHBR, për këta debitorë është kërkuar specifikisht:

- a) zgjidhja e kontratave për mos përnbushjen e detyrimeve kontraktuale të mbetura
- b) pagimin e kamatvonesave sipas kontratave respektive.
- c) Po kështu është kërkuar edhe vendosja e masës së sigurimit të padise për sekuestrimin e objektit, cka do të thote se deri në përfundim të proceseve gjyqësore subjektet debitorë nuk



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujësor dhe Rural"

kanë të drejte të përdorin linjat apo serat e marra nga AZHBR, nga të cilat realizojnë dhe përfitojnë të ardhura tatimore.

Pra AZHBRR në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore të hapura ndaj të gjithë debitorëve nuk ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave. Këto kërkesa me të drejtë nuk janë bërë në paditë e ngritura, sepse në rast se, gjykata do të vendoste kthimin e linjave apo serave, buxhetit i shtetit do të kishte një kosto të konsiderueshme që do të duhej për çmontimin, transportin, magazinimin si dhe montimin e tyre në ferma të tjera. Për të nxjerrë ne dukje koston e lartë buxhetore dhe raportin kosto-përfitim për AZHBRR, mjafton të përmendim dhe ti referohemi, VKM nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimit nr 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfituar nga fondi kundërparti" me anën e të cilave AZHBR është financuar nga buxheti i shtetit me 17 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për sekuestrimin (heqjen) transportin dhe ruajtjen e dy linjave (pajse dhe makineri për nxjerrjen e vajit të ullirit), të cilat aktualisht edhe sot që nga viti 2011 ndodhen në ruajtje në ambjentet e Bordin e Kullimit Tiranë dhe kanë humbur vlerën e tyre përdorimit, për shkak të amortizimit. Për më tepër po të përmendim këtu, rastet e sekuestrimit të serave me sipërfaqe të mëdha mbi 1 ha, që kanë vite të shumta përdorimi dhe janë tejet të amortizuara do të kërkonte fonde buxhetore të konsiderueshme për vlerësimin, çmontimin, ruajtjen, transportimin dhe magazinimin dhe përsëri montimin e tyre.

Deri në momentin e këtij auditimi, nga 30 procese gjyqësore të hapura kanë përfunduar proceset gjyqësore dhe kanë marrë formë të prerë nga Gjykata Administrative e Apelit, vetëm 3 (tre) subjekte. Konkretisht, "Ana; shpk;" "OERT" (Sucraalba), sh.a, dhe "SARA" sh.p.k. dhe në këtë kontekst për sa trajtuam më sipër, për këta 3 subjekte debitorë Gjykata ka marrë vendime të ndryshme si më poshtë:

1. Për subjektin "Sucraalba", ka vendosur, detyrimin e të paditurit shoqëria Sucraalba shpk, që të përmbushë detyrimet kontraktore të rrjedhura nga Kontrata nr. 328, Prot datë 04.06.2007, lidhur me date 20.11.2006, duke i paguar AZHBR-së shumën prej 188.280.750 lekë (e cila përbëhet nga vlera e principalit 162.866.930 lekë detyrim kontraktual dhe 25.413.820 lekë penalitete që janë interesa ligjore të pa paguara. Pra gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontrate dhe jo sekuestrimin e aseteve , duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhodojë aktivitetin e tij.

2. Për subjektin "ANA" sh.p.k ka vendosur, detyrimin e palës së paditur shoqëria "ANA" shpk, të paguajë në favor të palës paditëse AZHBR, detyrimin në masën 29,158,630 lekë dhe vlerën e kamatëvonesës në shumën 4.866.328 lekë. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë. Edhe në këtë rast, gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve , duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhodojë aktivitetin e tij.

3. Për subjektin "SARA" sh.p.k, ka vendosur, zgjidhjen e kontratës së shitjes me rezervë, të sendeve të paluajtëshme me nr.6741/1, datë 15.11.2017 dhe detyrimin e palës së paditur kundërpaditëse shoqëria tregëtare "SARA" sh.p.k. të kthejë sendin objekt kontrate. Pra sipas këtij



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

vendimi gjykata ka vendosur të parashkruajë (të shuajë) detyrimin e pretenduar nga AZHBR prej 48,329,484.36 lekë dhe ka vendosur kthimin në AZHBRR të sendit (serave). Pra, duket qartë se gjykata ndryshe nga dy rastet e mësipërme, në këtë rast ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave, edhe pse kjo nuk është kërkuar nga institucioni i AZHBR-së.

Në tabelën e mëposhtme po pasqyrojmë të dhëna të detajuara për 30 subjektet debitorë:

Tabela nr.2.

Nr	Emer Mbiemer	Granti	Gjendja debitore 31.12.2018 principal + penalitet	Statusi i Proceseve Gjyqesore
1	HALFA shpk (Faik Haruni)	Linjat 2005	20,599,621.95	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
2	ENERI shpk (Spiro Arapi)	Linjat 2005	14,235,387.40	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
3	NIVICA 95 shpk (Agron Papagjika)	Linjat 2005	25,183,665.94	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
4	ALELEON shpk (Shaban Hoxha)	Linjat 2005	20,498,402.44	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
5	IVAP shpk (Fotion Postoli)	Linjat 2005	13,766,045.37	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
6	HAJDARI shpk (Bedri Hajdari)	Linjat 2005	18,437,022.25	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
7	ANI shpk (Anastas Gjickondi)	Linjat 2005	16,656,170.09	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
8	KURJAN-Brahimi shpk (Beniamin Toro)	Linjat 2005	25,588,985.38	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

9	DURAKU shpk (Zyhdi Duraku)	Linjat 2005	14,353,262.54	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
10	QEHA-91 (Bujar Sula)	Linjat 2005	8,915,588.89	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
11	FERLUT sha (Ferdinand Ibrahim)	Linjat 2005	4,914,394.74	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
12	ADC shpk (Genci Mataj)	Linjat 2005	25,754,430.15	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
13	AEI shpk (Enis Kola)	Linjat 2005	15,484,121.78	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
14	Alb Kevi shpk (Besim Isufaj)	Linjat 2005	35,727,020.79	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
15	ALEUS shpk (Aleksande Klimi)	Linjat 2005	29,115,069.75	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
16	ALIRAJ shpk (Pellumb Aliraj)	Linjat 2005	21,376,739.30	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
17	ANA shpk (Sotiraq Paspali)	Linjat 2005	33,344,673.85	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
18	ELMAZI shpk (Luftar Elmazi)	Linjat 2005	14,942,367.27	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
19	ERISA shpk (Bujar Haxhisala)	Linjat 2005	19,699,121.93	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

20	FANI FOOD shpk (Ferdj Fani)	Linjat 2005	33,989,545.42	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
21	ISAK shpk (Ismail Sinani)	Linjat 2005	31,280,161.11	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
22	KIRALB shpk (Ilmi Sakti)	Linjat 2005	19,252,686.32	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
23	LUCA shpk (Viktor Cela)	Linjat 2005	82,434,625.19	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
24	OAZI Mulletit (Zydi Tegja)	Linjat 2005	26,759,893.51	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
25	OERT shpk (Ilir Kola)	Linjat 2005	202,013,824.52	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
26	SARA shpk (Mehmet Loci)	Linjat 2005	48,329,484.36	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
27	VAJRA BIMORE FIOL (Bajram Dine)	Linjat 2005	137,251,164.83	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
28	ZIN PAG (Trifon Murataj)	Linjat 2005	38,066,029.69	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
29	SAMUEL SHPK	Linjat 2005	18,006,119.11	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II
30	ARJAN HYKA (Arjani Serë)	Linjat 2005	16,669,154.67	Proces gjyqesor, Gjykatën e Administrative të Apelit, Tirane, Shkalla e II



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

	TOTALI		1,032,644,780.54
--	---------------	--	-------------------------

2. Debitorë për linjat e shpërndara për vitin 2009 rezultojnë 28 subjekte me një vlerë totale 169,388,097 lekë, e detajuar në tabelën nr.3.

Tabela nr.3. Debitorët e linjës 2009

Nr	Emer Mbiemer	Viti	Gjendja debitore 31.12.2018 principal + penalitet
1	SHEFKI HOXHA	2009	25,132.00
2	IZET SELXHAFERI	2009	4,709,889.59
3	FLAMUR KAZA	2009	13,801,500.19
4	SELMAN VOKA	2009	7,579,231.75
5	PELLUMB SEFERI	2009	6,277,780.22
6	SHABAN PUPA	2009	8,706,481.38
7	AHMET BALI	2009	6,277,780.22
8	BASHKIM MAÇI	2009	1,885,731.66
9	ARJAN BIÇAKU (LEDMARK)	2009	9,522,403.88
10	LAVDIMIR MARA	2009	2,841,760.52
11	LLUKAN KOTO	2009	9,982,951.83
12	REXHEP ALI	2009	3,205,816.19
13	IRFAN LICI	2009	4,827,955.51
14	SEZAI SHEHU	2009	3,343,877.18
15	YLLI BEMIT	2009	2,864,210.63
16	PELLUMB MUSO	2009	1,029,256.42
17	SERVET FEKA	2009	11,183,178.04
18	AGRON GJATA	2009	6,235,740.39
19	SPAHI JAHJA	2009	2,507,315.36
20	ARTAN NDREU	2009	2,287,370.22
21	FRAN HOTI	2009	10,049,555.78
22	HAKI CUNI	2009	8,475,900.93
23	AQIF DEZHGIU	2009	9,982,952.42
24	GENCI MITA	2009	13,011,782.21
25	PELLUMB BERZHESHTA	2009	2,296,436.18
26	EDMOND KASO	2009	8,707,978.35
27	SAFET LIÇI	2009	4,077,906.61
28	QERIM ALLKJA	2009	3,690,221.49
	TOTALI		169,388,097.14



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bnëësor dhe Rural"

Për subjektet e kësaj linje, kontratat janë siguruar me kolateral (Pasuri e patundshme), të cilat referuar VKM-së nr. 269, datë 12.03.2009 "Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të ish-projektit 2-KR" janë 100-150% i kredisë së marrë .

Për 28 debitorë janë hapur procese gjyqësore të cilat janë fituar nga AZHBR dhe vetëm për subjektin Qerim Allkaj pas përfundimit të procedurave të ankandit nga ZPE, pasuritë janë tashmë në pronësi të AZHBR-së, të vërtetuara me certifikata të pronësisë. Për subjektet e tjerë vazhdojnë procedurat nga shoqëritë përmbarimore shtetërore për verifikimin e pasurive apo aktiviteteve në emër të tyre.

3-Fondi i granteve Japoneze është ricikluar duke u shpërndarë dhe në formën e kredisë pa interes me VKM të posaçme në vitet 2009, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 pas krijimit të Agjencisë si e tillë. Nga 65 përfitues të kësaj skeme, subjekte debitorë janë 46. Nga 65 përfitues të kësaj skeme, subjekte debitorë janë 46. Nga informacionet dhe intervistat e kryera me sektorin e borxhit , subjektet nuk kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e këtyre kredive duke parashtruar kërkesa në shtrirjen e afatit të shlyerjes. AZHBR ka ndjekur në vazhdimësi të gjithë procesin, duke bërë njoftimet zyrtare dhe kanë filluar proceset gjyqësore në zbatim të kontratave ligjore mes palëve.

Debitorë të kredisë pa interes për vitin 2012 janë 10 subjekte me vlerë të paarkëtuar 134,672,169 lekë e dhënë në tabelën nr.4.

Tabela nr.4

Nr	Emer Mbiemer	Viti i Krijimit	Gjendja debitore 31.12.2018 principal + pena litet
1	Florin Mandreu "Flori"LE	2012	2,410,492.28
2	Simon Gjoka LE	2012	1,326,707.00
3	Valer Hoxha "AFP"TR	2012	17,062,563.76
4	Ramiz Jahbala "AMLA" Trop.	2012	39,824,780.95
5	Ilia Kuro "Lunxhi"Gjr.	2012	14,781,104.01
6	Vehip Salkurti "Kop-Frut Diber"	2012	13,877,439.14
7	AstritRramilli BiofermaRramill	2012	10,857,941.95
8	Dhimitraq Tamço "KDK" TR	2012	17,015,667.72
9	Refat Beqirllari KO	2012	510,099.13
10	Gezim Shahini "AzariProgres"EL	2012	17,005,372.77
	TOTALI		134,672,168.72

4-Debitorë të kredisë pa interes për vitin 2013 janë 8 subjekte me vlerë të paarkëtuar 76,228,142 lekë, e dhënë në tabelën nr.5.



KONTROLI I LARTË I SHPETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

Tabela. Nr.5.

Nr	Emer Mbiemer	Viti	Gjendja debitore 31.12.2018 principal + penalitet
1	Erjon Aliaj LU,dhom frigorifer	2013	13,397,602.00
2	Aristotel Kito" Amaltea"	2013	15,161,309.00
3	Ladovik Smakaj,Vellezrit smaka	2013	13,131,707.00
4	Vesaf Musa,musa oil	2013	2,451,203.00
5	Erjona Balla,Skanderbeg	2013	15,094,481.00
6	Bashkim Maçi,Maçi 2003	2013	14,941,414.00
7	Erida Zarka FR	2013	801,143.00
8	Arben Mustafaj PR	2013	1,249,283.00
	TOTALI		76,228,142.00

5-Debitorë të kredisë pa interes për vitin 2014-2015 janë 5 subjekte me vlerë të paarkëtuar **89,632,045** lekë e dhënë në tabelën nr.6.

Tabela Nr.6

Nr.	Emer Mbiemer	Viti	Gjendja debitore 31.12.2018 principal + penalitet
1	GPBM I	2014-2015	18,012,251.00
2	Kleidi Zika	2014-2015	20,739,853.00
3	Roland Llojku	2014-2015	21,910,050.00
4	Rexhep Rraja	2014-2015	13,457,145.00
5	Agro Alko	2014-2015	15,512,746.00
	TOTALI		89,632,045.00

Për sa më sipër AZHBR, është në proces të krijimit të komisionit me urdhër të Ministrit të MBZHR, për zhvillimin e procedurave të ankandit .

a) Me shkresën nr .286/2 prot, datë 27.03.2019, nga AZHBR është dërguar shkresa me lëndë: Anëtar për komisionin e zhvillimit të ankandit drejtuar MFE, e cila në përgjigjen e saj kthyer me shkresë nr.prot 5388/2, dat 09.05.2019, është shprehur se : AZHBR është autoriteti përkatës për zhvillimin e këtij procesi.

b)Në këto kushte, AZHBR, me shkresën nr .286.prot, datë 28.05.2019, ka kërkuar miratimin e këtij komisioni drejtuar – MZHBR-së.

6-Debitorë të skemave kombëtare janë 25 subjekte me vlerë të paarkëtuar **2,785,264** lekë.

7-Debitorë të traktorëve dhe plehrave kimike janë 585 subjekte me vlerë të paarkëtuar **551,770,839** lekë, për periudhën 2000-2005, të cilët kanë lidhur kontrata shitjeje me ish-Projektin 2KR dhe nuk kanë shlyer detyrimin kontraktual sipas grafikut të shpërndarjes dhe afatit të shlyerjes prej maksimumi 5 vjetësh, i cili ka qenë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural" dhe Rural"

Në rast se blerësi nuk respekton afatet e shlyerjes së kontratës së përcaktuar, shitësi ka të drejtë (AZHBR) që t'ia marrë menjëherë mjetet blerësit duke mos i kthyer pjesën e kësteve që ka paguar dhe shumën e lënë si garanci sipas kontratës.

Nga sektori i borxhit janë dërguar njoftime periodike për kthimin e detyrimit.

Aktualisht arkëtimet nga fermerët/debitorët e mekanikës bujqësore janë të pa përfillshme.

8-Debitorë të naftës janë 36 subjekte me vlerë të paarkëtuar **39,792,929 lekë**.

9-Debitorë të përmytjeve, borxh i krijuar në vitin 2017 janë 25 subjekte me vlerë të paarkëtuar **1,117,446 lekë**.

Pra nga analiza e mësipërme vlera prej 1,584,703,060 lekë është një vlerë e konsiderueshme e cila nuk ka "shpresë" për arkëtim dhe përbën 76,99 % të borxhit total që ka sot AZHBR.

Ky borxh për vetë "moshën" që ka dhe problematikat e përmendura më sipër konsiderohet i pambledhshëm nga AZHBR.

AZHBR ka hapur proceset gjyqësore me debitorët e linjave dhe ka përcjellë këtë problematikë në Ministrinë e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural nëpërmjet shkresave përkatësisht me nr.prot.2941/1 datë 14.12.2017 dhe me nr.prot 1487 datë 02.05.2018 ku pasqyron këtë situatë.

Nga Gjykata administrative e shkallës së Parë Tiranë janë pranuar paditë.

Nga të dhënat e sektorit të borxhit arkëtimet të ndara sipas viteve për periudhën në auditim, janë : Arkëtimet nga të gjitha subjektet debitore për periudhën Janar - Dhjetor 2017 kanë qenë vetëm në nivelin e 10%, ose e thënë ndryshe janë arkëtuar gjithsej **19,337,638 lekë**.

Situata e arkëtimeve të subjekteve debitorë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 7: Arkëtime sipas klasifikimit të debitorëve (Janar-Dhjetor 2017)

Nr	Emertimi	Plani 2017	Vlera e arkëtuar 3 mujori I	Vlera e arkëtuar 3 mujori II	Vlera e arkëtuar 3 mujori III	Vlera e arkëtuar 3 mujori IV	Totali (Janar-Dhjetor 2017)	Diferenca me planifikimin	Realizimi
1	Debitorët e FKP 2009	142,027,000	3,400,000	663,700	495,042	3,227,258	7,786,000	134,241,000	5.5%
2	Debitorët e FKP 2012	25,056,000	550,000	1,385,000	90,000	445,000	2,470,000	22,586,000	9.9%
3	Debitorët e FKP 2013	13,516,050	670,000	1,263,350	59,650	167,050	2,160,050	11,356,000	16.0%
4	Debitorët 2014-2015	16,978,203	1,630,000	1,274,543	3,846,743	-	6,751,286	10,226,917	39.8%
5	Debitorët e Trakt & Agregate	-	-	170,000	-	302	170,302		
6	Te ardhura të tjera	-				323,069	323,069		
TOTALI I-5		197,577,253	6,250,000	4,756,593	8,331,045	4,162,679	19,337,638	178,409,917	9.8%

Për përfituesit e traktorëve (kontrata të lidhura në vitet 2000 - 2005) nuk ka një plan të caktuar arkëtimimi për vitin 2017, pasi detyrimi duhet të ishte shlyer brenda 2 viteve nga nënshkrimi i kontratës. *Nga debitorët për traktorë janë arkëtuar vetëm 170,302 lekë për vitin 2017.*

Arkëtimet më të larta gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, në përqindje të detyrimit janë realizuar nga debitorët e vitit 2014-2015, në masën 40% të detyrimit për vitin 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Gjatë vitit 2017, vihet re që arkëtimi është shumë i ulët nga "Debitorët e traktorëve", për sa i përket kësaj çështjeje problemi mbetet edhe fakti i mungesës së fondeve për kryerjen e procesit të dorëzimit vullnetar të traktorëve dhe deditorët e FKP të viteve 2012-2013.

Arkëtimet më të larta gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, në përqindje të detyrimit, janë realizuar nga debitorët e vitit 2014-2015, në masën 40% të detyrimit për vitin 2017.

Gjatë vitit 2017, vihet re që arkëtimi është shumë i ulët nga "Debitorët e traktorëve", për sa i përket kësaj çështjeje problem mbetet edhe fakti i mungesës së fondeve për kryerjen e procesit të dorëzimit vullnetar të traktorëve dhe deditorët e FKP të viteve 2012-2013.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka bërë kërkesa zyrtare në MBZHR për ristrukturimin e kredive me Udhëzim të përbashkët të MBZHR dhe MF por nuk ka një zgjidhje të kësaj çështje. Arkëtimet për periudhën Janar – Dhjetor 2018 pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.8.

Nr.	Debitorët	Plani I-vjeçar	Arkëtimet e vitit	Realizimi
1	Kredi pa interes 2009*		588,000.00	
2	Kredi pa interes 2012	25,056,000.00	5,915,000.00	24%
3	Kredi pa interes 2013	13,516,050.00	2,266,750.00	17%
4	Kredi pa interes 2014	16,978,242.00	3,823,629.00	23%
5	Debitorët e traktorëve*		130,000.00	
6	Debitorët e skemës së përmbytjeve	4,015,124.00	1,067,551.00	27%
	TOTALI	59,565,416.00	13,790,930.00	23%

Sikurse konstatohet nga tabela, arkëtimet më të larta gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, në përqindje të detyrimit janë realizuar nga debitorët e skemës së përmbytjeve në masën 27% të detyrimit për vitin 2018.

Për kredinë pa interes 2009 dhe traktorët nuk ka parashikim plani, pasi afatet e shlyerjes janë tejkaluar.

Në total për vitin 2018 janë arkëtuar gjithsej **13,790,930 Lekë**.

Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën **2,058,454,729 lekë**, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave 2005-2009, me një borxh në vlerën **1,032,644,780 lekë** për linjat 2005 dhe një vlerë prej **169,388,097 lekë** për linjat 2009.

Hapja e proceseve gjyqësore nga AZHBR është shoqëruar me kosto të lartë ku rast konkret është dorëzimi vullnetar i 2 (dy) linjave të cilat ndodhen në Bordin e Kullimit Tiranë, bazuar kjo në VKM nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimin nr 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfituar nga fondi kundërparti" për marrjen e këtyre sendeve (sekuestro), duke e rënduar Buxhetin e Shtetit me një kosto prej 17.000.000 mln lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

Pavarësisht procedurave të ndjekura dhe dokumentuara nga AZHBR nëpërmjet shkresave dhe e-maileve të dërguara në MZHBR dhe MFE, si dhe proceseve gjyqësore të hapura e të shoqëruara me kosto të larta të tyre, nuk kanë sjellë një zgjidhje të situatës.

Për debitorët e linjave 2005-2009, të cilët kanë qenë subjekte të pajisur me nipt, pra të regjistruar në organin tatimor, u konstatua që ndër vite nuk kishte një bashkëpunim ndërmjet AZHBR dhe DPT-së, me qëllim që për të gjithë subjektet aktivë në organin e tatimeve dhe debitorë në AZHBR, nga linjat e përfituara nga kjo e fundit, të hartohej plani i monitorimit dhe arkëtimit në bashkëpunim me MFE-në për arkëtimin e këtyre detyrimeve në kohë.

<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën <u>2,058,454,729 lekë</u>, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave 2005-2009, me një borxh në vlerën <u>1,032,644,780 lekë</u> për linjat 2005 dhe një vlerë prej <u>169,388,097 lekë</u> për linjat 2009.</p> <p>AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë të linjave 2005-2009. Por, meqenëse ky fenomen është i përhapur në shumë fermerë, para se të hapeshin proceset gjyqësore, ish-Projekti 2KR dhe Ministria e Bujqësisë, duhet të analizonin shkaqet dhe arsyet objektive apo subjektive të krijimit të vështirësive financiare që i kanë detyruar këta fermerë të mos paguajnë këstet dhe kamatëvonesat sipas kontratave (shkaqet dhe arsyet, kanë të bëjnë me braktisjen e aktiviteteve nga vetë fermerët përfitues apo me mos subvencionimin e karburantit, in puteve bujqësore, mungesën e lehtësirave fiskale, etj).</p> <p>Në 30 akt-paditë e bëra nga AZHBR në gjykatë për këta debitorë është kërkuar specifikisht: zgjidhja e kontratave për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të mbetura, pagimin e kamatëvonesave sipas kontratave respektive. AZHBR në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore të hapura ndaj të gjithë debitorëve nuk ka kërkuar sekuestrimin dhe <u>kthimin e linjave apo serave</u>. Kjo kërkesë me të drejtë nuk është bërë në paditë e ngritura, sepse në rast se, gjykata do të vendoste kthimin e linjave apo serave, buxhetit i shtetit do të kishte një kosto të konsiderueshme që do ti duhej për çmontimin, transportin, magazinimin si dhe përsëri montimin e tyre në ferma të tjera. Për të nxjerrë në dukje koston e lartë buxhetore dhe raportin kosto-përfitim për AZHBR, mjafton të përmendim dhe ti referohemi, VKM-së nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimit nr. 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mblledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfituar nga fondi kundër parti" me anën e të cilave AZHBR është financuar nga buxheti i shtetit me 17 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për sekuestrimin (heqjen) transportin dhe ruajtjen e dy linjave (pajisje dhe makineri për nxjerrjen e vajit të ullirit), të cilat aktualisht edhe sot që nga viti 2011 ndodhen në ruajtje në ambientet e Bordin e Kullimit Tiranë dhe kanë humbur vlerën e tyre përdorimit, për shkak të amortizimit. Për më tepër po të përmendim këtu, rastet e sekuestrimit të serave me sipërfaqe të mëdha mbi 1 ha, që kanë vite të shumta përdorimi dhe janë tejet të amortizuara do të kërkonte fonde buxhetore të konsiderueshme për vlerësimin, çmontimin, ruajtjen, transportimin dhe magazinimin.</p>
------------------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

	<p>Deri në momentin e këtij auditimi, nga 30 procese gjyqësore të hapura kanë përfunduar procesin gjyqësor dhe kanë marrë formë të prerë nga Gjykata Administrative e Apelit, vetëm 3 (tre) subjekte. Konkretisht, "Ana; shpk; "OERT" (Sucralba), sh.a, dhe "SARA" sh.p.k. dhe në kontekst për sa trajtuam më sipër, për këta 3 subjekte debitorë Gjykata ka marrë vendime të ndryshme si më poshtë:</p> <p>Për subjektin "Sucraalba", ka vendosur, detyrimin që të përmbushë detyrimet kontraktore, duke i paguar AZHBR-së shumën prej 188,280,750 lekë (e cila përbëhet nga vlera e principalit 162.866.930 lekë detyrim kontraktuale dhe 25.413.820 lekë penalitete që janë interesa ligjore të pa paguara. Pra gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij.</p> <p>Për subjektin "ANA" sh.p.k ka vendosur, të paguajë detyrimin në favor të AZHBR në masën 29,158,630 lekë dhe vlerën e kamatëvonesës në shumën 4,866,328 lekë. Edhe në këtë rast, gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e aseteve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij.</p> <p>Për subjektin "SARA" sh.p.k ka vendosur zgjidhjen e kontratës së shitjes me rezervë, të sendeve të paluajtshme me nr.6741/1, datë 15.11.2017 dhe detyrimin e shoqërisë tregtare "SARA" sh.p.k. të kthejë sendin objekt kontrate. Pra sipas këtij vendimi gjykata ka vendosur të parashkruajë (të shuajë) detyrimin e pretenduar nga AZHBR prej 48,329,484.36 lekë dhe ka vendosur kthimin në AZHBRR të sendit (serave). Pra, duket qartë se gjykata ndryshe nga dy rastet e mësipërme, në këtë rast ka kërkuar sekuestrimin dhe <u>kthimin e linjave apo serave</u>, edhe pse kjo nuk është kërkuar nga vetë AZHBR.</p> <p>Debitorët e linjave 2005-2009, të cilët kanë qenë subjekte të pajisur me nipt, pra të regjistruar në organin tatimor, u konstatua se ndër vite nuk kishte një bashkëpunim ndërmjet AZHBR dhe DPT, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, dhe më pas për subjektet aktivë në organin e tatimeve dhe debitorë në AZHBR, të hartonin për këtë periudhë planin i monitorimit dhe arkëtimit në bashkëpunim me MFE-në, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në kohë reale.</p>
Kriteri:	VKM-në nr. 868, datë 27.10.2010 dhe Udhëzimin nr 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfutuar nga fondi kundër parti"
Ndikimi/Efekti:	Arkëtimi i borxhit në nivele të papërfillshme.
Shkaku:	Mosndjekia në mënyrë periodike e statusit të këyre debitorëve
Rëndësia:	I lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Nga *auditimi i pasqyrave financiare*, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimet, banka, janë përfshirë në paqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar.

Opinionin është i pakualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e *ISSAI 1700⁴*, dhe *ISSAI 1200⁵*, si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH-së, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural në datën 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018.

Baza mbi opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të

⁴ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

⁵ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur në vlerësimin e riskut dhe të materialitetit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar. Auditimi i përputhshmërisë në AZHBR është kryer së bashku me pasqyrat financiare dhe audituesi nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale.

Opinion i pakualifikuar⁶

Nën gjykimin e grupit të auditimit, në lidhje me auditimin e përputhshmërisë shpreh një konkluzion/opinion pakualifikuar, ku në gjykimin profesional, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk kanë devijime materiale.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

⁶ Audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar-pa rezerve kur në gjykimin profesional të tij audituesi nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organikës së AZHBR-së, u konstatua se struktura organike e këtij institucioni ka ndryshuar dy herë për një periudhë një-vjeçare, e cila korrespondon me periudhën në auditim 2017-2018, konkretisht sipas Urdhrit nr. 190, datë 06.11.2017 "Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), numri i punonjësve ndryshoi nga 123 në 133 dhe sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018 "Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural" duke ndryshuar nga 133 në 169 punonjës. Gjendja faktike numri i punonjësve është 129, pra ka një mungesë prej 40 punonjësish. Procedura e ristrukturimit të organikës së AZHBR-së, rritja e numrit të punonjësve nga 133 në 169, krijimi i vendeve vakant si rezultat i lirimit të punonjësve civilë shoqëruar kjo edhe me mos emërimin në kohë të punonjësve të rinj nga DAP, rezultat i procedurave të rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike, ka bërë që shumë sektorë dhe drejtori për një periudhë të punojnë me staf të reduktuar në numër, disa herë pa strukturat drejtuese (drejtorët dhe përgjegjësit), duke krijuar mbingarkesë të punonjësve me detyra shtesë si dhe ulje të efektivitetit në detyrat funksionale.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 29-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: AZHBR ti kërkojë DAP, për të filluar procedurat e rekrutimit për plotësimin e menjëhershme të vendeve vakante, veçanërisht të specialistëve të fushës së inxhinierisë së ndërtimit, mekanike dhe elektrike, me qëllim përdorimin sa më eficient të burimeve njerëzore në plotësimin e vizionit të këtij Institucioni që është fokusimi në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përftohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" u konstatua se, komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një ndarje të tyre sipas zërave: vlera total për pajisje informatike, vlera total



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

për vegla pune, mobilieri e pajisje zyre, kondicioner, etj sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit, por i ka grupuar në total në dy zëra "inventar ekonomik" dhe "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune". Veprime në kundërshtim me pikat 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",
(*Trajtuar më hollësisht në faq40-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Komisioni i inventarizimit të merren masa që gjatë inventarizimit të asetëve të bëhet ndarja e aktiveve sipas zërave, me qëllim krahasimin e gjendjes fizike me gjendjen në kontabilitet dhe për diferencat e konstatuara sipas zërave nëse do të këtë, të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se komisioni, për të dy vitet objekt auditimi ka konstatuar diferencat, për të cilat nuk janë dhënë sqarime të mëtjshme se kush janë personat përgjegjës apo nga kusht është shkaktuar mungesa. Për diferencat e konstatuara, komisioni nuk ka përpiluar një procesverbal, nëpërmjet të cilit vihet në dijeni instancat përkatës, për marrjen e masave të mëtjshme për kompensimin apo sistemimin e diferencave të konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 85, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 40-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Të ngrihet një komision i veçanta, për të bërë verifikimin e diferencave të konstatuara nga komisionet e mëparshme të inventarizimit dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse të personave që kane në ngarkim vlerat materiale, duke i reflektuar diferencat e konstatuara dhe në kontabilitet. Më pas institucioni të marrë masat që për diferencat e konstatuara të vlerave materiale të behet kompensimi i vlerave të tyre duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale te mëpasshme të cilat kanë sjell rritje te vlerës së tyre, si dhe vlerën e amortizimit të akumuluar.

Brenda datës 30.09.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 në zërin "Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar" janë të pasqyruara (llog. 202) "Studime dhe kërkime" në vlerën prej 21,674,642 lekë, e cila përbëhet nga shuma prej 295,800 lekë të projektit ish- 2KR dhe në shumën prej 21,378,842 lekë të dy kontratave për "Studim për mizën e ullirit" dhe "Projekti për ndërtimin e zyrave të AZHBR-së në Fushë Krujë" lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat nuk gjenden kontratat e lidhura. Në SKK nr. 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore. Aktivi në fjalë nuk është më në funksion, si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

rrjedhoje nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivitetit jo-material, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 46-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga AZHBR, të merren masat që në bashkëpunim me MBZHR dhe Ministrinë e Financës, të analizojnë gjendjen "Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuar" dhe në varësi të rezultateve të analizës të bëhet nxjerrjen jashtë përdorimi dhe çregjistrimin e tyre nga kontabiliteti, për të bërë të mundur një paraqitje sa më reale të pozicionit financiar të institucionit.

Brenda datës 31.12.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, për vitin buxhetor 2017 dhe 2018 AZHBR-ja, më së shumti ka realizuar procedura me blerje të vogla, ndërsa në lidhje mbi procedurat e prokurimeve publike, për zërin 231 (investime) dhe zërin (602) mallra e shërbime me vlera të lartë, pjesa më e madhe tyre janë realizuar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) ose nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si Autoritet Kontraktor u konstatua se institucioni nuk ka njësi të prokurimit, si strukturë permanente, por është krijuar, rast mbas rasti në momentin që ka pasur procedura. Gjithashtu u konstatua se, anëtarët të cilët janë vendosur nga Titullari i AK nuk janë specialist të fushës dhe nuk janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme pranë Agjencia e Prokurimeve Publike (APP). Veprime në kundërshtim me Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Manuali për MFK nr. 108 datë 17.11.2016, pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore".

(Trajtuar më hollësisht në faqet 67-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Rekomandim: AZHBR të marrë masa që në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimeve Publike, të bëjë një plan masash për trajnimin e anëtarëve të cilët do jene pjesë e komisioneve të prokurimeve, duke rritur cilësinë e procedurave me të gjitha hallkat e atyre, për të pasur efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet me fondet të financuara nga buxheti i Shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillim bujqësor dhe rural për vitin 2018, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillim rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", konkretisht për Masën 12 (Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit), ku citohet: "Masa e financimit është parashikuar 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika ose jo më shumë se 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.", u konstatua se:

Duke përdorur metodën krahasimore midis mesatares së çmimeve të preventivave ofertave të përfituesve, me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", rezultoi se, ka diferenca në vlerë. Kështu, përfituesit e serrave diellore, kanë paraqitur preventiva të rritura, afërsisht 43 % të vlerës së investimit total për tre zëra kryesorë (plasmas serrash dhe aksesorë, konstruksione metalike dhe betonin e gropave).

Për sa më sipër, duke pasur parasysh faktin se AZHBR, financon nga Buxheti i shtetit jo më shumë se 50% e vlerës së investimit, pra rreth 21.5% e vlerës së subvencionit, është financuar në mungesë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike sipas manualeve teknike shtetërore, por në referim të preventivave ofertues të mbështetura në çmimet e tregut vendas ose të huaj.

Kjo situatë ka ardhur, si pasojë e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, Kreu IIX "Kriteret specifike dhe dokumentacioni për masat mbështetëse", pika 2, ku nuk është kërkuar referimi i çmimeve mbështetur në manual për Masën 12, duke hequr kërkesën që "...çmimet e preventivit konkurrues nuk duhet të jetë i vulosur dhe i firmosur nga inxh. ndërtimi i liçensuar.", siç është kërkuar për masat e tjera.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Rekomandim: Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, gjatë hartimit dhe miratimit e akteve normative ligjore dhe nënligjore, për skemat e masave mbështetëse kombëtare që realizohen nëpërmjet investimeve ndërtimore, të vendosin kriteret specifike dhe dokumentacion të unifikuar dhe të standardizuar, të cilat nuk duhet të ndryshojnë nga viti në vitin buxhetor të radhës. Me qëllim për mirëpërdorimin e fondeve publike në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficientës, hartimi i preventiveve dhe llogaritja e vlerës së financimit të behet sipas manualeve teknike me çmimeve të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM. Për ato zëra dhe çmime që nuk përfshihen në këto manuale të hartohen analizat teknike të të çmimeve mbështetur në normativat teknike dhe në çmimet tregut.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i skemave mbështetëse kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural, të përcaktuara sipas VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018" dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 1, datë 19.02.2018 "Për procedurat dhe mënyrën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, si dhe auditimet e kryera në terren nga grupi i auditimit, u konstatua se, për masat mbështetëse të skemave kombëtare të zhvilluara nëpërmjet investimeve ndërtimore konkretisht për masat:

- Masa 20 "Ambiente grumbullimi dhe frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore"
- Masa 21 "Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime"
- Masa 22 "Linja përpunimi/makineri për fruta-perime, vaj ulliri dhe verë"
- Masa 23 "Linja selektimi, paketim, ambiente për fruta, perime dhe bimë medicinale"
- Masa 32 "Ndërtimin e thertoreve dhe pajisjeve"
- Masa 34 "Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe makineri dhe pajisje"
- Masa 44 "Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin të turizmit rural"
- Masa 45 "Mbështetje për investime në agroturizëm"
- Masa 51 "Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve",

Në situacionet përfundimtare të punimeve është përdorur termi "e pamatshme për punimet e maskuara". Grupet e monitorimit të AZHBR-së kryejnë, sipas manualit të kontrollit vetëm dy kontrole (një në fillim para lidhjes së kontratës dhe një në fund të përfundimit të investimit). Grupet e kontrollit përbëhen nga inspektorë kontrolli që kanë profil jurist dhe ekonomist, dhe jo profil teknik (inxh/ndërtimi, urbanist, inxh/ mekanik, inxh/elektrik, arkitekt etj), ndonëse nga AZHBR me disa shkresa nr.304 prot, datë 27.07.2018 dhe nr.3041 prot datë 27.07.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike është kërkuar rekrutimi i punonjësve për këto pozicione pune, të cilat ende janë vakante.

Kështu, specialistët të monitorimit, mbështeten vetëm në librezat e masave duke i marrë të mirëqena punimet e pamatshme, pa i bërë një analizë profesionale. Mbi punimet ndërtimore, përfituesit e subvencionit, e përcaktojnë vetë mbikëqyrësin e punimeve, i cili miraton volumet dhe projektin e azhornuar.

Nga auditimi i dosjeve të përfituesve të subvencionit, konstatohet se mbikëqyrësi i punimeve realizon vetëm librezën e masave dhe asnjë dokumentacion tjetër mbi punimet si, (procesverbalet e punimeve të maskuara, ditarin e punimeve, ndryshimet e projektit, testet e kontrollit, certifikatat e materialeve të përdorura, foto gjatë punimeve etj), duke mos mbajtur asnjë përgjegjësi për punimet mbas përfundimit të investimit, pasi edhe në kontratën e lidhur midis AZHBR dhe përfituesit të subvencionit, nuk është shprehur si detyrim kontraktor, *ekzistenca e një mbikëqyrësi punimesh me licencën përkatëse*, sipas një marrëveshjeje dypalëshe të njohur nga AZHBR. (Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga AZHBR në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të merren masa, që të plotësohen vendet vakante me specialistë të fushës, nëse kjo nuk realizohet në kohë të shikohet mundësia e hapësirave ligjore për punësimin me kontratë të përkohshme ekspertë të jashtëm të fushës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.2. Rekomandim: Për kontratat e skemave të mbështetjes kombëtare duhet të vendoset një pikë e veçantë, mbi kontraktimin e një mbikëqyrësi me licence, në përputhje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 7.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se, propozimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, drejtuar Këshillit të Ministrave, për miratimin e VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018” dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i ndryshuar, nuk është realizuar paralelisht me miratimin Buxhetit vjetor që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë brenda datës 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke mos qenë në koherencë me vitin bujqësor por me vitin kalendarik buxhetor. Kjo, ka sjellë penalizmi e aplikantëve fitues për masat mbështetëse të skemave kombëtare, duke shkurtuar në maksimum kohën e ndërtimit të investimeve për periudhën 2-3 muaj.

8.1. Nga auditimi, u konstatua se, Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR, nuk ka strategji komunikimi për të përcaktuar objektivat kryesore për masat mbështetëse (orientimi, treguesit etj) si dhe roli i AZHBR-së duket thjesht si ekzekutues i fondeve që duhen shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në VKM-së nr.72, datë 07.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018” dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Financave nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të cilat kanë pësuar ndryshime të shpeshta buxhetore, duke sjellë uljen e vlerës së parashikuar për skemat mbështetëse kombëtare.

8.2. Nga auditimi i procedurave të dhënies së subvencionet për skemat mbështetëse kombëtare kryesisht investime, numri i dokumenteve për të plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe kohore për aplikantët, për pasojë kemi ndikim në efektivitetin e skemave kombëtare. E kundërta ka ndodhur për masa direkte mbështetëse, ku në vitin 2018, për herë të parë, është përdorur aplikim me 0 dokumente, duke ulur numrin e dokumenteve për fermerin, por duke shtuar volumin e punës dhe kosto administrative të larta, të administratës të AZHBR-së.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me AZHBR-në, të marrin masat e nevojshme, për të realizuar në kohë propozimin dhe miratimin e kornizës ligjore dhe nënligjore, për hartimin e strategjisë, për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten, për përcaktimin e masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke rritur mundësinë që fondi i alokuar për skemat të mos pësojë ndryshime të shpeshta dhe të konsiderueshme gjatë vitit dhe të shtojë në këtë mënyrë aftësinë për të përthithur të gjitha fondet që akordohen nga Buxheti i shtetit për bujqësinë, në favor të përfituesve bujqësorë shqiptarë.



8.2. Rekomandim: AZHBR së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të punojnë për arritjen e marrëveshjeve dypalëshe, në mënyrë që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkohen aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej vetë AZHBR-së, duke patur akses on-line me institucionet që japin këto vërtetime, me qëllim lehtësimin e aplikantit-përfitues, duke ulur e koston financiare dhe kohën fizike për përgatitjen e tyre.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se, nga AZHBR hartimi i kontratave me përfituesit e skemave mbështetëse kombëtare, janë kontrata tip, pa ndryshime nga njëra masë tek tjetra, duke përcaktuar monitorimin e aktivitetit të detyrueshëm për 5 vite, por nuk dalin të qarta masat konkrete administrative, që duhet të ndërmerret AZHBR në rastet e mosplotësimeve detyrimeve kontraktore, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9817 datë 22.10.20017 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar, neni 39 (sanksionet) pika 1 citohet se "*Kundravajtjet administrative dënohen me gjobë në masën 30, 000 (tridhjetë mijë) lekë – 40, 000 (dyzet mijë) lekë si dhe kthimin e financimit të përfutur*".

9.1. Nga auditimi u konstatua se, strukturat e monitorimit të AZHBR-së, janë të pamjaftueshme me burime njerëzore, pasi nuk është e mundur të monitorohen në kohë subvencionet, dhe mos hartimi i një plani monitorimi periodik me objektiva të qarta, ka çuar në mungesë analize të hollësishme, në ecurinë e projekteve të investimeve mbi bazën e plan-bizneseve të paraqitura nga përfituesit.

Gjithashtu nga auditimit, u konstatua se, mungesa e monitorimit të objektivave (ku më kryesori është zbatimi i skemave kombëtare), të AZHBR, nga sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, për periudhën 2017-2018, ka ndikuar negativisht në eficientë, efektivitetin dhe ekonomikitetin e këtij institucioni në realizimin e zbatimit të skemave kombëtare. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: AZHBR me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave dhe Sektori i riskut parandalimit të mashtrimit, analizës dhe raportimit, të hartojnë planin e monitorimit për subjektet e konstatuara me mosplotësimin të detyrimeve kontraktuale për periudhën 2017 dhe 2018, duke verifikuar në terren vazhdimësinë dhe saktësinë e zbatimit të subvencioneve për afatin 5 vjeçar, duke aplikuar penalitete dhe sanksionet sipas rasteve.

9.2. Rekomandim: Nga AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ti propozojë Këshillit të Ministrave, rritjen e numrit të punonjësve për strukturat monitoruese, të cilat duhet të harmonizohen në ndërveprime të përbashkëta me sektorët e tjerë, duke rritur shkallën e profesionalizmit për të arritur qëllimin dhe objektivat e AZHBR-së.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në bazë të ligjit nr.9817 datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kreu VI, “Bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionet” neni 22, AZHBR krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të Regjistrit të fermës, proces i cili ende nuk është realizuar, ndonëse edhe në kuadër të procesit të aderimit për Bashkimin Evropian, si kusht për Agjencinë e Pagesave, është administrimi dhe funksionaliteti i IACS (Sistemi i Integruar i menaxhimit dhe kontrollit), me komponentë:

1-Regjistri i fermës;

2-LPIS-Sistemi i përcaktimit dhe i klasifikimit të parcelave bujqësore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masat, të fillojë projektin për krijimin dhe zhvillimin e Regjistrit të fermës, duke aplikuar të gjitha hapat ligjorë për një data basë të konsoliduar kombëtar dhe përfshirjen e të gjithë aktorët, për të përmbushur detyrimet ligjore sipas Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe Planit Kombëtar për Integrim Evropian.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve me përzgjedhje në AZHBR, u konstatua se me gjithë rekomandimet e dhëna nga sektori i auditimit të brendshëm, nuk ka fillim ecurie disiplinore nga Titullari i Institucionit për personat përgjegjës, dhe si rrjedhim ka një zbatim minimal të rekomandimeve të auditit për përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut. AZHBR në vlerësim të rëndësisë dhe frekuencës (numrit) së shkeljeve të konstatuara dhe të evidentuara në raportin përfundimtar të auditimit, duhet të kishte bërë klasifikimin e tyre dhe fillimin e procedurës për masë disiplinore për punonjësit përkatës. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 3, datë 30.12.2008 “Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR, si dhe Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, Kreu X “Disiplina në shërbimin civil”, neni 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor të shërbimit civil”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në AZHBR të planifikohen auditime mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të ndiqen me përgjegjësi maksimale niveli i zbatimit të tyre si dhe të evidentohen personat përgjegjës për raste të përsëritura të moszbatimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës së SAB-së, për vitin 2018 u konstatua se sipas Urdhrit nr. 140, datë 17.09.2018 “Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural” sektori i auditit të brendshëm duhet të kishte 4 punonjës 1+3 (një përgjegjës + tre auditues), por në fakt ka dy punonjës 1+1 (një përgjegjës + një auditues). Nisur nga rëndësia që ky sektor ka me rolin dhe misionin e tij, duke i mundur nivelit të lartë të menaxhimit siguri



objektive në mënyrë të pavarur dhe duke përmirësuar veprimtarinë dhe performancën e AZHBR-së nuk mund ta kryejë këtë funksion kur përgjegjësit të sektorit i duhet të kryejë edhe rolin e audituesit për realizimin e planeve strategjike dhe planeve vjetorë të auditimit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik" pika 3.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Juridike dhe Funksioneve Mbështetëse (sektori i burimeve njerëzore) në bashkëpunim me DAP (Departamentin e Administratës Publike), të merren masa të menjëhershme për plotësimin e dy vendeve vakant në këtë sektor shumë të rëndësishëm në mirë funksionimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, rregullores, udhëzimeve dhe urdhrave gjatë aktivitetit të AZHBR-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë, si pasojë e borxhit me vlerë prej 2,058,454,729 lekë, që trashëgon në mënyrë të vazhdueshme, i krijuar nga implementimi ish-Projekti 2KR (kredi pa interes që i ka dhënë Qeveria Japoneze Ministrisë së Bujqësisë për të ndihmuar fermerët shqiptar). Nga auditimi i 30 akt-paditë të bëra në gjykatë për këta debitorë është kërkuar vetëm zgjidhja e kontratave për shkak të mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të mbetura dhe pagimin e kamatëvonesave.

AZHBR në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore të hapura ndaj të gjithë debitorëve nuk ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave. Kjo kërkesë, nuk është bërë në paditë e ngritura, sepse në rast se, gjykata do të vendoste kthimin e linjave apo serave, buxheti i shtetit do të kishte një kosto të konsiderueshme që do të duhej për çmontimin, transportin, magazinimin si dhe përsëri montimin e tyre në ferma të tjera, por duhet një zgjidhje juridike, pa cënuar mungesa në buxhetin e shtetit. Për të nxjerrë në dukje koston e lartë buxhetore dhe raportin kosto-përfitim për AZHBR, mjafton të përmendim dhe ti referohemi, VKM-së nr. 868 datë 27.10.2010 dhe Udhëzimit nr. 4363 datë 15.9.2011 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitorë që kanë përfutur nga fondi kundër parti" me anën e të cilave AZHBR është financuar nga buxheti i shtetit me 17 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për sekuestrimin (heqjen) transportin dhe ruajtjen e dy linjave (pajisje dhe makineri për nxjerrjen e vajit të ullirit), të cilat aktualisht edhe sot që nga viti 2011 ndodhen në ruajtje në ambientet e Bordin e Kullimit Tiranë dhe kanë humbur vlerën e tyre përdorimit, për shkak të amortizimit. Për më tepër po të përmendim këtu, rastet e sekuestrimit të serave me sipërfaqe të mëdha mbi 1 ha, që kanë vite të shumta përdorimi dhe janë tejet të amortizuara do të kërkonte fonde buxhetore të konsiderueshme për vlerësimin, çmontimin, ruajtjen, transportimin dhe magazinimin. Deri në momentin e këtij auditimi, nga 30 procese gjyqësore të hapura kanë përfunduar procesin gjyqësor dhe kanë marrë formë të prerë nga Gjykata Administrative e Apelit, vetëm 3 (tre) subjekte. Konkretisht, "Ana; shpk," "OERT" (Sucralba), sh.a, dhe "SARA" sh.p.k. dhe në kontekst për sa



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

trajtuam më sipër, për këta 3 subjekte debitorë Gjykata ka marrë vendime të ndryshme si më poshtë:

Për subjektin "Sucraalba", ka vendosur, detyrimin që të përmbushë detyrimet kontraktore, duke i paguar AZHBR-së shumën prej 188,280,750 lekë (e cila përbëhet nga vlera e principalit 162.866.930 lekë detyrim kontraktuale dhe 25.413.820 lekë penalitete që janë interesa ligjore të pa paguara. Pra gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e asetëve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin "ANA" sh.p.k ka vendosur, të paguajë detyrimin në favor të AZHBR në masën 29,158,630 lekë dhe vlerën e kamatëvonesës në shumën 4,866,328 lekë. Edhe në këtë rast, gjykata ka vendosur vetëm kthimin e detyrimit sipas kontratës dhe jo sekuestrimin e asetëve, duke e lënë kështu këtë subjekt të vazhdojë aktivitetin e tij. Për subjektin "SARA" sh.p.k ka vendosur zgjidhjen e kontratës së shitjes me rezervë, të sendeve të paluajtshme me nr.6741/1, datë 15.11.2017 dhe detyrimin e shoqërisë tregtare "SARA" sh.p.k. të kthejë sendin objekt kontrate. Pra sipas këtij vendimi gjykata ka vendosur të parashkruajë (të shuajë) detyrimin e pretenduar nga AZHBR prej 48,329,484.36 lekë dhe ka vendosur kthimin në AZHBRR të sendit (serave). Pra, duket qartë se gjykata ndryshe nga dy rastet e mësipërme, në këtë rast ka kërkuar sekuestrimin dhe kthimin e linjave apo serave, edhe pse kjo nuk është kërkuar nga vetë AZHBR.

Gjithashtu, për debitorët e linjave 2005-2009, të cilët kanë qenë subjekte të pajisur me NIPT pra të regjistruar në organin tatimor, u konstatua se ndër vite nuk kishte një bashkëpunim ndërmjet AZHBR dhe DPT, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, dhe më pas për subjektet aktivë në organin e tatimeve dhe debitorë në AZHBR, të hartonin për këtë periudhë planin i monitorimit dhe arkëtimit në bashkëpunim me MFE-në, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në kohë reale.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13. 1. Rekomandim: AZHBR, në bashkëpunim me MBZHR, të ngrenë komision të veçantë me specialistë të fushës që të ketë për objekt pune:

- "Analizimin e shkaqeve dhe arsyeve të krijimit të subjekteve debitorë, fermerë". Nëse arsyet e krijimit dhe rritjes së debitorëve kanë ardhur si pasojë e mos subvencionimit të in puteve bujqësore dhe karburantit si dhe të mungesës së lehtësirave tatimore nga organet shtetërore, të mundësohet një marrëveshje bashkëpunimi dhe mirë kuptimin me subjektet debitorë, apo të marrin iniciativën ligjore për iniciimin e një projektvendimi të Këshillit të Ministrave, për rishikimin dhe ristrukturimin e këtij borxhi, me qëllim nxitjen e aktivitetit dhe shmangien e falimentimit që mund të vijnë nga shlyerja e këtyre detyrimeve si pasojë e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.

- Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatave formës së prerë u kërkohej zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja e detyrimeve. Nëse kosto e sekuestrimit (çmontimit, transportit, ruajtjes etj) del më e lartë se përfitimi, AZHBR në mirëkuptim me këto subjekte të mundësojë një akt-marrëveshje, apo të marrin iniciativën ligjore për iniciimin e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave, me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit, stimulimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre për të shmangur falimentimit që mund të vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Menjëherë

13.2. Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me MBZHR dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe nisur nga statusi që subjektet debitorë, mund të kenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një plan bashkëpunimi për të gjithë debitorët dhe veçanërisht për debitorët e linjave 2005-2009, për verifikimin e statusit në sistemin tatimor dhe marrjen e menjëhershme të masave bllokuese për ata subjekte që figurojnë aktivë dhe që prodhojnë të ardhura dhe realizojnë fitime pikërisht prej makinerive të linjave 2005-2009, të financuara nga AZHBR.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

13.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën **2,058,454,729** lekë, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave të viteve 2005-2009, me një borxh të mbartur në vlerën **1,032,644,780 lekë që i përket** linjave të vitit 2005 dhe një vlerë prej **169,388,097 lekë** që i përket linjave të vitit 2009. Për këtë borxh të mbartur prej shumë vitesh i krijuar nga implementimi ish-Projekti 2KR (kredi pa interes që i ka dhënë Qeveria Japoneze Ministrisë së Bujqësisë për të ndihmuar fermerët shqiptar) AZHBR, ka hapur procese gjyqësore për 30 subjekte debitorë. Por, meqenëse se është konstatuar që ky fenomen është i përhapur në shumë fermerë, para se të hapeshin proceset gjyqësore, nga ish-Projekti 2KR dhe nga Ministria e Bujqësisë, duhet të analizonin shkaqet dhe arsyet objektive apo subjektive të krijimit të vështirësive financiare që i kanë detyruar këta fermerë të mos paguajnë këstet dhe kamatëvonesat sipas kontratave (shkaqet dhe arsyet, kanë të bëjnë me braktisjen e aktiviteteve nga vetë fermerët përfitues apo me mos subvencionimin e karburantit, in puteve bujqësore, mungesën e lehtësirave fiskale, etj).
(Trajtuar më hollësisht në faqet 132-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.3. Rekomandim: AZHBR dhe MBZHR , të ngrejnë grup pune të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **2,058,454,729** lekë, pasi nga ky veprim nuk është krijuar fondi kundërparti dhe për pasojë nuk është vazhduar me skemën e refinancimit në dobi të fermerëve të tjerë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE:



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, si dhe reflektimin e tyre me qëllim përmirësimin e punës dhe proceseve, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore si një ndër objektivat kryesore të këtij institucioni.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Nga **auditimi i pasqyrave financiare**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia e zhvillimit bujqësor dhe rural (AZHBR), të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënie opinionit të pakualifikuar.

Opinionin është i pakualifikuar



Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e ISSAI 1700⁷, dhe ISSAI 1200⁸, si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH-së, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural në datën 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018.

Opinion mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar. Auditimi i përputhshmërisë në AZHBR është kryer së bashku me pasqyrat financiare dhe audituesi nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale.

Opinion i pakualifikuar⁹

Nën gjykimin e grupit të auditimit, në lidhje me auditimin e përputhshmërisë shpreh një konkluzion/opinion pakualifikuar, ku në gjykimin profesional, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk kanë devijime materiale.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

⁷ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

⁸ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

⁹ Audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar-pa rezerve kur në gjykimin profesional të tij audituesi nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural"

Drejtimi i Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputshmërinë e aktivitetit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

VI. ANEKSE

Bashkelidhur këtij raporti

Përsa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



ANEKSI 1

SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me rezerve. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

1. Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI II

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet 600-601 dhe 2% për shpenzimet 602, niveli i precizionit pranohet në vlerën 6,728,702 lekë për vitin 2017 dhe 30,904,124 lekë për vitin 2018 ku nuk kanë investimet për skemat mbështetëse kombëtare, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizuar menaxhimi financiar dhe kontrolli); dhe
- teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
2017			
Paga (600)	108,407,000	0.7	16
Sigurime Shoqërore (601)	18,035,000	0.7	6
Mallra e Shërbime (602)	77,963,000	2	11
Investime të brenda. (230-231)	0	2	0
Te tjera transfer. korrente (606)	210,947,000	2	2
Total	415,352,000		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	8,307,040		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

<i>Kalkulimi i precizionit</i>	
Materialiteti	8,307,040
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	<i>830,704</i>
Nëntotali	7,476,336
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>
Vlera e precizionit	6,728,702

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
2018			
Paga (600)	103,216,000	0.7	12
Sigurime Shoqërore (601)	17,503,000	0.7	5
Mallra e Shërbime (602)	79,879,000	2	8
Investime të brend. (230-231)	47,044,000	2	1
Te tjera transfer. korrente (606)	1,660,020,000	2	64
Total	1,907,662,000		
<i>Materialiteti në %</i>	<i>2%</i>		
Materialiteti në vlerë	38,153,240		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	38,153,240		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	<i>3,815,324</i>		
Nëntotali	34,337,916		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>		
Vlera e precizionit	30,904,124		

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si "efektiv";
- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si "pjesërisht efektiv" ose "jo efektiv".

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2017, grupi i auditimit mori në shqyrtim disa çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë dhe kontabilizimin, mbi llogarinë (600 – 601), 602 dhe 230-231 (kjo reflektuar në letrat e punës, pjesë e dosjes së auditimit). Mbi verifikimin dhe rakordimin e gjendjeve të llogarive në fund të periudhës, grupi i auditimit analizoi dhe verifikoi ekzistencën, plotësinë, vlerësimin dhe alokimin e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrindësor dhe Rural"

Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2017-2018 (llogaria 600 dhe 601), u bazua në një minimum të çështjeve, meqenëse llogaritja e pagave dhe sigurimeve (llog 600 dhe 601) bëhet me sistemin online, ku mundësia për të bërë gabime në llogaritjen e shpenzimeve (600-601) është pothuajse 0. Minimumi i çështjeve që u vlerësuan për auditim duke marrë në konsideratë nivelin e riskut për këtë zë specifik shpenzimi, rezultoi 16 dhe 12 për 2018, nga ku grupi i auditimit për të rritur sigurinë e arsyeshme mori në shqyrtim më pak çështje (pagat e punonjësve të shtrira në muaj).

Për vitin 2017, duke qenë se, kontrollet e brendshme u vlerësuan të kenë risk në nivel të ulët, **grupi i auditimit mbuloi me auditim shpenzimet operative (llogaria 602)** duke shtuar vlerën e transaksioneve për tu audituar në 14, pra mbi minimumin e çështjeve prej 11 çështjesh të vlerësuar sipas analizës së riksut.

Për vitin 2018, duke qenë se, kontrollet e brendshme u vlerësuan të kenë risk në nivel të ulët **grupi i auditimit mbuloi me auditim shpenzimet operative (llogaria 602)** duke shtuar vlerën e transaksioneve për tu audituar në 24, pra mbi minimumin e çështjeve prej 8 çështjesh. Të vlerësuar sipas analizës së riksut.

Mbulimi me auditim i prokurimeve në lidhje me investimet (230-231), për vitin 2017 nuk ka pasur prokurime me vlere të madhe dhe investime,

Për vitin 2018, mbulimi me auditim i prokurimeve në lidhje me investimet (230-231) është 100%, pasi kemi të bëjmë vetem me rikonstruksionin e agropikave dhe mobilimin e tyre.

ANEKSI III :

AUDITIMI I DETYRIMEVE (Të tjera operacione me shtetin).

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogarite e marrëdhënies me shtetin (42 e 43).

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin debitor"

- llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor"

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin debitor" është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm këto) si; pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi te ardhurat, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Nëse veprimi kontabël:

- a. Është bërë gjatë konstatimit të shpenzimit veprimi;
 - debi llogarite respektive të klasës 6 "shpenzime korrente",
 - kredi llogarite e detyrimeve afat shkurtra për konstatimin e detyrimit (42,43,40, e tjera).
- b. Në fund të periudhës ushtrimore është bërë veprimi;
 - debi llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin debitor"
 - kredi llogari 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"
- c. Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës është bërë veprimi;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rrënor dhe Rural"

- debi llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4)
- kredi llogaria 520 "Disponibilitete në thesar".
- d. Paralel me veprimin e mësipërm nëse është artikuluar veprimi tjetër;
 - debi llogaria 476 "Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur"
 - kredi llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin debitor";

Llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor", është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuar e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.

Nëse veprimi kontabël;

- a. Është bërë konkretisht kur më parë ka ndodhur situata për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion);
 - debi llogaria 411/468, "klientë e llogari të ngjashme" apo "debitorë të ndryshëm",
 - kredi llogarite respektive të klasës 7, të ardhura të konstatuar.
- b. Kur e ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi;
 - debi llogaria 8424 "Transferim për debitorë të konstatuar të ngjashëm",
 - kredi llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor",
- c. Në momentin kur arkëtohet e ardhura është kryer veprimi;
 - debi llogaria 520 "Disponibilitete në thesar";
 - kredi llogaria 411/468, "klientë e llogari të ngjashme" apo "debitorë të ndryshëm",
- d. Me qenë se e drejta u arkëtuara dhe llogaria 520 është llogari e thesarit nëse në fund të periudhave përkatëse është bërë veprimi përkatës;
 - debi llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor",
 - kredi llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" (për mbylljen e kësaj pjese).

ANEKSI IV:

AUDITIMI I DETYRIMEVE

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogaria 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit".

Ky grup llogarish përfaqëson specifikat që shoqërojnë marrëdhëniet e institucioneve me njëra tjetrën dhe me të tjerë të tretë për xhirimet materiale në natyrë.

Nga pikëpamja e kontabilitetit institucionet e lidhura auditohen nëse përgjithësisht kanë përdorur skemën si me poshtë;

a. Institucioni dhënës i cili ka kryer blerjet mbi bazën e fondeve të akorduara sipas skemës së zakonshme të buxhetimit, përveç veprimeve që lidhen me blerjen e operacionet e tjera buxhetore, nëse i ka bërë hyrje materialet e blera.

- Debi llogaritë e klasës 3 në kredi të llogarisë 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit".

b. Institucioni dhënës për daljet pa pagesë që u bën njësisë vartëse apo të tretëve nëse;

- Krediton llogaritë përkatëse të klasës 3 me kundër parti debitin e llogarive të grupit 45

"Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit".



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Rural"

- c. Institucioni dhënës nëse ka mbyllur llogarinë 45 pas marrjes së konfirmimit nga institucioni përfitues dhe ka;
- debituar llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në kredi të grupit 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit".
- d. Institucioni marrës i këtyre vlerave nëse i ka bërë hyrje ato duhet të;
- debitorë llogarite përkatëse të klasës 3 me kundër parti kreditimin e llogarisë së grupit 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda e jashtë sistemit".
- e. Institucioni marrës nëse e ka mbyllur llogarinë 45 "marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit" me dërgimin e konfirmimit në institucionin dhënës dhe të debitorë këtë llogari në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".
- f. Llogaria 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit" në fund të periudhës ushtrimor duhet të rakordohet dhe, si rregull, duhet të jetë e mbyllur.

Llogaria 466 "Kreditorë për Mjete në ruajtje".

Është llogari specifike në sektorin publik.

Në kredi të saj regjistrohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve të cilat në një periudhë tjetër do t'u kthehen nga kjo llogari të tretëve.

Të tilla mund të jenë:

- mjetet e xhiruara për llogari të zyrës së përmbartimit,
- paradhëniet e paguara nga të tretet për pjesëmarrje në ankande,
- garancitë bankare të ndryshme,
- të hyra për llogari të komisionit të kthimit e kompensimit të pronave,
- derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen,
- depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër,
- rimbursimi i tvsh nga llogaria e tatimeve,
- etj.

Llogaria 476 "Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur", përdoret si llogari kalkulative gjatë vitit ushtrimor.

Veprimet e mundshme në kontabilitet me këtë llogari janë;

- Debi llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" në kredi të llogarisë 476, për akordimin e fondeve buxhetore.
- Debi llogaria 476 (ose kredi me stornim) në kredi të llogarisë 520 (ose debi me stornim) për fondet buxhetore të pa përdorura në fund të periudhës ushtrimore dhe që nuk trashëgohen për vitin e ardhshëm.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 105, "Grante të brendshme kapitale" apo në kredi të llogarisë 720 "Grante korrente të përgjithshme" lidhur me përdorimet e këtyre fondeve respektivisht për investime e për shpenzime funksionimi.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 4342, paralel me pagesën e bërë për shlyerje detyrimesh të vitit të mëparshëm me fondet e akorduara të vitit ushtrimor.

Llogaria 481 "Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime", karakteristike kryesisht për institucionet e vetëqeverisjes vendore. Është llogari rregulluese ku përfshihen shpenzimet e kryera për riparimet e mëdha, shpenzimet për punime parapërgatitore të një lloji veprimtarie, shpenzime të kryera gjatë vitit ushtrimor (që nuk përfshihen në aktivet e qëndrueshme dhe nuk



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në "Agjencinë e Zhvillimit Bujëor dhe Rural"

mund të rëndohen tërësisht në rezultatin e ushtrimit). Këto shpenzime shpërndahen (amortizohen) në vitet e ardhshme.

Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*". Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një ushtrim të ardhshëm (*shpenzime të parapaguara*), si p.sh. qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara avancë, e tjera.

Llogaria 475 "*Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse*" e cila hyn në grupin e llogarive rregulluese. Sipas rastit të çdo institucioni evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.

Llogaria 478 "*Diferenca konvertimi -pasive*" pasqyron diferencat pasive që lidhen me konvertimet që rezultojnë nga vlerësimi me kurset e këmbimit në mbyllje të ushtrimit (*të kërkesave debitoare dhe detyrimeve*) të shprehura në monedha të huaja.

Llogaria 480 "*Të ardhura për t'u klasifikuar ose për tu rregulluar*" pasqyron të ardhura të arkëtuara, por me dokumentacion të pa plotësuar ose të paqartë deri në datën e mbylljes së bilancit kontabël të institucionit. Teprica kreditore e kësaj llogarie kërkon sqarime në të dhënat shpjeguese.

Llogaria 487 "*Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së urdhrit*" regjistron të ardhurat e arkëtuara, të cilat ekzistojnë në institucion të derdhura por nuk është marrë konfirmim nga Thesari deri në fund të periudhës ushtrimore.